monumentet



DO NOT COPY

2 / 1988

DO NOT COPY

Kopertina e parë

Kalaja e Bashtovës e shek. XV.

KOMITETI I KULTURËS DHE I ARTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

2/1988 (36)

KOLEGJIUMI I REDAKSISE

EMIN RIZA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZV/KRYEREDAKTOR)
ALEKSANDËR MEKSI, GJERAK KARAISKAJ, GJERGJ FRASHËRI, HASAN NALLBANI
NERITAN CEKA, PIRRO THOMO.

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
Pranë Komitetit të Kulturës dhe Arteve

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7.

Tirazhi: 353 kopje

Formati 70 x 100/12

Stash: 2204-8

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja «MIHAL DURI» – Tiranë, 1989

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

		Faqe
Sotir KOSTA	Mbrojtja, studimi dhe restaurimi i monumenteve të kulturës në Shqipëri	7
Aleksandër MEKSI *Hasan NALLBANI* *Fevziye Hayri OSMANOGLU*	Kritere për restaurimin e monumenteve të arkitekturës dhe të artit	19
Cevat ERDER	Programi i sektorit të pasurisë kulturore të UNESCO-S për mbrojtjen e vlerësimin e monumenteve.	23
	Veprimtaria e Qendrës Ndërkombëtare për Ruajtjen dhe Restaurimin e Pasurisë Kulturore (ICCROM).	27
Stavros BALTOJANNIS	Restaurimi estetik i veprave të artit	31
Guri PANI *Koço ZHEKU* *Lazër PAPAJANI* *Emin RIZA* *Neritan ÇEKA*	Restaurimi i monumenteve antike në vendin tonë	37
Apollon BAÇE	Qytetet-muze dhe vendi i tyre në jetën e sotme.	41
	Bylisi dhe etapat e zhvillimit urban në bashkësinë e bylinëve	47
Genc HAJDARI	Studim mbi zonifikimin arkeologjik të qytetit të Durrësit	55
	Varret monumentale të Selcës, probleme të konservimit	61
Gjergj FRASHËRI	Bashkëpunimi më i ngushtë arkeolog-restaurator, garanci për arritjen e niveleve më të larta në konservimin e mjediseve arkeologjike	67
Gjerak KARAISKAJ *Aleksandër MEKSI*	Fillimet e fortifikimeve për artileri në Shqipëri	71
	Ndërtimet e kultit të shek. VII-XV, aspekte të arkitekturës dhe restaurimit të tyre	75
Hasan NALLBANI *Vangjush GOLLOSHI* *Marita BECI* *Dhorka DHAMO* *Fatmir THAÇI* *Adrian DEVOLLI* *Mustafa ARAPI* *Odise CURRI* *Skënder MIHALÇKA* *Marita BECI*	Restaurimi dhe konservimi i pikturës murore	79
	Të dhëna të reja të përftuara nga studimi radiologjik i pikturës së kavaletit	83
	Piktura mesjetare e Beratit	89
	Probleme të restaurimit të disa ikonave	97
	Ecuri në ruajtjen dhe restaurimin e mozaikëve.	103
	Rezultate të ekzaminimit dhe të punimeve restauruese në pikturën murore të Manastirit të Ardenicës gjatë viteve 1984-1985	107
Latif LAZIMI *Pirro THOMO*	Përshtatja e monumenteve për qëllime shoqërore.	111
	Tiparet e arkitekturës popullore të gjysmës së dytë të shek. XIX – fillimit të shek. XX. Probleme të gjurmimit të saj	117
Genc SAMIMI	Restaurimi i ansambleve arkitektonike në zonën-muze të qytetit të Beratit	123
Shpresa PRIFTI	Ndihmesa e punimeve restauruese për studimin e banesave shkodrane	129
Leonard SULI *Valter SHTYLLA*	Banesa popullore e rrethit të Sarandës (shek. XV-XX).	135
	Ndërtimet shqiptare të rrugëve dhe urave gjatë shekujve XV – XIX	143
Ali MUKA	Mbi oborrin e banesës fshatare në disa zona malore të Shqipërisë së Mesme (shek. XIX-XX).	149
Izmini HAXHIU	Banesat historike vatra të rëndësishme gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe veprimtarisë revolucionare të shokut. Enver Hoxha	155
Kliti KALLAMATA *Fatbardha SHKUPI*	Mbi restaurimin e pazarit të Korçës	159
	Tiparet e zbukurimores nga shek. XVII deri në fillim të shek. XX në Shqipëri	163
Servet DANI *Marita BECI* *Gjergj SARAÇI*	Metoda e analizës së veprave të artit nëpërmjet rrezatimit X të fluoreshencës	169
	Mbi disa tipare të fortifikimeve ilire të shekujve IV-III p.e.sonë	173
Sokol AGOLLI	Roli dhe interesimi i shtetit në mbrojtje të monumenteve të kulturës nëpërmjet normave ligjore	177
Vera BUSHATI	Disa tendenca të arkitekturës shqiptare gjatë periudhës 1912–1944.	181

TABLE DE MATIERE

ARTIC
P

Sotir KOSTA	La protection, l'étude et la restauration des monuments historiques en Albanie	
Aleksandër MEKSI *Hasan NALLBANI* *Fevziye Hayri OSMANOGLU*	Les critères et les principes de base à la restauration des monuments	
	Le programme de la division du patrimoine culturel à l'unesco pour la préservation et la mise en valeur des monuments	
Cevat ERDER	What is ICCROM	
Stavros BALTOJANNIS	La restauration esthétique des oeuvres d'art	
Guri PANI, Koço ZHEKU	Restauration des monuments de l'architecture antique	
Lazër PAPAJANI *Emin RIZA*	Les villes-musées et la place qu'elles occupent dans la vie actuelle	
Neritan CEKA	Bylis et les étapes du développement urbain dans la communauté des bulins	
Apollon BAÇE	Étude sur la définition de la zone archéologique de la ville de Durrës	
Genc HAJDARI	Les tombes monumentales de Selce, problèmes de conservation	
Gjergj FRASHËRI	L'étroite collaboration archéologue-restaurateur, une garantie pour atteindre les plus hauts niveaux de la conservation des milieux archéologiques	
Gjerak KARAISKAJ	Les premières fortifications destinées à la défense contre l'artillerie en Albanie	
Aleksandër MEKSI	Constructions de culte de VIIIe Au XVe siècles, aspects de leur architecture et leur restauration	
Hasan NALLBANI *Vangjush GOLLOSHI* *Marita BECI* *Dhorka DHAMO Fatmir THAÇI* *Adrian DEVOLLI* *Mustafa ARAPI* *Odise CURRI*	Restauration et conservation des fresques	
	Nouvelles données obtenues par l'étude radiologique des peintures de chevalet	
	La peinture médiévale de la ville de Berat. Des problèmes posés par la restauration de quelques icônes	1
	Problèmes de restauration des anciennes mosaïques de notre pays	1
Skënder MIHALÇKA *Marita BECI*	Quelques résultats de l'examen et des travaux de conservation de la peinture mural du monastère d'Ardenice aux cours des deux années 1984-1985.	1
Latif LAZIMI	L'adaptation des monuments à des fins sociaux – culturels	1
Pirro THOMO	Traits de l'architecture populaire au cours de la deuxième moitié du XIXe sc. et du début du XXe sc. et les problèmes sur sa recherche	1
Genc SAMIMI	Restauration des ensembles architectoniques dans la zone-musée de Berat	1
Shpresa PRIFTI	Contribution des travaux de restauration à l'étude de l'habitation de Shkodra	1
Leonard SULI	L'habitation populaire de la région de Saranda aux XV – XXe siècles	1
Valter SHTYLLA	La construction des routes et des ponts albanais au cours des XV-XIXe siècles	1
Ali MUKA	La cour de l'habitation rurale dans quelques régions montagneuses de l'Albanie centrale (XIX-XXe sc.).	1
Izmini HAXHIU	Foyers importants pendant la lutte de libération nationale et l'activité révolutionnaire du camarade Enver Hoxha	1
Kliti KALLAMATA *Fatbardha SHKUPI*	Sur la restauration du bazar de Korça	1
	Les traits de la décoration du XVIIe sc. jusqu'au début du XXe sc. en Albanie	1
Servat DANI *Marita BECI* *Gjergj SARAÇI*	Quelques applications de l'analyse aux rayons X dans le domaine de la conservation des oeuvres d'art.	1
Sokol AGOLLI	Sur quelques traits des fortifications illyriennes des IV-IIIe sc. av. n.è.	1
Vera BUSHATI	Le rôle et l'intérêt que l'État porte à la protection des monuments culturels par des normes loyales.	17
	Quelques tendences de l'architecture albanaise au cours des années 1912-1944	18

DO NOT COPY

Ky numër i revistës «Monumentet» përmban materialet e simpoziumit «Mbrojtja, studimi dhe restaurimi i monumenteve të kulturës në Shqipëri».

Materialet botohen në formën që u mbajtën. Nuk përfshihen kumtesat e Prof.Dr. N.C. Moutsopoulos, Prof.Dr. G. Kochut, S. Dashit, si dhe diskutimet e R. Gegës dhe M. Zeqos, të cilat janë botuar në formë artikujsh në numrat e mëparshëm të kësaj reviste.

Ce numéro de la revue «Monumentet» publie les matériaux du symposium «La protection, l'étude et la restauration des monuments historiques en Albanie».

Les matériaux sont publiés tels qu'ils sont présentés au symposium. Sont exclus les communications de Prof.Dr. N.C. Moutsopoulos, de Prof. Dr. G. Koch,de S. Dashi ainsi que les discussions de R. Gega et M. Zeqo, lesquelles sont publiées comme articles dans les précédents numéros de cette revue.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Sotir KOSTA

MBROJTJA, STUDIMI DHE RESTAURIMI I MONUMENTEVE TË KULTURËS NË SHQIPËRI

Mbrojtja, studimi dhe restaurimi i monumenteve është një dukuri relativisht e re në jetën tonë kulturore, e cila lidhet tërësisht me vitet e socializmit. Monumentet e kulturës me vlerën e tyre të dyfishtë, si dëshmi historike dhe vepra arti, përbëjnë krijime në të cilat mund të ndiqet në vijueshmëri gjenia krijuese e popullit tonë në shekuj, historia e tij. Kujdesi i shtetit tonë socialist për trashëgiminë pozitive të së kaluarës në përgjithësi dhe atë të arkitekturës dhe artit në veçanti është në antitezë me shkujdesjen dhe mospërfilljen e hapur të regjimeve të së kaluarës për këto vlera të pazëvendësueshme.

Udhëheqësi dhe mësuesi ynë i paharruar shoku Enver Hoxha lidhur me trashëgiminë kulturore ka nënvizuar: «... objektet që dokumentojnë kulturën e popullit japin shumë bukë, ato përbëjnë një thesar me vlerë për kombin, prandaj duhet të ruhen me kujdesin më të madh ...» (E. Hoxha, Raporte – fjalime 1976 – 77, f. 329, Tiranë, 1980).

Ky vlerësim sintetizues i pasurisë sonë kulturore ka shërbyer si mbështetje themelore për mbarë orientimet e punës me monumentet, me pikësynim për të kërkuar, studiuar e mbrojtur gjurmët e zhvillimit të mendimit e veprimit krijues të popullit gjatë rrjedhës së historisë së tij.

Puna komplekse me monumentet ka arritur, në mënyrë të veçantë këto vitet e fundit, një nivel më të lartë mbi bazën e rritjes së përvojës dhe ngritjes së shkallës së kompetencës së disiplinës shkencore. Ajo ka fituar një varg tiparesh thelbësisht të reja, të cilat janë rrjedhojë e kushteve të krijuara në sajë të kujdesit të veçantë të Partisë, së klasës punëtore e të shtetit tonë socialist.

Sot ne vimë në këtë simpozium të parë mbi problemet e studimit, mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve tona, pas katër sesionesh shkencore me ndjenja të thella të përgjegjësisë shkencore e qytetare dhe me kënaqësi vemë re një sërë arritjesh të reja e të rëndësishme në veprimtarinë komplekse për vlerësimin e kësaj pasurie të pazëvendësueshme për sot e për të ardhmen.

Në sajë të një pune të gjerë gjurmuese, që zhvillohet prej vitesh në të katër anët e vendit, janë vënë në mbrojtje shtetërore mbi njëmijë monumente të kategorisë së parë, nga të gjitha gjinitë e krijimit arkitekturor e artistik, që prej muzgut të historisë së etnosit tonë, deri në ditët tona. Ruajtja e vlerave komplekse të Beratit e Gjirokastrës me cilësinë e «qytetit-muze», të «zonave-muze» në Shkodër, Korçë, Elbasan, Krujë, Tiranë e Vlorë, të qendrave arkeologjike Butrint, Apoloni, Bylis, Zgërdhesh, Finiq, Antigone, Durrës etj, janë dëshmi e kushteve e kujdesit dhe e nivelit të mendimit tonë shkencor për ruajtjen e traditës në kontekstin e jetës sonë socialiste.

Pas një pune të madhe gjurmuese disavjeçare, zgjedhja e ndërtimeve qytetare dhe fshatare më përfaqësuese dhe më të shquara, brenda kuadrit të lidhjeve logjike funksionale me krijime të tjera popullore, si në qytet e në fshat, krijimet e bukura në artet e aplikuara, skulptura në gur e dru, piktura murore, të kavaletit, mozaik etj, e ka shtuar ndjeshëm thesarin tonë kulturor.

Krahas veprimtarisë gjurmuese, ndërkohë janë arritur përfundime të rëndësishme në dokumentacionin e monumenteve në të tri llojet e tij: grafik, fotografik dhe përshkrimor.

Si një arritje e rëndësishme në fushën e mbrojtjes së monumenteve duhet mbajtur edhe hartimi i legjislacionit përkatës, lidhur me rregullimin ligjor të problematikës që lind jeta e përditshme në këtë fushë. Legjislacioni ynë, tashmë i verifikuar nga praktika disavjeçare, ka treguar se e mbulon mjaft mirë mbarë problematikën e vlerësimit të monumenteve. Është de-

tyrë e organizmave të Institutit dhe të pushtetit tonë popullor të bëjnë këtë mbrojtje të ligjit sa më efikase.

Ndërhyrjet restauruese në monumentet kanë ardhur përherë në rritje si numër e në thellim. Mjafton të përmendim se gjatë pesë vjetëve të fundit, brenda çdo viti, janë bërë ndërhyrje në rreth 200 monumente të të dy kategorive, me punime restauruese dhe konservuese, duke harxhuar për këtë qëllim shuma të konsiderueshme, duke angazhuar kuadër të kualifikuar, mjeshtra e punëtorë si dhe materiale të shumta, mjete teknike e transporti. Në të katër anët e vendit, gjatë gjithë vitit nuk rresht puna sistematike për restaurimin e monumenteve nga organizma të specializuara, me personel të përhershëm, në vartësi të Institutit tonë, i cili është i vetmi institucion i autorizuar për këtë punë.

Në tërësinë e përkujdesjeve për ruajtjen dhe vlerësimin e pasurisë sonë kulturore në fushën e arkitekturës dhe artit, veprimtaria në disa hallka, me kohë ka ardhur duke u zbehur, ndërsa në disa të tjera ajo është dendësuar, duke tërhequr forcat kryesore shkencore. Kështu, ndërsa veprimtaria në fushën e gjurmimit, vënies në mbrojtje e të legjislacionit, për arsye të kuptueshme, ka pësuar ulje të intensitetit, ajo në fushën e ndërhyrjeve restauruese ka mbetur një konstante e pandryshueshme përsa i përket përkujdesjes, por ka pësuar rritje të vazhdueshme përsa i përket shkallës së gjerësisë dhe thellësisë së ndërhyrjeve.

Vlera e monumentit të kulturës në vështrim historik e shoqëror në mbarë shfaqjet e tij, në hapësirë dhe kohë, si pjesë e pasurisë sonë kulturore kërkon atë mbrojtje, atë përkujdesje të veçantë e të kualifikuar, e cila përmblidhet me termin «restaurim», si hallka e fundit e atij procesi që fillon me gjurmimin, dokumentimin dhe studimin e monumentit në mbarë shfaqjet e tij.

Përvoja e derisotme e kërkimeve sistematike për vlerësimin e monumenteve të arkitekturës dhe artit është kristalizuar në disa parime bazë, dhe më tej në metodën e studimit të tij në plan kompozicional, estetik dhe teknik në përgjithësi. Në kuadrin e këtyre arritjeve restaurimi ka hyrë në jetën e monumentit si domosdoshmëri, me mision kryesor evidentimin dhe ruajtjen e vlerave autentike, në kuadrin e një disipline të mirëfilltë shkencore.

Pikërisht për këtë arsye kërkimet në fushën e arkitekturës e të artit kanë qenë gjithmonë në qendër të vëmëndjes sonë, si bazë e domosdoshme për restaurime të shëndosha, por pa harruar njëkohësisht se ato kanë një vlerë intrinseke në disiplinat përkatëse. Qëndrimi ndaj monumenteve, problemi i raportit të vlerave të mirëfillta me ato të dyshimta në aspektin e qëndrimit restaurues, përcaktimi i metodave e kritereve të ndërhyrjeve me karakter teorik e praktik, kontributi i biografisë së monumentit në historinë e arkitekturës e artit, janë probleme bazë të punës sonë q vënë në lëvizje mendimin e veprimin tonë krijues teknik e shkencor.

Zbulimi i rrugëve dhe mjeteve për të siguru qëndrueshmërinë teknike dhe vlerat estetike të monumentit, çështja e marrëdhënieve të tij me monumente të tjera të të njëjtit stil, ose të së njëjtës epok qëndrimi ndaj monumentit pas restaurimit, vendi q i përket atij në jetën e sotme, janë gjithashtu pr bleme të rëndësishme që lidhen me mbarë veprimt rinë tonë kërkimore restauruese me monumentet. P çelësi i këtyre kërkimeve është pa dyshim zbulimi dh nxjerrja në pah e vlerave të monumentit. Veprimtar për ruajtjen e tij me një shtrirje të gjerë problemo përfshin patjetër edhe përpjekjet për forcimin përh rë e më të madh të rolit edukues e njohës të këty vlerave në kuadrin e trashëgimisë sonë kulturor Duke vështruar çështjen e monumenteve mbi kë baza, misioni i specialistëve në këto fusha mbetet s i rëndësishëm teorikisht, aq edhe dobiprurës për t'i përgjigjur kërkesave gjithnjë në rritje, për të hyrë r thellësinë e jetës së shekujve dhe për t'i ruajtur a për të ardhmen.

Monumentet e kulturës, duke filluar nga a mbi tokë e deri tek ata që dalin nga gërmimet arke logjike ashtu si burimet e shkruara, ose të gjalla, p gjuhën, zakonet, veshjet etj, janë dëshmi që flasi për prejardhjen e lashtë dhe vazhdimësinë etniko-ku turore të popullit tonë, janë fakte të gjalla që dë shmojnë për identitetin tonë kombëtar. Shkenca jon shqiptare si dhe studiues të huaj objektivë kanë dhë në tashmë një kontribut të rëndësishëm shkencor, n të cilin rreshtohet edhe kontributi modest i punës s bërë nga punonjësit tanë, me studimet e tyre në fu shën e monumenteve.

Gjallërimi i punës edukative me njerëzit, rritja interesit të tyre për njohjen e historisë sonë dhe t monumenteve të saj është faktor me rëndësi për t siguruar ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore. «T edukojmë njerëzit – theksonte shoku Enver, – me kët kujdes, sepse ky është një mjet për të çelnikosur do shurinë e popullit për atdheun e tij, për «gurët e tho të», që thotë populli, për kalatë ku është derdh gjaku i tij. Kur t'i shpjegohen mirë popullit këto gjër atij do t'i hyjë medoemos dashuria për to». (E. Hoxh Vep. 12. f. 303-304).

Njohja e studimi i monumenteve tona në lidhj të fuqishme me mbarë zhvillimin kulturor e artistik t vendit, ka krijuar klimë të shëndetshme jo vetëm pë të rritur ndjenjën e krenarisë kombëtare, por dhe

DOKUMENT

DOKTORI

mbështetje për krijime të reja më të bukura dhe më të frymëzuara për të sotmen dhe të ardhmen.

Restaurimi i monumenteve të kulturës, veçanërisht këto vitet e fundit, mbi bazën e përvojës së fituar dhe rritjes së kualifikimit të mëtejshëm të kuadrit restaurator të të gjitha niveleve, ka pësuar një rritje të ndjeshme. Kjo rritje lidhet në radhë të parë me kuptimin dhe konceptimin e gjerë kulturor të kësaj veprimtarie, me saktësimin e rrugës metodike të ndërhyrjeve restauruese dhe me kristalizimin e fazave të domosdoshme, që sigurojnë nivelin e kënaqshëm shkencor të këtyre ndërhyrjeve.

Në procesin e gjerë kërkimor në fushën e monumenteve ka qenë kurdoherë i pranishëm mendimi teorik i shokut Enver Hoxha, vepra e tij e madhërishme që orienton shkencërisht drejtimet thelbësore të vlerësimit objektiv të traditës. Në vepra të tilla si «Vite të vegjëlisë», «Mes njerëzve të thjeshtë», studiuesit tanë gjejnë shkallën e vlerësimit më të lartë, por edhe mendimin e gjerë sintetizues për trashëgiminë tonë kulturore që e ka burimin në kuptimin e thellë marksist-leninist të dukurive dhe problemeve.

Restaurimi është konsideruar si një proces që përfshin disa faza, të cilat, duke u kryer me metodikën dhe kompetencën e duhur, kanë siguruar përfundime të kënaqshme në ruajtjen e vërtetësisë së monumentit në aspektin strukturor, kompozicional dhe estetik të tij. Studimi i gjithanshëm i monumentit, hartimi i projektit të restaurimit, zbatimi i punimeve dhe botimi i përfundimeve të arritura, shënon ato hallka të domosdoshme pa të cilat nuk do të ishin siguruar asnjë nga ato përfundime të kënaqshme që shihen në veprimtarinë restauruese.

Monumenti bart përgjithësisht një histori të gjatë, me transformime nga faza origjinale, transformime ku shfaqen vlera të epokave të veçanta, po shpesh edhe me dëmtime të shkallëve të ndryshme. Pikërisht në sqarimin e këtyre problemeve ka synuar edhe studimi paraprirës dhe i pandërprerë i monumenteve që u janë nënshtruar ndërhyrjeve restauruese, studim, i cili në përgjithësi është nisur nga monumente të veçanta, pa përjashtuar edhe studime përgjithësuese mbi bazë tipologjike apo rajonale. Natyrisht, të dyja format kanë ndikuar në mënyrë të ndërvarur mbi njëra-tjetrën, duke qenë studimi individual i monumentit një kusht i pashmangshëm. Raportet midis studimeve për gjini të ndryshme monumentesh kanë qenë të ndryshme. Kështu, atje ku tipologjia ka qenë më e njësuar studimet përgjithësuese tipologjike kanë përbërë një bazë me vlera të mëdha për qartësimin e studimit individual të monumentit, siç ka ndodhur për ndërtimet popullore, ku studimet tipologjike-morfologjike kanë qenë gjithmonë një bazë e shëndoshë për studimin e sqarimin individual të monumentit. Përkundrazi, në monumentet që i përkasin gjinisë së ndërtimeve mbrojtëse, atyre të kultit dhe veprave të artit, studimi individual i monumentit, me përjashtime të rralla, ka paraqitur thuajse gjithmonë parësi. Studimet tipologjike për banesën popullore fshatare e qytetare, studimet individuale të thelluara për kalanë e Shkodrës, Beratit, Gjirokastrës, Krujës, për kishën e Mesopotamit, manastirin e Ardenicës, për urat mesjetare, afresket e kishës së Mborjes, kishave të kalasë së Beratit, një sërë mozaikësh, ikonash e varret monumentale të Selcës, kanë ndikuar për orientimin e drejtë të ndërhyrjeve restauruese.

Në procesin e punës restauruese hartimi i projektit të restaurimit, në bazën e tij ka pasur studimin e gjendjes së monumentit dhe kriteret e ndërhyrjeve, duke iu përmbajtur fort parimit se monumenti vjen si dëshmi me vlera të papërsëritshme historiko-artistike, pra si dokument historik dhe vepër arti, që përjashton si i tillë çdo ndërhyrje tjetërsuese. Duke u mbështetur në këtë parim themelor, ruajtja e fazave të ndërtimit si dëshmi e kontributeve të epokave të ndryshme historike, konservimi, i kuptuar si tërësia e ndërhyrjeve të vazhdueshme mirëmbajtëse, për të siguruar sa pari qëndrueshmërinë e monumentit, çlirimi nga shtesa pa kriter që kanë dëmtuar vlerat unikale, si dhe përforcimi i strukturave apo elementeve, duke mos parapëlqyer rindërtimin, kanë qenë disa nga kriteret bazë, udhëheqëse në punën me monumentet. Nese në shumicën e parimeve të sipërpërmendura qëndrimet kanë qenë të qarta e të respektuara thuajse rigorozisht, qëndrimi karshi strukturave statike të dëmtuara rëndë, nuk ka qenë gjithmonë në lartësinë e kërkesave metodike. Veçanërisht kjo është vërejtur në gjininë e ndërtimeve popullore, monumentet e së cilës për vetë funksionin e tyre dhe ndërtimin me materiale e struktura të brishta prej druri, qerpiçi dhe teknika jo të qëndrueshme, shpesh kanë arritur deri në ditët tona në degradime të rënda, të cilat, në kushtet e sotme, praktikisht është e pamundur të konsolidohen pa iu drejtuar procesit të rindërtimit. Por forcat dhe dijet tona janë përqendruar në të mirë të mënjanimit përherë e më të madh të ndërhyrjeve rindërtuese të strukturave në prag të rrënimit. Shkalla e ndërhyrjeve për të siguruar qëndrueshmërinë e strukturave origjinale apo të gjurmëve të rralla, por tepër të vlefshme të elementeve të ndryshme të monumentit, përbën një problem të veçantë dhe të diskutueshëm. Kriteri i çuarjes së punimeve deri në një shkallë sa të sigurohet qëndrueshmëria e monumentit dhe ruajtja e gjurmës origjinale, është synuar të mos shkelet me justifikimin e të ashtuquajturës «përpjekje për lexueshmërinë e monumentit» dhe rolit didaktik të tij. Në

DOKTORATURA

këtë çështje, shtrirja e arsyetimit për monumentet e artit apo të atyre të arkitekturës, ku është e pranishme vepra e artit, merr përmasa të tjera, që domosdo nuk dalin nga kufiri i kriterit që përmendëm. Ndërhyrjet e thella restauruese në kishat e shën Todrit, apo Shën Vllahernës në kala të Beratit, sidomos në strukturën konstruktive të tyre me përforcime të maskuara, duke ruajtur rigorozisht pikturën murore, zbatimi i parimit të anastilozës në disa monumente artike (Agonotetët – Apoloni, në kala të Lezhës, Zgërdhesh, Bylis, Butrint etj.) tregojnë për mundësi të mëdha në ruajtjen e vlerave origjinale. Nuk është përjashtuar edhe praktika e zhvendosjes dhe rivendosjes, sidomos në fushën e veprës së artit (pikturë murore, mozaik, skulpturë e aplikuar), e cila është kryer pa tjetërsimin e veprës, por me ndërhyrje në strukturën mbajtëse të saj, për ta ndërprerë dëmtimin e mëtejshëm.

Veçanërisht, vitet e fundit ka pasur një dendësim të ndërhyrjeve në veprat e artit, pjesë e monumenteve të arkitekturës. Në pikturën murore është punuar gjerë për konsolidimin, pastrimin si dhe në procese më të ndërlikuara për të siguruar mosdëmtimin e mëtejshëm të saj. Punimet në kishat e Beratit, Mborjes, Voskopojës etj, kanë qenë me përfundime të mira. Ndërhyrje të gjera janë bërë edhe në fondin e madh të ikonave. Krahas është punuar mirë në gjininë e mozaikëve, me ndërhyrje që prej konsolidimeve e deri te zhvendosja e mozaikut në rastet e dëmtimeve të rënda. Kështu është ndërhyrë në mozaikët e Pojanit, Antigonesë, Linit, Mesaplikut etj. Si një fillim premtues duhen mbajtur ndërhyrjet në veprat e artit në dru dhe në gurë, të cilat do të zgjerohen në të ardhmen.

Për arritjen e përfundimeve të kënaqshme në punën studimore restauruese, siç tregon përvoja jonë 20-vjeçare ka ndikuar edhe forma e mirë organizative e drejtimit të kësaj veprimtarie. Struktura organizative me Institutin dhe një sërë degësh e ateljesh të varura prej tij në qytete të ndryshme të vendit, që mbulojnë mbarë monumentet, është treguar efikase. Për t'u theksuar është arritja në krijimin e hallkave të shkallëzuara të kompetencës dhe përgjegjësisë për problemet e përcaktimit të radhës dhe shkallës së ndërhyrjes në monumentet. Sektorët e Institutit që mbulojnë gjini të ndryshme monumentesh, përbëjnë bërthamat themelore shkencore ku hartohen studimet dhe projektet e restaurimit. Këto të fundit, sipas rëndësisë, gjejnë miratim në sektorë, komisionet e restaurimit të veprave të artit apo arkitekturës, si dhe në këshillin shkencor të Institutit. Vlerat e rëndësishme që na janë besuar për t'i ruajtur dhe vlerësuar e kanë bërë të domosdoshme që pa përjashtuar përgjegjësinë personale të autorit të projektit, ajo të sho rohet me diskutime e rrahje mendimesh kolektive shkallë të ndryshme, për të mënjanuar gabime mundshme, shpesh të pakorrigjueshme. Hartimi aprovimi i «Kritereve për restaurimin e monumen kulturore të arkitekturës dhe të artit» përbën një tje të rëndësishme të punës sonë, e cila do të n mojë për thellimin e kërkesave ndaj ndërhyrjeve monument.

Studimi për veprat ndërtimore dhe të artit, thelb i përket disiplinës së historisë së arkitekt dhe artit, natyrisht me një orientim të veçantë. vetë puna studimore për nevojat e restaurimit dhënë një ndihmesë veçanërisht të vlefshme e për lëvrimin e historisë së arkitekturës shqiptare, të dhëna mbi tipologjinë dhe morfologjinë e gji të ndryshme të monumenteve, mbi teknikën e n timit, duke u nisur nga studime mbi monumente veçanta në aspektet historiko-arkitektonike. Është qartë se me këtë nuk mund të zgjidhen gjithë det në këtë fushë si për nga shtrirja, e cila përfs ndërtimet që prej prehistorisë e deri në ditët t ashtu si dhe nga metoda dhe thellësia, është i m dur, madje kërkohet një zgjerim i ndjeshëm në ardhmen. Hartimi i maketit të «Historisë së arkitek rës shqiptare nga fillimet deri në vitin 1912», bo i një sërë monografish, i artikujve shkencorë në vistën «Monumentet» etj, flasin për domosdoshmë e ndërlidhjeve të ngushta ndërmjet disiplinave të storisë së arkitekturës dhe artit me restaurimin. monumentet e artit, nga specifika e tyre dhe përv relativisht e re, arritjet në fushën e studimit të tyre për sot janë modeste.

Kërkimet në fushën e arkitekturës e të artit k qenë pa dyshim në përgjithësi orientuese e njëhe konkrete në dy procese: në anë të zgjedhjes së rave për t'u vënë në mbrojtje dhe në vetë procesi ndërhyrjeve restauruese. Shembujt e ndërhyrjeve arritura në sajë të njohjes së mirë të historisë së kitekturës shqiptare në përgjithësi, të gjinive të çanta të monumenteve dhe më tej të historikut të v monumentit, janë vërtet të shumta në praktikën r tauruese. Në bashkëmarrëdhënie e dy disiplinave stori e arkitekturës – restaurim, historia e arkitektu nuk ka qenë vetëm dhënëse, duke shërbyer si m shtetje për ndërhyrje të drejta restauruese, por shumë shembuj, ndërhyrjet restauruese kanë prurë reja të rëndësishme për jetën e monumentit të veça e për pasojë për mbarë gjininë, ku ai bën pjesë. përfundime pozitive kanë qenë veçanërisht ndërhy në fazën e hapjes së punimeve restauruese në mo ment. Punimet e çlirimit, sondazhet dhe vrojtimet

thella në monument, të cilat i mundëson procesi i punës restauruese, kanë prurë dëshmi me vlera të një rëndësie të veçantë, të cilat nuk mund të arriheshin as nga syri i një specialisti tepër të kualifikuar. Kjo dukuri e rëndësishme, e cila presupozon njohuri të mira të restauratorit nga fusha e historisë së arkitekturës, për të qenë në gjendje të vlerësojë këto dëshmi shpesh të zbehta, tregon edhe më qartë, lidhjen e ngushtë të këtyre disiplinave të afërta e madje ndërplotësuese. Kjo dukuri vërehet jo vetëm në monumentet e arkitekturës, ku zbulohen faza të reja ndërtimit, elemente të panjohura etj, por edhe në veprat e artit ku shpesh faza të mëvonshme e ndonjëherë me vlera të dyshimta mbulojnë vepra më të vjetra me vlera të mëdha. Këmbëngulja për të ruajtur të pacënuar historinë e veprës, vërtetësinë e saj, ka kërkuar dhe do të kërkojë përpjekje studimore ndërdisiplinore për të përfituar metoda, rrugëzgjidhjen dhe përdorimin e materialeve moderne në brendësi të strukturave të veprës. Përdorimi i çimentimeve me gëlqere të vjetëruar me shtesa hidraulike, që sigurojnë ngurtësim të shpejtë në brendësi të mureve, apo qemereve si dhe përdorimi i rrëshirave sintetike që japin të njëjtin efekt, garantojnë qëndrueshmërinë e monumentit.

Problemi i ruajtjes së elementeve të drunjta, përdorur tradicionalisht aq dendur në monumentet tona, si në struktura ashtu dhe në elemente që përmbajnë zbukurime, ka kërkuar e gjetur dy rrugëzgjidhje: lehtësimin e ngarkesave mbi to dhe së dyti përforcimin nëpërmjet elementeve metalike dhe gurësimin e materialit prej druri. Për të dy rrugët janë bërë të njohura përkatësisht metodat e llogaritjes dhe mënyra e gurësimit me materiale sintetike të kohës. Këto mënyra sigurojnë ruajtjen e vlerave origjinale të monumentit dhe të substancës së tij të lashtë, por njëkohësisht ato janë ndërhyrjet më efikase dhe shpesh më ekonomike. Me interes kanë qenë edhe ndërhyrjet për të ruajtur lëndën e vjetër si p.sh. në nënshtresat e pikturës murore, në ikonat, ikonostaset e zbukurimoren e banesës popullore, si dhe në drejtim të përforcimit të mureve, kur janë vënë re shpërbërje të elementeve lidhëse dhe ku rrezikohej qëndrueshmëria e tërësisë strukturore të veprës.

Problematika e monumenteve të arkitekturës antike e mesjetare paraqitet mjaft komplekse, pasi shpesh ka të bëjë me zgjidhjen njëherazi të detyrave të përbashkëta, që u takojnë si vlerave arkitektonike ashtu dhe atyre të artit, me pika takimi kryesisht në monumentet e kultit. Veçanërisht në kishat shfaqet më dendur domosdoshmëria për punimet që duhet të ndërmerren në veprën arkitektonike për mbrojtjen e veprës së artit nga lagështia. Lagështia inxhinjerike, që i vjen pikturës prej filtrimeve nëntokësore, është mënjanuar me ndërhyrje të efektshme në kishat e Leusës, Bualit, Voskopojës, Shelcanit etj. Përsa i përket lagështisë fizike nga kondensimet arritjet janë ende modeste, për rrjedhojë, zgjidhja e tyre kërkon studime të mëtejshme, madje komplekse, me ritme të përshpejtuara, veçanërisht kur fenomenet e shfaqjes së lagështisë janë më të qarta dhe atëhere kur degradimi i veprës së artit të aplikuar është në zhvillim të pandërprerë. Paraprirja në të tilla raste, me punime profilaktike në arkitekturë, si është vepruar me kishat e kalasë së Beratit, ato në Boboshticë të Korçës, në Ardenicë dhe në Shën Kollin e Voskopojës, duhet konsoliduar dhe bërë rregull. Në ndihmë të zgjidhjes së problemit të lagështisë vijnë sot në konsideratë një sërë studimesh bashkëkohore me vlerë.

Trajtimi i rrënojave arkeologjike me vlera arkitektonike dhe arti, deri më sot, ka konsistuar kryesisht në pastrimin dhe evidentimin e konstruksionit të rrënojës, si dhe në punimet përforcuese, duke bërë përjashtim disa vlera unikale, ku është zbatuar praktike e mbulimit të tyre me mbikonstruksione, si në rastin e vendvarrimit të Skënderbeut, në Varret e Selcës, në kapelën e amfiteatrit të Durrësit etj, mbulime këto që nuk kompromentojnë vlerat e mirëfillta të monumentit. Problemi i mbulimit të rrënojave që ruajnë gjurmë të pikturës murore ose mozaikë, me anë të mbistrukturave të lehta që sigurojnë vizitueshmërinë gjithëvjetore, është një problem i diskutueshëm madje dhe në praktikën botërore të konservimit të rrënojave. Në rastin e rrënojave me mbeturina afresku, si në Ballsh, Tujan, Krujë, Arapaj, etj. është ndjekur praktika e mbrojtjes së veprës së artit me anën e mbulesave të vogla me materiale mjaft të lehta e shpesh të heqshme. Në praktikën e punës sonë restauruese me monumentet e dala nga gërmimet arkeologjike në përgjithësi ka pasë një bashkërendim të ngushtë të punës së arkeologut me restauratorin. Mjaft të përmendim punimet në Lezhë, Apoloni, Zgërdhesh, Bylis etj. Ky bashkëpunim në këto monumente, që paraqesin një specifikë të dallueshme, duhet forcuar edhe më tej, në dobi të vlerësimit dhe ndërhyrjeve sa më të shpejta e njëherazi, sa më të kualifikuara.

Vlera të një rëndësie të veçantë në tërësinë e trashëgimisë sonë arkitektonike, paraqesin edhe ato monumente historike që lidhen me ngjarje dhe figura të shquara, të kohëve të ndryshme që arrijnë deri në ditët tona. Kriteret e ndërhyrjeve restauruese në këtë gjini monumentesh janë udhëhequr nga një parim themelor metodik, ai i ruajtjes së gjendjes që lidhet me momentin historik, apo jetën e personalitetit. Në

DO NOT COPY

DOKTORATURA

këtë drejtim, sidomos kohët e fundit, është zhvilluar një veprimtari tepër e gjerë, duke ndërhyrë me punime restaurimi thuajse në të gjitha këto vepra. Përkujdesje e veçantë i është kushtuar sidomos restaurimit të monumenteve që lidhen me periudhën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe bazat ku ka zhvilluar veprimtari gjatë kësaj periudhe udhëheqësi ynë i paharruar, shoku Enver Hoxha.

Monumentet e kulturës, p.kërisht se janë pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare, dëshmi historike e artistike e së kaluarës, duhet të jetojnë aktivisht ne kontekstin e kohës sonë. Natyrisht në përputhje me gjininë vlerat dhe gjendjen teknike të monumentit, shkallët dhe mënyrat e përfshirjes së tij në jetën e sotme kanë qenë e do të jene të ndryshme duke pasur si kriter themelor dhënien e funksioneve të dobishme që nuk cënojnë vlerat për të cilat ai ruhet. Në gjininë e banesave, është pranuar si më frytdhenëse praktika e shfrytëzimit të tyre për qëllimet origjinale për të cilat janë ndërtuar ato. Shembuj të shumtë i përkasin në këtë drejtim banesës popullore tshatare dhe qytetare. Shfrytëzimi i këtyre monumenteve për banim brenda kritereve të njohura, që lidhen me vlerat e tyre si monumente të kategorisë së parë dhe të dytë, ka dhënë në përgjithësi përfundime të kënaqshme. Veçanërisht i pranueshëm dhe pozitiv ka qenë trajtimi i monumenteve të kategorisë së dytë, në të cilet lejohen ndryshime në përputhje me kerkesat e kohës, duke qenë se këtu kemi të bëjmë me ndërtime, vlerat e të cilave lidhen kryesisht me formulimin e arkitekturës së jashtme brenda në zonë. ose të mbrojtur. Në mjaft raste, monumente të kategorisë së parë, me viera përfaqësuese, janë kthyer në muze etnografik. Ky ktnim në muze, ka gjetur e gjen fushë më të gjerë dhe është thuajse e vetmja rrugëzgjidhje në monumentet historike, të cilat lidhen me ngjarje apo figura të shquara historike. Veçanërisht bazat e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në mbarë vendin, që lidhen me figurën e udhëheqësit tonë të paharruar, Enver Hoxha, përbëjnë shembullin më të mirë të përvojës sonë lidhur me rolin e monumentit në jetën e sotme. Për qendrat historike dhe veçanërisht për qytetet-muze, problemi i përfshirjes së vlerave urbanistiko-historike në jetën e sotme, duke i ruajtur në maksimum ato, është zgjidhur kryesisht me rrugën e përshtatjes së monumenteve të kategorisë së dytë për funksione të reja, të cilat i kërkon mënyra e sotme e jetesës. Mund të themi se është duke u bërë si rregull tek ne, që të përfshihen monumentet e kulturës në kuadrin e studimeve dhe projektimeve të reja urbanistike.

Problemi i grupit të monumenteve jofunksionale paraqitet njëherazi më i larmë dhe më i vështirë. Kthimi i tyre në pika të vizitueshme, apo në muze karaktereve të ndryshme, është pranuar si zgjidh më e zbatueshme. Punimet sistematike, në mjaft ng monumentet tona, kanë bërë që ato të shërbejnë pika të rëndësishme referimi jo vetëm për specialistë por edhe për masën e gjerë të të interesuarve, dul plotësuar kështu një rol të rëndësishëm didaktik. Sh mbujt e qytetit antik të Apolonisë, të Lezhës, Bylis puna sistematike e këtyre viteve të fundit në kalatë Gjirokastrës, të Krujës, Lezhës e Shkodrës, janë mja tregues në këtë drejtim. Janë bërë përpjekje edh për të përfshirë monumentet e kultit në jetën e sotm duke iu dhënë atyre funksione të përshtatshme sip natyrës së tyre. Kthimi i Xhamisë së Plumbit në Ber dhe i asaj së Muradies në Vlorë në muze arkitektur Katedrales në lagjen Kala të Beratit në muzeun «On fri», Muzeu i armëve në kala të Gjirokastrës, Muze arkeologjik në Manastirin e Apolonisë etj, kanë çu më përpara mendimin për vendin e monumente në jetën e sotme.

Gjurmimi, studimi dhe restaurimi i monumentev orientohet gjithmonë nga parimi se këto vepra nu duhet të jenë objekt trajtimi e aq më pak njohjeje një rrethi të ngushtë specialistësh. Monumentet duh të japin ndihmesën e tyre për plotësimin e kuad historik të periudhës që i përkasin dhe si të tilla a duhet të njihen jo vetëm nga specialistët, por vler e tyre themelore duhet të përfshihen në njohuritë masave të gjera. Kjo përligj më mirë vlerësimin tyre edhe në anën tjetër lehtëson punën e vështi të ruajtjes dhe restaurimit të kësaj pasurie të paz vendësueshme, e cila si përvojë me theks kombët ka meritat e veta në thesarin e madh të kulturës b tërore, merita që janë formuar nëpër vepra tragjik e njëkohësisht madhështore, me fizionomi të qar kombëtare.

Vlerësimi i monumenteve edhe roli njohës dh edukues i tyre ka gjetur shprehje edhe në hallkë përfundimtare e tepër të rëndësishme të veprimtaris sonë mbrojtëse e restauruese, në atë të botimit. Kj veprimtari siç përmendëm ka pasur dy drejtime: a të botimeve me karakter shkencor dhe atyre me ka rakter popullarizues. Në drejtimin e parë vendin kry sor e zë revista «Monumentet», e cila tashmë m ndihmesën që jep për njohjen e monumenteve shqip tare ka gjetur jehonë pozitive si brenda ashtu edh jashtë vendit. Krahas, janë botuar një sërë albumes e monografish, që paraqesin e trajtojnë problem të rëndësishme të trashëgimisë sonë arkitektonike. Bo timet popullarizuese janë pritur me interes nga publ ku i gjerë. Kjo veprimtari ka prurë një ndihmesë t rëndësishme për rritjen e njohurive të masave t gjera për vlerat e monumenteve si premisë e domos

doshme për ruajtjen e kësaj pasurie. Në këtë drejtim duhet theksuar edhe veprimtaria e gjerë propaganduese në organet e shtypit, në radio e televizion. Veçanërisht e frytshme është «Java e monumenteve», gjatë së cilës dendësohet ndjeshëm veprimtaria e gjithanshme njohëse për monumentet.

E gjithë kjo veprimtari e gjerë presupozon një punë të kualifikuar e të specializuar shkencore për të përballuar problematikën komplekse të ruajtjes dhe vlerësimit të monumenteve. Edhe në këtë fushë, ashtu si në fushat e tjera, ne jemi mbështetur fuqimisht në kuadrot e dala nga bankat dhe auditorët e Universitetit dhe shkollave tona të larta. Specializimi në punë e nëpërmjet punës, siç tregojnë përfundimet e arritura, ka qenë rruga kryesore e njëherazi më frytdhënëse. Kjo natyrisht flet për shfrytëzimin e arritjeve bashkëkohore nëpërmjet njohjes së literaturës nga specialisti, pjesëmarrjes në organizata ndërkombëtare për problemet e restaurimit dhe lidhjeve me institucione të ndryshme, paralele, të brendshme e të jashtme. Padyshim një rol të veçantë lot këtu edhe shkëmbimi i përvojës me specialistë të huaj, si dhe specializimi i kuadrit tonë jashtë vendit. Duhet thënë se në këtë drejtim ne ende jemi duke bërë hapat e para.

Rrugët e ruajtjes së monumenteve, në vështrim më të gjerë, pa dyshim kërkojnë përsosje të njohurive mbi historikun e tyre dhe përgjithësisht mbi historinë ekonomike, shoqërore dhe kulturore-politike të vendit tonë dhe nga ana tjetër sigurimin e mjeteve tekniko-shkencore që garantojnë një punë të kualifikuar për jetëgjatësinë e monumenteve. Bashkëpunimi me disiplina të tjera, të cilat mundësojnë diagnostikimin, apo shkallën e llojin e ndërhyrjeve restauruese, lehtëson zgjidhjen e problemeve komplekse që paraqesin monumentet e kulturës në vendin tonë.

Mbrojtja e monumenteve me trinomin e vet: gjurmim, studim, restaurim, lipset të hyjë në jetën shkencore me më shumë thellësi e forcë vepruese e përmbyllëse. Duke kërkuar dhe vlerësuar krijimet më të shquara të kombit tonë në arkitekturë dhe në art, ne zbulojmë edhe veçoritë e tyre si pasqyrim i një konteksti të dhënë ekonomiko-shoqëror.

Problemi i studimit të monumenteve, i gjetjes së anëve dalluese më tipike në arkitekturë e art që është e përbashkët për vendin tonë që nga kohë të lashta e deri në ditët tona, mbetet një pikë themelore për programin tonë të së ardhmes si bazë për detyrën numër një: ruajtjen me besnikëri të vetë monumenteve dhe bashkëjetesën e tyre me krijimet e kohës së sotme. Kjo duhet të arrihet nëpërmjet një zgjerimi të mëtejshëm të njohurive tona, por dhe nëpërmjet një vështrimi kritik të punës sonë, të gjithë asaj që kemi arritur, gjurmuar e vënë në mbrojtje. Në këtë kuptim edhe botimet duhet të synojnë më mirë e më qartë drejt këtyre objektivave, për të nxjerrë në pah vlerat më karakteristike të arkitekturës dhe artit, për të ngritur më lart nivelin shkencor e teknik të punës sonë restauruese, detyrë kjo plot përgegjësi ndaj kulturës sonë kombëtare socialiste.

Rrugët e shfrytëzimit të monumenteve në përshtatje me kërkesat që nxjerr koha, gjithmonë pa cënuar vlerën e tyre, mbeten një fushë e gjerë që aktualisht merr më shumë theks për ansamblet, fortifikimet, qendrat antike mesjetare, veçanërishtn në bujt e tyre më përfaqësues.

Restaurimi i monumenteve, pa përjashtuar forcat e mirëmbajtjes së përhershme, tashmë të organizuara, do të drejtohet të realizojë synimin e mbrojtjes dhe të vizitueshmërisë, duke pasur përparësi monumentet më me vlerë, ata që lidhen me ngjarje e figura të shquara të historisë së popullit tonë, duke pasur gjithmonë parasysh shkallën e dëmtimit dhe mundësinë për t'i kthyer ato në qendra të vizitueshme.

Kryerja me sukses e punimeve restauruese duhet të kushtëzohet me njohjen e thellë të monumentit, me diagnostikime të sakta dhe dokumentacion të pasur teknik e shkencor. Cilësia e këtyre ndërhyrjeve pa nënvleftësuar ato «më të thjeshta», kërkon njohuri të thella të shkencës bashkëkohore, kërkesa në rritje, për të vënë në shërbim të monumentit shkallën më të lartë të mendimit e të veprimit praktik restaurues.

Programi i punës propaganduese duhet të parashikojë ndjekjen e formave më efikase për të rritur e forcuar ndërgjegjen e masave, të njerëzve të thjeshtë, për të ruajtur monumentet. Në mënyrë të veçantë, tek brezi ynë i ri, duhet të edukohet ajo ndjenjë, ai pasion, që ka pasur shoku Enver për këto vlera. Shoku Ramiz Alia duke folur për Gjirokastrën thekson: «...Gjirokastrën Partia e do të jetë kështu e bukur...» sepse siç porosiste shoku Enver ajo është «një mrekulli».

Këto porosi, si çdo porosi tjetër të tij, thekson shoku Ramiz duhet ta kemi vath në vesh të tërë, ju gjirokastritët e ne «tiranasit», punëtorët e arkitektët.

Përfundimet e derisotme, me zgjidhjen e problemeve themelore të punës me monumentet janë një mbështetje e sigurtë për një hop cilësor në të ardhmen, kryesisht në mënyrën dhe thellësinë e ndëhyrjeve restauruese, në përsosjen e fazës studimore dhe interpretimin e drejtë të veprës në zhvillimin e saj historik.

Kujdesi i vazhdueshëm i Partisë, që buron nga natyra e sistemit tonë socialist, trashëgimtar i gjithçkaje pozitive që krijoi gjenia shqiptare në shekuj, është garanci për arritje të reja edhe më të mëdha.

DOKUMENT

Sotir KOSTA

LA PROTECTION, L'ETUDE ET LA RESTAURATION DES MONUMENTS HISTORIQUES EN ALBANIE

DO NOT COPY

La protection, l'étude et la restauration des monuments est un phénomène relativement nouveau dans notre vie culturelle, il est apparu et s'est affirmé au cours des années de construction socialiste. Les monuments historiques constituent, par leur valeur double de témoignages historiques et d'oeuvres d'art, des créations qui permettent de suivre continuellement l'itinéraire du génie créateur de notre peuple au cours des siècles, sa longue histoire. L'attention attachée par notre État socialiste au patrimoine progressiste hérité du passé en général et à l'héritage architectural et artistique en particulier est aux antipodes de l'indifférence totale des régimes antérieurs à l'égard de ces valeurs irremplaçables.

En ce qui concerne notre patrimoine culturel, le camarade Enver Hoxha, notre guide et éducateur inoubliable, a indiqué: «... Les objets qui témoignent de la culture de notre peuple sont d'une valeur inestimable, ils constituent un véritable trésor pour la nation albanaise, aussi devons-nous veiller avec le plus grand soin à leur conservation...»

Le vaste travail de recherche accompli depuis des années aux quatre coins du pays a permis à notre État de mettre sous sa protection plus de mille monuments de première catégorie de tous les genres de la création architecturale et artistique depuis les origines de l'histoire de notre peuple jusqu'à nos jours. La conservation des valeurs complexes de Berat et de Gjirokastër en leur qualité de «villes-musées» des «zones-musées» de Shkodër, Korçe, Elbasan, Kruje, Tirana et Vlore, des sites et centres archéologiques de Butrint, Apollonia, Bylis, Zgërdhesh, Finiq, Antigone, Durrës, etc., est un témoignage de l'importance attachée à l'élévation du nievau de notre pensée scientifique relative à la conservation des traditions dans le cadre de notre vie socialiste.

A la suite d'un grand travail de recherche s'étalant sur plusieurs décennies, le choix des constructions citadines et rurales les plus typiques et les plus notoires dans le cadre des liens logiques et fonctionnels avec d'autres créations populaires dans les villes comme à la campagne, les résultats encourageants obtenus dans les arts appliqués, la sculpture sur pierre et sur bois, la peinture murale et de chevalet, l'art de la mosaïque, etc., ont sensiblement accru notre patrimoine culturel.

Parallèlement au travail de recherche, d'importants progrès ont été enregistrés dans la documentation propre aux monuments et cela au niveau graphique, photographique et descriptif.

D'autre part, il faut considérer comme un grand pas avant accompli dans le domaine de la protection des mo ments la mise au point de la législation afférente, à sav la réglementation légale de l'ensemble des problèmes que p la vie de tous les jours dans ce domaine également. No législation, déjà confirmée par une pratique longue de qu ques années, a fort bien couvert tous les problèmes posés l'appréciation des monuments. Il incombe aux organismes notre Institut et à ceux du pouvoir populaire de rendre enc plus efficace cette protection qu'assure la loi.

Les interventions à des fins de restauration dans les n numents historiques n'ont cessé d'augmenter en nombre elles se sont toujours améliorées. Ainsi, au cours des c dernières années, environ 200 monuments des deux catégor ont fait chaque année l'objet d'interventions et de travaux restauration et de conservation nécessitant des frais considé bles, des cadres hautement qualifiés, de nombreux maîtr ouvriers et matériaux, ainsi que des moyens techniques et transport. Partout dans le pays et tout au long de l'année, c organismes spécialisés, dotés d'un personnel permanent service de notre institut, le seul habilité à conduire ces op rations, mène un travail systématique en vue de la restaurati des monuments.

Les villes-musées en tant qu'organismes presque complets, permettent de suivre de façon capilaire le passé quant aux détails et largement quant aux corrélations sociales, économiques culturelles et artistiques dans un contexte historique précis.

La mise sous protection des villes de Berat et de Gjirokastra, posait plus que pour les autres monuments particuliers, le problème de la place qu'elles devaient occuper dans la vie actuelle, par conséquent l'attitude qu'on devait y adopter dans le cadre des interventions de restauration. Deux prémisses représentent et représenteront une constante dans toutes les corrélations temporelles des habitations des villes-musées avec leurs structures architectonique et urbanistique.

1) La conservation la plus complète que possible des valeurs d'urbanisme, d'architecture et d'ambiance.

2) Une vie active de ville-musée dans les conditions contemporaines.

Ce sont à première vue, deux prémisses presque discordantes, mais d'une discordance non insoluble surtout dans un contexte social qui sent bien la nécessité impérieuse de la conservation de ces valeurs, qui se réalise par la coordination avec les exigences de la vie contemporaine.

Que montre-t-elle l'expérience albanaise dans l'application des conceptions déjà mentionnées quant à la création des conditions favorables à l'application de la première premisse.

Chez nous, l'atténuation de la contradiction toujours problématique entre l'ancienne centre et les nouvelles exigences de la vie, est favorisée par l'envisagement de quelques mesures.

La division de la ville-musée en zones, avec de différentes exigences quant à la sauvegarde de l'ancien ensemble micro-urbain, permet des modifications indisponsables et uniques qui peuvent satisfaire aux exigences impératives de la vie actuelle dans les zones mises sous protection de l'Etat.

La classification des monuments en deux catégories, et concrètement la sauvegarde totale des monuments de la première catégorie et de ses composants fonctionnels, techniques et compositionnels et la tolérence des modifications de la composition dans les monuments de deuxième catégorie en satisfaisant les besoins de la vie actuelle, pratiquement offre une bonne solution au problème de l'utilisation de ces monuments.

A l'heure actuelle sont convenables aussi les interventions reversibles, qui permettent des améliorations fonctionnelles sans altérer profondément la structure compositionnelle et technique des monuments de la première catégorie.

Enfin, l'intensification de l'activité sur la popularité des valeurs de ces centres, l'accroissement du nombre des milieux touristiques et l'organisation des activités culturelles et artistiques dans ces endroits aident les habitants de ces centres à mieux apprécier les valeurs des villes-musées.

Les considérations déjà mentionnées jouissent d'appui en général dans nos deux centres connus, la ville de Berat et la ville de Gjirokastra mais ayant en vue leur particularités considérables, elles s'y appliquent différemment.

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

monumenet

DO NOT COPY

Neritan CEKA

BYLISI DHE ETAPAT E ZHVILLIMIT URBAN NË BASHKËSINË E BYLINËVE

Territori antik i bylinëve, që përputhet me shtrirjen e sotme gjeografike të krahinës së Mallakastrës, përfaqëson një nga trevat më klasike për ndjekjen e procesit të urbanizimit tek ilirët (fig. 1). Këtu, jeta qytetare njeh fillimet më të hershme, në një periudhë parakoloniale, protoqytetare, me Margëlliçin dhe Mashkjezën dhe zhvillohet në mënyrën më të plotë gjatë shek. IV-I p.e.sonë me përfaqësues kryesor Bylisin. Veçimi i periudhave kryesore dhe i tipareve karakteristike në fushën e arkitekturës përbën edhe detyrën e kësaj kumtese.

Periudha e parë protoqytetare është datuar nga shtresat kulturore të Margëlliçit, Mashkjezës dhe Klosit, nga mesi i shek. VII p.e. sonë deri në mesin e shek. V p.e.sonë. Brenda këtyre caqeve kohore janë dalluar dy faza fortifikimi. E para që i takon gjysmës së dytë të shek. VII përfaqësohet në Margëlliç e Mashkjezë nga dy tipe të ndryshme planimetrike. Margëlliçi, në një sipërfaqe prej 15 ha, ka pasur një planimetri shumëkëndëshe, që i përshtatej me trase të drejtë të mureve formës së terrenit, në një zgjidhje që e njohim nga fortifikimi i madh protoqytetar i Kalivosë pranë Butrintit. Ka mundësi që dhe Klosi, ku dëshmohen shtresa kulturore të së njëjtës periudhë, por ende jo mure rrethuese protoqytetare, të bënte pjesë në të njëjtën tip fortifikimi. Mashkjeza, me një sipërfaqe prej rreth 0,2 ha ka pasur një planimetri katërkëndëshe, një zgjidhje rigoroze gjeometrike, që do të ndeshet pak më vonë edhe në Dorëz, Zgërdhesh, Samobor. Përdorimi i këndeve të drejta apo të gjera në kthesat e murit është diçka e përbashkët për Margëlliçin dhe Mashkjezën. Tek kjo e fundit njohim edhe një tip të ri hyrje me korridor paralel me trasenë e murit, të vendosur në njërën prej kthesave të tij. Teknika e ndërtimit është e njëllojtë për të dy qendrat: blloqet e gurëve janë punuar vetëm në faqet horizontale, për të zgjeruar sipërfaqen e kontaktit. Gjithashtu është ndjekur një vendosje në rreshtat e blloqeve (fig. 2).

Faza e II protoqytetare e fortifikimeve na përfaqësohet nga një rindërtim i plotë i murit rrethues në Mashkjezë (fig. 3) dhe nga plotësime të trasesë në Margëlliç, të realizuara në gjysmën e dytë të shek. VI dhe në fillim të shek. V p.e.sonë. Një fortifikim i ri ndërtohet në Belishovë, me një planimetri plotësisht katërkëndëshe dhe me hyrjen tipike në kënd të saj. Ndoshta i takon kësaj kohe edhe fortifikimi i Gurzezës, i njohur vetëm nga disa trakte të anës jugore. Në Margëlliç banesat ishin vendosur të gjitha brenda murit rrethues, në tarracën, që krijohej pas tij. Në Mashkjezë, për shkak të sipërfaqes së kufizuar të fortifikimit, pjesa më e madhe e banesave ishte vendosur jashtë mureve, në shpatin e kodrës.

Periudha e dytë në zhvillimin urban të territorit të bylinëve nis pas mesit të shek. V p.e.sonë me formimin e qytetit të mirëfilltë në Klos. Edhe ajo përfaqësohet nga fortifikimi, tashmë i njohur i Klosit, që bën pjesë në grupin e qendrave të para qytetare me Amantien e Butrotin. Me to Klosi ka të përbashkët tipin planimetrik me linjën zig-zage të trasesë, ku shfaqen për herë të parë bastionet e thjeshta dhe të dyfishta. Si një element më i përparuar shfaqen në mënyrë ende jo të plotë vetëm dy kthesa dhëmbë sharre (Tab. I. a).

Me Amantien përkon edhe tipi i hyrjes gjysmë ballore, që përfaqëson evolucionin e mëtejshëm të hyrjes tipike protoqytetare. Duke u vendosur njëlloj, në një kthesë të murit rrethues, hyrja arrihet me një kalim të detyruar rrëzë vazhdimit të tij dhe pjerësisë së kodrës ku lihet i zbuluar krahu i djathtë i sulmuesve.

Përsa i përket teknikës së ndërtimit, Klosi përbën

DO NOT COPY

një shembull më të përparuar, me zgjerimin e bazamentit të murit në 3.30 m, nga 2.50 m që e kishte Amantia dhe rreth 2 m të fortifikimeve protoqytetare. Gjithashtu në Klos shfaqet për herë të parë emplektoni me ndarjet tërthore në mbushjet e murit. Një dallim tjetër është edhe lënia e faqes së gurores në fasadë (fig. 4), ndryshe nga trajtimi i rrafshtë në Amantia e Butrot. Klosi është shembulli më tipik i qytetit të quajtur të pllajës nga A. Baçe dhe që përbën zgjidhjen e vetme planimetrike të qytetit të hershëm në gjysmën e dytë të shek. V të përfaqësuar në Butrot, Foinike, Amantie dhe Klos. Klosi shoqërohet edhe me një kështjellë në kufirin jugllindor të trevës byline, pranë fshatit Rabie të Tepelenës. Ajo ka planimetri shumëkëndëshe, pa kulla, me një sipërfaqe 0.36 ha (Tab. I d). Muri ka të njëjtin ndërtim si Klosi, me gjerësi 3 m të përshkuar nga parete tërthore dhe fasadën prej blloqesh të mëdha trapezoidalë me lartësi të ndryshme, të plotësuar në rreshtat e thyer me gurë më të vegjël. Një shoqërim të qytetit me një kështjellë periferike ndeshim dhe në krahun tjetër të Vjosës me Amantien dhe Matohasanajn. Ky është tregues i formimit të bashkësive territoriale qytetare që na dëshmohet tërthorazi edhe në burimet historike. E dhëna e pseudo-Skylaksit se amantët ishin ilirë nga bylinët gjen një mbështetje edhe nga ngjashmëria e fortifikimeve në të dy anët e luginës së Vjosës.



Fig. 1

Periudha e tretë në zhvillimin e qytetit në territorin bylin përfaqësohet nga Gurzeza. Qyteti zhvillohet aty mbi bazën e fortifikimit protoqytetar, në shpatin jugor të kodrës, në një planimetri të përafërt katërkëndëshe, me kulla, me gjatësi muresh 1700 m dhe sipërfaqe prej rreth 21 ha (Tab. I. b) Vendosja në shpatin e pjerrët dhe përdorimi i traseve dhëmbësharrë në zbritje e afron Gurzezën me Foiniken dh Kasopenë, dy qendra të datuara në bazë të lis tës së teorodokëve të Argosit, para vitit 360 p. sonë. Me këtë grup qytetesh të shpatit ku futet edh Mavrova, Butroti III, Çuka e Ajtojt lidhet edhe teknik e mureve të Gurzezës qytetare. Muri me gjerësin 2,40 m ka një trajtim poligonal të blloqeve të pu nuara me kujdes në faqet horizontale dhe në at ballore (fig. 5). Ka mundësi që kjo të jetë vetë xokolatura e një muri prej qerpiçi, të ndërtuar sipa tipit apoloniat.

Periudha e katërt e zhvillimit urban në trevë byline, nis rreth mesit të shek. IV p.e.sonë, me ndërti min ex novo të Bylisit. Për nga trajtimi i hapësirës Bylis shënon një kalim të ri në qytetin e pllajës. Me sipër faqen prej 30 ha, brenda një trekëndëshi mures me gjatësi 2300 m, është qyteti më i madh vendas Ilirisë së Jugut. Kjo sipërfaqe ka qenë ndarë në t zona kryesore: zona e banuar e vendosur në tarraca e anës lindore e perëndimore (20 ha), zona e ago

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

rasë, veçuar me një mur dekorativ në anën jugperëndimore (4 ha) dhe zona e rezervuar për popullsinë fshatare në raste luftrash (6 ha) (fig. 6), njëlloj si në Apoloni, në anën juglindore. Një shfaqje e re në planimetrinë e Bylisit janë kullat e vendosura me kursim në pikat më të afrueshme të murit rrethues. Me përjashtim të një kulle më të vonë që mbron hyrjen nr. 6, të gjitha ato janë vendosur gjatë trasesë së murit, gjë që tregon se nuk ishte formuar ende koncepti i flankimit të hyrjeve nga kulla.

Hyrjet janë elementet më me interes në planimetrinë e Bylisit (fig. 7). Hyrja 2, i takon tipit të njohur epirot nga Foinike dhe Batia, që shënon një hap të mëtejshëm në kalimin nga hyrja ballore në atë tërthore. Hyrjet e tjera janë ndërtuar sipas skemës tërthore me korridor paralel me murin. Hyrja nr. 4 ka një korridor 8.50 m të gjatë e 4.20 m të gjerë. Kontrafortet që dalin në korridor shënojnë shpatullat e tri harqeve mbi të cilat mbështetej një kullë. Hapësira e parë midis tyre mbyllej me një sistem të dyfishtë portash, ndërsa e dyta ishte e hapur brenda, për strehimin e rojeve. Porta të dyfishta me mbulim me konstruksion harqesh kishin edhe portat 1 dhe 5. Bylisi na jep, krahas Amanties, shembullin më të hershëm për përdorimin e harkut në mbulimin e hyrjeve që në mesin e shek. IV p.e.sonë. Në Bylis, gjithashtu, bëhet një përpjekje për zhvendosjen e kullës nga sipër korridorit në njërin krah të tij, siç e ndeshim në hyrjen nr. 6. Përsa i përket teknikës së ndërtimit, Bylisi, është një model i zbatimit të muraturës katërkëndëshe izodemike, me faqe të sheshta, prerje të këndeve dhe rresht me lartësi rreth një këmbë e gjysmë (0,50 cm) (fig. 8). Kjo teknikë zbatohet edhe në rindërtime të pjesshme të trasesë së murit rrethues në Klos. Ndërtime të këtij karakteri ndeshim edhe në Gurzezë, por ato janë realizuar, me teknikën tipike të Apolonisë, me xokolaturë katërkëndëshe pseudoizodemike, me faqe të rrafshëta e monograme mbi të cilën kalonte muri prej tullash (fig. 9). Në Margëlliç me këtë teknikë realizohet ndërtimi i fortifikimit qytetar, i cili ruan planimetrinë protoqytetare dhe pjesërisht edhe trakte të rrethimit të vjetër. Kjo periudhë, e dendur në zgjerimin e jetës qytetare, ka



Fig. 4



Fig. 5

tipare të njëllojta arkitektonike edhe në terri
amant me rindërtime të gjera në Amantie dhe
rimin e qytetit në Mavrovë. E para qëndron më
Bylisit për nga tipi i hyrjeve tërthore, me një
mbi harqe. Mavrova, për trajtimin e fryrë të faqe
gurëve, lidhet më ngushtë me Beratin, një tjetër
tifikim qytetar i mesit të shek. IV p.e.sonë. Rreth
saj kohe plotësohet edhe sistemi i fortifikimit të



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

rritorit bylin me ndërtimin e kështjellës së Kalivaçit, që kontrollonte hyrjen nëpër bregun e djathtë të Vjosës. Me këtë merr fund dhe etapa e formimit të veshjes së jashtme të qendrave qytetare byline ndërkohë kur vëmendja ishte kthyer në trajtimin e hapësirës së brendshme. Kjo realizohet gjatë një shekulli, deri në mesin e shek. III p.e.sonë, në klimën e rritjes së prodhimit vendas, zgjerimit të marrëdhënieve skllavopronare, prerjeve monetare të bashkësive, formimit të shtetit ilir etj.

Bylisi ka dhënë shembullin më të qartë të drejtimeve në të cilat trajtohen hapësira e brendshme e një qyteti ilir të mirëfilltë, ku kriteret themelore janë zbatimi i sistemit ortogonal dhe veçimi i agorasë me ndërtimet shoqërore.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. I



a

b

c

d

Neritan CEKA

DO NOT COPY

BYLIS ET LES ETAPES DU DEVELOPPEMENT URBAIN DANS LA COMMUNAUTE DES BYLINS

RESUME

La vie citadine connaît ici ses plus anciens débuts au commencement du VIe siècle avant notre ère en une période précoloniale, protocitadine, à Margëlliç et Mashkjezë et continue son développement durant IV-I^e siècle a.n.e. avec principal représentant Bylis.

Les couches culturelles de Margëlliç, Mashkjezë et Klos datent de la première période protocitadine.

La seconde période protocitadine des fortifications est représentée par une reconstruction totale du mur d'enceinte de Mashkjezë et par les complétements du tracé à Margëlliç entamés pendant la deuxième moitié du VIe siècle et la première moitié du Ve siècle a.n.e. Une nouvelle fortification se construisit à Belishovë.

Les habitations de Margëlliç se situaient toutes à l'intérieur du mur d'enceinte, à la terrace créée derrière celui-ci. A Mashkjezë la plupart se trouvaient en dehors des murs, au versant de la colline à une pente de 40°.

La seconde période du développement urbain du territoire des bylins commence après la moitié du Ve siècle avec la fondation de la ville de Nikae (Klos).*

Avec Amantia coïncide aussi le type de l'entrée semi-frontale qui représente l'évolution ultérieure de l'entrée typique protocitadine.

En ce qui concerne la technique de construction Klos en est un exemple plus évolué, étant également accompagné d'un château à la frontière sud-est de la contrée byline, auprès du village Rabie de Tepelena. Un exemple pareil se rencontre à l'autre rive de Vjosa avec Amantia et Matohasanaj.

La troisième période du développement de la ville au territoire de Bylis est représentée par Gurzeza. La ville se développe sur la base de la fortification protocitadine au versant méridional de la colline à planimétrie presque quadrangulaire.

Avec la construction du ex novo de Bylis, vers la moitié du IVe sc., commence la quatrième période du développement urbain de la contrée byline.

Vu le traitement de l'espace, Bylis marque un nouveau passage vers la ville du plateau qui donnait de plus larges possibilités soit par la position des habitations que par la mise à part de la zone sociale de agora. Les tours disposées de façon économique dans de différents points proches au mur d'enceinte représentent une nouveauté dans la planimétrie de Bylis.

Quant à l'appareil utilisé Bylis représente le modèle du mur quadrangulaire isodome, à faces plates, angles pointus et assises de hauteur d'environ un pied et demi.

Mavrovë, vu l'appareil en bossage représente des liens plus proches avec Berat, une autre fortification citadine de la moitié du IVe siècle a.n.e.

A cette période de temps se complète également le système de fortification du territoire bylin notamment avec la construction du château de Kalivaç qui contrôlait le passage au bord de la rive droite de Vjosa. Avec ceci se termine aussi l'étape de l'entourage extérieure des centres citadins bylins et l'attention tourne vers le traitement de l'espace intérieur. Cela se réalisa pendant un siècle, jusqu'à la moitié du IIIe siècle a.n.e. au climat de l'accroissement de la production du pays, de l'élargissement des relations de servage, des coupes monaitaires des tribus, du renforcement de l'état illyrien.

---

* *habitants de Bylis*

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Apollon BAÇE

STUDIM MBI ZONIFIKIMIN ARKEOLOGJIK TË QYTETIT TË DURRËSIT

Durrësi, porta kryesore dhe njëri nga qytetet më të mëdha të vendit tonë, ka pas shpine një jetë të pakëputur prej më se 27 shekujsh. Historia e tij, me vlerë të veçantë kombëtare dhe ndërkombëtare, pasqyrohet qartë në gjurmët materiale: monumentet e spikatura, të larme për nga gjinitë e koha dhe shtresat e pasura kulturore. Pikërisht për këtë vendimi i Këshillit të Ministrave i qershorit 1961 e shpalli «pjesën e vjetër të qytetit të Durrësit qytet-muze», duke e vënë në mbrojtje shtetërore. Përshpejtimi, në vitet e fundit, i ritmit të ndërtimeve dhe kërkesa për hartimin e planit të ri rregullues, i cili e përcakton, një herë e mirë perspektivën e zhvillimit urbanistik të qytetit, nxori në pah domosdoshmërinë e zonifikimit arkeologjik të nëntokës së Durrësit dhe të rregullores përkatëse, që garanton paprekshmërinë e monumenteve.

Zonifikimi arkeologjik i qytetit të Durrësit nuk është një proces i thjeshtë, pasi monumentet e tij nuk i shpalosen vështrimit, por ndodhen të fshehura në gjirin e tokës, nuk integrohen dot organikisht në jetën e qytetit, pasi janë funksionalisht të vdekura, në gjendje rrënoje. Së fundi, dhe kjo është kryesorja, Durrësi nuk ka jetë të këputur, që do të lejonte kthimin e lehtë në rezervat arkeologjik, por një jetë gjithnjë e në rritje, me një popullsi që brenda 20 vjetëve të ardhshme arrin në 104.000 banorë. Këto veçori kushtëzojnë një zgjidhje simbiotike, të bazuar në vënien në jetë të orientimit të shokut Enver se «në Durrës jemi duke ndërtuar dhe do të ndërtojmë, por me ndërtimet që bëjmë nuk mund të ecim tym, pa ruajtur e pa mirëmbajtur objektet e duhura monumentale». Parashtrimi i rrugës së ndjekur për këtë zonifikim është dhe synimi i kumtesës.

Hartimi i projektzonifikimit kërkon së pari njohjen e topografisë së qytetit, të zhvillimit të tij në hapësirë e kohë. Fillimisht me këtë problem janë marrë arkeologët Hezej, Rej, Shober. Por, materiali i mangët në dispozicion solli një trajtim hipotetik të shtrirjes dhe lëvizjeve të qytetit dhe mosprekjen e mikrozonimit dhe dendësisë, elemente këto të domosdoshme për zonifikimin. Sot monumentet e njohura kryesisht nëpërmjet ndërtimeve të reja, të botuara në një pjesë të mirë prej tyre nga V. Toçit, F. Mirajt, H. Myrtos, arrijnë në 140, përfshirë këtu dhe 4 zona disahektarëshe. Për vështrimin e tyre tërësor, të ndihmuar prej F. Mirajt, kryem rikonjicionin në terren, të shoqëruar me përcaktimin në hartë të monumenteve, të botuara ose jo. Shpërndarjen e tyre në hapësirë dhe kohë po e paraqesim më poshtë.

Nga burimet mësojmë se Kolonia e Epidamnit u ngrit në v. 627 p.e.s. në një vendbanim pararendës taulant. Kjo dëshmohet dhe nga gjetjet e hershme, të cilat tregojnë për dy zona të larguara nga njëra-tjetra: Zonën jugore të zënë nga qyteti i sotëm, ku janë gjetur materiale prehistorike dhe qeramikë e prodhimit ilir, si dhe zonën veriore në kodrat dhe rrafshin në lindje të tyre, ku gjenden dy tempuj, varre dhe objekte arkeike. Në shekujt e mëtejshëm, falë zhvillimit të prapatokës, ndërfutjes në masë të elementit ilir pas luftës së viteve 431 – 404 dhe hegjemonisë së shtetit ilir ndaj qytetit pas viteve 350 – 335, Durrësi kthehet në një «pjesë përbërëse të realitetit ilir» dhe në kryeskelën e Adriatikut. Pikërisht në këta shekuj, nga i IV në të II p.e.s. vërehet një shpeshtim i ndjeshëm i gjurmëve materiale. Tashmë nekropoli i qytetit shtrihet në tërë shpatet e kodrave të ulëta duke arritur një sipërfaqe prej 60 hektarësh, ndërsa në rrafshin në lindje dhe verilindje të tij, midis vargut kodrinor dhe lagunës, gjurmët e banesave dhe ndërtimeve shoqërore zënë një territor të gjerë, prej më se 50 hektarësh. Në drejtim të jugut këto gjurmë

rrallohen dora — dorës, derisa në brendi të rrethimit të shek. V — VI hasen vetëm 4 ndërtime të kësaj kohe; një punishte qeramike, një ndërtim monumental dhe 2 banesa, njëra prej të cilave me mozaik. Praninë e jetës disi të kufizuar në këtë anë e dëshmon dhe nekropoli i vogël buzëdetar i Currilave. Në territorin verior, ku si pasojë e jetës së shkurtër, shtresa kulturore është e cekët, 1,2 — 1,5 m, shtrirja dëshmohet mirë nga gjurmët sipërfaqësore; qeramika e ndërtimit dhe detajet arkitektonike. Në të kundërt, në brendi të rrethimit, ku jeta vijoi pa shkëputje, horizonti i banimit 5 m i thellë arrihet rrallë nga themelet e ndërtimeve. Rrjedhimisht panorama e kësaj hapësire për këtë kohë nuk njihet mirë. Sidoqoftë, mund të supozojmë se krahas pjesëve veriperëndimore ku u ngulit kolonia, me sa duket e lidhur me detin nëpërmjet lagunës së hapur nga veriu, po zhvillohej dhe vendbanimi pararendës që synonte në bashkimin me të parin. Ky shpjegim mbështetet dhe nga burimet historike që flasin për dy qendra të ndara nga njëra-tjetra: Dyrrahun dhe Epidamnin.

Me pushtimin romak në fillimet e shek. I. Durrësi e humbi statusin e qytetit të lirë për t'u kthyer në koloninë Jule të Augustit. Ndërkohë jeta në territorin verior, buzë lagunës, pësoi një rënie thuajse të plotë, gjasisht si pasojë e degjenerimit të lagunës në kënetë. Nekropoli i ri 50 hektarësh i kësaj kohe shpesh me varre të pasura vijon në formën e një pyke midis dy zonave, e cila shkëput qartë zonën veriore nga jugorja, duke përvizuar dhe kufizuar njëkohësisht kufirin e sipërm të qytetit. Kjo është pikërisht dhe koha kur qyteti e braktis emrin Epidamn, që mendojmë se i takonte pjesës veriore, për të fituar emrin Dyrrah, që mendojmë se i takonte pjesës jugore. Kësaj kohe i përket dhe numri më i madh i monumenteve: 50 nga 120 të njohurit. Orientimi i tyre, traseja, ujësjellësi, tregojnë se rrugët e sotme ndoqën me besnikëri endjen urbanistike të kësaj kohe. Këto gjurmë tregojnë se zona e banuar, me ndërtime shpesh të pajisura me mozaikë, synonte ndaj veriut, ndërsa zona e ndërtimeve shoqërore rëndonte drejt jugut, gjasisht e tërhequr nga skela. Siç e tregojnë dy nga ndërtimet kryesore, termat dhe amfiteatri, si dhe sheshi i lirë mes tyre. Kjo zonë u zhvillua përreth vendit të bashkimit të magjistraleve. Krahas kësaj, gjetja e gjurmëve të tempujve dhe në skajet tregon për një sistem nënqendrash periferike. Tiparet urbanistike të Dyrrahut lexohen më qartë nëpërmjet impulsit ndërtimor që ai përftoi në vitet 491 — 518 prej perandorit bizantin Anastasit I, origjinar nga ky qytet. Rrethimi kryesor tregon se qyteti kishte pësuar një rrudhje nga 80 në 50 ha, por shtojca veriore e rrethimit, e pajisur me sistem kanalizimi, tregon për synimin e rishtrirjes në përmasat e para, synim që nuk u arrit. Sistemi i kanalizimeve dhe një bllokë e madhe në qendër tregon ruajtjen e endjes parë urbanistike. Por kishat paleokristiane në brez të lagjeve, të qarkuara me varre, tregojnë një shurdh qendërzim, element i ri ky në skemën urbanistike.

Rëndësia e Durrësit në mesjetë, kryeqendrës temës së fuqishme të njëemërt, dëshmohet nga shtesa e pasur kulturore, mozaikët dhe rindërtimet, ndërtimet e spikatura të kishave dhe fortifikimit. Të to gjurmë tregojnë gjithaq se qyteti e ruajti end urbane dhe shtrirjen e antikitetit të vonë. Por në 1496, kryesisht si pasojë e synimit të venecianë për ta kthyer Durrësin në një skelë të tyren dhe qytet rival, ai, siç e tregojnë burimet, kthehet në një «qytet të madh të rrënuar». Si i tillë ai u pushtua lehtë nga turqit, të cilët në 1506 ia reduktuan shtrirjen në 1/7 e sipërfaqes së parë.

Këto të dhëna janë ende të mangëta për përcaktimin e saktë e të detajuar të topografisë së qytetit në antikitet dhe mesjetë, çka do të kërkonte gërmime të rregullta, të shoqëruara me sondime të shpeshta. Por, nga ana tjetër, ato janë të mjaftueshme për njohjen e shtrirjes së qytetit, shpeshtësisë së ndërtimeve dhe përcaktimin e mikrozonave urbane, pra të elementeve të domosdoshme dhe të mjaftueshme për zonifikimin arkeologjik. Zona me dendësi më të madhe dhe me monumente më të spikatura është zona fushore e përvizuar nga rrethimi i shek. V — VI, veçanërisht pjesa 50 — hektarëshe e rrethimit kryesor. Kjo është dhe zona ku nga fundi i shek. XVII u rifuqizua qyteti i mesjetës së vonë dhe ku përqendrua jeta deri pak vite përpara. Për këto arsye, territori i rrafshët brenda mureve rrethuese i projektzonifikimin arkeologjik është përcaktuar qe dër historike me përbërëse të sajën zonën — muze përvizuar nga rrethimi kryesor, ku ndodhet qendra shoqërore me monumentet më të spikatura e shpeshta, dhe zonën e mbrojtur të përvizuar ng shtojca veriore me monumente më të rralla, kryesisht me banesa. Për të pajtuar kontradiktën ndërmjet vi mësisë së jetës dhe ruajtjes së vlerave të pazbuluar ndërtimet e reja në zonën-muze lejohen vetëm përre qendrës dhe dy magjishtraleve, të cilat e kanë fitu fizionominë e tyre, por pas gërmimeve arkeologjik dhe duke i lënë monumentet e zbuluara të vizitues me, si në rastin e termeve. Pjesa tjetër parashikoh të kthehet në zonë të gjelbëruar, duke përmirësu kështu dhe treguesin e ulët të gjelbërimit të qytet Në këtë zonë lejohen vetëm ndërtime të rralla e ulëta, me themele të cekëta mbi shtresën kulturor Në zonën e mbrojtur ndërtimet e reja, të cilat lej hen të kryhen vetëm pas sondazheve arkeologjik

DOKUMENT

duhet t'i lenë monumentet e rëndësishme të vizitueshme. Territori tej rrethimit, i zënë nga varreza e shek. I – III, përcaktohet zonë nën mbikqyrje. Në të, ndërtimet e reja nuk paraprihen nga gërmimet ose sondazhet, por në rast se zbulohen objekte ose monumente merren masa për ruajtjen e tyre. Së fundi, zonë nën mbikqyrje është përcaktuar dhe territori i qytetit në buzë të lagunës, i cili për shkak të sizmicitetit të lartë, për 20 vjetët e ardhshëm është lënë tokë bujqësore.

Kjo zgjidhje, që u rrit pas bashkëpunimit me institucionet e tjera, veçanërisht me qendrën e Kërkimeve Arkeologjike dhe ISP Nr. 1, lejon bashkëjetesën e së resë me të vjetrën në një raport dialektik, ku ndërtimet e reja respektojnë trashëgiminë kulturore dhe trashëgimia kulturore nuk e pengon zhvillimin e jetës së re.

DO NOT COPY

DO NOT COPY


PROJEKT ZONIFIKIMI ARKEOLOGJIK I
Durrësit
KENETA E DURRESIT
DETI ADRIATIK
Shpjegues
SHEK VI I PES.
SHEK I - III E S.
SHEK IV - VI E S.
SHEK VII - XV E S.
SHEK XVI - XIX
VARR
GJETIE PREHISTORIKE
MOZAIK
BANESE
AMFITEATER
TEMPULL
GJETIE ARKEOLOGJIKE
ELEMENTE ARKITEKTONIK
TUBACIONE
BANJA
KISHA
XHAMI
FURRE QERAMIKE
KANALIZIME
0 25 50 75 100 125 M

Apollon BAÇE

DO NOT COPY

ETUDE SUR LA DEFINITION DE LA ZONE ARCHEOLOGIQUE DE LA VILLE DE DURRËS

RESUME

L'accélération du rythme des constructions au cours de ces dernières années dans la ville de Durrës, ainsi que le besoin d'un nouveau plan d'aménagements qui définirait une fois pour toutes la perspective de l'évolution de l'urbanisme de la ville, fit appeler la nécessité impérieuse d'une définition de la zone archéologique qui sanctionne et garantit la sauvegarde des monuments.

Pour cela, on fit la récognition sur place qui fut accompagnée par la fixation des monuments sur la carte.

Dans deux zones éloignées l'une de l'autre, on rencontre des traces de matériaux de VIIe-VIe sc. av.n.e. Les traces matérielles du IVe au IIe sc. se présentent plus nombreuses. Le nécropole de la ville s'étend déjà sur une superficie de 60 ha, occupant toutes les basses collines du nord, alors que sur le plateau à l'est du nécropole, entre la chaine des collines et la lagune, apparaissent les traces des habitations et des constructions sociales qui occupent une superficie de 50 ha. Vers le sud, ces traces deviennent moins denses.

On peut supposer que de pair à la partie nord-ouest où s'installa la colonie et qui, parait-il, communiquait avec la mer par la lagune ouverte au nord, évolua l'agglomération précédente qui reliait les deux parties.

Aux premiers sc. de n.e. la vie au nord, au bord de la lagune subit une décadence presque complète et se déplace au sud, peut-être à cause de la dégénération de la lagune en marée. L'orientation des monuments de ce territoire montre que les routes actuelles suivent exactement le réseau urbanistique de cette époque et la zone des habitations s'oriente vers le nord, alors que celle des constructions sociales se concentre au sud. La principale enceinte des années 491-518 montre que la ville au cours de cette période de la Basse Antiquité subit un retrécissement, de 90 ha sa superficie devint 50 ha. Le système des canalisations et une grande basilique au centre démontrent la conservation du réseau urbanistique. Entre temps les églises paléochrétiennes à l'intérieur des quartiers, entourées de cimetières, font preuve d'une multiconcentration, un élément nouveau du schéma de l'urbanisme.

Même au Moyen-Age, la ville conserva le réseau urbanistique et le contour précédent. Mais en 1496 elle se transforma «en une grande ville ruinée». Comme telle, elle fut facilement envahie par les turcs, qui en 1502 réduirent sept fois sa superficie. Les traces déjà mentionnées montrent que la zone plate limitée par l'enceinte du Ve-VIe sc., surtout la partie à l'intérieur de la principale enceinte, représente la zone la plus dense et la plus riche en monuments. C'est pour cette raison qu'on prévoit nommer centre historique le territoire plat à l'intérieur des murs d'enceinte, qui est composé de la zone musée à l'intérieur de l'enceinte principale et de la zone mise sous protection. Afin d'adoucir la contradiction entre la continuité de la vie et la sauvegarde des valeurs qui ne sont pas encore mis au jour, dans la zone musée on permet de nouvelles constructions seulement autour du centre et des deux magistrats qui déjà ont acquis leur physionomie, mais toujours après les fouilles archéologiques, en rendant accessibles aux visiteurs les monuments mis au jour, comme au cas de thermes. L'autre partie avec des habitations dégradées sera convertie en zone couverte de verdure, où seront permis seulement quelques basses constructions à fondations peu profondes, au dessus de la couche culturelle. Dans la zone mise sous protection, les nouvelles constructions ne doivent pas altérer l'aspect visible des monuments mis au jour. Enfin, le territoire au délà de l'enceinte, occupé par le cimetière du I-IIIe sc. sera nommé zone en surveillance alors que le territoire occupé par la ville antique au bord de la langue, qui demeure un terrain agricole intact des travaux en profondeur, sera traité comme zone en surveillance.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Genc HAJDARI

VARRET MONUMENTALE TË SELCËS, PROBLEME TË KONSERVIMIT

Varret e Selcës i përkasin periudhës qytetare ilire, shekujve IV – III p. e. sonë. Me arkitekturën, zgjidhjen urbane dhe atë kompozicionale, kjo vepër e shquar e arkitekturës ilire bën një monument unikal të gjinisë së saj në vendin tonë dhe jashtë. Qyteti ilir, të cilit i përkasin këto varre, mendohet të jetë Peljoni.

Për nga mënyra e punimit, në Selcë hasen 2 tipe varresh, të skalitura në shkëmb dhe me mjedise të mbyllura me blloqe guri, të veçuara nga të gjitha varret e tjera. Varret shkëmbore përbëhen nga paradhoma e dhoma e punuar në brendi të shkëmbit. Madhësia dhe plastika volumore e tyre është e ndryshme, ndërsa në stil të kujtojnë orderin jonik. Varret karakterizohen nga plastika arkitektonike e skalitur në sipërfaqe të shkëmbit natyror, e cila fiton rol parësor dhe përbën vlerën kryesore të veprës monumentale. Në këto varre del mirë në dukje, realizimi mjeshtëror i plastikës, nëpërmjet mënyrave tradicionale të gurskalitjes. Aty shihet «plastika e madhe», krijimi i formave të përgjithshme me teknikën e shkathët e të ngrohtë të daltimit me sgupje nga tehu i sëpatës, kombinuar me ritmikën e daltës-shtizë ose me majë e presë. Me këtë teknikë është arritur që elementet skulpturale, dekorative, të spikasin qartë. Në këta të fundit, veçanërisht në fakturat e drapërive, ornamentet mortore, kanelyrat e pilastrave, kapitelet etj. plastika e faktura është realizuar me daltat presë shpatuke shumëdhëmbëshe ose me dhëmbë të imët. Varret monumentale të Selcës janë grabitur dhe dëmtuar që në fillim, pak mbas ndërtimit të tyre e deri në shekujt e fundit të antikitetit të vonë, kur ato u mbuluan nga mbushjet e ndryshme. Pas vitit 1971, gjatë të cilit u zbuluan varret monumentale, është vërejtur se dëmtimet janë në rritje të vazhdueshme. Është e qartë se faktori kryesor, që ka ndikuar dhe përshpejtuar dëmtimin, alterimin, është veprimi shkatërrues i agjentëve atmosferikë (fig. 1. 2).



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

Ndryshimet e temperaturës, duke krahasuar vlerat maksimale e minimale për stinat dimër-verë (– 13.5° dhe +22.5°) dhe vlerat më të mëdha të regjistruara gjatë 10 vjetëve të fundit – 15.5° dimër dhe + 36.6° verë, dëshmojnë për një klimë kontinentale shumë të ndryshueshme. Fenomenit bynim-tkurrje që ndodh nga kjo diferencë e temperaturave i shtohen pasojat nga rreshjet, që paraqiten me ngarkesë të madhe në të tria stinët, vjeshtë, dimër, pranverë. Ndoshta këtu ndikon dhe klima e liqenit të Ohrit. Nga ana tjetër, rrjeshjet e shumta në periudhën e kalimit nga stina e vjeshtës në atë të dimrit dhe daljen në fillim të pranverës, shoqërohen nga një periudhë e gjatë ngricash. Shkëmbi i ngopur me ujë gjatë vjeshtës e dimrit, i nënshtrohet ngrirjes në dimër, me pasojat e rritjes së volumit të ujit në brendi, gjatë kthimit të tij në akull. Me shkrirjen e më pas avullimin, gjatë verës shtresat e sipërfaqes bëhe më tepër poroze dhe i ndiejnë më tepër gërryerj nga erozioni. Në vazhdim, tharja e plotë, shkakto shkriftimin dhe rënien e sipërfaqes së shkëmbit n formë petash ose pluhuri. Fenomeni dëmton veçanë risht sipërfaqet e punuara me dekoracion dhe ele mentet arkitektonike. Nga ana tjetër, shkëmbi, ndie veprimet fiziko-kimike që lidhen me përbërjen mi neralogjike të tij. Formacionet e Selcës janë sedi mentare ranore. Si të tilla, ato mund të paraqiten s ranore, kuarcore, feroze ose argjilore, me funksio të lidhësit çimentues në përbërje të papërfillshm për fushë. Ranoret e çimentuar me karbonat kalciu mi shkatërrohen nga tretja e karbonatit në kontak me ujërat acide dhe meteorike dhe me riformim të gëlqeres në sipërfaqe gjatë stinës së nxehtë. Ranore kuarcite kanë rezistencë ndaj veprimeve kimike. Ana

liza petrografike tregoi se varret e Selcës janë punuar në formacione të llojit kuarcor me 95% bioksid selici, me kokërrzim të imët dhe sortim të mirë (fig. 3, 4, 5, 6.)

Shkëmbi është i ngjeshur në formacionin e tij gjeollogjik. Por, ngjeshja dhe lloji i radhitjes, njëtrajtshmëria e kokrrizave të kuarcit tregon për një kohezion të dobët. Megjithatë, kokrrizat tepër të puthitura nuk lejojnë mundësi për penetrim likuidesh të reja çimentuese, veçanërisht ky lloj ranori nuk pëson alterim kimik, por vetëm fizik dhe rolin dëmtues e ka klima shumë e ndryshueshme e Selcës së Poshtme. Krahas analizave të përmendura, të arritura në sajë të bashkëpunimit me Institutin e Hidrometereologjisë dhe Gjeologji-Minierave, duke u bazuar në to; kryem analizën e dëmtimeve. Këto dëmtime i kemi klasifikuar në disa lloje: 1. Elemente dekorative të humbura. 2. Shkëputje elementesh të plota ose të pjesshme, që ndodhen pranë monumentit. 3. Rrëzime sipërfaqësore në fasadë nga shkriftimi i vazhdueshëm me rënien e fakturës. 4. Çarje masive në thellësi, sipas shtresëzimit gjeologjik të krijuar më herët sesa ndërtimi i monumentit. 5. Dëmtime nga bimësia, myshqet dhe algat, të cilat shkaktojnë krijimin e gropave, mbulimin e pjesëve të fasadës dhe ndryshimin e ngjyrës. 6. Dëmtime të bazamentit nga pikat e shiut që bien nga kornizat dhe shkaktojnë shkarjen e shtresave sipërfaqësore.

Në përfundim të kërkimeve tona u arrit të formulohet parimi duke vendos që monumenti të ruhet në gjendjen e sotme, si dhe teknologjia e ndërhyrjes. Mbulimet masive, apo ndërhyrjet e tjera, të karakterit të shtesave, u parashikuan të përdoren vetëm në raste të veçanta. Plotësimet e pjesëve



Fig. 4



Fig. 5

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 6



Fig. 7

munguese duhet të përmbushin kushtet konstruktive dhe estetike. Së fundi, trajtimi i sipërfaqes shkëmbore u vendos të bëhet me rezinë Rhodorsil – XR – 893 metifenilpolisilikon të shkrirë në toluen me një tretje përfundimtare 15% solid. Mbi këto kritere kemi bindjen që monumenti do të jetë krejtësisht i siguruar nga dëmtimet e mëtejshme duke u ruajtur në gjendjen që ka arritur deri më sot dhe nga ana estetike do të jetë më i kompletuar.

Për restaurimin e varreve monumentale të Selcës së Poshtme ndërhyrja u bë në tri momente me renditjen: pastrim, konsolidim dhe mbrojtje.

Diagnostikimi i varreve monumentale u bë du
vjelë një dokumentacion të shumëllojshëm, i cili
plotësua me një informacion të vazhdueshëm të ç
stine, ku u evidentuan në përgjithësi sëmundjet
gurit, për t'i klasifikuar ato dhe për të dhënë kri
katet e sakta që duhet të përdoren. Ndër anët n
gative të formacionit shkëmbor të Selcës, ësh
thithshmëria e madhe e ujërave, poroziteti i lartë
sipërfaqe, që krijon korozion nga ndryshimet e te
peraturës. Gjurmët e këtyre formacioneve, sidom
tretja e lidhësit gëlqeror në kontakt me ujërat a
de e meteorike, shihet në zonën e gropëzimeve kr
hasimisht të mëdha, ku krijohen shtresa të petëzu
ra (11 – 20 cm), të cilat i nënshtrohen ciklit të mi
llëzimit. Koret e formuara nga koha, pluhurat, bim
sia, ndotjet dhe elementet e tjera të depozituara
fakturë, në rastin tonë, kur monumenti 70% të tij
e ka eksterier, kanë një ndikim tepër të keq. Nd
dëmtuesit kryesorë të fakturës së monumentit ja
kripërat e tretshme, sepse ato depërtojnë brenc
poreve, apo të çarave të materialit me anë të cikl
ve të lagies dhe tharjes, që janë të paevitueshm
në çdo klimë. Rrjedhimisht, kërkesat kryesore gja
pastrimit dhe mbrojtjes qenë si më poshtë: Ko
trolli i vazhduar për shkallëzimin e operacionit
pastrimit sipas kërkesës së monumentit, eliminimit
materialit që del gjatë pastrimit, që mund të bëh
shkak për proceset e ardhshme koroduese, mbajtja
lëmuar, e sipërfaqes, pa të çara, ashpërsime e plo
saritje, sepse në të kundërt shpejtohet procesi i pr
shjes nga erozioni.

Konsolidimet u kryen në ato vende ku monu
menti e kishte humbur rezistencën fizike. Për këtë



Fig. 8

duke marrë parasysh se ranori i Selcës në procesin e imprenjimit është i predispozuar për thithjen, sepse hapësira midis kokrrizave mbushet me konsolidant në mënyrë të etshme, u përdorën dy procese imprenjimi. Në ndërhyrjen e parë u imprenjua konsolidimi kimik, material inorganik, i aftë që të ngjisë strukturën e gurit. Në ndërhyrjen e dytë u synua të futej sasi sa më e madhe ngjitësi, solucioni, rezinë, midis kokrrizave që e kishin humbur lidhjen. Kjo u arrit me rezinë paraleloide B/72 të tretur me shkrirës aceton ose toluol. Eksperimentalisht u përdor rrëshira monomere ose termoplastike me veti tepër të lëvizshme, të cilat sollën si rezultat një imprenjim më të thellë.

Për sigurimin nga çdo dëmtim i mëtejshëm elementet ndërtimore dhe skulptura dekorative u plotësuan me një ndërhyrje të dallueshme në ngjyrë, por që lidhet në harmoni me pjesët origjinale të monumentit. Me të njëjtën teknologji u ribënë për simetri në fasadë disa kapitele e pilastra të humbura, të cilat e ndihmuan monumentin, si nga ana konstruktive, ashtu dhe estetike. Stukot dhe ngjitësit që u përdorën në Selcë kishin kërkesë bazë komogjenizimin. Për këtë të çarat dhe plasaritjet u mbushën me stuko të përgatitur me pluhur silici dhe rrëshirë epokale të lëngshme. U përdor gjithashtu dhe silici me acetat polivinili. Këto mbyllën rrugët nga mund të futej uji në thellësi të monumentit, me qëllim që të rritej rezistenca dhe të shmangej dëmtimi mekanik nga bymimi. fig. 7, 8.

Punimet restauruese – konservuese u shtrinë në të gjitha varret me pllombine, mbushje të karakterit konstruktiv e estetik. Qepjet atike, në dhomën e varrimit të Varrit 1, ku gjetëm gjurmët, u plotësuan duke ruajtur të njëjtën gjuhë trajtimi, por me gurë kuadratikë të rinj, të së njëjtës kavo. U çimentuan çarjet gjeologjike dhe u krijuan mbulesa provizore me ondoluks mbi konstruksion druri, për të parë shkallën e ruajtjes e dëmtimit të monumentit gjatë një 10 vjeçari.

Këto janë përmbledhtazi rezultatet e studimit, eksperimentimit dhe restaurimit në varret monumentale të Selcës së Poshtme. Punimet do të vazhdojnë dhe në vitet e ardhshme duke patur parasysh që krahas konservim-restaurimit të bëhet dhe ekspozimi përfundimtar i monumentit.

DO NOT COPY

Genc HAJDARI

LES TOMBES MONUMENTALES DE SELCE, PROBLEMES DE CONSERVATION

RESUME

Les tombes monumentales de Selce remontent à la période urbaine illyrienne des IV-IIIe sc. av.n.e. Par leur architecture, leur solution d'urbanisme et de composition ils constituent le monument unical dans leur genre, chez nous et à l'étranger.

On y distingue, quant au mode de construction, deux types de tombes: sculptées dans le roc et construites en murs de pierres quadratiques. Les tombes sculptées dans le roc représentent une construction à deux pièces: vestibule et chambre funéraire. Elles sont de différentes dimensions mais leur style nous rappelle l'ordre ionique. Les tombes monumentales ont été pillées et endommagées dès le début, peu après leur construction jusqu'aux derniers siècles de la Basse Antiquité, quand elles furent remblayées. Depuis les fouilles de l'année 1971 on remarque que les agents atmosphériques influent toujours sur l'altération ultérieure du monument.

On y remarque des éléments décoratifs détachés ou perdus, des affaissements superficiels dans les façades, des altérations causées par une grande variété de formes végétales comme: les différentes plantes, les algues, des dégâts de la base où s'écoulent la pluie des corniches entraînant le glissement des couches superficielles du terrain.

La restauration des tombes monumentales de Selca consi au nettoyage, à la consolidation et à la protection. On y p céda graduellement, faisant attention au nettoyage des détri qui pourraient causer une corrosion ultérieure et au maint d'une superficie lisse sans lézardes, rugosité ou fentes.

La consolidation consista là où le monument avait pe la résistance physique.

Pendant la première intervention on y imprégna du maté inorganique afin de coller les parties en pierre. Pendant deuxième intervention on essaya d'introduire une bonne quan de résine paraloid B 72 parmi les grains qui avaient pe leur liaison. Afin d'empêcher une dégradation ultérieure, éléments de construction et la sculpture décorative fur complétés d'une autre couleur qui se marie bien avec les part originales du monument. Pour réaliser une symétrie de la façade on compléta par la même technologie quelques cha teaux et pilastres perdus. Les lézardes et les fentes furent bo chées d'un stuc préparé par de la poudre de silice et de résine époxide liquide qui empechêrait l'infiltration de l'e en profondeur du monument.

Les travaux de restauration en cours, de pair à la prote tion du monument, visent à le rendre accessible aux visiteu

DO NOT COPY

Gjergj FRASHËRI

BASHKËPUNIMI MË I NGUSHTË ARKEOLOG-RESTAURATOR, GARANCI PËR ARRITJEN E NIVELEVE MË TË LARTA NË KONSERVIMIN E MJEDISEVE ARKEOLOGJIKE

Kur flasim për konservim të rrënojave arkeologjike gjatë proçesit të zbulimit nënkuptojmë ndërhyrjen për mbrojtjen e tyre qëkurse ato fillojnë të dalin në dritë, ose më konkretisht pjesëmarrjen dhe veprimtarinë e restauratorit në procesin e gërmimeve arkeologjike. Duhet përmendur me këtë rast se bashkëveprimi paralel i arkeologut me restauratorin gjatë zbulimit të mjedisit arkeologjik, edhe në përvojën botërore, është një nga praktikat më të reja të shkencës së restaurimit të monumenteve. Madje, në vendin tonë, për një veprimtari të tillë mund të flasim vetëm pas çlirimit. Ato pak zbulime spontane që u bënë deri në vitet 30 nga misionet e huaja, jo vetëm që nuk u shoqëruan nga ndëhyrjet konservuese, por edhe më pas, mjedise të zbuluara si ato në Apoloni, Finiq, Butrint, u lanë në mëshirën e fatit. Kuptohet se për vetë mungesën e theksuar të traditës dhe të specialistëve që u trashëguan nga e kaluara në fushën e mbrojtjes së monumenteve në përgjithësi, ende në vitet 50, kur në vendin tonë morën hov ekspeditat arkeologjike, nuk mund të themi se ato u bashkërenduan me veprimtarinë e njëkohshme të restauruesve. Për rrjedhim, në ndonjë nga mjediset e zbuluara në këtë periudhë (si p.sh. në mbetjet e vendbanimit palafit të Maliqit), mund të vërejmë se ndërhyrjet konservuese nuk u kryen në kohën e duhur, domethënë nuk iu përgjigjën nevojave të menjëhershme, madje edhe niveli i tyre profesional, sigurisht që linte për të dëshiruar. Kjo gjendje pa dyshim ndikoi në mosruajtjen si duhet të materialit kulturor të zbuluar, jo të objekteve arkeologjike për të cilat u tregua qysh në fillim një përkujdesje e veçantë nga vetë arkeologët, për konservimin e tyre në terren dhe laboratorik, por për mbetjet «in situ» të mjedisit, konservimi i të cilave u takonte specialiteteve të ngushta të restaurimit.

Ndërsa veprimtaria konservuese e mbetjeve arkitektonike filloi në vendin tonë në vitet 50, bashkëpunimi i arkeologëve, me restauruesit, qysh në fazën e zbulimit të rrënojave arkeologjike, nisi të bënte hapat e veta në kapërcyellin e këtij dhjetëvjeçari. Me fillimin e viteve 60 pjesëmarrja e konservuesve në gërmimet arkeologjike, erdhi gjithnjë duke u shtuar. Fillimisht, ajo u sigurua për zbulimin e mjediseve të kohës antike dhe pak më vonë, për ato mesjetare. Mjaft nga zbulimet e kryera në kalanë e Lezhës, të Zgërdheshit, të Kaninës, të Apolonisë, të Butrintit, të Beratit, të Klosit, të Bylisit, të Krujës, të Durrësit, të Prezës, të Petrelës, të Shurdhahut, të varreve monumentale në Selcën e Poshtme, në termet e stacionit të Bradashesht, të kishave paleokristiane të Bylisit, Arapajt, Ballshit, të mozaikëve në Apoloni, Tiranë, Durrës etj. janë realizuar nga veprimi i përbashkët i arkeologëve dhe i konservuesve, të parët me detyrën e drejtuesit të gërmimeve, të dytët me atë të konservimit të rrënojave, qysh në momentin e shfaqjes së tyre. Përvoja e mbledhur deri tani vërteton se niveli i konservimit të rrënojave arkeologjike varet pikërisht nga shkalla e pjesëmarrjes në gërmime të restauruesve. Në këtë kontekst, ka vend për të shtjelluar avantazhet që fitohen në mbrojtjen e vlerave të monumentit, prej pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së konservuesve në procesin e gërmimit arkeologjik të tij. Por në të njëjtën kohë, kanë vend për t'u trajtuar edhe problemet që lindin në harmonizimin e veprimeve të tyre të pavarura. Ndërhyrjet për mbrojtjen e rrënojave arkeologjike gjatë gërmimit, ndonëse veprojnë me të njëjtat mjete, kanë natyrë tjetër nga ato që kryhen pas zbulimit në mbetjet arkitektonike. Përveç shkallës së lartë të reversibilitetit, ato karakterizohen në përgjithësi nga mënyra provizore e veprimit, pasi një mënyrë përfundimtare e konservimit të tyre në këtë etapë nuk mund të kryhet pa njohjen e plotë të rrënojës.

Midis ndërhyrjeve më me përgjegjësi, më të shpeshta dhe më urgjente që janë kryer në mjediset arkeologjike gjatë zbulimit të tyre, mund të përmen-

DO NOT COPY

dim pajantimet e ndryshme të karakterit provizor për mënjanimin e shembujve të rrënojave me boshllëqe e zgavrime (termat Bradashesh, kalaja e Beratit, e Prezës, e Krujës etj.), për largimin e masës së dherave që peshojnë mbi rrënojat, nëpërmjet vetë gërmimit arkeologjik (kalaja e Prezës, ajo mesjetare e Lezhës, e Beratit, e Ishmit, oborrit i fortifikuar i Krujës, etj.) në rimbushjen me dhé të rrënojave, nga një sezon i gërmimit në tjetrin (kalaja e Krujës, bazilika e Ballshit etj), për mbulimin me strehë të përkohshme të tyre (termat Bradashesh, kalaja e Krujës, etj.) kanalizimet, drenazhet dhe rrethimet me gardh të mjedisit gjatë zbulimit të tij, etj.

Përvoja e derisotme tregon qartë se çdo gjë që bëhet në momentin, kur struktura e rrënuar fillon të dalë në dritë, mbetet vendimtare për jetëgjatësinë e saj, më tepër sesa ndërhyrjet që bëhen më vonë. Dihet se këtë ndihmë të parë në gërmim e japin konservuesit. Në këtë kontekst, pjesëmarrja e restauruesve në tërë procesin e zbulimit të mjedisit është bërë tashmë një normë e afirmuar. Planifikimi dhe aktivitetet e përbashkëta midis QKA dhe IMK në gërmimet arkeologjike të kryera në dy dekadat e fundit, si në kalanë e Zgërdheshit, të Lezhës, të Durrësit, të Bylisit, të Butrintit, të Krujës, të Shkodrës, të Beratit, në mozaikët dhe rrënojat e bazilikës së Bylisit, Arapajt, të Ballshit, etj., përbëjnë një praktikë që tregon se aspektet e konservimit të rrënojave po konsiderohen nga vetë arkeologët si pjesë përbërëse e gërmimeve arkeologjike.

Në fakt, në praktikën ndërkombëtare, ndarja midis atij që gërmon dhe atij që restauron ka qenë shumë e fortë në të kaluarën, pothuaj një hendek i pakapërcyeshëm. Ai ka konsistuar në moslënien, nga ana e arkeologëve, e kryerjes së veprimeve konservuese gjatë zbulimeve të tyre. Çështjen e konservimit të materialit arkeologjik ata e kanë konsideruar si një veprimtari që kryhet pas gërmimeve dhe jashtë çdo përgjegjësie të tyre. Pa dyshim, ky koncept i vjetëruar metodologjik vazhdon të ketë ndikimet e veta, bile vihet re se, për arsye të ndryshme, ai ekziston ende i tillë në praktikën e ndonjë vendi. Por në përvojën e përparuar ndërkombëtare, ky hendek, ka nisur të kapërcehet dhe tashmë është pranuar epërsia e bashkëveprimit në gërmime të arkeologut dhe restauruesit. Si shembull të freskët mund të sjellim dy ballafaqimet e fundit ndërkombëtare të organizuara nga ICCROM-i për shkëmbimin e përvojave të konservimeve arkeologjike. Megjithatë, **(Conservation on archaeological excavations,** ICCROM, Romë, 1984 dhe **Preventive measures during excavation and site protection,** ICCROM Rome, 1986). Megjithatë, këtu nuk e kemi fjalën për zhdukjen e dallimit të detyrave midis arkeologut dhe konservuesit. Në një gërmim të organizuar mirë, dallimi duhet të jetë i qartë mi asaj që arkeologu duhet të bëjë vetë dhe asaj që nuk duhet të bëjë vetë, që është konservimi i objteve dhe i strukturave in situ. Kjo është evidente, p si duke punuar direkt mbi të njëjtin material, detyra dhe interesa të ndryshme, arkeologëve d restauruesve gjithmonë u dalin përpara probleme, cilat kanë të bëjnë me fushën e përgjegjësisë së cilit me pavarësinë e veprimtarisë së tyre në terr me koherencën midis kërkesave për zbatimin pa penguar të kritereve të kërkimit arkeologjik (medologjisë stratigrafike), ndaj atyre, që hapin në njëjtën kohë nevojat e konservimit. Fjala është respektimin reciprok në kryerjen e veprimeve të se lit, paralelisht. Për mendimin tonë faktori kryesor ndikon në harmonizimin e këtyre detyrave është v arkeologu. Kushti që i kërkohet atij është që të p nojë vlerën dhe mundësinë e ndërhyrjeve konservu se në gërmimet e tij dhe njëkohësisht kriterin që gjë të mos zbulojë kur s'ka siguri në konservimin saj. Nga ana tjetër edhe për konservuesin ka dyshim kufizime. Gjatë gërmimit ai nuk mund të p tendojë të kryejë konservime për çdo mbetje që sh qet, por të kryejë vetëm ato ndërhyrje që janë ve dimtare për shpëtimin e rrënojës, kur ka përpara tuata të rënda për çdo moment kohe që ikën. Gji ashtu edhe për sa i takon mënyrës dhe afatit konservuesi cakton për ndërhyrje, masës së integri dhe shkallës së reversibilitetit të saj, pavarësisht këto çështje janë në kompetencë dhe kryhen prej mendojmë se ato duhet të gjejnë miratim të përb shkët.

Formula teknike dhe harmoninë e dialogut keolog-konservues në morinë e rasteve që paraqit për zgjidhje gjatë gërmimit të mjedisit, është e p mundur të jepen. Punimet tona të kumtuara në Konferencën II Ndërkombëtare për konservimet arkeologjike, patën tërhequr disi vëmendjen për **përgjegjsinë e përbashkët** në zbulimin e një mjedisi, një p kufizim, ndoshta i njohur nga pikëpamja teorike, p jo aq i provuar në terren nga ana praktike. Kjo të thotë se, megjithëse teorikisht është pranuar tas më prej kohësh, se «zbulimi pa konservim është r nim», në praktikë, vihet re se, ende nuk ka gjetur zgjidhje të vetme organizative dhe se të gjitha pë vojat janë në këtë drejtim në rrugën e kërkimeve mëtejshme. Lidhur me këtë çështje kemi shpreh mendimin se në praktikën e punës sonë për mbr tjen e mjediseve arkeologjike, zbulimi dhe konservi në çdo etapë të tyre përbën vetëm një qëllim d konsiderohet vetëm një detyrë. Formula bazë e pra tikës për realizimin e këtij qëllimi në terren ësh vetëm përgjegjësia e përbashkët mbi gjithçka që ës të detyrë të arrihet.

BOTIMI I PARË

Gjergj FRASHËRI

DO NOT COPY

L'ETROITE COLLABORATION ARCHEOLOGUE-RESTAURATEUR, UNE GARANTIE POUR ATTEINDRE LES PLUS HAUTS NIVEAUX DE LA CONSERVATION DES MILIEUX ARCHEOLOGIQUES

RESUME

Sur la conservation des ruines archéologiques au cours de leur découverte, on ne peut parler qu'après la libération nationale du pays. Il est évident que par manque de tradition et de spécialistes, au cours des années 50, quand les expéditions archéologiques prirent un certain élan, on ne peut pas parler de collaboration avec les restaurateurs. Par conséquent, dans quelques milieux découverts à cette époque, le niveau professionnel des interventions de conservation laisse à désirer, non pas envers les objets archéologiques qui dès le début furent maintenus d'attention par les archéologues eux-mêmes, mais envers les restes in situ des milieux dont la conservation revenait aux spécialités de restauration.

Au début des années 60, la présence des conservateurs dans les fouilles archéologiques devint de plus en plus évidente. Elle débuta avec la découverte des milieux des époques antiques plus tard à celle du Moyen-Age. Plusieurs découvertes effectuées dans la forteresse de Lezhë, Zgërdhesh, Kanine, Apollonie, Butrint, Berat, Klos, Bylis, Krujë, Durrës, Prezë, Petrelë, Shurdhah, aux tombes monumentales de Selca e Poshtme, aux églises paléochrétiennes de Bylis, Arapaj, Ballsh, aux mosaïques d'Apollonie, Tirana, Durrës etc., sont réalisées par la collaboration des archéologues et des conservateurs. Parmi les plus fréquentes et les urgentes interventions entammées sur ces milieux, furent les étayages de caractère provisoire qui évitaient l'éboulement des ruines, (les thermes de Bradashesh, la forteresse de Berat, Preze, Krujë, etc.), le déblaiement des terres qui encombraient les ruines (la forteresse de Preza, celle médiévale de Lezha, de Berat, la cour fortifiée de Kruja et Ishmi etc.); le remblayage des ruines d'une saison des fouilles à l'autre (la forteresse de Kruja, la basilique de Ballsh, etc.), les couvertures provisoires (les thermes de Bradashesh, la forteresse de Kruja, la basilique de Ballsh etc.); les canalisations, les drainages et les enceintes du terrain au cours de sa découverte etc.

L'expérience actuelle montre que le niveau de la conservation des ruines archéologiques dépend de la participation des restaurateurs aux fouilles. Dans ce contexte, la participation des restaurateurs pendant tout le processus d'une découverte archéologique, est déjà devenue une norme affirmée. La planification et les activités communes, entre le centre des Recherches Archéologiques et l'Institut des Monuments Culturels, au cours des fouilles archéologiques effectuées pendant les deux dernières décennies, représentent une pratique qui montre que les aspects de la conservation des ruines sont considérés par les archéologues eux-mêmes, comme partie intégrante des fouilles archéologiques. Il est impossible de donner des formules techniques sur l'entente du dialogue archéologue-conservateur, dans les nombreux cas qui se présentent au cours des fouilles. Nos travaux communiqués à la conférence Internationale sur la conservation archéologique, qui se tint à Gent (Belgique), attirèrent l'attention sur la responsabilité commune dans la découverte d'un milieu, une définition peut-être connue du point de vue théorique, mais qui n'est pas bien expérimentée sur place du point de vue pratique. Cela veut dire que bien que théoriquement on admette depuis longtemps déjà que «découverte sans conservation est une ruine», en pratique on remarque qu'elle n'a encore trouvé une solution bien organisée. Nous pensons que dans la pratique de notre travail, afin de protéger les milieux archéologiques, la découverte et la conservation doivent être vues dans chaque étape, en unité l'une avec l'autre.

La responsabilité commune sur la sauvegarde des valeurs mises au jour par la découverte archéologique devient la formule de base de la pratique pour la réalisation de cette unité sur place.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

FILLIMET E FORTIFIKIMEVE PËR ARTILERI NË SHQIPËRI

Transformimi rrënjësor që pësuan kështjellat mesjetare në vendet kryesore të Evropës, nga mesi i shek. XVI e më vonë, duke u kthyer në fortesa të bastionuara, kushtëzohet nga zhvillimi i shpejtë i artilerisë me barut, që ishte shfaqur shumë kohë më parë. Për të arritur deri tek sistemet e bastionuara u desh të kalohej një rrugë e gjatë kërkimesh e transformimesh për t'i përshtatur këto ndërtime mbrojtëse kundrejt mjeteve dhe mënyrave të reja të sulmit. Pikërisht, këtë periudhë kalimtare, që shënon fillimet e një epoke të re në historinë e fortifikimit, do të përpiqemi ta ilustrojmë me shembuj materialë e letrarë nga territori i Shqipërisë. Megjithëse për goditjen e kështjellave qenë përdorur topa që nga mesi i shek. XVI, kjo armë e cila do të përmbyste një sistem të tërë fortifikimi, i cili i kish rezistuar shekujve, do të arrinte suksesin e saj të vërtetë vetëm një shekull më vonë, në mesin e shek. XV.

Teoritë e para moderne të fortifikimit që u shfaqën rreth kësaj kohe, fillimisht në gadishullin Apenin dhe u materializuan në ndërtimin e kështjellës së Viskontëve të Milanos, parashikonin sistemin e kullave rrethore me të njëjtën lartësi me kurtinat dhe rritjen e dukshme të trashësisë së mureve të tyre. Në të njëjtën kohë ne shohim të realizohet në praktikë një ide të tillë edhe në kullën e hyrjes së kalasë së Krujës, të ndërtuar nga Skënderbeu në vitet 1451-52, si dhe në një kullë tjetër rrethore të kësaj kalaje nga ana jugperëndimore. Barleti na jep të dhëna të sakta për formën e kullës së hyrjes dhe për qëllimet që e shtynë Skënderbeun ta ndërtonte atë në mënyrën e përshkruar prej tij. Sipas thënies së Barletit, Skënderbeu e ndërtoi këtë kullë në mënyrë të tillë që të mos ngrihej mbi muret rrethuese e kështu të mos goditej nga artileria armike, ndërsa bazës së saj i dha pjerrësi në formën e një skarpati». Kjo kullë e restauruar



Fig. 1

në vitin 1967 (fig. 1) ruhet akoma edhe sot me të gjitha karakteristikat e saj, në hyrjen kryesore të kalasë së Krujës, duke shërbyer si një dokument i rëndësishëm historik jo vetëm për historinë e fortifikimeve shqiptare, por edhe për saktësimin e thënieve të Barletit edhe me hollësi të tilla arkitektonike. Vlen të përmendim dy raste akoma më të hershme, ku, gjithashtu, gjejnë zbatim praktik në formë fillestare parime të tjera të teorisë moderne të fortifikimit.

Midis viteve 1407-1416, në kalanë e Shkodrës, para hyrjes kryesore u ndërtua një barbakan dhe një sistem para muresh gjatë gjithë anës veriore të kështjellës. Sistemi i paramureve paraqet interes për temën në shqyrtim. Ato formojnë kënde të mprehta, të ngjashme me bastionet, janë mjaft më të ulëta se muret e kështjellës dhe bien me pjerrësi mbi terrenin

duke filluar që nga kreshta e tyre, ndërsa në pjesën e brendshme janë të mbushura me dhe, gjë që i bënte më rezistente kundrejt goditjeve të artilerisë. Një element tjetër me rëndësi është një hyrje e fshehtë në rrëzë të këtyre mureve, e cila, sipas përshkrimit të Barletit, ishte e gdhendur në shkëmb të gjallë dhe në brendësi kishte kthina ku mbaheshin armë e municione për mbrojtjen e «gropave». Këtu është fjala për mbrojtjen e hendekut që ndodhej para këtyre mureve. Ideja e mbrojtjes së rrëzës së hendekut zhvillohet e materializohet vetëm në fortifikimet e bastionuara gjatë shek. XVI, kur për këtë qëllim përdoret dhe zjarri i artilerisë. I së njëjtës natyrë dhe me siguri i shek. XV, është dhe fortifikimi për artileri në Shirokë, buzë liqenit të Shkodrës. Gjatë shek. XV vihen re edhe ndërhyrje të tjera në kështjellat mesjetare për t'i bërë ato më rezistente kundrejt goditjeve të artilerisë, siç është rritja e trashësisë së mureve, kthimi i kullave drejtkëndëshe në rrethore si dhe ndërtimi në to i bazamenteve të pjerrëta, siç mund t'i hetojmë në kalanë e Drishtit, në Petrelë, dhe në kështjellën e sipërme të Krujës ku trashësia e murit arrin në 5 m.

Në radhën e kështjellave të modifikuara, apo të ndërtuara në këtë periudhë, një vend të veçantë zë kalaja e Rodonit (fig. 2), e ndërtuar në mesin e shek. XV nga Skënderbeu. Ne nuk do të parashtrojmë qëllimet që e shtynë Gjergj Kastriotin të ndërtonte këtë kështjellë dhe as rëndësinë e saj strategjike e ekonomike, por se ç'të reja solli ajo në artin e fortifikimit të kohës. Nga gjurmët e ruajtura në këtë kështjellë të bie në sy menjëherë lartësia e vogël e murit me frëngji topash parahyrjes, si dhe trashësia e madhe e mureve në këtë kompleks që arrijnë në 5 m. Por, po të shfletojmë dokumentat e kohës do të njihemi me një sërë të dhënash të sakta, që dëshmojnë për ide novatore për kohën që udhëhoqën projektimin e kësaj kështjelle. Me interes është përshkrimi i kështjellës para rindërtimit të saj nga venecianët, në vitin 1500. Muret cilësohen si të një trashësie të jashtëzakonshme duke qenë vetëm 6 këmbë të larta. Para murit ndodhej një kanal me thellësi 40 hapa dhe gjerësi 10 hapa, i cili ishte i mbushur nga shkarja e dheut e rrënimet. Kulla qendrore (torion), që është ajo pranë hyrjes, ishte pajisur me shumë kazemate e frëngji për artileri, të ndërtuara nga Skënderbeu, të cilat qenë rrënuar pjesërisht. Gjithashtu, kullat në të dy anët e murit në breg të detit ishin me mure mjaft të gjera dhe nuk e kalonin lartësinë 4 m. Nga gjurmët e ruajtura në vend kuptohet se kullat anësore kanë qenë ndërtuar posaçërisht për vendosjen e topave në mjediset e brendshme të tyre. Në rrënojat e njerës nga kullat ruhen gjurmët e një oxhaku që shërbente për nxjerrjen e tymit të shkaktuar nga djegia e barutit. Me interes është fakti i lartësisë së vogël të murit rrethues rreth 2 m dhe i gjerësisë së tij më tepër se 3 herë më të madhe nga lartësia, në një kohë kur sapo kishin filluar hapat e para të futjes së koncepteve moderne për fortifikimin. Një veçori tjetër është mbulimi me zjarr anësor të artilerisë, i rrëzës së murit nga ana e jashtme, si dhe të një pjese të hendekut, që është një nga karakteristikat thelbësore të sistemeve të bastionuara. Këto masa qenë kombinuar dhe me cilësitë mbrojtëse të terrenit, që siç shprehen specialistët bashkëkohës «ky vend qe vendosur në mënyrë të tillë që pak ushtarë nuk mund



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY

ta dëmtonin, ndërsa për një ushtri më të madhe nuk kish vendqëndrim».

Mbrojtjen e hendekut e shohim në fazën e saj embrionale që në kalanë e Shkodrës, ndërsa në Rodon ky mendim ka evoluar shumë, deri në vënien në përdorim të zjarrit të artilerisë. Tendenca për të ulur lartësinë e kështjellave mesjetare e sidomos kullat e tyre të larta dhe elegante, solli pas mesit të shek. XV lindjen e një tipi të ri kulle, që u quajt Rondele. Në disa vende Rondelet u përhapën gjerësisht vetëm në brigjet e Adriatikut, jo shumë kohë pas rënies së Konstandinopolit. Rondele u ndërtuan në Raguzë, Bokar, Minçeta, etj, dhe i atribuohen arkitektit të njohur italian Michelozzo Michelozzi, i cili pati veprimtari ndërtuese në këto vende gjatë viteve 1459-1462. Një nga këto Rondele është ruajtur në gjendje mjaft të mirë edhe në Durrës (fig. 3). Ajo ka një diametër rreth 17 m dhe lartësi 9 m (me gjithë bedenat). Përbëhet nga një mjedis i vetëm, i mbuluar me kupol sferike në të cilën vendosej një bateri prej 5 topash. Artileria mund të vendosej edhe mbi tarracë. Kulla duhet të jetë ndërtuar midis viteve 1456-1478, periudhë në të cilën u morën masa të ngutshme për fortifikimin e Durrësit nga Venecianët. Një nga elementet arkitektonike që lindën në këtë periudhë janë edhe frëngjitë për topa. Të ndërtuara bashkë me muret e kullës ato shfaqen mjaft herët në Shqipëri, para se kullat të fillojnë t'i përshtaten armës së re. Kështu kemi frëngji topash në kulla tipike mesjetare të kohës së armëve të ftohta si në Petrelë. Të njëjtën pamje kishin edhe kështjellat e mëvonshme që u ndërtuan nga pushtuesit osmanë, të cilat, nganjëherë, vetëm prania e frëngjive për topa i dallon nga kështjellat mesjetare të kohës së armëve të ftohta, siç është p.sh. kalaja e Prezës e Peqinit etj. Frëngjitë më të hershme ishin ato në formë vrime çelësi, në të cilat mbi vrimën e rrumbullakët për grykën e zjarrit ndodhej një e çarë vertikale për vrojtim. Frëngjitë e tjera kishin formën e një dritareje të mbuluar me hark ose përfaqësonin një zmadhim të thjeshtë të frëngjive për shigjeta. Shumëllojshmëria e tyre, ashtu si dhe në vende të tjera, tregon për një fazë eksperimentale. Siç shihet nga materiali i parashtruar, hapat e para drejt fortifikimeve të mirëfillta për artileri, në Shqipëri përputhen në kohë me fillimet e këtij procesi në vendet më të zhvilluara në këtë drejtim. Këto dukuri duhet t'i shohim në rolin që luajtën dhe në pozitën që zinin territoret shqiptare kundrejt ekspansionit osman, në traditën e pasur në forma e zgjidhje arkitektonike në fushën e fortifikimeve, si dhe në ndikimet e arkitekturës ushtarake veneciane e italiane të kohës. Zhvillimi i mëtejshëm i fortifikimeve shqiptare u ndërpre nga pushtimi turk. Fortifikimet e ndërtuara nga administrata osmane edhe të një shekulli më vonë ishin të varfëra në ide e mendime, ato përfaqësonin mure të thjeshta rrethuese me kulla për strehimin e një garnizoni. Mjaft kuptimplotë është fakti që për ndërtimin e kështjellës së Ishmit në vitin 1573 jepet porosi nga Porta e Lartë, që ajo të vendosej aq larg nga bregu i detit sa të mos mundte ta godiste topi i anijeve.

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

DO NOT COPY

LES PREMIERES FORTIFICATIONS DESTINEES A LA DEFENSE CONTRE L'ARTILLERIE EN ALBANIE

RESUME

Dans cette communication nous allons traiter la période passagère qui caractérise la transformation des forteresses médiévales destinées à se défendre contre les armes blanches, en fortifications contre l'artillerie, période qui marque le début d'une nouvelle époque dans l'histoire de la fortification. Vers la fin du XIVe sc. les féodaux albanais furent fournis d'armes à feu, importées de Venise et Ragouse tandis que au milieux du XVe sc. l'artillerie à poudre fut largement utilisée dans les fortifications albanaises. Cette période coïncide avec les transformations des systèmes de défense à cause de l'utilisation de l'artillerie, en cas de siège, contre les murs médiévaux. Seulement longtemps après, l'artillerie obtint son plus grand succès, au milieu du XVe sc. au cours de la réoccupation de Normandie par les français et de l'occupation du Costantinople par les turcs. Une théorie et une pratique isolée dans le domaine de la fortification qui apparurent pour la première fois en Italie à Rome et à Milan, devancèrent le danger de cet arme.

Presque en même temps nous voyons se réaliser en pratique l'une des premières idées de la théorie moderne de la fortification, aux deux tours de la forteresse de Kruja faites construire par Skënderbeg au cours des années 1451-52. Barlet nous fournit des données précieuses sur la forme de l'une de ces tours qui se conserve près de l'entrée principale, et sur les raisons qui motivèrent cette forme. Elle ne devait pas dépasser la hauteur des murs pour ne pas être atteinte de l'artillerie et sa base devait être en talus.

On rencontre dans beaucoup d'autres fortifications des éléments où s'appliquent les principes de la théorie moderne de la fortification. A Shkodra, les murs et les tours septentrionales du barbacan, construits entre 1407-1416, étaient ba en talus du type «terro pieno», tandis que le fossé de eux était protégé par une sortie secrète pourvue d'un sys de tunnels creusés en roches où l'on cachait les armes et munitions. On rencontre une tour pareille à Shirokë. Au c du XVe sc. on remarque l'autres modifications dans les fo resses médiévales, telles l'épaississement des murs, la tran mation des tours quadrangulaires en tours circulaires et construction des bases en talus comme à Drisht, à Petrele Krujë etc. Entre autres, la forteresse de Rodon, faite c struire par Skënderbeg au milieu du XVe sc. occupe une pl particulière.

On y distingue la petite hauteur des murs pourvus canonières, d'une largeur trois fois plus grande que la haut Le fossé et le pied du mur protégé par le feu de l'artillerie parurent un siècle plus tard. Vers la fin du XVe sc. en Alba se construisirent les tours de l'artillerie appelées «Rondell qui entre les années 1459-62, apparurent pour la premi fois sur la côte de l'Adriatique.

L'évolution ultérieure des fortifications albanaises vers c lles des bastions fut entravée par l'occupation turque.

Les premiers pas vers les vraies fortifications de l'artille en Albanie correspondent au commencement de ce process dans les pays les plus avancés dans ce domaine. Cela est au rôle que jouèrent et la position qu'occupaient les territoir albanais contre l'expansion ottomane, à la riche tradition formes et solutions architectoniques dans le domaine des fo tifications ainsi qu'aux influences de l'architecture militaire v nétienne et italienne de l'époque.

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

NDËRTIMET E KULTIT TË SHEK. VII-XV, ASPEKTE TË ARKITEKTURËS DHE RESTAURIMIT TË TYRE

Ndërtimet mesjetare të kultit që ruhen në tërësinë e arkitekturës mesjetare, japin mundësinë për të njohur nivelin e ndërtimeve në përgjithësi dhe të arkitekturës në veçanti, si dhe nivelin e përgjithshëm ekonomiko-shoqëror e kulturor të shoqërisë shqiptare gjatë mesjetës. Studimet e kryera deri më sot në vendin tonë kanë dalluar dy periudha kryesore në këtë gjini të arkitekturës, në përputhje me zhvillimin historik të vendit dhe nivelin e tij. Periudha e parë nis me fillimet e mesjetës, shek. VII deri në fund të shek. XII, e dyta shek. XIII-XV deri në vendosjen e plotë të pushtimit osman të vendit. Për shekujt e errët të mesjetës së hershme kemi fare pak shembuj ndërtimesh të reja. Dyndjet barbaro-sllave të fundit të shek. VI-VII prunë një gjendje rrënimi ekonomik në tërë trevat ballkanike dhe një rënie në ndërtimet. Nga kjo kohë kemi dëshmi të përdorimit të mjaft ndërtimeve të periudhës paleokristiane, një sërë bazilikash që përbëjnë dhe hallkën lidhëse të traditës. Të tilla janë ndërtimet e Durrësit, Arapajt, Sarandës, Butrintit, Lezhës, që qëndruan në këmbë duke u ripërdorur deri vonë. Me rigjallërimin e jetës ekonomike të vendit në shek. IX, me riorganizimin administrativo-politik e kishtar, duket se kemi dhe një shtim të ndërtimeve të reja, që tashmë kanë edhe pretendime arkitekturore. Deri më sot, në mungesë të kërkimeve sistematike arkeologjike, këtë e dëshmojnë një sërë fragmentesh të skulpturës arkitekturore të shek. IX-XI nga Durrësi, Drinopoja, Pojani, Ballshi, Ulqini e Tivari, me vlera të mëdha jo vetëm për historinë e arteve, por edhe për historinë e vendit. Të qarta janë, gjithashtu, lidhjet e tyre si me skulpturën bashkëkohore, bizantine, ashtu edhe me anë të brigjeve perëndimore të Adriatikut, rezultat i rrethanave historike dhe i pozicionit të veçantë të vendit tonë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, si një vendkalim i detyrueshëm i rrugëve ndërmjet tyre. Me rimëkëmbjen ekonomike të vendit, me fuqizimin, e ekonomisë feudale, me rritjen e feudalëve vendas, kemi dhe një etapë të re në arkitekturën mesjetare. Kjo përkon me shek. XIII-XV, prej të cilëve kemi një sërë ndërtimesh me vlerë që karakterizojnë qartë këtë arkitekturë, si në Veri, ashtu dhe në Jug. Në gjithë periudhën e parë, që përkon me mesjetën e hershme, shek. VII-XII, në të cilën ndodh formimi i kombësisë shqiptaro-arbëreshe, tipat e përdorur janë kryesisht kishat njënefshe dhe bazilikat, bazë e traditës vendase në arkitekturën e kultit.

Në fund të kësaj periudhe (shek. XI-XII) futet në Shqipërinë e Jugut, edhe pse në forma ende primitive, tipi kryq i brendashkruar me kupolë (Peshkopi, Zervat, Kosinë), ndërkohë që në Shqipërinë e Veriut (Rubik) dhe në Durrës kemi ndikimet e para të arkitekturës romanike. Në aspektin e Tipologjisë duhet të theksohet vazhdimësia e bazilikave, dëshmi e vijimit të traditave ndërtimore dhe e vazhdimësisë së jetesës në këto troje nga e njëta popullsi vendase. Në periudhën e dytë (shek. XIII-XV), në të cilën realizohet uniteti i popullsisë arbëreshe dhe shtrirja e saj përkon pak a shumë me trojet e banuara sot prej tyre, në aspektet më kryesore, kanë dallime të qarta ndërtimet e Shqipërisë Jugore ndaj atyre të Veriut dhe të Shqipërisë së Mesme. Siç rezulton nga studimi i vetë monumenteve dhe rrethanave historike, kjo gjë ka ndodhur nga ndikimet e mëdha të arkitekturës perëndimore ndërmjet Tivarit dhe Durrësit dhe lidhjeve kishtare me Romën. Në këtë zonë ndërtohen kryesisht kisha njënefshe me elemente të arkitekturës romaniko-gotike, ndërkohë që në Shqipërinë e Jugut gjejnë përdorim të gjerë kishat e tipit kryq i brendashkruar me kupolë me tipologji të qartë provinciale. Edhe në këtë periudhë të dytë vijojnë të ndërtohen në të gjithë Shqipërinë bazilikat (Shirgj, Shënmri, Klos, Çiflik).

DOKUMENT

Gjatë shekujve të mesjetës së mesme arkitektura mesjetare shqiptare, edhe pse e lidhur ngushtë me dy drejtimet kryesore të arkitekturës bashkëkohore, atë romaniko-gotike dhe arkitekturën bizantine, me ndërtimet e provincave fqinje dhe qendrave kryesore të botës mesdhetare ka një fytyrë të vetën, me dallime në Shqipërinë e Veriut dhe të Mesme nga ajo e Jugut. Kështu në Shqipërinë e Veriut dhe bregdetin jugor dalmatin, madje edhe në Kosovë, në zonat shqiptare të varura kishëtarisht nga Tivari, veprimtaria ndërtimore i përket një shkolle arkitekturore, ku mjeshtrit shqiptarë zënë vendin kryesor. Fillimisht në ndërtimet e para vërehen ndikime të arkitekturës perëndimore, ndërsa më vonë kemi ndërtime të përfshira në arkitekturën romaniko-gotike të kësaj shkolle, që ku më shumë e ku më pak afirmohet në ndërtimet e shumta që ne ruajmë sot. Ndër to shquhen kisha e Shirgjit, Katedralja e Shkodrës, Vau i Dejës, kambanoret e Rashkullës e Mazrekut. Karakteristika të këtyre ndërtimeve janë teknika e ndërtimit të mureve, muret me pilastra që lidhen me harqe të verbra, harqet dhe qemeret me profil të mprehtë, ngritja vertikale e godinës dhe kupolës, dhe planimetritë njënefshe, të cilat hasen jo vetëm në kishat e vogla pa rëndësi. Një vend të veçantë zënë ndërtimet e Durrësit e rrethinës së tij që dëshmohen nga kisha e çetës dhe një sërë kapitelesh të Durrësit e elementet e tjera që flasin për arkitekturën romaniko-gotike që lulëzonte në këtë qytet, sidomos gjatë shek. XIII-XV. Veç kësaj, kemi dhe një sërë ndikimesh të arkitekturës perëndimore, që vërehen dhe në mjaft monumente të Shqipërisë së Jugut. Ato vijnë nga dy rrugë: së pari, nga kontakte të drejtpërdrejta me bregdetin perëndimor të Adriatikut, Venedikun dhe bregdetin dalmatin, së dyti, nga vendosja në vendin tonë, nga shek. XIII, me anzhuinët e feudalë të tjerë perëndimorë të peshkopatave katolike, nga Durrësi e deri në jug (Vlorë e Butrint). Këto ndikime janë përgjithësisht në elemente të formës si: në kapitele e skulptura, harqe e kambanore (Berat, Zvërnec, Pojan, Perondi, Mesopotam).

Për sa u përket ndërtimeve të përfshira në arkitekturën bizantine të Shqipërisë së Jugut, krahas kishave njënefshe që janë ndërtime të thjeshta, kemi dhe ndërtime të shumta të tipit kryq i brendashkruar me kupolë, i cili, ndërsa **hyn** me forma të rënda e primitive dhe në lidhje të ngushtë me tipin bazilikal në shek. XI-XII, formohet plotësisht në shek. XIII-XIV, duke u përdorur gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha variantet. Kjo larmi dëshmon, për nivelin e mjeshtërve ndërtues vendas, që arrijnë deri në krijimin e zgjidhjeve krejt të veçanta (Labovë, Mesopotam).

Krahas elementeve dhe formave të përbashkëta me provincat e tjera dhe Kostandinopojën kemi m veçanti lokale dhe parapëlqime.

Karakteristika të këtyre ndërtimeve janë kupo me tetë faqe ku këmbehen niket e dritaret, absi trifaqëshe, vijat e drejta në çatitë dhe frontone krahëve të kryqit, dekori keramoplastik i përmba dhe varianti provincial i planimetrisë.

Ndër të tjera studimi i ndërtimeve mesjetare kultit ka prurë të dhëna me interes për njohjer strukturave e në veçanti të teknikës së ndërtimit mureve, që kanë dhënë ndihmesën e tyre jo vet në problemet e kronologjisë dhe fazave të ndërtir por edhe në orientimin e drejtë të punimeve resto ruese dhe cilësinë e realizimit të tyre. Fillimisht p doren gurë të mëdhenj me tulla ndërmjet tyre, tej gurët zvogëlohen përdorimi i tullave merr rregu shmëri që vendosen njëra mbi tjetrën ndërmjet gave vertikale dhe në fugat horizontale, ku she bullin më të plotë e më të realizuar të së cilës kemi në Perondi (shek. XI). Më tej në fugat ver kale përdoren tulla të vendosura në mënyrë të pj rrët (Bual-Kosinë, Labovë) e në shek. XII-XIII fillon përdoret kluasonazhi dhe dekori keramoplastik.

Në Shqipërinë e Veriut është në përdorim v tëm guri, i cili fillon të skuadrohet në shek. XIII n gurë më të gjatë se të lartë e që në shek. XV syno drejt formave katrore. Njohja e plotë e arkitektur mesjetare tregon qartë zhvillimin e saj në kohë, r përputhje me zhvillimin ekonomiko-shoqëror të ver dit dhe rrethanat historike. Karakteristikat e veçant të këtyre ndërtimeve janë rezultat i traditave shekë llore, i formimit të veçantë kulturor dhe arkitekturo brenda kuadrit të zhvillimit në kohë të vendit. Edh duke qenë të përfshira në drejtime më të mëdha a kitekturore, ndërtimet tona kanë një fytyrë të tyre të dallueshme qartë.

Ndërtimet mesjetare të kultit për vetë vlerat tyre të arkitekturës dhe të artit kanë qenë objek përkujdesjeje të veçantë, duke filluar nga punime për mirëmbajtjen e vazhdueshme e deri në restauri min e tyre të plotë. Ndërhyrjet e para kanë filluar që me vënien e tyre në mbrojtje. Vetëkuptohet, që ajo ishte mirëmbajtje e thjeshtë e objekteve, e cila dora -dorës, me rritjen dhe forcimin e strukturave organizative dhe kualifikimit të kuadrit, ka ardhur në rritje e duke u thelluar përherë e më tepër, deri në restaurime më të plota. Në aspektin e shkallës së prekjes së monumentit ndërhyrjet e kryera kanë qenë trillojesh: ndërhyrje konservuese në monumentet rrënojë, mirëmbajtje e përhershme dhe ndërhyrje të thella restauruese. Ndërsa dy të parat kanë pasur për qëllim ruajtjen e vlerave të monumentit, sidomos në aspektin e dëshmisë historike, ndërhyrjet restauruese

kanë synuar jo vetëm t'i ruajnë këto vlera, por edhe t'i vënë në dukje, duke respektuar dokumentin historik dhe vlerat estetike autentike.

Në aspektin e tipologjisë ndërhyrjet restauruese kanë qenë ndërhyrje çlirimi nga shtesat e mbivënien e pavlera (Perondi, Shën Triadhë Berat), ndërhyrje përforcuese (Mborje, Vllahernë, Marmiro), plotësime të pjesëve munguese (Perondi, Berat, Marmiro), si dhe rindërtime të domosdoshme të elementeve të strukturës dhe mbulesës (Perondi, Pojan, Bual, Sop) me mjete dhe teknika të kohës sonë, që sigurojnë jetëgjatësinë e ndërtesës. Gjatë ndërhyrjeve restauruese ka qenë e domosdoshme të plotësohen mjaft pjesë mungese, apo të dëmtuara, siç janë dritaret, pjesë të zbukurimores dhe kornizat dhëmbësharrë. Lidhur me shtesat që u janë bërë në kohë kishave, për qëllime nga më të ndryshmet, qëndrimi ka qenë rezultat i gjykimit të vlerave dokumentare të shtesave, vlerave estetike të tyre dhe i asaj që mbetej pas largimit të shtesave. Kështu në Perondi janë larguar mjaft nga shtesat, që nuk kanë respektuar monumentin duke u shëmtuar dhe fshehur vlerat e vërteta të tij, por janë lënë kambanorja me mjaft vlerë, si dhe gjurmë të rindërtimeve të shek. XIV-XV.

Punimet konservuese-restauruese në ndërtimet mesjetare të kultit kanë shmangur rrezikshmërinë në mjaft prej tyre, si dhe kanë nxjerrë vlerat e tyre shkencore e estetike.

DO NOT COPY

Aleksandër MEKSI

DO NOT COPY

CONSTRUCTIONS DE CULTE DE VIIe AU XVe SIECLES, ASPECTS DE LEUR ARCHITECTURE ET LEUR RESTAURATION

RESUME

Les études effectuées jusqu'à présent concernant l'évolution de l'architecture des constructions de culte pendant le Haut et le Milieu Moyen-Age ont révélé deux périodes principales. La première se situe du VIIe au XIIe siècles tandis que la seconde du XIIIe au XVe siècles. On dispose de témoignages d'utilisation d'un grand nombre d'églises paléochrétiennes à ces périodes, ce qui constitue un maillon de liaison avec la tradition. Il semble que les constructions deviennent plus nombreuses à partir du IXe siècle, après la réorganisation administrative et ecclésiastique du système byzantin des thèmes. Ceci est témoigné par une série de fragments de sculptures datant du IX-XIe siècles, trouvés dans de différents centres du pays. Ils sont d'une grande importance historique et artistique, et démontrent les liens avec l'art byzantin ainsi qu'avec celui des côtes occidentales de l'Adriatique.

Pour la première période l'on possède un grand nombre d'exemples de basiliques et de constructions à nef unique. A la fin de cette période (XIe siècle) commence à apparaître dans notre pays le type de croix inscrite avec coupole. Pendant la deuxième période on remarque que les deux premiers types mentionnés ci-dessus et les églises croix inscrite avec cou deviennent les constructions les plus importantes pour l'Alb méridionale qui s'incluent dans l'architecture byzantine, que dans l'Albanie centrale et septentrionale l'on remarque constructions suivant l'architecture gréco-gothique. Néanm les constructions en Albanie, dans chacune des deux zo se distinguent par leur physionomie particulière qui leur propre, bien que l'on ait des liens et des influences ne par les principaux centres des pays voisins. Ainsi on distin facilement l'école de la côte dalmate méridionale et de banie septentrionale par celle de l'Albanie méridionale, on trouve les constructions dans toutes les contrées habitées les albanais et en dehors de celles-ci.

Les constructions moyenageuses de culte, vu les val qu'elles représentent, ont été objets de soins continus. A les interventions continues de restauration et de maintien, d un grand nombre de celles-ci on a effectué des travaux construction complète, qui ont eu pour but le renforcement structures et la mise en évidence de leurs valeurs scientifiq et artistiques.

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

RESTAURIMI DHE KONSERVIMI I PIKTURËS MURORE

Për veprat e artit, si pjesë e trashëgimisë kulturore me vlera historike dhe estetike, në vitet e pushtetit popullor është treguar një interesim i veçantë, i cili është pasqyruar në cilësimin e shumë prej tyre «monument kulture». Në eksperiencën e gjatë historike të zhvillimit kulturor ato përbëjnë një provë dhe dokument, që përcakton nivelin dhe shkallën e këtij zhvillimi. Janë këto arsyet që kanë bërë të domosdoshëm hartimin e një programi të administrimit dhe restaurimit të tyre.

Sikurse mjaft vepra të artit që ruhen në monumente, pikturat murore, me përjashtime shumë të rralla, janë përgjithësisht të dëmtuara rëndë, në krahasim me veprat dhe objektet e lëvizshme. Për këtë arsye objekt i ruajtjes ka qenë në radhë të parë inventarizimi dhe gjurmimi, që përcakton vlerat që disponohen, shtrirjen e problemeve që ato përballojnë dhe radhën e përparësisë. Në këtë kuadër, veç identifikimit, një dokumentim fotografik dhe diagnostikim empirik i gjendjes ishte detyra e parë e realizuar periodikisht në të gjitha objektet e pikturës murore. Kjo masë e radhës së parë ka qenë shoqëruar shpesh-herë me një ndihmë të parë, që ka konsistuar në marrjen e masave urgjente të konservimit, të pikturës murore. Ndërkohë puna restauruese mori dukuri e baza më të drejta në hartimin dhe praktikën e masave që duheshin ndërmarrë. Koncepti mbi kriteret dhe rrugën që duhej ndjekur kaloi nëpërmjet një procesi që njohu disa faza zhvillimi.

Fillimisht masat restauruese u kryen në llojin e provave ose sondazheve të kufizuara në disa vepra të pikturës murore, me qëllim që të viheshin në dukje vlerat e fshehura, ose në raste të shkëputura si masa të mirëfillta konservimi. (Piktura me pasqyrimin e brezit të shenjtorëve në kishën e Vllahernës, apo masat për zhvendosjen e afreskeve të dëmtuara të kishës së Shën Kollit në kalanë e Beratit) (fig. 1). Gjithashtu, punime për zhvendosjen dhe pastrime të Voskopojës dhe të Vithkuqit në rrethin e Korçës. (Vendosja e merleve, para rreth dy dekadash, në kalotat e kishës së Shën Mërisë – Voskopojë, vendosja e perleve në pikturën e dëmtuar të kishës së Shën Mëhillit – Vithkuq, etj.) Këto masa të kufizuara dhe të paprogramuara mbi një plan të studiuar dhe të klasifikuar në radhë dhe problematikë, kanë sjellë në disa raste efekte negative, të cilat janë të shpjegueshme për kohën dhe mungesën e përvojës së mjaftueshme në këtë fushë.



Fig. 1

Duke e konsideruar ndërhyrjen konservuese si një veprim që përfshin fusha të ndryshme shkencore, problemi i ruajtjes gjeti kuptim dhe interpretim më të drejtë. Konservimi i veprave të artit nuk mund të realizohej pa bashkëveprimin e sektorëve përkatës dhe

veçanërisht, pa mbështetjen e një laboratori kimik, i cili do të diagnostikonte mbi bazën e mostrave dhe prerjeve studimin e materialeve përbërëse, kontrollin e lagështisë, dritës etj, kushte këto që kërkojnë një mbikqyerje të vazhdueshme të konditave ku jeton vepra e artit. Bashkëpunimi me qendra të tjera, që për analogji ndihmojnë ose sqarojnë problemet që interesojnë veprat e artit, ka qenë efektiv në punën tonë.

Problemet që përballojnë veprat e pikturës murore tek ne, mund t'i rendisim shkurtazi:

1) Dëmtime nga lagështia.

2) Dëmtime, si pasojë e veprimeve të faktorëve kimikë e biologjikë.

3) Dëmtime nga pluhurat, mbishtresat e vajrave e vernikëve, depozitimet organike të kafshëve e shpendëve.

4) Dëmtime nga mbishtresa, ripikturimi ose mbulimi me gëlqere, të vendosura në shtresa mbi pikturë.

5) Dëmtime nga pluhurat industriale, lëkundjet e tërmeteve, drita e diellit, ndryshimet e temperaturës, si dhe me origjinë në vetë llojin dhe natyrën e materialeve përbërëse të veprës.

Faktori i parë me origjinë lagështinë, me format e saj të ndryshme, si infiltrimet nga mbulesat e papërshtatshme, ujërat nëntoksore, lagështi kondensimi ose me origjinë kapilariteti, është fenomeni m shpeshtë dhe me pasoja shkatërruese. Madje, faktor ka ndihmuar e stimuluar edhe faktorët e t kimikë e biologjikë, duke sjellë në raste të veçq edhe zhdukjen fizike të pikturës. I tillë është n i pikturës së kishës së Rubikut, ku prezenca e lq shtisë në kontakt me gazin sulfuror të mjedisit in strial ka sjellë sulfikimin e materialeve gëlqerore shpërndarjen e tyre. Humbja e lidhjes midis shtres përbërëse të pikturës (aricio – intonako) me m mbajtës, ka sjellë, në raste të shumta, dëmtimin e tetit fizik duke shkaktuar gropa, boshllëqe, rënie shtresave përbërëse e forma të tjera që dëmtq dhe shëmtojnë veprat, si fizikisht, ashtu edhe nga estetike. Zhvillimi i kripërave të formave të ndrysh si pasojë e lagështisë mbi veprat e pikturës mur ka sjellë gjithashtu dëmtime të materialeve përbër të veprës (fig. 2). Në këto raste, si dhe atëhere kanë vepruar faktorë të llojit që përmendëm, vep e artit, veçanërisht pikturat murore, u janë nënshtr proceseve degraduese, që me kohë kanë sjellë pas shkatërruese. Për rastin e lagështisë, që është n më të ndërlikuarat për pasojat që lë mbi pikturën m rore, janë praktikuar masa të ajrimit të mjedis me lagështi, nëpërmjet ventilimit të natyrshëm. raste të tjera, si p.sh. në kishën e Shën Kollit – V kopojë, ku lagështia përveç formave të tjera vi



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY

edhe nëpërmjet kondensimit, si pasojë e ujërave nëntokësore që kalonin nën dysheme. Janë kryer drenazhime e sistemime për të mënjanuar, ose vënë në funksion sistemin e vjetër të drenazhimit të ujërave që kishte vetë objekti. Mënjanimi i pasojave të tjera me origjinë infiltrimi është kryer, gjithashtu, nëpërmjet drenazhimeve në themelet e mureve me lagështi, si p.sh., në zonën e apsidës së kishës së Vllahernës, ose në murin perëndimor të saj. Problemi i mënjanimit të kripëzimeve të formave të ndryshme, përherë me pasoja dëmtuese mbi pikturë, ka qenë zgjidhur vetëm pjesërisht në rastet e kripërave të tretshme, ndërsa zhdukja e kripërave të tilla si karbonati i kalciumit, mbetet ende një problem i pazgjidhur. Rivendosje të stabilitetit fizik të pikturës, ose që vepra të rifitojë në masën e mundur unitetin estetik të humbur, si pasojë e dëmtimeve të lidhjeve të shtresave përbërëse, janë kryer në mënyra e metoda të rekomanduara sipas rastit. Përdorimi i kazeatëve gëlqerorë si dhe i materialeve vinilike është zbatuar përgjithësisht në rastet e boshllëqeve e xhepave në pikturë, duke parapëlqyer sigurimin e veprës mbi shtresën e saj origjinale (fig. 3). Me rastet e cedimit të strukturave mbajtëse janë kryer punime përforcuese në muraturë dhe vetëm në pjesë të vogla, e raste të detyrueshme, janë bërë zhvendosje të pikturës me teknikën e strapos, si në pikturën e faqes jugore të kishës së Shën Kollit, atë të faqes perëndimore të kishës së Vllahernës, etj. Për rifitimin e mundshëm të unitetit estetik në pikturat e fragmentuara janë praktikuar përforcime dhe integrime në materiale të heqshme, sa më afër atyre origjinale dhe përherë qartësisht të dukshme, si ndërhyrje të kryera nga ana jonë. Ky problem është zgjidhur duke bërë diferencime si në planin volumor e plastik, ashtu dhe kromatik, nëpërmjet toneve neutrale ose fakturës me diferenca nga ajo e veprës origjinale. Pluhurzimet që vihen re në raste jo të pakëta mbi pikturat murore me origjinë nga faktorë të ndryshëm, janë trajtuar me fiksativa polimere, që rekomandohen me cilësitë e kërkuara dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme. Largimi i vernikut të dekompozuar, që errëson pamjen dhe ndërron ngjyrat, është kryer me solventë të ndryshme: aceton, alkool, dometil, benzol, etj, me proporcionet dhe lidhjet e rekomanduara. Bikarbonati i sodës dhe i amonit, i zbatuar nëpërmjet një xhelatinizuesi me origjinë celuloze, ka dhënë në mjaft raste rezultate të kënaqshme, si në kishën e Vllahernës, atë të Ristozit, në pikturën e një banese të shek. XIX etj. Problem i diskutueshëm ka qenë ai i integrimit të pikturave murore të dëmtuara dhe të fragmentuara në unitetin e tyre stilistik (fig. 4). Ruajtja dhe respektimi i vlerave origjinale, si dhe fazave me ndryshime të mundshme gjatë historisë, ka qenë kriter që ka diktuar edhe vendimet përkatëse. Vetëm për rastet e plotësimeve e ripikturimeve sipas stilit e teknikës që e kanë shëmtuar veprën, janë marrë vendime për çlirimin e tyre nga këto ripikturime që falsifikojnë vlerat fillestare dhe dëmtojnë unitetin estetik të veprës. Në këto raste vendimi ka qenë i diferencuar për pjesë e faza të ndryshme. Integrimi estetik nëpërmjet materialeve të përdorura për lidhjen e pjesëve të dëmtuara është bërë me një ngjyrë të vetme neutrale, e cila është praktikuar përgjithësisht në të shumtën e rasteve duke bërë përjashtimin për pjesët e vogla, të cilat janë trajtuar me ngjyrat përkatëse të përafërta në gamën shumëngjyrëshe të pikturës.

Ndonëse janë zgjidhur mjaft probleme, faktorët degradues që kanë lënë pasoja të ndjeshme mbi veprat e artit dhe ato, që për vetë natyrën e materialeve përbërëse vazhdojnë të ekzistojnë, shtrojnë për zgjidhje ende shumë raste e probleme që presin ndërhyrje restauruese. Në këtë kuadër hartimi dhe vënia në praktikë e projekteve të restaurimit vitet e fundit ka gjetur një pasqyrim më të drejtë në realizimin e një sërë detyrash në monumentet e pikturës murore. Vënia në përdorim e praktikave bashkëkohore të punës restauruese nëpërmjet bashkëveprimit, të sektorëve përkatës do të çojnë edhe më përpara këtë fushë të veprimtarisë sonë të përditshme.



Fig. 4

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

RESTAURATION ET CONSERVATION DES FRESQUES

RESUME

En général, en comparaison avec les oeuvres et les objets mobiliers, les fresques se présentent gravement délabrées. C'est pour cette raison que l'objet de leur sauvegarde fut d'abord l'inventaire qui définit leurs valeurs, leur étendu, les problèmes qui se posent. Dans ce cadre, à part l'identification, une documentation photographique ainsi qu'un diagnostic empirique de l'état, fut notre premier devoir. Entre temps on prit des mesures urgentes de conservation. Les mesures de restauration tout d'abord s'effectuèrent en tant qu'épreuves souvent sans connaître encore l'effet que les interventions de restauration produiraient dans le temps. En considérant une intrevention de restauration comme une action qui embrasse de différents secteurs historiques et scientifiques, le problème trouva un sens et une plus juste interprétation en se basant sur un programme basé sur les données du laboratoire et les analyses critiques de l'état, de l'histoire et des besoins des oeuvres d'art.

Les problèmes qui se posaient furent:

– dégradation dûe à l'humidité,

– dégradation dûe aux facteurs chimiques et biologiqu

– dégradation dûe aux différentes précipitations,

– détériorations causées par les tremblements de terre, p

l'endommagement des structures de support en architectu

par les altérnations de la température ainsi que par l'origi

et la nature du matériel constituant.

Le premier facteur, le plus fréquent et le plus dangereu

demeure à la tête des mesures entreprises. L'application d

couvertures, des drainages et de la ventilation naturelle fure

les premiers devoirs à accomplir pour sauvegarder les fresqu

La perte des liaisons entre les couches constituantes et l

structures de support est restaurée par les injections, les r

constructions des structures endommagés, leur nivellement p

le système d'étayage ou de la poussée en cric, ainsi que p

l'intégration des parties fragmentées prenant en considérati

l'unité physique et esthétique des oeuvres. Malgré la résoluti

des nombreux problèmes de conservation, les agents de d

gradation qui ont laissé des traces évidentes sur les oeuvr

d'art, posent encore d'autres problèmes de restauration.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Vangjush GOLLOSHI – Marita BEÇI

TË DHËNA TË REJA TË PËRFTUARA NGA STUDIMI RADIOLOGJIK I PIKTURËS SË KAVALETIT

Vetitë e rrezeve rëntgen kanë lejuar zbatimin e një metode analize lidhur me pikturat e kavaletit, që i janë nënshtruar procedurës së restaurimit. Qëllimi i kësaj metode ekzaminimi ka qenë:

1. Zbulimi i nënpikturës eventuale, e cila ka rëndësi të madhe orientuese në qëndrimin e restauruesit ndaj veprës.

2. Përcaktimi i shkallës së dëmtimit të veprës në përbërësit e saj: shtratin pikturor, gruntin dhe suportin.

3. Marrja e të dhënave për njohjen e stilit të autorit në ekzekutimin e pikturës.

Në këtë kumtesë do të japim rezultatet e ekzaminimit radiologjik të bëra mbi ikona të periudhave dhe autorëve të ndryshëm si: Onufri, Nikolla dhe krijues anonimë. Ikonat janë marrë në shqyrtim nga sektori i artit i Institutit të Monumenteve të Kulturës. Të gjitha ekzaminimet radiologjike janë bërë pranë shërbimit radiologjik të Spitalit Klinik Nr. 1 Tiranë, Spitalit Civil në Korçë dhe Berat. Filmat e përdorur kanë qenë të tipit ORWO HS 11. Për ekzaminimin e pikturave janë përdorur tensione të ulëta 30 – 45 kv, koha e ekspozimit 001 – 0,1 sek dhe rryma 50 mA. Të gjitha rastet e ekzaminuara janë shoqëruar me analiza të përbërjes së pigmenteve dhe foto paraprake.

1) Ikona «Ungjillizimi», pikturë e shek. 17. marrë nga fondi i ikonave Korçë. (Fig. 1) Druri i saj është i gruntuar me karbonat kalciumi (kretë) dhe është pikturuar me teknikën e temperës. Shtrati pikturor është mjaft i dëmtuar, veçanërisht në gjysmën e poshtme të ikonës, ku ka rënie të tij dhe të gruntit. Në grafi vërehet struktura e ruajtur e portreteve, ndërsa sfondi ku janë vendosur këto portrete paraqet ndryshime të dukshme në këqyrjen radiologjike (fig. 1). Në shumë pjesë ruhen ripikturime p.sh. në anën e djathë të pikturës, ndërtesa paraqet një pamje të ndryshme nga ajo që shihet me sy. Në pjesën ku janë pikturuar dy dritaret vërehet një rreth i qartësuar me një shumëkëndësh të shënuar me pika (fig. 2). Po ashtu në pjesën e ndërtesës vërehen vija, të cilat nuk i korrespondojnë pamjes me sy të kësaj pjese. Në këtë dritare është vizatuar një rrjetë. Grafia në pjesën e poshtme të pikturës vë në dukje dëmtime të rënda të gruntit, gjë që vërtetohet nga struktura



Fig. 1



Fig. 2

karakteristika e drurit. Siç shihet nga grafia, sh
pjesë, të cilat duken me sy të zhveshur, në grafi j
tone shumë të dobëta, gjë që e orienton restauru
për densitetet e ngjyrave në shtresa të ndryshme.

Ikona «Shën Minai», marrë nga fondi i iko
Korçë, e ka shtratin pikturor tepër të copëtuar
në pjesën e poshtme ka rënie të plotë të tij së ba
me gruntin (fig. 3). Ngjyrë mbizotëruese në këtë
në është e gjelbra me tone të errëta dhe më të
lëta.

Nga shqyrtimi i grafisë së kësaj pikture de
karakteristikë e përgjithshme e saj është përdori
pigmenteve me densitete të ulëta, në atë masë
grafia nxjerr më tepër në pah prezencën dhe d
timet e vernikut sesa linjat piktorike. P.sh. në g
silueta e kalit, formohet vetëm nga dëmtimi i vern
(fig. 4), ndërsa fytyra e kalorësit paraqitet dobët
nuk të jep detaje për studimin. Sipër, në anën e n
të të grafisë, vërehet një pikturë e vogël, së c



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

edhe nëpërmjet kondensimit, si pasojë e ujërave nëntokësore që kalonin nën dysheme. Janë kryer drenazhime e sistemime për të mënjanuar, ose vënë në funksion sistemin e vjetër të drenazhimit të ujërave që kishte vetë objekti. Mënjanimi i pasojave të tjera me origjinë infiltrimi është kryer, gjithashtu, nëpërmjet drenazhimeve në themelet e mureve me lagështi, si p.sh., në zonën e apsidës së kishës së Vllahernës, ose në murin perëndimor të saj. Problemi i mënjanimit të kripëzimeve të formave të ndryshme, përherë me pasoja dëmtuese mbi pikturë, ka qenë zgjidhur vetëm pjesërisht në rastet e kripërave të tretshme, ndërsa zhdukja e kripërave të tilla si karbonati i kalciumit, mbetet ende një problem i pazgjidhur. Rivendosje të stabilitetit fizik të pikturës, ose që vepra të rifitojë në masën e mundur unitetin estetik të humbur, si pasojë e dëmtimeve të lidhjeve të shtresave përbërëse, janë kryer në mënyra e metoda të rekomanduara sipas rastit. Përdorimi i kazeatëve gëlqerorë si dhe i materialeve vinilike është zbatuar përgjithësisht në rastet e boshllëqeve e xhepave në pikturë, duke parapëlqyer sigurimin e veprës mbi shtresën e saj origjinale (fig. 3). Me rastet e cedimit të strukturave mbajtëse janë kryer punime përforcuese në muraturë dhe vetëm në pjesë të vogla, e raste të detyrueshme, janë bërë zhvendosje të pikturës me teknikën e strapos, si në pikturën e faqes jugore të kishës së Shën Kollit, atë të faqes perëndimore të kishës së Vllahernës, etj. Për rifitimin e mundshëm të unitetit estetik në pikturat e fragmentuara janë praktikuar përforcime dhe integrime në materiale të heqshme, sa më afër atyre origjinale dhe përherë qartësisht të dukshme, si ndërhyrje të kryera nga ana jonë. Ky problem është zgjidhur duke bërë diferencime si në planin volumor e plastik, ashtu dhe kromatik, nëpërmjet toneve neutrale ose fakturës me diferenca nga ajo e veprës origjinale. Pluhurzimet që vihen re në raste jo të pakëta mbi pikturat murore me origjinë nga faktorë të ndryshëm, janë trajtuar me fiksativa polimere, që rekomandohen me cilësitë e kërkuara dhe rezultatet kanë qenë të kënaqshme. Largimi i vernikut të dekompozuar, që errëson pamjen dhe ndërron ngjyrat, është kryer me solventë të ndryshme: aceton, alkool, dometil, benzol, etj, me proporcionet dhe lidhjet e rekomanduara. Bikarbonati i sodës dhe i amonit, i zbatuar nëpërmjet një xhelatinizuesi me origjinë celuloze, ka dhënë në mjaft raste rezultate të kënaqshme, si në kishën e Vllahernës, atë të Ristozit, në pikturën e një banese të shek. XIX etj. Problem i diskutueshëm ka qenë ai i integrimit të pikturave murore të dëmtuara dhe të fragmentuara në unitetin e tyre stilistik (fig. 4). Ruajtja dhe respektimi i vlerave origjinale, si dhe fazave me ndryshime të mundshme gjatë historisë, ka qenë kriter që ka diktuar edhe vendimet përkatëse. Vetëm për rastet e plotësimeve e ripikturimeve sipas stilit e teknikës që e kanë shëmtuar veprën, janë marrë vendime për çlirimin e tyre nga këto ripikturime që falsifikojnë vlerat fillestare dhe dëmtojnë unitetin estetik të veprës. Në këto raste vendimi ka qenë i diferencuar për pjesë e faza të ndryshme. Integrimi estetik nëpërmjet materialeve të përdorura për lidhjen e pjesëve të dëmtuara është bërë me një ngjyrë të vetme neutrale, e cila është praktikuar përgjithësisht në të shumtën e rasteve duke bërë përjashtimin për pjesët e vogla, të cilat janë trajtuar me ngjyrat përkatëse të përafërta në gamën shumëngjyrëshe të pikturës.

Ndonëse janë zgjidhur mjaft probleme, faktorët degradues që kanë lënë pasoja të ndjeshme mbi veprat e artit dhe ato, që për vetë natyrën e materialeve përbërëse vazhdojnë të ekzistojnë, shtrojnë për zgjidhje ende shumë raste e probleme që presin ndërhyrje restauruese. Në këtë kuadër hartimi dhe vënia në praktikë e projekteve të restaurimit vitet e fundit ka gjetur një pasqyrim më të drejtë në realizimin e një sërë detyrash në monumentet e pikturës murore. Vënia në përdorim e praktikave bashkëkohore të punës restauruese nëpërmjet bashkëveprimit, të sektorëve përkatës do të çojnë edhe më përpara këtë fushë të veprimtarisë sonë të përditshme.



Fig. 4

DO NOT COPY

Hasan NALLBANI

RESTAURATION ET CONSERVATION DES FRESQUES

RESUME

En général, en comparaison avec les oeuvres et les objets mobiliers, les fresques se présentent gravement délabrées. C'est pour cette raison que l'objet de leur sauvegarde fut d'abord l'inventaire qui définit leurs valeurs, leur étendu, les problèmes qui se posent. Dans ce cadre, à part l'identification, une documentation photographique ainsi qu'un diagnostic empirique de l'état, fut notre premier devoir. Entre temps on prit des mesures urgentes de conservation. Les mesures de restauration tout d'abord s'effectuèrent en tant qu'épreuves souvent sans connaître encore l'effet que les interventions de restauration produiraient dans le temps. En considérant une intrevention de restauration comme une action qui embrasse de différents secteurs historiques et scientifiques, le problème trouva un sens et une plus juste interprétation en se basant sur un programme basé sur les données du laboratoire et les analyses critiques de l'état, de l'histoire et des besoins des oeuvres d'art.

Les problèmes qui se posaient furent:

– dégradation dûe à l'humidité,

– dégradation dûe aux facteurs chimiques et biologiqu

– dégradation dûe aux différentes précipitations,

– détériorations causées par les tremblements de terre, p l'endommagement des structures de support en architectu par les altérnations de la température ainsi que par l'origi et la nature du matériel constituant.

Le premier facteur, le plus fréquent et le plus dangereu demeure à la tête des mesures entreprises. L'application d couvertures, des drainages et de la ventilation naturelle fure les premiers devoirs à accomplir pour sauvegarder les fresqu La perte des liaisons entre les couches constituantes et l structures de support est restaurée par les injections, les r constructions des structures endommagés, leur nivellement p le système d'étayage ou de la poussée en cric, ainsi que p l'intégration des parties fragmentées prenant en considératio l'unité physique et esthétique des oeuvres. Malgré la résolutio des nombreux problèmes de conservation, les agents de d gradation qui ont laissé des traces évidentes sur les oeuvr d'art, posent encore d'autres problèmes de restauration.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Vangjush GOLLOSHI — Marita BEÇI

TË DHËNA TË REJA TË PËRFTUARA NGA STUDIMI RADIOLOGJIK I PIKTURËS SË KAVALETIT

Vetitë e rrezeve rëntgen kanë lejuar zbatimin e një metode analize lidhur me pikturat e kavaletit, që i janë nënshtruar procedurës së restaurimit. Qëllimi i kësaj metode ekzaminimi ka qenë:

1. Zbulimi i nënpikturës eventuale, e cila ka rëndësi të madhe orientuese në qëndrimin e restauruesit ndaj veprës.

2. Përcaktimi i shkallës së dëmtimit të veprës në përbërësit e saj: shtratin pikturor, gruntin dhe suportin.

3. Marrja e të dhënave për njohjen e stilit të autorit në ekzekutimin e pikturës.

Në këtë kumtesë do të japim rezultatet e ekzaminimit radiologjik të bëra mbi ikona të periudhave dhe autorëve të ndryshëm si: Onufri, Nikolla dhe krijues anonimë. Ikonat janë marrë në shqyrtim nga sektori i artit i Institutit të Monumenteve të Kulturës. Të gjitha ekzaminimet radiologjike janë bërë pranë shërbimit radiologjik të Spitalit Klinik Nr. 1 Tiranë, Spitalit Civil në Korçë dhe Berat. Filmat e përdorur kanë qenë të tipit ORWO HS 11. Për ekzaminimin e pikturave janë përdorur tensione të ulëta 30 — 45 kv, koha e ekspozimit 001 — 0,1 sek dhe rryma 50 mA. Të gjitha rastet e ekzaminuara janë shoqëruar me analiza të përbërjes së pigmenteve dhe foto paraprake.

1) Ikona «Ungjillizimi», pikturë e shek. 17. marrë nga fondi i ikonave Korçë. (Fig. 1) Druri i saj është i gruntuar me karbonat kalciumi (kretë) dhe është pikturuar me teknikën e temperës. Shtrati pikturor është mjaft i dëmtuar, veçanërisht në gjysmën e poshtme të ikonës, ku ka rënie të tij dhe të gruntit. Në grafi vërehet struktura e ruajtur e portreteve, ndërsa sfondi ku janë vendosur këto portrete paraqet ndryshime të dukshme në këqyrjen radiologjike (fig. 1). Në shumë pjesë ruhen ripikturime p.sh. në anën e djathë të pikturës, ndërtesa paraqet një pamje të ndryshme nga ajo që shihet me sy. Në pjesën ku janë pikturuar dy dritaret vërehet një rreth i qartësuar me një shumëkëndësh të shënuar me pika (fig. 2). Po ashtu në pjesën e ndërtesës vërehen vija, të cilat nuk i korrespondojnë pamjes me sy të kësaj pjese. Në këtë dritare është vizatuar një rrjetë. Grafia në pjesën e poshtme të pikturës vë në dukje dëmtime të rënda të gruntit, gjë që vërtetohet nga struktura



Fig. 1



Fig. 2

karakteristika e drurit. Siç shihet nga grafia, sh
pjesë, të cilat duken me sy të zhveshur, në grafi j
tone shumë të dobëta, gjë që e orienton restauru
për densitetet e ngjyrave në shtresa të ndryshme.

Ikona «Shën Minai», marrë nga fondi i ikor
Korçë, e ka shtratin pikturor tepër të copëtuar
në pjesën e poshtme ka rënie të plotë të tij së bas
me gruntin (fig. 3). Ngjyrë mbizotëruese në këtë
në është e gjelbra me tone të errëta dhe më të
lëta.

Nga shqyrtimi i grafisë së kësaj pikture del
karakteristikë e përgjithshme e saj është përdorir
pigmenteve me densitete të ulëta, në atë masë
grafia nxjerr më tepër në pah prezencën dhe d
timet e vernikut sesa linjat piktorike. P.sh. në g
silueta e kalit, formohet vetëm nga dëmtimi i vern
(fig. 4), ndërsa fytyra e kalorësit paraqitet dobët
nuk të jep detaje për studimin. Sipër, në anën e m
të të grafisë, vërehet një pikturë e vogël, së c



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5

i dallohen mirë konturet dhe copëtimi i vernikut të pjesëve të tjera, si dhe një portret me aureolë. Anash tij dallohen dhe konturet e një portreti tjetër, edhe ky shumë i zbehtë. Megjithëse dëmtimi i kësaj pikture duket qartë me sy, grafia vë në dukje një pikturë të vogël në anën e majtë, sipër saj. Këtu dallohen mirë konturet e saj dhe copëtimi i vernikut e pjesëve të tjera, si dhe një portret me aureolë. Anash tij dallohen dhe konturet e një portreti tjetër, gjithashtu, shumë të zbehta, ndërsa koka e kalit formohet nga dëmtimi i vernikut. Kjo të bën të mendosh se kemi të bëjmë me variante të ndryshme dhe me cilësi të ndryshme. Fytyra e kalorësit duke u paraqitur dobët nuk jep detaje për studim, për arsye se ngjyrat e përdorura kanë pasur densitete të ulëta.

Ikona «Shën Mëria», e quajtur përkëdhelëse, është punuar prej mësues Kostandinit nga Vithkuqi (Fondi i ikonave Korçë) (fig. 5). Kjo ikonë është ruajtur në një gjendje të mirë. Shtrati pikturor në përgjithësi është i lidhur mirë me suportin e drunjtë. Në portret vërehet lëvizja e penelit, e cila për restauruesin ka interes të madh në njohjen e autorësisë së veprës. Në qoftë se në pamjen me sy të zhveshur shtresa e ngjyrës duket e realizuar nëpërmjet kombinimit të toneve, nga grafia del se kjo është realizuar me disa penelata. Po kështu, portreti i gruas është i rrethuar me një kornizë metalike të gdhendur, ndërsa fytyra është e rrethuar me pikëzime metalike mbi thekët e praruar të vellos (fig. 6). Në grafi del qartë vizatimi plot elegancë i palave dhe këmbët e zhvezhura të fëmijës (fig. 7). Në portret ka disa ndërtime, të cilat siç shihet nga grafia, nuk janë të thella, por të sipërfaqshme dhe si të tilla mund të eliminohen me riprekje. Në vazhdim të punës sonë për thellimin e njohjes nëpërmjet ekzaminimit radiologjik, u analizuan disa piktura të Onufrit, për të cilat paraprakisht, nga cilësia e grafisë, konstatuam se janë realizuar me përdorimin e pigmenteve me densitete të rënda. Për ilustrim të kësaj pune po japim vrojtimet mbi dy ikona:

Ikona e Joan Pagëzorit

Kjo pikturë ndodhet e ekspozuar në Muzeun e Onufrit në Berat. Nga grafia vërehet se në përgjithësi janë përdorur ngjyra me densitete të rënda në for-



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 7

mimin e ballit dhe të pjesës së vetullave, të cilat janë realizuar duke përdorur linja të harkuara penelate. Këto linja janë përdorur edhe për të formuar pamjen e syve, ndërsa konturet e fytyrës shkrihen në tonet e sfondit. Po në këtë pikturë (grafia e fragmentit) del se fytyra e Joanit, në krahasim me kokën që mban në dorë, ka një diferencë të dukshme në përbërjen e pigmenteve të ngjyrave të përdorura. Në këtë rast lind pyetja: A kemi të bëjmë me një ripikturim? Për ta përforcuar ose përjashtuar këtë mendim, i rekomandohet restauruesit të bëjë stratigrafinë e shtratit pikturor.

Ikona e Hyrjes së Shë Mërisë në Tempull

Është ikonë e pikturu nga Onufri dhe ndodhet ekspozuar në Muzeun me njëjtin emër në Berat.

Ndërsa në portretin e pë shkruar më sipër bie në sy nesa, në këtë të fundit, b në sy përdorimi i ngjyrës kuqe në gjithë spektrin e s Në studimin radiologjik m rret punimi në ansambël mjedisit ku mbisudojnë linj e drejta dhe loja e dritë-hij në formimin e portreteve. D ke përfunduar theksojmë s

1) Ekzaminimi radiolog ka vlerë të madhe për të zb luar nënpikturën dhe orig nalitetin e veprës.

2) Ekzaminimi radiologjik jep restauruesit të dhëna rëndësishme në drejtim restaurimit të pikturës, siç j në shkalla e dëmtimit të v prës të shtratit pikturor, gruntit dhe suportit.

3) Ky ekzaminim, kur kombinohet me metoda tjera (fizike, kimike, të ndërthurura këto me përvoj e njohjes të pikturës bizantine, kontribuon mjaft përcaktimin e kohës dhe të autorësisë së veprës.

Në bazë të përvojës së derisotme, puna jonë mëtejshme do të synojë në përcaktimin e param trave teknike dhe në studimin radiologjik të piktura sipas një programi të detajuar në rrethe të ndryshi të vendit. Ky program do të realizohet nëpërmjet th llimit të bashkëpunimit midis institucioneve përkatë

Marita BEÇI – Vangjush GOLLOSHI

DO NOT COPY

NOUVELLES DONNEES OBTENUES PAR L'ETUDE RADIOLOGIQUE DES PEINTURES DE CHEVALET

R E S U M E

L'examen de la peinture de chevalet aux rayons Röntgen a eu pour but:

1. De découvrir la sous-peinture, qui aide beaucoup à déterminer le comportement du restaurateur envers l'oeuvre.

2. De définir le degré d'endommagement de l'oeuvre, la dégradation de la couche de l'enduit et du support.

3. De donner des indices pour connaître le style utilisé par l'auteur, qui est spécifique pour l'art byzantin.

Dans cette communication on donne les résultats des examens radiologiques effectués sur des icônes de différentes périodes et auteurs tels: Onufri, Nikolla ainsi que des anonymes pris en étude par la Section de l'Art de l'Institut des Monuments Culturels.

Tous les examens ont été effectués auprès du service radiologique de l'Hôpital Clinique N° 1 de Tirana, de l'Hôpital de Korça et celui de Berat. On a utilisé des pellicules du type ORWO HS 11 et on a appliqué des tensions 30-45 kW courant des 50 mA, avec temps d'exposition de 0,01-0,1 sec. Tous les cas examinés ont eté accompagnés par l'analyse de composition des pigments et par photos préparatoires.

1) L'icône «L'Annonciation» est une peinture du XVIIe sc., dont la couche picturale se présente très délabrée. Par la graphie on découvre des parties repeintes et quelques raies qui ne se voient pas à l'oeil nu.

2) L'icône «Saint Mina» se présente avec une couche picturale très fragmentée dont la partie inférieure et l'enduit sont en partie détachés. L'examen de la peinture démontre l'utilisation des pigments de faibles densités, dans une telle mesure que la graphie montre beaucoup plus la présence et l'endommagement du vernis que les lignes de la peinture.

3) L'icône «Notre Dame» surnommée «caressante» à été réalisée par maître Constantin de Vithkuq. Par l'examen radiologique on remarque le jeu de pinceau, qui représente de l'intérêt pour le restaurateur de manière à connaître la paternité de l'ouvrage.

Nous avons également examiné quelques peintures d'Onufre où préalablement nous avons constaté l'utilisation des pigments forts. Dans la communication on donne en détail les résultats des examens radiologiques effectués sur les icônes. «Jean Baptiste» et «L'entrée de Sainte Marie au temple» peintes par Onufre, qui sont exposées au musée Onufri à Berat.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dhorka DHAMO Fatmir THAÇI

PIKTURA MESJETARE E BERATIT

Me traditat e pasura figurative afro njëmijëvjeçare, Berati ngre përpara studimeve tona të artit mesjetar disa probleme mjaft të rëndësishme. Së pari, ç'kanë dhënë e çfarë kanë marrë shekujt në pikturën e Beratit dhe së dyti, cilat janë lidhjet dhe vendi i saj në suazën e pikturës sonë mesjetare. Vepra më e rëndësishme e periudhës bizantine në Berat përfaqësohet me afresket e kishës së Shën Triadhës (fig 1, 2), të fundit të shek. XIII. Mjeshtëria dhe niveli spikatin në kompozimet e organizuara me logjikë dhe koncept të saktë profesional. Siguria dhe eleganca në vizatim, ekspresioni i lëvizjes së figurave i jep ansamblit shprehje të fuqishme psikologjike. Figurat pikturohen me njolla të gjera dekorative, çdo palë apo dekor në veshjet i nënshtrohet volumit të madh të formës monumentale. Dy ikona të vogla të shek. XIV, ajo e «Ungjillizimit» dhe e «Krishtlindjes», (fig. 3, 4), paraqesin në Berat traditën paleologe në gjininë e kavaletit. Stili, vlera teknike, niveli i lartë i pikturimit, tregojnë se ikonat duhet të jenë fryt i së njëjtës atelje, në mos i së njëjtës dorë të prirë nga zhanri. Shumë komponente si: kompozimi, ngjyra, vizatimi dhe drita në këto vepra mbështeten në pikturën e mëparshme, sidomos në Shën Triadhën. Ikonat, duke marrë nga tradita, bëhen në të njëjtën kohë pikënisje për piktorët që do të përjetësojnë talentin në gjirin e kalasë. Fragmentet e Vllahernës, shtresa e parë, ndonëse nuk ndriçojnë vazhdën dhe lidhjet konkrete me pikturën e mëvonshme, gjithsesi, vërtetojnë praninë e një tradite të pikturës murore, me vlera të larta piktorike të shek. XIII-XIV, me një zhvillim intensiv e të gjithanshëm në të gjithë qytetin, gjë që tregon se piktura nuk lindi në një vend të zbrazët. Kjo dokumentohet edhe nga ajo sasi kodikësh të shek. IX-X të ilustruara me figurat e ungjillorëve të shek. XI-XII, që shënojnë një evolucion të mëtejshëm të miniaturave me spiritualizëm pasikonoklast. Kodikët janë pasqyrë e gjallë e veprimtarisë së dendur ideologjike të zhvilluar në Berat nga kishat dhe manastiret e shumta, veprimtari që duke gjykuar nga kodiku i vitit 1438, shkruar nga Theodhor Gramatia dhe ndo-



Fig. 1

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

një vepër tjetër, nuk u ndërpre as në një situatë kaq të trazuar siç ishte shek. XV për vendin tonë.

Edhe fillimet e Onufrit, piktorit më në zë të shek. XVI, janë të lidhura me një atelje të punimit në miniaturë. Me Onufrin piktura e Beratit arriti zhvillimin e saj më të lartë. Në afresket e Shën Todrit vërehet qartë ndikimi i pikturës së kishave të kalasë dhe sidomos i Shën Triadhës, nga e cila buron ai thjeshtëzim i formës së madhe dekorative në veshje dhe volumi me dritën e plotë në fytyrat, (fig. 5, 6). Shfaqet tek Onufri, gjithashtu, ndikimi i pikturës së kavaletit të shek. XIV, qoftë në ikonat apo pikturën murore. Por, si artist me talent të fuqishëm ai diti që gjithë këtë trashëgimi ta bëjë pjesë organike të krijimtarisë së tij, ta pasurojë me përvojën artistike përtej Beratit e mbi të gjitha me fantazinë dhe hovin e tij krijues që herë-herë del tej caqeve të kanonit bizantin duke i dhënë veprës së tij një origjinalitet të veçantë, një ngjyrë lokale të përftuar nga kontakti i drejtpërdrejtë me jetën e tronditur, me peizazhin dhe kulturën popullore shqiptare. Tensioni dhe dramaciteti i veça i Onufrit shpreh në mënyrën e vet tendosjen shpi rore dhe revoltën popullore të kohës. Traditën be tase do ta ndjekim paskëtaj në radhë të parë përn jehonës së personalitetit krijues të Onufrit, si dhe veprave të nxënësve e pasuesve të tij të shumtë. Ës me interes të vemë në dukje se Onufri, «mësues» të gjithë ata nxënës që udhëhoqi në veprimtari akti u përpoq t'u zhvillonte individualitetin krijues. Sh mbulli më i qartë janë veprat e të birit të tij, Nil llës. Si nxënës dhe si artist i talentuar, Nikolla r mund të mos përfitonte nga arritjet stilistike, zgjidh teknike dhe ikonografike të të atit, por në të njëjt kohë figurat artistike të krijuara prej tij në mur kavalet (fig. 7) dallohen nga karakteri individu Ato shquhen nga silueti i veçantë, koloriti i pjel dhe vështrimi zhbirues. Portreti është objekti ku p tori thellohet më shumë (fig. 8). Çdo shenjt në afresl e Vllahernës është tipizuar në detajet më të imëta fytyrës. Portretet spikatin pranë formave të sheshta



Fig. 4



Fig. 5

veshjeve dhe të peizazhit me arkitekturën, që merr efekt motivesh zbukuruese.

Pasuesi i dytë i Onufrit, që njohim me emër, është Onufër Qiprioti. Mund të jetë mbase me prejardhje greke, por pa dyshim vendlindja e tij si artist është Berati. Ndikimi i pikturës së Beratit, sidomos i mjeshtrit kryesor, po dhe i Nikollës, ndihet fort në të gjithë veprën e Qipriotit, si në kishën e Shën Kollit në Berat, ashtu dhe gjetkë. Në pikturën e Qipriotit as ana dekorative nuk rrëmben mbi piktoriken, as tensioni i brendshëm i figurave nuk dominon. Vizitori admiron bukurinë e teknikën e harmonizimit të ngjyrave, pa përftuar, emocionin që të ngjall arti plot shpërthime dramatike i Onufrit dhe Nikollës. Pikturat pas vitit 1591, vepra të anonimeve, janë me interes të dyfishtë, si për lidhjen me traditën e mëparshme të Beratit, ashtu dhe për shkëputjen nga kjo traditë, si një fazë kryesore e ndryshimeve që ndodhin në drejtim të nivelit artistik e të stilit. Mbetet për t'u qartësuar nëse të gjithë këta piktorë janë vendas, apo ka dhe të ardhur. Duke njohur pikturën e stilizuar, të stërholluar të një grupi ikonash standarte të Shën Mërisë, ku vërehet ndikimi i shkollave të shartuara manieriste (fig. 9), që vepronin në këtë periudhë në Athos dhe Venedik, priremi nga mendimi se mdis këtyre autorëve duhet të ketë dhe artistë të ardhur në kohën kur piktura e Beratit, shek. XVI, zhvishet nga momenti psikologjik dhe futet në fazën e ilustrimit dekorativ, si në kishën e Shën Kostandinit dhe Elenës (fig. 10), pikturuar në vitin 1647.

Në shek. XVIII-XIX, në vitet 1777 dhe 1812 – 14 në Berat kanë aktivitet të gjerë K. Shpataraku dhe grabovari J. Katro. Duke sjellë aty origjinalitetin e krijimtarisë së tyre, ata, në të njëjtën kohë ndjekin dhe pasurojnë më tej një traditë shumë të rëndësishme të pikturës beratase, futjen në pikturë të elementit etnografik të objekteve dhe të peizazhit real të Beratit apo zonës së Myzeqesë.

Krahas arkitekturës në shek. XVIII-XIX, në Berat u zhvillua dhe piktura islamike (fig. 11), e cila trashëgonte gjithashtu shumë tipare dhe elemente që të kujtojnë pikturën e mëparshme. Teqeja e Xhelve-

DO NOT COPY

tive 1784, ashtu si kishat, pjesët e brendshme i ka të zbukuruara me motive dekorative në trajtë panosh me lule e peizazhe, me mbishkrime, citate dhe vitrazhe. Deri edhe tavani i gdhendur në dru është i pikturuar me të njëjtat ngjyra bazë, me të njëjtën teknikë të pikturës murore që përdornin piktorët e besimit ortodoks. Më qartë kjo vihet re në xhaminë e Beqarëve (1828). Në brezin me pikturë në mur me teknikën e afreskut në pjesën e jashtme të mureve autori, përveç peizazheve shabllone të Stambollit, realizon objekte dhe skena të frymëzuara nga jeta e zakonshme e qytetit, lule të preferuara të vendasve si: karafila dhe trëndafila. Më vonë piktura islamike merr një karakter intim, duke u shtrirë dhe në mjediset e brendshme të pasanikëve dhe zyrtarëve të qytetit (shtëpia kullë e lagjes Gorricë). Skenat nga jeta marrin karakter tregimtar dhe ilustrativ, po indirekt shtjellohen dhe ide që lidhen me potencën ushtarake të perandorisë. Piktura dhe përmbajtje tare islamike e humbet qëllimin e vet të mëparsh Ajo gjithashtu kthehet në një dekor me përmbo të thjeshtë dhe frymë popullore.

E gjithë kjo traditë pikturore doemos që mund të rilevohet vetëm përbrenda kufijve të ngus të Beratit. Ajo lindi dhe u zhvillua nën ndikimi fuqishëm të artit bizantin, nën ndikimin e rrym ideologjike dhe stileve të kohës, por duke lënë njanë këtë aspekt me karakter të përgjithshëm pikturën bizantine të vendeve të ndryshme, vërej se lidhjet më të afërta e të drejtpërdrejta, piktur Beratit dhe monumenti më i rëndësishëm i saj Sh Triadha, i ka patur me pikturën e Apolonisë. Rap tet stilistike nuk lënë asnjë dyshim se pikturat e Ap lonisë janë jo të një dore me ato të Shën Kleme në Ohër (1295), por dhe më të parme. Mbetjet afreskave në monumentet përqark, në Perondi, K



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10

jan, tregojnë se atelieja e dëgjuar, që bujari shqiptar, Progon Zgurra, pajtoi në Shën Klement, provat e para i ka bërë në Shqipërinë e Mesme. Qoftë edhe këto vepra e fakte, pa folur për vazhdën e traditës apoloniate që e ndjekin dhe në monumente tej Shqipërisë, në Shën Mitër të Pejës, apo në Shën Thanas të Kosturit, do të mjaftonin për të mos u pajtuar me atë mendim të shpejtuar e të pabazuar shkencërisht, që e cilëson Shqipërinë e Mesme si «pellgmbledhëse», jokrijuese e imituese të artit serb të Milutinit. Nëpërmjet Onufrit kryesisht dhe pasuesve të tij, jehona e shkollës të Beratit u përhap gjithandej. Brenda vendit Onufri e çoi atë në Shpat të Elbasanit, duke krijuar kryeveprat e tij. Nikolla dhe Joani në Kurjan të Fierit, Qiprioti në jug të Shqipërisë, në Vrahogoranxi të Gjirokastrës. Vepra të Onufrit, të nxënësve dhe ateliesë së tij gjejmë dhe përtej kufijve të Shqipërisë. Më 1547 në kishën e Kosturit në Greqi (Sh. Apostujt) Onufri shënon jo pa krenari «I ardhur nga qyteti i shkëlqyer i Beratit». Fakte e vepra të reja tregojnë se Onufri dhe ateljeja e tij e ka rrahur disa herë rrugën për në viset e Maqedonisë, Greqisë dhe Jugosllavisë. Më 1535, Onufri pikturon dy kisha të zonës së Perlepit, «Shën Kollin» dhe «Shpërfytyrimin» e fshatit Zerze. Në këtë të fundit ka dhe ikona të tij. Në Slepce, në zonën e Demir Hisarit, janë zbuluar ikona dhe kryqe të gdhendura në dru të Onufrit dhe të Nikollës. Më 1561 Nikolla pikturon kishën e Shën Gjergjit në Arbanas të Bullgarisë.

Ndonëse zbulimi dhe identifikimi i pasuesve të Onufrit jashtë Shqipërisë është ende në fillim dhe këtu kemi disa të dhëna me interes. Mjeshtër Longini më 1580 ka pikturuar mjaft ikona dhe afreske në

DO NOT COPY



Fig. 11

manastirin Lomnica, në juglindje të Bosnjës. Origjinën e tij nuk e njohim, por dimë se ka qenë murg i manastirit të Pejës. Në artin e Longinit hetojmë shumë pika takimi me atë të Onufrit dhe të atelies tij, në prerjen e ikonave, në kompozimet katrore mur, në radhitjen e studiuar të ansamblit etj. epitetet për Krishtin, që janë cilësuar si jotipike pikturën e atij pellgu, përkojnë me atë të Onufr

Studimi i pikturës së Beratit dëshmon për zhvillim të pandërprerë të saj, ku shekujt kanë m kanë dhënë e kanë pasuruar njëri-tjetrin. Në të v re ndikimin frytdhënës të pikturës bizantine pale ge dhe mbi të gjitha lidhjet e ngushta me art pellgut nga Shkumbini në Vlorë me qendër Apol në dhe jehonën rrezatuese përtej kufijve të Shq risë. Piktura e Beratit me përvojën e vet njëmijë çare marrëse e dhënëse dëshmon për evolucioni brendshëm të pandërprerë të pikturës sonë me tare, për mbështetjen kryesisht në traditën lokal frymën e kohës, që i ka dhënë asaj aromën e veç dhe fytyrë individuale.

DO NOT COPY

Dhorka DHAMO – Fatmir THAÇI

DO NOT COPY

LA PEINTURE MEDIEVALE DE LA VILLE DE BERAT

RESUME

La plus importante oeuvre de la période byzatine de la ville de Berat, est documentee par les tresques monumentales de l'église de la Sainte Trinite datant de la fin du XIIIe sc. La tradition paleologue apparait à Berat, sous une forme évoluée par deux petites icônes: «L'annonciation» et «La nativité» réalisées, au cours du XIVe sc. L'église de la Sainte Trinité et ces icones représentent une phase importante de l'art de cette ville et serviront d'appui aux autres peintres qui, plus tard, réaliseront des fresques et des icônes dans les églises de la citadelle. La dense activité des églises et des monastères de la ville de Berat est documentee par le grand nombre des codexes des IX-X^e sc. et plus tard des XI-XIIe sc., lesquels, par la riche décoration et les couleurs vives, marquent une évolution ultérieure. Dans la plupart des cas ce sont des oeuvres commandées par les autorités de la ville de Berat, par des nobles, des clergés, réalisées par des calligraphes et des peintres de miniature qualitiés du pays.

La présence d'un important atelier qui fonctionna à Berat au cours des XIII-XIVe sc. et les ressemblences avec les fresques d'Apollonie et de l'église de Saint Clément d'Ohrid réalisées plus tard en 1295, nous poussent à ne pas prendre en considération l'opinion erronée selon laquelle l'Albanie centrale n'est pas une région originale, et imite l'art serbe de Milutin.

La peinture de Berat fleurit au cours du XVIe sc. en atteignant sa perfection avec Onufre. Aux fresques de l'église de Saint Théodore on remarque bien l'influence de la peinture précédente des monastères de la forteresse et surtout de celle de l'église de Sainte Trinité, d'où vient la simple forme décorative des vêtements et les visages volumineux et pleins de lumière. Dans la peinture d'Onufre, la couleur ses rapports complémentaires, deviennent le plus puissant moyen d'expression. Onufre intensifie la tâche des couleurs nettes, le rouge, le bleu, le vert, lesquelles brillent l'une près de l'autre comme par magie. (La belle porte du musée de Korça).

Du point de vue artistique et réalisation technique, aux oeuvres d'Onufre à Berat, il faut ajouter deux grandes icônes, celle de «Jean Baptiste» de la cathédrale et celle des «anargires de Cosme et Damjan» de l'église de Saint Jean.

L'oeuvre d'Onufre revêt les dimensions d'une école, avec les successeurs affirmés Nicolas, Jean, Onufre de Chypre et les anonymes du XVIIe sc.

Toutes les peintures datant après l'année 1591, appartiennent à une importante phase de transformations que subirent le style et le niveau. La tendence décorative est présentée par la peinture de l'église de Saint Costandin et d'Hélène, tandis que celle maniériste, caractéristique pour les écoles éclectiques des peintures post-byzantines d'Athos et Venise, par un groupe d'icônes de Notre Dame stylisée en forme standarte raffinée.

Ce tableau précède la peinture du XVIIIe-XIXe sc. représentée par C. Shpataraku et J. Katro. De pair à l'élément baroque, dans la peinture ecclésiastique s'introduirent dans une grande mesure l'élément ethnofolklorique et les objets réels du paysage de Berat. Les couleurs, le dessin, la composition des images, ne se marient pas toujours bien, prenant souvent un aspect décoratif qui s'associe aux sculptures en bois des iconostases de la cathédrale de Notre Dame.

Le même phénomène apparait à la peinture islamique du «Teqe de Xhelvetia» et surtout à la Mosquée de Beqar et à la maison «kulla» du quartier Goricë, décorée en peinture du XIX sc. au cours de deux étapes.

La présence d'une riche tradition dans ce domaine de la peinture caractérisée par des particularités de style des traits et des éléments locaux ethnofolkloriques, fait preuve d'une évolution artistique et culturelle de la ville de Berat, qui représente l'une des plus importants centres urbains du pays à cette époque. De cette brillante ville, Onufre entreprit son voyage vers les régions de Macédoine, à Castoria en Grèce et à Prilep en Yougoslavie, Nicolas et Jean, menèrent plus loin l'écho de l'atelier d'Onufre par leur oeuvre connue à Arbanas, l'église de Saint Georges en 1561. D'autres oeuvres et auteurs témoignent des liens et du large rayonnement de la peinture de Berat tant à l'intérieur qu'à l'extérieur de l'Albanie.

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

monumenet

DO NOT COPY

Adrian DEVOLLI Mustafa ARAPI

PROBLEME TË RESTAURIMIT TË DISA IKONAVE

Konservimi dhe restaurimi i ikonave, nga viti në vit, ka shënuar arritje cilësore. Gjatë këtyre viteve janë restauruar ikona të shumë autorëve të njohur si të: Onufrit, të birit, Nikollës, David Selenicës, Kostandin Shpatarakut, vëllezërve Zografi etj, si dhe shumë ikona autorësh anonimë. Bashkëpunimi me laboratorët e Fizikës Bërthamore, Institutit të Kërkimeve Gjeologjike, Institutit të Historisë, me Rëntgenografinë e Spitalit Nr. 2 Tiranë kanë ndihmuar për diagnostikimin dhe për marrjen e të dhënave laboratorike për të përcaktuar sa më drejtë ndërhyrjet restauruese.

Ikonat e restauruara shquhen për vlerat e larta estetike, kompozimet dinamike, elegancën, modelimet e ndjeshme, si dhe për futjen e elementeve vendase në skenat ikonografike. Mund të përmendim qendrën e ikonostasit të kishës së Evangjelizmoit në kalanë e Beratit të Onufrit. Të njëjtat vlera na japin dhe mjaft ikona anonime si ato të Lindjes së Krishtit (shek. XIV), Vajtimi i Mbivarrshëm i David Selenicës, Dyert e Bukura të pikturuara prej Onufrit dhe dy ikona anonime të Shën Mëhillit. Të ardhura nga kohë dhe vende të ndryshme, ato në shumë raste, kanë zgjidhje kompozicionale koloristike e teknologjike të veçanta. Si rrjedhim, edhe në punën restauruese e konservuese ne jemi munduar të përdorim forma të ndryshme. Për një diagnostikim dhe ekzaminim sa më të plotë, ikonave fillimisht u është bërë dokumentacioni përshkrimor, fotografik dhe ai grafik i gjendjes ekzistuese, ku evidentohen dëmtimet që ka pësuar vepra në kohë. Ky dokumentim dhe ekzaminim lidhet në radhë të parë me përcaktimin e një diagnoze më të plotë të sëmundjeve, si dhe përcaktimin e rrugëve që do të ndiqen për trajtim. Në ekzaminimin shkencor të ikonave jemi munduar të paraqesim tërësinë e të dhënave që kanë të bëjnë me natyrën dhe përbërjen e lëndëve.

Në kumtesë ne do të ndalemi kryesisht në problemet e veçanta të disa ikonave. Në ikonën e Shën Mërisë (fig. 1), të katedrales së Sh. Mërisë në Berat, një ndër problemet ishte trajtimi i drurit, i kthyer në formë sfungjeroze nga insektet. Për dezinfektimin e saj u përdorën avuj të sulfurit të karbonit. Konsolidimi i drurit u bë me paraloid B. 72 të injektuar fillimisht në gjendje mjaft të holluar për të depërtuar sa më në thellësi të drurit. Këto ndërhyrje i kthyen ikonat në të forta e të rezistueshme ndaj temperaturës e lagështisë dhe infeksioneve bakteriologjike. Në ikonat e qendrës së ikonostasit të kishës së Evangjelizmosë në kalanë e Beratit (fig. 2), probleme kryesore ishin trajtimi i mbishtresës së vernikut të dekompozuar dhe heqja e ripikturimeve. Verniku i një shtrese relativisht të trashë, në ngjyrë të errët në të kuqërremtë, që e errësonte mjaft imazhin piktorik dhe kompozicional, paraqiste në vetvehte një sërë dëmtimesh si plasaritje në formë lëvoreje mbi shtresën e arit, të shkaktuara nga kontraksionet e ndryshimeve në prezencë të lagështisë. Mbi ngjyrë ai paraqitej në formë ishullore duke tërhequr ngjyrën me vete dhe duke zbuluar shtresën e arit në siluetat e disa shenjtorëve. Rezultatet e analizave sollën të dhëna për përbërjen mineralogjike të ngjyrave dhe të arit, ndërsa nga analiza e vernikut rezultoi se ai ishte me bazë rrëshire. Kjo na ndihmoi për përcaktimin e solucioneve që u përdorën për trajtim. Pastrimi fillimisht u krye me solucione relativisht të lehta si terpentinë, aceyon e më tej u vijua me solucionet më të forta si dimmitil formamid me amil acetat. Nga një vëzhgim që iu bë ikonave të sipërpërmendura me ndriçim ultraviolet, u konstatua se kryqi në duart e Shën Andreas, dy engjëjt që ndodhen prapa Krishtit, si dhe në veshjet e Shën Simonit dhe Shën Bartolemeut, ishin të ritokuar.

Ikona e punuar nga David Selenica (fig. 3) kishte një çarje, e cila përshkonte horizontalisht qendrën kompozicionale të ikonës. Për qepjen e saj u ndoq mënyra e parketazhit. Analiza e gruntit tregoi se ai kishte për bazë sulfatin e kalciumit. Konsolidimi i

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 3



Fig. 2

zonës së dëmtuar nga lagështia u bë duke imp
njuar xhelatinë të holluar me ujë me anë të shi
gave dhe duke vendosur nga sipër letër japone
Tek «Dyert e Bukura» të marra nga kisha e Kostand
dhe Helenës u vu re se kishte ndryshime stilis
ndërmjet trajtimit të figurave dhe pikturimit të a
tekturës. Nga kjo lindi dyshimi se kishim të bë
me dy shtresa pikture. Vrojtimi me rreze rëntgen n
në pah nënpikturën, si dhe gjendjen e saj. Meqen
nënpiktura, piktura origjinale, ruhej përgjithësisht
gjendje të mirë, mendimi ynë, si dhe ai i komisi
të restaurimit ishte që të hiqeshin ripikturimet.
shtirësia e trajtimit ishte se shtresat qenë të ven
sura direkt mbi njera-tjetrën. Për këtë fillimisht u b
sondazhe në sfond dhe për çdo ngjyrë. Nga at
vu re se zonat ku ndihej prezenca e ngjyrës së b

dhë, duart, portretet, paraqisnin rezistencë të madhe për t'u hequr. Sa më shumë rritej përqindja e së bardhës, aq më e vështirë bëhej tretja e saj. Kështu në disa zona të portretit të Shën Mërisë, të kryeëngjëllit Gabriel, si dhe profet Ilias, ajo ishte gati e paheqshme, pasi kishin të bënin me të bardhë të përgatitur me kazeinë. Gjatë trajtimit doli një mbishkrim me gërma të zeza të stilit bizantin që tregonte se ikona ishte punuar nga Onufër Qiprioti në vitin 1560.

Në ikonën «Shpërfytyrimi» (fig. 4-5) dhe skena nga «Jeta e Krishtit» (fig. 6) të kishës së fshatit Drianë të rrethit të Gjirokastrës, piktori e kishte përdorur vernikun në funksion të dyfishtë, si ngjyrë dhe si shtresë mbrojtëse. Ai, duke qenë në ngjyrë të kuqërremtë shumë të bukur, harmonizonte të gjithë koloritin dhe i jepte ikonës një gamë të ngrohtë duke na krijuar një gjendje të veçantë koloristike. Por verniku ishte i oksiduar në sipërfaqe, kështu që lindte problemi i trajtimit të tij. Ndërhyrja vazhdoi deri në shkallën e largimit të oksidimit, duke nxjerrë në pah vlerat e veprës.

Në shumë ikona të restauruara integrimi ka qenë dhe mbetet një nga problemet shqetësuese dhe më të vështira, pasi përfshin problemet estetike të veprës që kanë të bëjnë me një qëndrim individual të restauruesit. Kështu, në ikonën «Lindja e Krishtit» në vendet ku mungonte piktura së bashku me gruntin, inte-

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5



Fig. 6

grimi u bë me vija të drejta vertikale, në mënyrë që mos krijonte vlera të reja, ndërsa në zonat që nuk lindte hipoteza u respektua i njëjti kolorit me tor litet dallues. Në ikonën Kostandini dhe Helena mu gonte gati 1/3 e sipërfaqes së pikturës. Meqenë kishim të bënim me një kompozim monumental metrik ballor, dyfigurësh, ku lindnin shumë hipoteza mbylljes së siluetave të kompozimit, integrimi u me vija vertikale të përdredhura duke respektuar c ngjyra që lidheshin dhe harmonizoheshin me krejt g mën koloristike të ikonës. Plotësimi i kryqit të ma që e mbajnë në duar Kostandini dhe Helena, ku n kishim të bënim me një problem hipotetik të vazhd mësisë së siluetave, integrimi u bë po me ato ngjy përshtatëse, por duke i dhënë përparësi ngjyrës kryqit, duke mbyllur kështu siluetën e tij.

Paraqitëm kështu disa procese të punës resta ruese në sektorin e artit, të cilat mendojmë se jap një kontribut në ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave ku turore të traditës sonë.

DO NOT COPY

Adrian DEVOLLI – Mustafa ARAPI

DES PROBLEMES POSES PAR LA RESTAURATION DE QUELQUES ICÔNES

RESUME

Au cours de ces années sont restaurés des icônes faites par de nombreux peintres connus, tels Onufre, son fils Nicola, David Selenica, Kostandin Shpataraku, les frères Zograf, etc. Réalisées dans de différentes régions et époques, dans la plupart des cas elles représentent une solution de composition, de couleurs et de technologie particulière, ce qui exige aussi de différentes formes au processus de restauration. Tout d'abord on procéda à la documentation descriptive, photographique et celle graphique de l'état existant. Nous allons nous arrêter essentiellement aux problèmes particuliers que posa la restauration de quelques icônes. Pendant la restauration de l'icône de la Vierge, le traitement du bois provoqua quelques difficultés. Pour la désinfection on utilisa la vapeur du sulfure de carbone. La consolidation fut réalisée par le paraloid B 72. La restauration des icônes de l'église de l'Anonciation à Berat posa le problème du traitement de la couche de vernis décomposée. Les résultats des analyses nous renseignèrent sur le contenu minéralogique des couleurs et du vernis, ce qui aida la définition des solutions qu'on devait utiliser.

Les scènes de la Porte du Rétable étaient composées de deux couches de peinture. L'examen aux rayons X mit en évidence la sous-peinture et son état. On rencontra des difficultés en enlevant la couche peinte en blanc. Dans les icônes «la transfiguration» et «la vie de Christ» du village Drianë, le vernis jouait une double fonction, celle de la couleur et de la couche protectrice. Le traitement de la surface oxydée mit à jour les valeurs, de l'oeuvre. Dans plusieurs icônes, l'intégration demeure l'un des problèmes les plus difficiles. A l'icône «Constantin et Hélène» l'intégration fut réalisée par des lignes verticales, tandis que dans les zones où il n'y avait pas lieu d'hypothèse on respecta les mêmes couleurs mais à une tonalité distincte.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Odise ÇURRI

ECURI NË RUAJTJEN DHE RESTAURIMIN E MOZAIKËVE

Numri i mozaikëve në vendin tonë është mjaft i madh dhe ka shtrirje të gjerë kohore, prej shek. IV p.e.s. deri në mesjetën e mesme. Përveç qendrave të mëdha të qytetërimit të lashtë të vendit tonë si Durrësi, Apolonia, Butrinti etj, ato i gjejmë të shpërndara në gjithë territorin e vendit, çka tregon për një zhvillim të mirë ekonomik e kulturor edhe të brendësisë. Me mozaikë zbukurohen dyshemetë e mjediseve publike si banja, gjimnaze, mjedise të banesave qytetare, si dhe të bazilikave paleokristiane. Mozaiku ynë muror përfaqësohet vetëm në dy raste: në kapelën e amfiteatrit në Durrës dhe në dy nike në nimfeun e gjimnazit në Butrint. Përgjithësisht, mozaikët janë punuar me teknikën «opus teselatum» (me kubikë të prerë), përjashtuar një rast të vetëm me «opus barbarikum» (me gurë zalli), në mozaikun e gruas në Durrës. Kompozimet e tyre i gjejmë nga ato më të thjeshtat, të cilat mjaftohen vetëm në shpërndarjen harmonike gjeometrike të teselave, deri në ato me zgjidhje të ndërlikuar kompozicionale, me larmi të theksuar në konceptimin koloristik bardhë e zi, me pak tone ngjyrash, si dhe shumë të tjerë me një gamë mjaft të gjerë koloristike. Teselat — kubikët janë prerë nga gëlqerorë shumëngjyrësh, nga balta e pjekur, mermeri, si dhe brumi i xhamit. Në drejtim të ndërtimit të nënshtresave mbajtëse të veprës vërejmë, në përgjithësi, një korrektësi zbatimi, që shprehet në dyshemetë me një hidroizolim dhe një rezistencë të përkryer në zgjedhjen e materialit të duhur për çdo shtresë, raportin e rregullt të materialeve, si dhe granulometrinë. Një ndërtim i tillë, për periudha të ndryshme pësoi një zhvillim të ndjeshëm, i cili në periudhën bizantine arrin pikën më të lartë.



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

Ruajtja dhe vlerësimi i kësaj pasurie të madhe kulturore lidhet tërësisht me periudhën e Pasçlirimit. Tashmë është stabilizuar gjendja në drejtim të degradimit të mëtejshëm dhe po punohet për restaurimin e tyre në përshtatje me vlerën dhe gjendjen e secilës vepër duke u ballafaquar me përvojën bashkëkohore të përparuar.

Kujdesi për ruajtjen e mozaikëve fillon që me ndërmarrjen e gërmimeve arkeologjike, ku është i pranishëm edhe grupi restaurues, i cili përforcon pjesët e dëmtuara dhe grumbullon të dhëna dokumentare. Koordinimi i arkeologut me restauruesin kohët e fundit ka qenë i mirë dhe si rezultat i kësaj, humbjet kanë qenë më të vogla. Puna jonë konservuese ka synuar gjithmonë për zgjatjen e jetës së veprës për t'ua trashëguar brezave të ardhshëm me atë formë e strukturë, pa i hequr ose shtuar asaj asgjë. Për të arritur këtë, në mozaik janë bërë ndërhyrje konservuese, konsolidime të anëve dhe zonave të dëmtuara në brendësi të kompozimit, injektime të pjesshme etj. Si llaç konsolidues është përdorur llaçi i gëlqeres me materiale të përafërta me ato të strukturës së nënshtresave të veprës, me vetitë e mundësisë së reversibilitetit.

Në problemin e integrimit gjithmonë është mbajtur një qëndrim i rezervuar. Boshllëqet i kemi ndarë në dy kategori sipas dimensioneve dhe gjendjes së tyre: boshllëqe me riformulim të vizatimit, siç janë humbje e një tesele ose edhe një grup teselash te motivet e qarta gjeometrike, i cili përbën një pjesë të vogël të motivit, dhe boshllëqet e mëdha që nuk mund të riformulohen, siç janë ato kur mungon pjesa më e madhe e motivit, ose kur ai mungon fare. Plotësimi i kubikëve në rastin e parë dokumentohet, ndërsa kubikët e përdorur merren nga sasia e kubikëve gjetura të shpërndara gjatë gërmimit. Për të arrit tone të këndshme të llaçit mbushës janë kryer par prakisht një sërë provash, në mënyrë që këto mbush të mos bëhen faktor shqetësues në paraqitjen estet ke të veprës. Llaçin e kemi vendosur 1 – 2 mm n poshtë sipërfaqes së ekspozuar të teselave, duke pr feruar një sipërfaqe në të shumtën e rasteve të ash për (fig. 1, 2). Mozaikët i lajmë nga papastërtitë n ujë të pastër, ndërsa depozitimet e kripërave ose mbeturinave të gëlqeres i kemi larguar me anë të b sturisë, duke iu shmangur përdorimit të solucionev gërryese. Mbulimin e tyre gjatë dimrit e kemi kry me rërë të larë me një shtresë polietileni në mes. P ruajtje dhe ekspozim më të mirë po punohet p ndërtimin e mbulesave me konstruksione të lehta m talike e xham. Në rastet kur kemi vërejtur një degr dim të plotë të nënshtresave, kur ato i kanë humb vetitë e tyre mbajtëse të veprës, kur ndodhen në v nde të largëta e të izoluara në pamundësi vizitin është marrë vendimi për të bërë edhe zhvendosjen tyre. Duke parë ecurinë dhe rezultatet e kësaj pun vërejmë se ka një evoluim të dukshëm në drejtim koncepteve restauruese, për metodat, materialet përdorura etj. Në fillimet e punës, nga mungesa përvojës, rivendosja filloi të bëhej në panela beto -armeje, (fig. 6/1), materiali ireversibël që sillte rrez kun e çlirimit të kripërave të tretshme, të cilat në s përfaqe kombinohen dhe kristalizohen në kompleks të patretshme në poret e pjesëve të sipërme të tes lave, duke i dhënë një ngjyrë gri uniforme krejt kom pozimit. Më pas, me fitimin e përvojës, teknologjia metodës së mësipërme u përsos. Tani ndërmjet pan lit të betonit dhe qilimit vendoset një shtresë e ndë

DO NOT COPY



Fig. 5

mjetme (reversibile) llaçi me gëlqere të stazhionuar, pluhur guri, pluhur qeramike, si dhe një sasi e vogël çimentoje të bardhë, e cila vazhdimisht ka ardhur duke u zvogëluar (fig. 6/2, fig. 3). Me këtë metodë u restauruan mozaiku i Antigonesë, Tepesë në Elbasan, Mesaplikut, Tiranës, si dhe ndonjë fragment i shkëputur mozaiku në Ballsh e Mesopotam. Vitet e fundit, duke pasur në theb përgjegjësinë për monumentin, si dhe evolucionin e ndjeshem të kualifikimit profesional kemi pasur rezultate më të mira. Veprën e kemi parë në unitet me arkitekturën, jemi munduar që edhe gjatë rivendosjes të ruajmë sa më tepër karakteristika të origjinës së mozaikut në pamje dhe strukturë. Duke u nisur nga këto parime, veprën nuk e ngurtësojmë më në panela betoni, por e vendosim në vendin e saj fillestar drejtpërdrejt mbi një suport me llaç të shtresëzuar gëlqereje (fig. 6/3, fig. 4) (pa armaturë metalike), duke imituar stratigrafinë origjinale. Kjo metodë kohët e fundit është zbatuar me sukses në restaurimin e mozaikëve të Apolonisë, Durrësit dhe Linit. Për të arritur këtë, paraprakisht nga ana e laboratorit dhe restauruesit drejtues të punimeve është bërë një punë e plotë ekzaminuese, ku merren të dhëna të plota për stratigrafinë në bazë shtrese dhe gjer te mundësia për të kuptuar mënyrën e realizimit nga mjeshtri.

Në vazhdën e këtyre arritjeve me interes është edhe përpjekja që u bë në vitin që shkoi në mozaikun e Arapajt. Në restaurimin e pjesshëm që u bë (rreth 10 m²) u arrit me sukses që ai t'i përshtatej natyrës së ondulimit të gjithë dyshemesë (fig. 5). Për këtë u desh të bëhej në radhë të parë një dokumentacion i saktë i marrjes së kuotave me bazë rrjetin kuadratik, si dhe të kryhej një punë serioze për ndërtimin e nënshtresave.

Shkulja e sipërfaqeve me mozaik, në të gjitha rastet, është realizuar me prerjen e sipërfaqes me fragmente me përmasa rreth 1 x 1 m duke shfrytëzuar gjithmonë boshllëqet, bordurat, figurat gjeometrike, pa dëmtuar motivin figuror. Deri më sot nga ana jonë ende nuk është bërë ndonjë provë për vënien në përdorim të materialeve të reja, si dhe të mënyrave të fundit të rivendosjes së mozaikëve, sepse i jemi përmbajtur teknologjisë tradicionale për të cilën arritjet kanë qenë pozitive.

Në këtë mënyrë, ndërhyrjet për mirëmbajtjen e vazhdueshme të sipërfaqes me mozaik, që me daljen në dritë nga gërmimi arkeologjik, si dhe ato të restaurimit deri në rivendosje mbi suport të ri, kur është e domosdoshme, kanë bërë që të grumbullohet një përvojë e mirë, që do të jetë në themel të punës së ardhshme për ruajtjen e vlerave dhe vizitueshmërinë e tyre.



Fig. 6

DO NOT COPY

Odise ÇURRI

EVOLUTION AU PROCESSUS DE LA SAUVEGARDE ET DE LA RESTAURATION DES MOSAIQUES

RESUME

On retrouve des mosaïques dans tout le territoire de notre pays, mais elles sont plus concentrées dans les villes antiques de Butrint, de Durrës, d'Apollonia etc. Ce sont des mosaïques réalisées depuis le IVe sc. av. n.e. jusqu'au milieu du Moyen-Age. Seulement après la libération nationale du pays on fit attention à la sauvegarde et l'appréciation de cette grande richesse culturelle. On procéda à leur restauration afin d'empêcher une dégradation ultérieure. Notre travail vise à faire prolonger la vie de l'oeuvre par la même structure et la même forme.

Pour cela on n'a entammé que quelques petites interventions de conservation et de consolidation des bordures et des parties à l'intérieur, quelques injections dans le cas où les tesselles sont détachées du support ainsi qu'un nettoyage superficiel des tesselles. Quant au problème de l'intégration on a toujours adopté une attitude reservée, on a procédé à la substitution d'une ou deux tesselles perdues tandis que les grandes lacunes sont remplies de mortier de chaux d'une superficie un peu granuleuse à un plus bas niveau que celui des t selles. Au cours de l'hiver les mosaïques sont couvertes sable bien lavé avec une feuille plastique au milieu. Dans cas d'une détérioration complète du support et du bain pose ou quand la mosaïque se situe à quelque coin éloigné inaccessible on décide sa dépose. Au début, cette dépose réalisait par des panneaux en béton armé, au milieu panneau en béton et le tapis des tesselles on mettait u couche reversible de mortier de chaux et un peu de cime Ces dernières années on n'utilise plus les panneaux en bét mais les supports en mortier de chaux en imitant la stratig phie originale. Des travaux de restauration sont entammés mosaïques d'Arapaj et d'Apollonie. On put faire adapter partie restaurée à la nature de l'ondulation de tout le pa ment. Ainsi les efforts, pour l'entretien ultérieur des mosaïqu la restauration et la dépose au besoin, sont une bonne ex rience qui aidera notre travail de conservation et de rest ration.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Skënder MIHALÇKA – Marita BEÇI

REZULTATE TË EKZAMINIMIT DHE TË PUNIMEVE RESTAURUESE NË PIKTURËN MURORE TË MANASTIRIT TË ARDENICËS GJATË VITEVE 1984 – 1985

Manastiri i Ardenicës ngrihet mbi vargun kodrinor të Ardenicës. Ai përbën një ansambël me vlera, në qendër të të cilit ndodhet kisha Lindja e Shën Mërisë, e rindërtuar në vitin 1743.

Ajo përbëhet nga naosi, narteksi, ekzonarteksi, dykatësh dhe portiku në anën jugore. Në pasurinë artistike të saj, përveç veprave plastike, bëjnë pjesë pikturat murore realizuar në vitin 1744 nga piktorët Kostandin dhe Athanas Zografi nga Korça.

Piktura e Zografëve është e stilit provincial, vazhdim i traditës së vjetër pikturore të vendit tonë, që përkon me periudhën e paleologëve të shek. XIV, e cila përmban vlera historike dhe artistike në kuadrin e artit tonë mesjetar. Në të ka kompozime me prirje realiste, shprehje të ndjenjave individuale në portretet e shenjtorëve, qëndrime monumentale të personazheve dhe elemente origjinale realiste që e pasurojnë atë (fig. 1). Suvaja e pikturuar mbulon rreth 3/4 e sipërfaqes, e cila shtrihet në muraturën e ndërtesës së përbërë nga gurë shtufi dhe gurë të bardhë, të lidhur me llaç gëlqereje. Suvaja ka një trashësi që ndryshon nga 10-13 mm dhe përbëhet nga dy shtresa. Shtresa e parë përgatitore, me trashësi 10 mm, është thjesht gëlqere lidhur me kashtë gruri, ndërsa shtresa e dytë, me trashësi 2-3 mm, përbëhet vetëm nga gëlqere, mbi të cilën është ekzekutuar piktura. Në përgjithësi suvaja është reduktuar në një shtresë të vetme të përbërë nga gëlqere dhe kashtë. Duke përfituar nga degradimi i shtratit pikturor në portretin e Shën e Dielës, mundëm të riprodhonim etapat e pikturimit të saj. Për ekzaminimin sipërfaqësor të portretit përdorëm edhe një aparat me rreze ultraviolet, i cili lokalizonte më mirë dëmtimet sipas shtresave. Si etapë e parë ishte vizatimi përgatitor me ngjyrë okër të kuqe, e cila vihet re kudo në pikturimin e ansamblit. Pastaj, një ngjyrë lokale e gjelbër në okër,



Fig. 1

e cila formon tonin bazë të fytyrës dhe mbi të gjysmëtonet me ngjyrë të gjelbër dhe kafe. Si etapa përfundimtare janë vendosja e pjesëve të ndritshme me ngjyrë okër të përzier me të bardhën e gëlqeres, rimarja e vizatimit dhe vendosja e thekseve, duke mos lëvizur shumë nga vizatimi përgatitor. Siç rezulton nga parimi i ndjekur i pikturimit, kemi të bëjmë me teknikën e afreskut në gëlqere, e cila në këtë periudhë ekzekutohej me të meta teknike, gjë që vihet re në dëmtimet e shtresave përfundimtare të piktu-

DO NOT COPY



Fig. 2

rës. Analizat fizike të ngjyrave na kanë dhënë natyrën inorganike të tyre: ngjyra e verdhë ka si substancë bazë hekurin, ngjyra e kuqe ka si substancë bazë zhivën, ngjyra kafe ka si bazë hekurin dhe ngjyra e gjelbër ka si substancë bazë nikelin. Në sfondin e zi konstatohen dy shtresa, e para me ngjyrë të kaltër smeraldi dhe mbi të e zeza.

Gjatë konsolidimit të afreskeve, në faqen perëndimore, u dalluan dy faza pikturimi (fig. 2). Në fazën e parë ishte pikturuar e gjithë faqja e murit, kurse në fazën e dytë, me anën e një lyerjeje të hollë 5 mm, suvaja është shtrirë mbi lyerjen e parë, pa mbuluar skenën «Fjetja e Shën Mërisë» dhe mbishkrimin e piktorëve që i takonin fazës së parë. Shkakun e këtij ndryshimi mund ta shpjegojmë jo aq me ndryshimin e programit ikonografik se sa me atë të elementeve të arkitekturës, mbylljes së dritareve fillestare dhe zvogëlimit të portës, gjurmët e të cilave duheshin mbuluar me anën e ripikturimit. Krahasimi stilistik dhe teknik i këtyre dy fazave rezulton si vepër e këtyre piktorëve. Në faqen lindore të narteksit piktura i përshtatej konstruksionit fillestar të tij, e cila shtrihej edhe në katin e parë. Por, me modifikimin që pëson më vonë narteksi dhe hapjen e dritareve që korrespondojnë me ato të naosit, afresket janë prerë në këto zona. Në përgjithësi, vepra e artit ruan formën e saj, por paraqet dëmtime si të aspe tit fizik, ashtu edhe estetik. Shkaktarët kryesorë këtyre dëmtimeve kanë qenë lagështia e formave ndryshme dhe dëmtimet e godinës nga tërmetet e teve 1960 dhe 1983. Duke pasur parasysh këto d gradime, kemi grupuar në mënyrën e mëposht edhe radhën e ndërhyrjeve restauruese:

a) Dëmtime mekanike, të shkaktuara nga lëviz sizmike dhe pesha e rëndë e trarëve të mbulesës, p sojat e të cilave kanë rënë mbi suvanë origjinale formë shkëputjeje, çarjesh dhe deformimesh të mu

b) Dëmtime fizike dhe kimike (fig. 3), për shk të lagështirës së kapilaritetit, depërtimit dhe kullim të cilat kanë shkaktuar shkëputje të mëdha të s vasë, formimin e boshllëqeve ndërmjet bazës dhe ll çit, çarje, degradimin e shtratit pikturor dhe depoz timin e kripërave të gëlqeres (fig. 4).

c) Nga ana estetike piktura, përveç patinës k hore, ka mbivënie të ndryshme, të cilat i kanë tjetë suar aspektin artistik veprës së artit. Në këto mbiv nie përmendim: shtresa verniku, pluhura, blozë q rinjsh, bojëra vaji, lëndë organike dhe suvatime vona të lyera me bojëra muri, që kanë mbuluar edh disa afreske.

Për monumentin u hartua paraprakisht projekti restaurimit dhe radha e ndërhyrjeve. Punimet e kon



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 5

solidimit filluan pas tërmetit të vitit 1983, i cili kishte dobësuar një pjesë të afreskeve duke rrezikuar shkëputjen e tyre. Probleme të veçanta të konservimit paraqiste faqja perëndimore e naosit, që lidhej me ekzistencën e dy shtresave të pikturimit dhe humbjes së lidhjes midis tyre. Konsolidimi i këtyre zonave u bë nëpërmjet trajtimit të bordurave, qepjeve dhe rindërtimin e boshllëqeve, duke nxjerrë në pah shtresën e parë nga shtresa e dytë. Në këtë faqe, për shkak të dëmtimeve që ka pësuar arkitektura, janë parashikuar punime të mëvonshme në afresket. Në përgjithësi, nga punimet e viteve 1984-1985 është prekur i gjithë ansambli, duke kryer procese të ndryshme të konsolidimit, (fig. 5), si ngjitjen e afreskeve me anën e injektimeve, qepjen e të çarave, përforcimin e anëve të suvasë së pikturuar me anën e trajtimit të bordurave dhe pastrimin nga verniku të disa zonave. Kështu, në faqet lindore dhe veriore u ndërmorën punime deri në lartësinë 1.60 m dhe 2.80 m në të cilat lagështia e kapilaritetit dhe e depërtimit kishte dërrmuar suvanë origjinale dhe shtratin pikturor. Për lokalizimin e veprës origjinale ajo u çlirua nga suvatimet pa kriter dhe llaçrat e panevojshëm në sipërfaqe të konsiderueshme të naosit dhe narteksit, duke krijuar një gjendje të qartë të pikturës ekzistuese.

Pa dyshim, kjo kumtesë, që synoi të paraqesë gjendjen e monumentit dhe punimeve të kryera në të, nuk i ka kapur të gjitha aspektet që paraqet ky monument në tërësinë e ndërhyrjeve restauruese. Ndërhyrjet e derisotme, kryesisht me karakter konsolidimi, mbi bazën e njohjes së historikut, fazave dhe teknikës së ndërtimit të monumentit, përbëjnë një hap vërtet të parë, por të rëndësishëm për sqarimin e gjendjes dhe konsolidimin e saj, duke lejuar ndërhyrje më të gjera e më të thelluara në të ardhmen.

DO NOT COPY

Marita BEÇI – Skënder MIHALÇKA

DO NOT COPY

QUELQUES RESULTATS DE L'EXAMEN ET DES TRAVAUX DE CONSERVATION DE LA PEINTURE MURALE DU MONASTERE D'ARDENICE AUX COURS DES DEUX ANNEES 1984-1985

RESUME

Le Monastère d'Ardenice constitue un ensemble architectonique au centre duquel se trouve l'église «La nativité», reconstruite en 1743. Il est probable que ce monument appartienne à des périodes plus anciennes notamment au XIIIe sc. ce qui concorde avec la période du Despotat d'Épire. Cette église se présente sous un plan simple basilical en grand espace de volume. Le naos a été décoré par une peinture murale par les artistes Constantin et Athanas Zografi en 1744 alors que le narthex par les peintures de Grabove (Katro) pendant la deuxième moitié du XVIIIe sc. La peinture des frères Zograf est du style provincial, continuité de l'ancienne tradition en matière de peinture dans notre pays de la période des Paléologues au XIVe sc.

L'enduit peint occupe les 3/4 de la profondeur de la peinture. On identifie les phases de l'exécution de la peinture en examinant la peinture de Sainte Dimanche où l'on remarque des couches de peinture qui suivent le principe de l'exécution de la peinture de la fresque.

Pendant la consolidation des fresques de la partie occidentale on a remarqué deux phases d'exécution de la peinture, faites par les mêmes auteurs qui s'expliquent plutôt par le changement de l'architecture de la construction que par le programme iconographique. Dans la partie orientale du narthex, vu la modification qu'il a subie, la peinture a été coupée à l'endroit où sont les fenêtres tandis qu'au rez-de-chaussée a été recouverte d'enduit frais.

En général cette oeuvre d'art représente des endommagements physiques et chimiques, mécaniques et d'aspect esth que. La principale cause de ces endommagements a été l' midité et les mouvements séismiques que la construction subi lors du tremblement de terre des années 1960 et 1983

Nos travaux en 1984-1985 visaient à éléminer les prin paux endommagements. La restauration de la face occident du naos qui avait deux couches de peinture indépendan l'une de l'autre posa des problèmes particuliers de conser tion. La consolidation de ses fresques se réalisa par les coutur le traitement des bordures et des lacunes tout en mettant évidence la première couche. Dans cette zone on prévoya d travaux complexes à cause de la dégradation du mur. général tout l'ensemble a été retouché appliquant des pr cessus de conservation tels l'application de l'enduit sur le mu la «couture» des fissures, la consolidation des bordures, fixation de la couche picturale et l'enlèvement du vernis d quelques scènes. Ainsi on travailla jusqu'à une hauteur d 1.60-2.80 m aux faces orientale et septentrionale, aux endroit où l'enduit et la couche picturale étaient dégradés par l'hu midité par capilarité. Pour réaliser la localisation de l'oeuvr originale on débloqua les parties couvertes d'enduit sans critère et du mortier excessif ce qui a mieux mis au jou la peinture.

Les interventions de consolidation effectuées jusqu'à présent, sur la base des connaissances des caractéristiques du monument, constituent un premier pas important, qui permettra des interventions plus larges et plus profondes dans le futur.

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Latif LAZIMI

PËRSHTATJA E MONUMENTEVE PËR QËLLIME SHOQËRORE

Përshtatja e monumenteve të kulturës pa tjetërsuar vlerat si monument është në rend të ditës si në vendin tonë, ashtu dhe në praktikën botërore. Ritmet e larta të zhvillimit, ndërtimet e reja dhe ndryshimet në mënyrën e jetesës i japin një rëndësi të madhe këtij problemi. Monumentet e kulturës, ku përfshihen të gjitha gjinitë dhe ansamblet arkitektonike të ruajtura në gjendje të mirë, duke plotësuar funksionin e tyre si dëshmi historiko-artistike, duhet njëherazi të plotësojnë edhe funksione të tjera të dobishme për shoqërinë. Në këtë kumtesë do të ndalemi në përvojën e fituar te ne, jo vetëm në qëndrimin ndaj monumenteve të veçanta, por edhe ndaj ansambleve, zonave e qyteteve-muze. Në qytetet dhe zonat-muze, jeta e sotme ka shtruar nevojën për institucione dhe mjedise të reja shoqërore dhe social-kulturore, si kopshte, çerdhe, biblioteka, shkolla, poliklinika, kinema, muze, teatro, terrene sportive, sheshe për lojërat e fëmijëve etj. Vetë zhvillimi i jetës së sotme në këto qytete ose zona-muze i ka të nevojshme e të domosdoshme këto institucione. Përvoja jonë ka treguar se monumenti mund të përdoret për qëllime të tilla të dobishme për shoqërinë. Ky parim ka gjetur e gjen zbatim në një kategori të tillë ndërtimesh siç janë banesat popullore. Në dy qendrat më të mëdha historike të vendit tonë në qytetin-muze të Gjirokastrës dhe Beratit, ky problem është më i mprehtë. Vështirësitë më të mëdha i paraqet qyteti-muze i Gjirokastrës, jo vetëm për shkak të madhësisë së tij, por për shkak se qendra historike e këtij qyteti shtrihet mbi një terren shumë të aksidentuar dhe zona e lirë është e lidhur organikisht me zonën-muze. I gjithë problemi qëndron në gjetjen e një mënyre të tillë zgjidhjeje që duke ruajtur gjithmonë vlerat muzeale, banorët e tij të jetojnë me të njëjtat kushte si të qyteteve të tjera. Rregullorja për qytetet-muze dhe zonat-muze i përjashton ndërtimet e reja brenda tyre, prandaj, për plotësimin e kërkesave që lindin, mënyra e vetme është ajo e shfrytëzimit të ndërtimeve ekzistuese. Duke iu referuar praktikës sonë, monumentet e kategorisë së parë ruhen në të gjithë përbërësit kompozicionalë arkitektonikë dhe konstruktivë. Për pasojë këto monumente mund të përdoren për ato funksione shoqërore, të cilat nuk dëmtojnë vlerat e tyre, fjala vjen si muze. sallë leximi etj. Për sa u përket kërkesave e nevojave të tjera, e vetmja rrugëdalje mbetet përshtatja e monumenteve të kategorisë së dytë brenda caqeve që lejojnë normat përkatëse. Praktikisht, te ne, monumentet e kategorisë së parë, në shumicën e rasteve janë përshtatur për muze të profileve të ndryshme. Mjaft prej tyre janë kthyer në muze etnografikë. Në Gjirokastër banesa e Zekatëve (fig. 1), banesa e Skëndulajve, në Elbasan banesa e Sejdinit, në Shkodër banesa e Luigj Gurakuqit, në Klos-Katund një banesë karakteristike, (fig. 2), në Berat banesa e Xhokaxhiut, në Krujë banesa e Hamit Kalasë etj. Funksioni i ri që kanë marrë këto banesa përputhet me karakterin e tyre pa i cënuar vlerat arkitektonike-konstruktive. Në mënyrën e ekspozimit është synuar që pa cënuar kërkesat muzeale, të mos preken as përbërësit e shumtë arkitektonikë, funksionalë dhe dekorativë që pasurojnë brendësinë e këtyre banesave. Zgjidhja me shije e mënyrës së ekspozimit nuk ka cënuar vështrimin e përgjithshëm estetik të vlerave të brendisë së monumentit. Përvoja jonë në monumentet e kategorisë së dytë, ndonëse tani për tani e paktë, flet për mundësitë e shumta që ekzistojnë.

Poliklinika e qytetit-muze të Gjirokastrës (fig. 3), shkolla 8-vjeçare dhe dyqanet në lagjen «Kala» të qytetit-muze të Beratit, etj. flasin qartë për mundësitë e mëdha në zgjidhjen e problemit. Përshtatja e këtyre banesave për objekte shoqërore është bërë pa cënuar kompozimin volumor dhe plastikën e jashtme, ndërsa në brendësi janë bërë ndryshime në



Fig. 1

përputhje me funksionin bashkëkohor që kërkon
jekti. Kjo zgjidhje është plotësisht në frymën e kri
reve për mbrojtjen e qendrave historike dhe njëh
razi frytdhënëse, për shkak të mundësive që ofro
një pjesë e tipave të banesave popullore për
përshtatur për objekte social-kulturore. Dihet se fo
din më të madh të ndërtimeve në ansamblet e
teteve-muze e përbëjnë banesat, në të cilat, du
ruajtur pamjen e tyre, shtrohet nevoja e përshtatjes
vazhdueshme për banim, përmirësimi i zgjidhjes fur
sionale për të krijuar kushte më komode jetese (fig.
Me gjithë vështirësitë, zgjidhja e kësaj kërkese b
që qytetet-muze të mbeten si të tilla duke ripërtëri
fondin e strehimit të tyre në përshtatje me kusht
e sotme të jetës.

Në formulimin e qyteteve-muze bëjnë pjesë di
ndërtime shoqërore si: pazaret, hanet, hamamet. Edh
te këto ndërtime, duke ruajtur frymën origjinale, d
gjithsesi kërkesa e përshtatjes për nevojat e sotm
me një profil të afërt me funksionet fillestare. Kësh
pazaret e Krujës, Korçës, Shkodrës, Gjirokastrës fu
ksionojnë si qendra tregtare, hani i Manastirit
Korçë është kthyer në hotel me kërkesa dhe komod
tetin e kohës. Përdorimi i monumenteve arkitektonik
të gjinive të tjera si kalatë, kishat, manastiret, xha
mitë, që i takojnë periudhës antike dhe mesjeta
për funksione të sotme, është praktikuar në vendi
tonë, veçse në një masë të kufizuar. Del detyrë që n
të ardhmen të preken një numër më i madh i këty
monumenteve. Kalatë antike dhe mesjetare tashmë
restauruara, mund të shfrytëzohen në dy drejtim
Sheshet e krijuara brenda mureve perimetrale mun
të përdoren për shfaqje teatrale, estrada, festival
folklorike e aktivitete të tjera masive kulturore, ndë
sa mjediset e ndërtimeve të ruajtura në territorin



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

kalasë mund të përshtaten për muze dhe lokale shërbimi.

Tradita e krijuar në kalanë e Gjirokastrës, ku organizohet Festivali Folklorik Kombëtar dhe në kalanë e Shkodrës organizimi i Takimit Kombëtar të Lojërave Popullore, mund të praktikohet dhe në kalanë e Beratit (në sheshin e Akropolit) për veprimtari të ngjashme. Pajisjet për mobilimin e këtyre mjediseve të hapura, si karrige, podiume, skena duke u bërë të lëvizshme dhe jo në kontakt me monumentin, nuk e dëmtojnë atë. Zgjidhja me shije e tyre nuk prek vlerat e përgjithshme të vetë monumentit.

Mjediset e ndërtimeve brenda mureve të kalasë, duke marrë një funksion dhe si pasojë, duke qenë të vizitueshme, bëhen më të afërta për masat. Një nga shembujt më të rëndësishëm përbën kalaja e Gjirokastrës, në të cilën ekzistojnë mundësitë që, përveç Muzeut Kombëtar të Armëve, të shfrytëzohen dhe mjediset e tjera për qëllime shoqërore, për të bërë kështu më të vizitueshëm monumentin në tërësi. Edhe në kalanë e Shkodrës mjediset e ndërtimeve ekzistuese mund të përshtaten për muze dhe mjedise shoqërore. Monumentet e kultit, kishat, manastiret, xhamitë të cilat e kanë ruajtur funksionin e dikurshëm dhe brendësinë karakteristike me gjithë përbërësit, si pikturat murore, ikonat, ikonostaset, mund të ruhen dhe të konservohen në gjendjen e trashëguar, siç po veprohet në katedralen, në lagjen «Kala» të qytetit-muze të Beratit, e cila do të kthehet në muze. Mjedisi kryesor i katedrales po restaurohet me të gjithë përbërësit e saj për t'u kthyer në gjendje të vizitueshme. Mjediset ndihmëse do të përdoren për ekspozimin e pikturave mesjetare të autorëve tanë të asaj kohe. Ky është nga shembujt më të mirë të shfrytëzimit të monumenteve të kultit. Po me këtë kriter ruhet dhe xhamia në qytetin e Tiranës, e cila është në gjendje të vizitueshme etj.

Monumentet e kultit, të cilat ruajnë pjesërisht përbërësit e brendësisë, mund të kthehen të vizitueshme, në atë gjendje ose të përdoren si mjedise për ekspozimin e afreskeve, të koleksioneve të ikonave, librave të vjetër me vlerë dhe pajisjesh të ndryshme me vlera historiko-artistike. Me këtë kriter është vepruar në kishën e Shën Todrit., Vllahernës, në Xhaminë e Plumbit, në qytetin-muze të Beratit e cila është përshtatur për Muze të arkitekturës, ashtu si xhamia e Muradies, në qytetin e Vlorës, që është përshtatur për Ekspozitë të kulturës popullore. Përshtatje të këtij lloji, që nuk cënojnë vlerat e monumentit na duken të dobishme. Manastiret janë monumente komplekse, të cilat përfshijnë në kompozimin e tyre konakët dhe kishën. Konakët mund të përshtaten për muze ose hotel, ndërsa për kishën vlejnë kriteret e përmendura. Në Apoloni konakët e manastirit janë përdorur për muze, ndërsa kisha është kthyer në gjendje të vizitueshme (fig. 5). Po me këtë mënyrë mund të bëhet përshtatja e manastirit të Ardenicës për hotel me mjediset e duhura të shërbimit. Së fundi, trajtimi i monumenteve në gjendje rrënoje është një problem që lind diskutime. Vlerësimi i tyre, kur lidhen dhe me ngjarje të rëndësishme kombëtare, tregon përkujdesjen e shoqërisë sonë. Fjala vjen, drejt është vepruar me rrënojat e kishës së Shën Kollit në Lezhë, ku është ngritur përkujtimorja e Skënderbeut (fig. 6). Me shumë rëndësi janë monumentet historike që lidhen me figura të shquara të historisë së kombit tonë. Në

DO NOT COPY



Fig. 6

to sipas përvojës sonë mund të bëhen rikonstruksione pjesore të mbështetura në një dokumentacion të plotë. Banesa e Mic Sokolit në Tropojë është ilustrimi i kësaj praktike. Por përshtatja, duke qenë një proble që po gjen zbatim në gjini të ndryshme të monume teve të kulturës, nuk mbaron vetëm me ndryshim funksionale dhe konstruktive, ose të trajtimit të int rierit nga ana ekspozicionale. Ajo kërkon të zgjidh dhe kërkesat për ngrohje dhe ndriçimin elektrik. N vetë funksioni shoqëror që marrin këto monumente p përshtatjes mund të aplikohet ngrohja qendrore, një ndërhyrje e re e kohës, ndërsa ndriçimi mu dhe duhet të realizohet në mënyrë të tillë, që nd çuesit dhe mënyra e ndriçimit të mos dëmtojnë vle e monumentit.

Në mbyllje dëshirojmë të theksojmë se, me g thë përvojën dhe arritjet, përshtatja e monumente të kulturës, në përputhje me kërkesat dhe nevojat kohës, mbetet një problem i hapur. Detyra jonë ësh që ato gjithsesi t'i shërbejnë sa më mirë shoqëris jo vetëm me vlerën e tyre historiko-artistike, por ed atë utilitare.

DO NOT COPY

Latif LAZIMI

DO NOT COPY

L'ADAPTATION DES MONUMENTS A DES FINS SOCIAUX-CULTURELS

RESUME

Le problème de l'adaptation des monuments culturels à de diverses fins est aujourd'hui dans l'ordre du jour.

Les monuments culturels, où font partie tous les genres et les ensembles architectoniques, conservés en bon état, acomplissant leur fonction de témoin historico-artistique, souvent ne répondent pas aux nouvelles exigences. Les principes de restauration et notre expérience dans ce domaine ont montré que le monument doit être utilisé à des fins utiles pour la société. Ce principe s'applique surtout aux habitations populaires, notamment dans les deux plus grands centres historiques de notre pays, les villes-musées de Gjirokastra et Berat. Dans ce cas il faut trouver une telle solution que, tout en conservant les valeurs des villes-musées et des zones musées, la vie s'y déroule dans les mêmes conditions que celle des autres villes. Le réglement des villes et des zones musées exclut la construction des nouveaux édifices à l'intérieur de celles-ci, par conséquent la seule manière pour satisfaire aux besoins est l'utilisation des constructions existantes. Mais si l'on se rapporte à notre pratique, les monuments de première catégorie, ne peuvent pas toujours être adaptés à des fins utilitaires parce qu'ils sont conservés dans tous leurs composants: compositionnels, architectoniques et constructifs. Par conséquent la seule issue est l'adaptation des monuments de deuxième catégorie, dans les limites des normes respectives. Pour les monuments de première catégorie on a trouvé comme solution l'adaptation en museé, telles les habitations des Skëndulej, des Zekat à Gjirokastra, l'habitation de Sejdin à Elbasan et celle des Xhokaxhi à Berat. Pour les monuments de deuxième catégorie notre expérience est moindre dans ce domaine. On est intervenu dans tels monuments comme la polyclinique de la ville-musée de Gjirokastra et les boutiques du quartier «Kala» de la ville-musée de Gjirokastra et les boutiques du quartier «Kala» de la ville-musée de Berat. Dans l'ensemble des villes-musées le plus grand fonds des constructions est attribué aux habitations, qui continuent à se faire adapter pour être habitables en créant des conditions de vie plus commode. L'adaptation des autres constructions sociales tels les bazars, les auberges, les bains populaires, a été faite en suivant le plus que possible leurs fonctions initiales. (Les bazars de Kruja, Korça, Shkodra et Gjirokastra).

Les chateaux antiques et moyenâgeux, lesquels sont conservés en état de ruine, déjà restaurés, peuvent être utilisés à deux buts. Les places créées à leur intérieur peuvent être utilisées pour donner des représentations théâtrales des festivals folkloriques, alors que les pièces des constructions conservées dans le territoire de la forteresse peuvent être adaptées en musée et en locaux de service comme on a déjà procédè aux citadelles de Gjirokastra et Shkodra.

Les monuments de culte, les églises, les mosquées, les monastères qui ont gardé l'originalité et l'intérieur caractéristique avec tous les composants comme les peintures, les icônes, les iconostases, peuvent être conservées et se conservent tels quels comme par exemple la cathédrale de Berat qui fut convertie en musée.

Les monuments de culte, qui conservent particulièrement les composants de l'intérieur, peuvent être rendus visitables tels qu'ils sont ou bien peuvent être utilisés comme salles d'exposition, des fresques, des collections d'icônes et de divers équipements à valeurs historico-artistiques comme à l'église de Saint-Théodor, Sainte Vllaherne, la Mosquée des Beqar, la Mosquée de Plumb etc. à Berat.

Les monastères sont des monuments complexes qui englobent dans leur composition les pièces et l'église. Les pièces peuvent être adaptées en musées ou en hôtel.

Finalement, le traitement des monuments en état de ruine représente un problème qui engage des discussions. Leur évaluation et leur exposition avec goût dénotent les soins apportés dans ce domaine comme c'est le cas de l'église Saint Nicolas et le mémorial de Skanderbeg à Lezha. Font exception de ce critère les monuments historiques, auxquels, à des cas très particuliers, on peut faire des reconstructions, comme l'habitation de Mic Sokol dans la région de Tropoja, celle de Haxhi Qamil dans la région de Tirana.

L'adaptation des monuments demeure toujours un problème à résoudre qui, au futur, persons nous, traitera un plus grand nombre de monuments avec leur valeur historico-artistique mais aussi celle utilitaire.

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Pirro THOMO

TIPARET E ARKITEKTURËS POPULLORE TË GJYSMËS SË DYTË TË SHEK. XIX-FILLIMIT TË SHEK. XX. PROBLEME TË GJURMIMIT TË SAJ

Gjurmimi dhe vënia në mbrojtje e ndërtimeve popullore janë kryer duke u mbështetur në kritere tashmë të përpunuara. Ato kanë synuar të zgjedhin ekzemplarë të tillë, që të përmbajnë në vetvete vlerën e dokumentit historik dhe të një vepre arkitektonike. Kështu monumentet e vëna në mbrojtje do të fiksojnë për sot dhe të ardhmen, historinë e arkitekturës shqiptare, duke vlerësuar drejt çdo periudhë të zhvillimit të saj. Një nga këto periudha, pa dyshim mjaft e rëndësishme, është dhe ajo që përfshihet ndërmjet gjysmës së dytë të shek. XIX deri në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX, e cila lidhet me periudhat e rëndësishme të historisë së popullit tonë, me Rilindjen dhe Pavarësinë Kombëtare, tiparet urbanistiko-arkitektonike të së cilës dhe disa probleme që dalin në lidhjet me gjurmimin dhe vënien në mbrojtje të shembujve përfaqësues të saj, do të përbëjnë objektin e kësaj kumtese. Kjo nuk do të thotë se kjo periudhë deri sot nuk është vlerësuar si duhet. Fakti që janë vënë në mbrojtje 7 ansamble e zona-muze në Korçë, Shkodër, Vlorë, Elbasan, Tiranë, Gjirokastër e Berat, si dhe rreth 200 monumente të veçanta të kategorisë së parë, flet për kujdesin që është treguar edhe për këtë periudhë, megjithatë thellimi i studimeve në këtë fushë, vënia në dukje e proceseve dhe dukurive të reja, që lindin gjatë kësaj periudhe, si dhe karakteri specifik i arkitekturës së saj nga të cilat mund të përmendim numrin e madh të ndërtimeve që ruhen, konsiderimin e tyre shpesh si «të reja», vendin që ato zënë në strukturën urbanistike të qyteteve tona, pleksjen, disa herë, të tipareve të reja me strukturat të vjetra ndërtimore etj, meritojnë të njihen thellë për të rivlerësuar arritjet e derisotme, për të intensifikuar gjurmimet dhe për të orientuar ndërhyrjet restauruese në monumentet e vëna në mbrojtje.

Historikisht dihet se në dhjetëvjeçarin e parë të



Fig. 1

shek. XIX, po bëhej gjithnjë e më e qartë shthurja e marrëdhënieve të vjetra feudale dhe lindja e formave të reja të marrëdhënieve kapitaliste në jetën ekonomike e shoqërore të vendit. Ashtu si marrëdhëniet e reja ekonomiko-shoqërore ishin mohim dialektik i marrëdhënieve të vjetra, edhe arkitektura popullore, e cila nuk vonoi të pasqyrojë këtë gjendje, do të mbyllë një periudhë për të hapur një të re, me tiparet e saj të veçanta.

1. Si rezultat i gjendjes së re historike, disa qytete filluan të humbasin rëndësinë e madhe që kishin në jetën ekonomike e shoqërore të vendit, ndërsa disa të tjera po fuqizoheshin gjithnjë e më tepër. Ndër to përmendim Korçën e më vonë Vlorën e Durrësin, si porte kryesore të vendit, Fierin, si qendër e një

krahine të madhe bujqësore, Tiranën pas shpalljes si kryeqytet të vendit, etj. Të nisura nga një nivel relativisht i ulët zhvillimi, të pakushtëzuara nga struktura urbanistike e arkitektonike ekzistuese e të vjetërsuara dhe të rritura numerikisht me shtresa shoqërore të prira drejt zhvillimit, në këto qytete gjeti fushë të përshtatshme zbatimi i sistemeve të përparuara urbanistike dhe futja e të rejave arkitektonike, teknike e teknologjike. Rast më tipik i kësaj rruge zhvillimi është qyteti i Korçës (fig. 1).

2. Shthurja e sistemit të vjetër ekonomik, si p.sh. organizimi i prodhimit në esnafe, krijimi dhe fuqizimi i shtresave të reja shoqërore, gjallërimi i mëtejshëm i jetës ekonomike e shoqërore, sollën kërkesa dhe ndryshime në strukturën urbanistike të qyteteve tona. Kështu p.sh. pazaret, si ansamblet kryesore të prodhimit dhe të shkëmbimit, filluan të humbasin rëndësinë e tyre të dikurshme. Shumë njësi prodhimi, shërbimi dhe shitjeje u shpërndanë në ansamblet e banuara. Në qytete u krijuan arterie që fituan një karakter tregtar e shoqëror, të mbushura me dyqane, hotele, ndërtime shoqërore, administrative, etj. Shembujt të kësaj natyre janë rrugët «Enver Hoxha» (fig. 2) e «Branko Kadia» në Shkodër, «Justin Godard» në Vlorë, bulevardet «Lenin» e «Republika» në Korçë, «Pazari i Ri në Gjirokastër» etj. Ky organizim urbanistik vazhdoi edhe gjatë shek. X në Durrës, Tiranë etj. Ndryshoi gjithashtu edhe raporti i banesës në strukturën urbanistike dhe karakteri i ndërtimeve, oborri i banesës zvogëlohet së tepërmi, një pjesë e mirë e banesave nxjerrim pamjen e tyre ballore në rrugë, ndërsa në rrugët tregtare e shoqërore përgjithësohen ndërtimet me dyqane në katin përdhes dhe me mj dise banimi në katin e sipërm.

3. Kërkesa për ndryshimin e mënyrës së jetes u pasqyrua dhe në tipologjinë e banesës.

Proceset evolutive relativisht të ngadalshme periudhës së mëparshme, u lenë vend proceseve vrullshme, që pasohen nga shndërrime në banesë, cilat u shfaqën në dy forma kryesore: në përshtatje ose rikonstruksionin e tipave të vjetër dhe në lindje e tipave të rinj. Rikonstruksionet e tipave ekzistues prekën thellësisht trajtimin e pamjeve të jashtme t elementeve arkitektonike e dekorative, thjeshtësua trajtimin, zbukurimin dhe pajisjen e mjediseve t brendshme dhe ndryshuan krejtësisht ose pjesërish funksionin e disa njësive kompozicionale, si të ça dakëve, dhomës së zjarrit, mjediseve të katit përdhe etj. Ky proces, i cili i paraprin lindjes së tipeve t reja të banesës, nuk qe i njëtrajtshëm në të gjith tipet dhe qendrat apo krahinat e vendit. Ai kushtëzo hej nga shkalla dhe intensiteti i futjes së marrëdhë nieve të reja, si dhe nga arritjet arkitektonike të ba nesës paraardhëse. Kështu p.sh., në banesën qytetar rikonstruksionet u ndien më pak në banesën tirana se dhe në atë me hajat dhe më ndjeshëm në banesa me çardak (fig. 3) dhe në atë gjirokastrite, ndërsa në banesën fshatare, më pak në Shqipërinë e Veriu dhe më tepër në Shqipërinë e Jugut.

Por, me gjithë përmirësimet që sollën në banesë këto rikonstruksione apo përshtatje, zgjidhja kompozicionale e formuar, përmasat e mjediseve, vendosja e banesave në strukturën urbanistike të qyteteve e pengonin plotësimin e kërkesave të reja. Shkallë-shkallë

DO NOT COPY



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY



Fig. 4

po fitonte terren procesi i dytë, ai i lindjes së tipit të ri të banesës, i cili, që në konceptimin e tij synonte të materializonte mënyrën e re të jetesës. Shfaqjen më të plotë tipi i ri i banesës e pati në qytetin e Korçës, si rezultat logjik i vetë zhvillimit të këtij qyteti (fig. 4). Banesa e re korçare, duke ruajtur tiparet thelbësore të përbashkëta, u shfaq me një sërë variantesh, si pasqyrim i diferencimeve klasore dhe i fazës së zhvillimit dhe të përpunimit arkitektonik të tipit. Ajo shquhet nga një skemë funksionale racionale, nga një kompozim i qartë e i thjeshtë dhe nga një barastrajtim i pamjeve të jashtme e të brendshme. Ky tip u përhap dhe në qendrat e tjera të vendit, duke dobësuar shumë dallimet krahinore dhe duke i dhënë arkitekturës së kësaj periudhe një prirje të spikatur konvergjente.



Fig. 5

4. Progresi teknik e teknologjik i kohës, futja e materialeve ndërtimore dhe strukturave konstruktive të reja, si tullës, hekurit, etj. i dha shkas rritjes së repertorit arkitektonik e dekorativ të banesës. Ndërtesat përgjithësisht suvatohen, duke i dhënë mundësi përpunimit të detajeve dekorative në korniza çatie, dritareje, dyersh, etj. Guri, tashmë, luan një rol kryesisht zbukurues në kolona, kapitele, kornizime dyersh etj. Krahas tij, rritet së tepërmi përdorimi i hekurit



Fig. 6

në kangjellat e rrethimit, parapetet e ballkoneve e shkallëve, në skarat e dritareve dhe të dyerve. Me vendosjen e banesave buzë rrugëve, përpunimi i detajit arkitektonik krijon motive të dorës së parë në hijeshimin, sidomos të rrugëve kryesore, apo të shëtitoreve (fig. 5).

5. Si pasojë e zhvillimit të arkitekturës gjatë kësaj periudhe ndryshon dhe raporti ndërmjet banesës qytetare dhe asaj fshatare. Tashmë banesa qytetare bëhet parësore dhe ushqyese me ide e koncepte për banesën fshatare. Në këtë të fundit vërehen të njëjtat procese, d.m.th. rikonstruksioni i banesave, ekzistenca dhe lindja e tipave të rinj, të cilët, jo ve
që morën shumë nga banesa qytetare, por në
fshatra të zhvilluara të Shqipërisë së Jugut, si. p
në Dardhë të Korçës, shumë banesa ishin krej
njëjta me ato të qytetit (fig. 6).

Duke i hedhur një sy listës së monumenteve
i përkasin periudhës prej gjysmës së dytë të shek.
mendojmë se ka vend ende për gjurmime e stud
të mëtejshme për të materializuar tiparet, proceset
dukuritë kryesore arkitektonike e urbanistike të kë
periudhe, që u përpoqëm të vinim në dukje më si

DO NOT COPY

Pirro THOMO

TRAITS DE L'ARCHITECTURE POPULAIRE AU COURS DE LA DEUXIEME MOITIE DU XIXe SC. ET DU DEBUT DU XXe SC. ET LES PROBLEMES SUR SA RECHERCHE

RESUME

La recherche et la mise sous protection des constructions populaires basées sur des critères élaborés, ont visé à sélectionner de tels exemplaires, qui fixent l'histoire de l'architecture populaire, en appréciant bien chaque période de son évolution. Une de ces périodes est celle entre la deuxième moitié du XIXe sc. et la première décennie du XXe sc. une importante période de l'histoire de notre peuple, celle de la Renaissance et de l'Indépendance Nationale. L'étude des traits de l'architecture populaire de cette période sert à apprécier les résultats obtenus, à intensifier les recherches et à orienter les interventions de restauration aux monuments mis sous protection.

Par la nouvelle situation historique, beaucoup de villes, connaissent au cours de cette période un essor considérable (Korça, Durrësi, Tirana, Fieri etc.) et l'application des nouveaux critères au domaine de l'urbanisme à la typologie de l'habitation, au traitement général architectural, constructif et décoratif, trouve un terrain favorable. Des processus et des phénomènes inconnus par les périodes précédentes apparaissent.

1) Dans l'aspect de l'urbanisme, l'ancienne structure subit des transformations, de nouveaux systèmes avancés pour l'époque, s'introduisent en apportant des améliorations de caractère fonctionnel, sanitaire et de l'aspect général architectonique.

2) Les transformations à la typologie de l'habitation apparaissent sous deux formes principales: l'adaptation ou la reconstruction des anciens types et l'apparition des nouveaux types qui visent à mieux matérialiser le nouveau mode de vie.

3) Le progrès technique et technologique de l'époque, l'introduction des matériaux de construction et des nouvelles structures constructives, contribuent à l'enrichissement du répértoire architectonique et décoratif de l'habitation.

4) L'opinion avancée par les spécialistes, ingénieurs et architectes, au projet de construction, limite l'activité du maître populaire sans l'écarter complètement. Dans ces conditions, la maestria populaire revêt de nouveaux traits.

5) L'évolution de l'architecture au cours de cette période apporte un changement dans le rapport entre l'habitation rurale et celle urbaine. Déjà l'habitation urbaine devient primaire et fournit des idées et de nouvelles conceptions à l'habitation rurale.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

DO NOT COPY

Genc SAMIMI

RESTAURIMI I ANSAMBLEVE ARKITEKTONIKE NË ZONËN MUZE TË QYTETIT TË BERATIT

Qyteti muze i Beratit, një nga qendrat e para të vëna në mbrojtje shtetërore, zë një vend të veçantë në trashëgiminë tonë kulturore. Ky vend përcaktohet nga shumëllojshmëria e gjinive të monumenteve që ruhen në të, si dhe nga kohësnitrirja e gjerë shumëshekullore. Muret rrethuese të qytetit, një mozaik duarsh që prej periudhës ilire deri në periudhën e pashallëqeve të mëdha shqiptare, ndërtimet e besimeve prej kishave me kompozime kompakte në formë kryqi të shek. XIV-XV e deri te bazilikat e shek. XVIII, xhamitë, fondi i pasur e i plotë i arkitekturës popullore dhe monumentet historike që lidhen me ngjarje të shënuara të historisë sonë, e bëjnë Beratin një thesar të vërtetë vlerash arkitektonike-kulturore. Udhëheqësi ynë i paharruar shoku Enver Hoxha, duke folur për Beratin, ka theksuar: «Berati ka ndryshuar e do të ndryshojë akoma më shumë por ai është njëkohësisht një qytet shumë i vjetër dhe ka shumë ndërtime me vlerë të madhe artistike, për ndërtimin e të cilave gjyshërve e stërgjyshërve tanë u është dashur të derdhin shumë djersë. Këto vepra arti duhen ruajtur me kujdesin më të madh brez pas brezi». Vlerat e jashtëzakonshme të kësaj qendre kanë bërë që prej rreth 25 vjetësh, Instituti i Monumenteve, nëpërmjet degës së tij të ngritur në këtë qytet, të zhvillojë një punë sistematike dhe komplekse për të ruajtur me ndërhyrje kompetente restauruese këtë vepër të rëndësishme të krijimtarisë shqiptare. Përqendrimi i forcave restauruese në Berat është mundësuar edhe për arsye se tri zonat-muze të këtij qyteti, lagjet «Kala», «Mangalem» dhe «Goricë», të cilat përbëjnë thelbin e qytetit-muze, janë disi të shkëputura nga pjesa tjetër e kësaj qendre. Kjo rrethanë, që lidhet me mundësinë e plotësimit të nevojave komunale e kulturore në përgjithësi, nëpërmjet shërbimeve dhe institucioneve në pjesën tjetër të qytetit, si dhe aftësia e rrjetit rrugor tradicional për të plotësuar nevojat e jetës së sotme, i ka bërë më të lehta e më të frytshme ndërhyrjet restauruese. Në përpjekjen për një vështrim vlerësues e kritik njëherazi të arritjeve të derisotme për ruajtjen dhe vlerësimin e qytetit-muze të Beratit, në radhë të parë duhet theksuar vetëdija e ngulitur mirë se në rastin e dhënë jemi përpara një njësie të madhe urbane, e cila përmban një tërësi komplekse. Pikërisht ky unitet krijimesh në raporte të caktuara kompozicionale, kohore dhe vlerash, ka kushtëzuar edhe radhën, shkallën dhe mënyrën e ndërhyrjeve restauruese.

Megjithëkëtë, duhet theksuar se afërsisht 10-vjeçari i parë i ndërhyrjeve restauruese në qytetin-muze të Beratit ka qenë i lidhur më shumë me shikime të pjesshme të problematikës restauruese, në kuptimin se përkujdesja ishte drejtuar kryesisht në punime shpëtimi. Kjo është e kuptueshme, po të kemi parasysh se qyteti-muze, vinte nga e kaluara në gjendje mjaft të dëmtuar, madje edhe me monumente në prag të rrënimit të pjesshëm apo të plotë. Kështu që vëmendja kryesore në këtë periudhë iu kushtua pikërisht ndërhyrjeve në ata monumente që paraqisnin dëmtime serioze, kryesisht të karakterit të qëndrueshmërisë. Të tilla ndërhyrje përfshinë kryesisht fondin e banesave popullore dhe veçanërisht ato të lagjes «Kala», e cila vinte në një gjendje mjaft të dëmtuar. Krahasi u kryen punime konsolidimi edhe në muret rrethuese të kalasë. Pas punësh të gjera konsoliduese, duke pasur edhe një përvojë të mirë në njohjen e vlerave të monumenteve në aspektin historiko-arkitektonik dhe atë tekniko-ndërtimor, u krijuan kushtet për zbatimin konkret të ndjekjes së punimeve vlerësuese në mbarë ansamblet. Edhe në këtë rast tipologjia dhe larmia e vlerave bënë që të tri ansamblet të shiheshin me përparësi të ndryshme. Vëmendja kryesore iu kushtua lagjes «Kala», e cila

DO NOT COPY



Fig. 1

historikisht, së pari, përbënte vetë qytetin, ndërsa deri vonë, nga shek. XIX, mbeti një lagje e rëndësishme e tij. Pikërisht në këtë ansambël të rrallë, në trashëgiminë tonë arkitektonike, ndeshim dëshmi materiale disa shekullore në muret rrethuese, akropolin, kishat, si dhe formulimin urbanistiko-arkitektonik të lagjes së banuar që i përgjigjet në përbërësin e parë shek. XVII-XIII, ndërsa në të dytën shek. XVIII-XIX. Krahas, por me ritme më të ulëta, ka ecur puna për restaurimin e veprave të artit.

Puna restauruese në këtë ansambël u konceptua si një ndërhyrje që synonte të arrinte në vlerësimin e tërësisë urbanistiko-arkitektonike, prandrejtimet e ndërhyrjeve ndoqën paralelisht ndërtimmbrojtëse, ato të kultit, si dhe zonën e banuar. Bazuar mbi vrojtime e studime të kujdesshme, elemetet e ndryshme të fortifikimit si ndërtimet mbrojtëse duke përfshirë këtu muret rrethuese, me elementet ndryshme si kulla, hyrje, etj, akropoli me ndërtimet tij, si dhe kalimi i mbrojtur për marrjen e ujit ng lumi, iu nënshtruan, së pari punimeve të pastrim nga materiali ndërtimor i rrënimeve. Pastrime të till të kryera me përkujdesjet që kërkojnë këto ndërhrje, bënë që të lëvizin volume shumë të mëdha mbturinash, veçanërisht në zonën e akropolit, duke nxjrrë në dritë pjesë të reja muresh, apo elementesh tjera ndërtimore, si dhe duke sqaruar gjendje të dshimta elementesh të njohura pjesërisht. (fig. 1).

Përpjekja për të krijuar një unazë kalimi e vrtimi rreth mureve të kalasë, ka qenë gjithashtu nsynim për t'u arritur. Krahas fortifikimit, prej vitesh nlagjen «Kala», janë bërë objekt ndërhyrjesh sistemtike objektet e kultit (fig. 2), mjaft kisha dhe dy rrnoja xhamish (fig. 3), me vlera të veçanta në gjinie tyre. Lagja «Kala» ruan vlera të rëndësishme edbnë gjininë e monumenteve të kultit. Kisha e ShTriadhës, Vllahernës, Shën Todrit, kanë vlera të nrëndësie të veçantë dhe paraqisnin probleme të vshtira restauruese, të cilat pas punimesh disa vjeçre, u kryen me sukses. Krahas filloi puna sistematipër restaurimin e objekteve të tjera të kultit me relizime më modeste, por me vlerat e veta historik-arkitektonike, si shprehëse të një konteksti të catuar historiko-shoqëror. Sot të gjitha monumentet kultit në këtë ansambël janë të restauruara dhe



Fig. 2



Fig. 3

kthyera në objekte të vizitueshme. Trashëgimia urbanistiko-arkitektonike në fushën e krijimtarisë popullore, gjithashtu paraqiste vlera e probleme të veçanta në një fushë ku përvoja dhe kompetenca jonë ishin të një shkalle më të lartë. Thuajse që me fillimet e ndërhyrjeve restauruese në monumentet e kategorisë së parë e të dytë, krahas banesës në kuptimin e ngushtë të termit, objekt përkujdesjesh u bënë edhe elementet e rrethimit, muret, portat etj. Në dhjetëvjeçarin e fundit filloi puna sistematike për restaurimin e mbarë rrjetit rrugor të lagjes, duke përfshirë këtu elementet e ndryshme ndërtimore përbri tij. Të gjitha këto ndërhyrje të bashkëkohshme, të udhëhequra së pari nga vlera dhe gjendja teknike dhe më vonë nga vendi i tyre në një mikromjedis të caktuar, sot kanë bërë që ky ansambël të na shfaqet mirë me vlerat e tij urbanistike, arkitektonike dhe mjedisore. Realizimi, me frymën e arkitekturës së ansamblit, i disa objekteve të domosdoshme shoqërore, e bën sa mësimdhënëse, aq edhe të këndshme njohjen e vlerat e tij, jo vetëm për studiuesit por edhe për njeriun e zakonshëm që interesohet për historinë e kulturës materiale. Punimet në këtë ansambël sipas parimeve të mësipërme metodike, kanë ecur mjaft përpara. Pesëvjeçari i ardhshëm do të jetë vendimtar për të arritur atë lidhje të plotë ndërmjet të gjitha njësive ndërtimore të ansamblit, duke bërë kështu realitet synimin për restaurimin tërësor të tij, sipas parimeve bashkëkohore të disiplinës së restaurimit. Në lagjen «Kala», (fig. 4), punimet patën dendësi e larmi më të madhe, por krahas u punua po aq sistematikisht edhe në lagjet «Mangalem», e «Goricë», (fig. 5). Në dallim nga ansambli i kalasë dy të



Fig. 5

tjerat formohen thuajse vetëm nga vlera të arkitekturës popullore. Kështu që ndërhyrjet në këto lagje kanë synuar në restaurimin e vlerave urbanistiko-arkitektonike që lidhen me banesën dhe rrugën, si element i vetëm urbanistik. Banesa, muri rrethues, porta, rruga janë elementet e zakonshme, që në mënyrë sistematike e të njëkohshme janë bërë objekt përkujdesjesh restauruese në këto lagje. Gjendja e tyre më e mirë në krahasim me monumentet e së njëjtës gjini në lagjen «Kala» dha përfundime më të shpejta dhe njëherazi më të frytshme. Një problem që prej vitesh paraqiste shqetësim ishte gjendja e vargut të dyqaneve në pjesën e poshtme të lagjes «Mangalem».



Fig. 4



Fig. 6

DO NOT COPY

Tjetërsimi i formulimit të ballit të tyre, pa as më të voglën përkujdesje për të respektuar vlerat madhore që shtriheshin mbi të krijonte një gjendje të papranueshme dhe cënonte rëndë njësinë e këtij ansambli unikal e me vlera vërtet të rralla (fig. 6). Ndërhyrje në këtë varg ndërtimesh, duke ruajtur sa qe e mundur strukturat origjinale konstruktive dhe duke trajtuar ballët e dyqaneve sipas gjuhës arkitektonike të mbarë ansamblit u konsiderua si zgjidhja më e gjetur, gjithë duke pasur vetëdijen se në këtë rast k të bëjmë me një rast të jashtëzakonshëm nga c metodike. Në lagjet Goricë, u zbatua zgjidhja e k dërt, një ndërtim me tiparet e sotme, për nevoja shërbimeve tregtare. Veçimi nga lagjja dhe syn për të mos konfonduar autentikën nga kontributi qenë motivet e kësaj zgjidhjeje. Koha dhe qëndr kritik pa dyshim që do të thonë fjalën e tyre n këto zgjidhje.

DO NOT COPY

Genc SAMIMI

DO NOT COPY

RESTAURATION DES ENSEMBLES ARCHITECTONIQUES DANS LA ZONE-MUSEE DE BERAT

RESUME

La ville musée de Berat, l'un des premiers centres mis sous protection d'État, occupe une place particulière dans notre héritage culturel. Cette place est définie par la diversité des genres de monuments mis sous protection, ainsi que par leur âge multiséculaire. Les murs d'enceinte, les constructions de culte, comme les églises de composition compacte en forme de croix du XIV-XVe siècle jusqu'aux basiliques du XVIIIe siècle, et les mosquées, le riche patrimoine de l'architecture populaire ainsi que les monuments historiques qui ont des liens avec de mémorables événements de notre histoire, font de Berat un vrai trésor de valeurs architectoniques et culturelles. Ces valeurs extraordinaires de ce centre ont amené l'Institut des Monuments Culturels depuis 25 ans à faire, par l'intermédiaire de l'atelier de restauration fonctionnant dans la ville même, un travail autant systématique que complexe pour pouvoir protéger cette oeuvre importante de la créativité albanaise par des interventions compétentes de restauration.

La première décennie des interventions de restauration dans la ville-musée de Berat se porta plutôt à des études partielles des problèmes de restauration les soins étant plutôt apportés aux travaux de sauvegarde.

Après avoir effectué de larges travaux de consolidation, ayant une bonne expérience quant'à la connaissance des valeurs des monuments dans l'aspect historique, architectonique et technico-constructif, on procéda à l'application concrète de la poursuite des travaux d'évaluation dans tout l'ensemble. On a prêté beaucoup d'attention au quartier «Kala» qui historiquement représente la ville même et, plus tard, au XIXe siècle, devint un quartier de grande importance de la ville. C'est précisément dans ce rare ensemble, que l'on rencontre des témoins matériels multiséculaires comme les murs d'enceinte, l'acropole, les églises ainsi que dans l'envisagement urbain et architectonique du quartier habité, appartenant la première partie aux XVII-XVIIIe siècles et la seconde au XVIII-XIXe siècles. De pair à ce travail, mais à des rythmes plus lents, on poursuivit le travail de restauration des oeuvres d'art.

La restauration dans cet ensemble fut conçue comme une intervention qui avait pour but de réaliser l'évaluation de l'intégralité urbaine et architectonique, et c'est pour cela que les interventions s'entamèrent parallèlement aux constructions défensives, à celles de culte ainsi que à la zone habitée.

Entre temps on travailla systématiquement aux quartiers: «Mangalem» et «Goricë». En distinction de l'ensemble de «Kala» les deux autres offrent seulement des valeurs de l'architecture populaire. Ainsi les interventions dans ces quartiers ont visé à la restauration des valeurs urbaines et architectoniques liées à la construction et à la rue, comme élément unique de l'urbanisme.

Les résultats évidents obtenus à la ville-musée de Berat pour la protection et le renouvellement de ses valeurs, pendant une période relativement courte, témoignent d'une manière convaincante les soins extraordinaires que l'on a accordé dans notre pays à l'évaluation du patrimoine de la culture matérielle.

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

NDIHMESA E PUNIMEVE RESTAURUESE PËR STUDIMIN E BANESAVE SHKODRANE

Banesa shkodrane e shek. XVIII--XIX zë një vend të rëndësishëm në arkitekturën qytetare shqiptare. Për vetë funksionin e saj, ajo është një kategori mjaft e ndryshueshme në kohë, duke materializuar programet e shumta me kërkesa nga më të ndryshmet të shoqërisë klasore të së kaluarës.

Këto ndryshime i lejon tipologjia e banesës së hapur me çardak në tri variantet e saj, duke zotëruar sipërfaqe të hapura e të bollshme të hajatit e çardakut dhe të mjediseve të pabanuara të katit përdhe, me synim për t'i kthyer këto në mjedise të banuara. Arrihet kështu në banesa në një kompozim të riprekur dhe me ndryshime të rëndësishme, si në trajtimin arkitektonik, ashtu dhe atë konstruktiv, dukuri këto tepër të përhapura, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX e më pas. Ndryshimet e mëdha që pëson kjo gjini monumentesh në kohë, e bëjnë të kuptueshme ruajtjen e shumë gjurmëve që të çojnë te këto ndryshime, të cilat mbyllen nga rindërtimi dhe dhe dalin sërish në dritë nga restaurimi. Rastin më të mirë, për të depërtuar thellë në strukturën e banesës, për të vërejtur dhe qartësuar të dhënat e reja që ofron ajo, jep ndërhyrja restauruese, nëpërmjet hapjes, zhveshjes dhe sondazheve që i bëhen banesës në monumentin e duhur. Këto të dhëna, të udhëhequra nga një njohës e studiues i mirë i gjinisë së banesës popullore, në disa raste sjellin fakte të reja që qartësojnë dyshimet gjatë studimit të banesës dhe njëherazi japin të dhëna mjaft domethënëse për përcaktimin e drejtë të fazave të ndërtimit.

Në këtë kumtesë do të shqyrtohen disa nga shembujt më të spikatur të restaurimeve të kryera, ku ndërhyrja restauruese ka kontribuar në studimin e banesës shkodrane.

Një shembull tipik paraqet banesa në lagjen «Qafë» një nga të paktat e tipit me çardak, që ruhet ende në Shkodrën e vjetër (tab. 2). Ajo spikat për kompozimin volumor dhe trajtimin e jashtëm arkitektonik, karakteristika këto, që e shkëputin qartazi nga masa e ndërtimeve përreth, duke bartur në vetvete karakteristikat e njohura të banesave të tipit me çardak. Banesa është ndërtim njëkatësh i variantit me çardak të hapur në njërin krah dhe mjedis të dalë në krahun tjetër. Përgjatë çardakut ka të vendosura radhazi tri mjedise, duke qenë në mes shtëpia e zjarrit. Në pjesën e mbrapme ndodhet qilari. Duke vrojtuar me kujdes banesën në aspektin tipologjik, dukej qartë se ajo kishte pësuar ndryshime. Para studiuesit qëndronin disa probleme për përcaktimin e drejtë të fazave të ndërtimit. Treguesi kryesor, në mungesë të dhënash dokumentare, ishte ai tipologjik. Paqartësia kompozicionale shtronte pyetjen nëse kemi të bëjmë me një banesë që në fazën fillestare ka qenë me çardak në gjithë ballin dhe mjedisi i krahut të ketë qenë shtesë, apo banesa ka qenë e tipit me çardak në njërin krah, në ç'raporte kohore qëndronin këto dy faza ndërtimi, si dhe të sqaroheshin ndryshimet e tjera të bëra në banesë. Në vështrim të parë, pa u thelluar në hapjen e plotë të banesës, vetëm duke sqaruar disa ndryshime lidhur me teknikën e ndryshme të punimit të muraturës së gurit, nivelit të ndryshueshëm të dekoracionit të brendësisë së mjediseve, gjurmëve të shtyllave të drurit që dilnin te qoshku i mbyllur në çardak dhe të fugës së murit anësor të çardakut, u hodh ideja se faza fillestare e banesës është ajo me çardak në ballë e tri mjediseve përgjatë tij, duke qenë mjedisi i dalë në formë krahu shtesë e mëvonshme.

Ky përcaktim, i bazuar mbi të dhëna të pjesshme të monumentit, ndryshoi kur banesa iu nënshtrua zbulimit të plotë të strukturave të saj të fshehura në procesin e ndërhyrjes restauruese. Faktet e reja që dolën ishin mjaft bindëse. Fugat e ndërtimit në katin përdhe në vendtakimet e dy mureve të dy ahureve, teknika më e hershme e dekoracionit të odës së krahut të majtë (ky mjedis me kohë kishte pësuar ritrajtim si në anën kompozicionale ashtu dhe atë dekorative), dritaret e odës së zjarrit të krahut të djathtë

DO NOT COPY

me kohë ishin përshtatur si dyer për komunikimin me mjedisin e krahut të djathtë. Këto gjurmë na bindën se gjithë ndërtimi i krahut të djathtë ishte shtesë volumi i mëvonshëm. Banesa kishte kaluar kështu nëpër tri faza ndërtimi. Kontributi i ndërhyrjes restauruese qe me shumë vlerë për studimin e kësaj banese. Ajo korrigjoi në mënyrë të argumentuar supozimin e parë mbi fazën fillestare të kësaj banese.

Rastet krahasimisht të dendura të ndryshimeve që kanë pësuar banesat prej shek. XVIII dhe gjatë gjysmës së shek. XIX e më vonë, si mbyllja e çardaqeve dhe ndryshimet në formulimin arkitektonik dhe atë konstruktiv në përgjithësi, pasqyrohen dhe në banesën tek lagjja «Kongresi i Përmetit» rruga «N. Gjylbegu» nr. 17, tab. II, e cila përbën, gjithashtu, një shembull tipik të ndihmesës së ndërsjellë të ndërhyrjeve restauruese dhe njohurive mbi historikun e monumentit të dhënë. Në gjendjen e sotme banesa paraqitej e variantit të zhvilluar me çardak të mbyllur në qendër e dy mjedise simetrike anash tij. Ndërhyrja restauruese në këtë monument nxori në dritë vlera të reja, të rëndësishme për historinë e tij, duke përcaktuar fazën e saj fillestare, e cila i përkiste variantit të banesës me çardak në gjithë ballin dhe tri mjedise përbri tij. Evolucioni i banesës në studim ka ardhur si rezultat i shtesave që i janë bashkëngjitur banesës në kohë të ndryshme, duke shkrirë në një të vetme dhe në mënyrë tepër origjinale gjithë ndërtimin e përftuar.

Një aspekt i rëndësishëm i ndihmesës restauruese që kontribuoi në përcaktimin e drejtë të tri fazave të ndërtimit të kësaj banese qe ai i teknikës së ndërtimit, i shumë elementeve konstruktive, si dhe formulimit arkitektoniko-dekorativ në strukturat e fshehura. Për shembull, për mjediset e ndodhura bri çardakut u përforcua idea se janë ndërtime të fazës së parë nga teknika e hershme e suvatimit me fije kashte dhe fije pambuku. Për odën e zjarrit dhe mjediset e banimit ndihmoi në këtë vlerësim dhe teknika e ndërtimit të dritareve dyfishe të dala në çardak, mbërthimi i dyshemeve me gozhda kovaçi, si dhe gjurmët e trapazanit të murosura në kohë, niveli dekorativ i të cilit është në kontrast me ato të odave të dala anash çardakut. Ndërsa vazhdimësia e çardakut u përforcua nga elementet origjinale, të cilat dolën gjatë punimeve të restaurimit si shtyllat e drurit dhe jastekët e daltuar (Tab. I b).

Një rast tjetër paraqet banesa nr. 27 në rrugën «Pashko Vasa» në qytetin e Shkodrës, e cila përbën një rast tipik të monumentit me vlera të dyfishta, si monument historik e arkitektonik. Banesa lidhet me jetën e patriotit të shquar të Rilindjes sonë Kombëtare Pashko Vasa. Banesa ka pësuar transformime të rëndësishme qoftë në planin kompozicional, ashtu dhe në atë arkitektonik. Ajo ka një formë të çrregu planimetrike të përbërë nga tri pjesë ndërtimi të dhura midis tyre nga çardaku i transformuar në kol Si e tillë, ajo nuk ruan një skemë të ngjashme tip logjike me banesat e tipit me çardak, të zhvilluc gjatë shek. XVIII – XIX. Ndërtimet shtesë të bë me kalimin e kohës janë vendosur pa ndonjë kri të caktuar, apo lidhje logjike funksionale në tërësi e monumentit. Për këtë studimi i banesës paraqi një problem të ndërlikuar.

Për të arritur në zbërthimin e evolucionit të s duhej të përcaktohej nëse kishim të bënim me banesë të vetme që në fazën fillestare, apo me pje të veçanta dhe, në qoftë se ishte kështu, në ç'rap kohor qëndronin ato karshi njëra-tjetrës. Për të sc ruar këto pikëpyetje, banesa iu nënshtrua një st dimi të hollësishëm mbi bazën e njohjes së tipare dhe karakteristikave të kësaj kategorie ndërtimo duke marrë për bazë mjaft të dhëna historike si d të dhëna gojore. Vrojtimi i kujdesshëm analitik, c ke gjurmuar me kujdes çdo tregues, i cili sqar drejtpërdrejt ndryshimet në kohë të monumentit, ndihmesa themeltare për të qartësuar zhvillimin kohë të monumentit. Fugat e ndërtimeve në vendta met e mureve në pjesës së mbrapme të ndërtimit, krahun e majtë, teknika e ndërtimit të muraturës ndryshme për të tria pjesët e ndërtimit, gjurmët shtyllave të drurit dhe trarëve gjatësore që dalin çardak, niveli i ndryshëm i trajtimit dekorativ të m diseve bënë të mundur përcaktimin e tri faza ndërtimore të monumentit të vendosura këto vet në kronologji relative, për arsye të mungesës së da meve. Përsa i përket qëndrimit ndaj fazave të ndë timit për të tri banesat e parashtruara, është mbaj qëndrim vlerësues ndaj shtesave apo ndryshimeve monumentit, duke i parë ato si kontribute të pe udhave e rrethanave të caktuara në të cilat ato zhvilluan. E rëndësishme është të theksojmë se n shembujt e prurë, krahasimisht të paktë, po të ke parasysh rastet e shumta të ndeshura në praktik restauruese të banesës shkodrane, saktësohet më miri se varianti fillestar i banesës shkodrane ësh ai me çardak të hapur në ballë, me dy apo tri mj dise përbri tij.

Përfundimisht, mund të themi se studimi i b nesës shkodrane dhe punimet restauruese në të ja në marrëdhënie ndihmesash të ndërsjellta njëra nc tjetrës, në faza të ndryshme të asaj veprimtarie gjerë teoriko-studimore dhe praktiko-zbatuese, emërtohet restaurim i monumenteve. Shumë të dh na dalin si kontribute të restaurimit, duke hedh dritë të plotë mbi fazat e ndërtimit, njëherazi ato ja fakte me rëndësi për tipologjinë e banesës shk drane.

DO NOT COPY

Tab. 1

GJENDJA EKZISTUESE



Perspektive



KATI PERDHE



Shpjegues

FAZA PARE

FAZA DYTE

FAZA TRETE



0 2 4 6 8M KATI I PARE

FAZA FILLESTARE



PAMJE KRYESORE



KATI PERDHE



KATI I PARE

0 2 4 6M

TAB II





(6)





0 2 4 6 M

GJENDJA EGZISTUESE

FAZA FILLESTARE







0 4 8 12 16 M

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

CONTRIBUTION DES TRAVAUX DE RESTAURATION A L'ETUDE DE L'HABITATION DE SHKODRA

RESUME

L'habitation de Shkodra des XVIIIe-XXe sc. occupe une place importante dans l'architecture populaire urbaine.

La typologie, une habitation à «tchardak», pourvue de grandes superficies ouvertes comme le «hajat» et le «tchardak», ainsi que d'autres pièces inhabitées du rez-de-chaussée, toléra les nombreuses modifications qu'elle subit au cours du temps. La conservation des nombreuses traces originales aide à identifier ces modifications qui disparaissent par la reconstruction et réapparaissent par la restauration.

Les travaux de restauration et les sondages effectués au moment voulu, donnent la meilleure occasion pour connaître les anciennes structures de l'habitation. Ces données, ainsi qu'une bonne instruction sur l'habitation populaire en quelques cas apportent de nouveaux faits, qui éclaircissent les doutes pendant l'étude de l'habitation, et en même temps aident à bien définir les phases de construction.

Cette communication traite quelques exemples des restaurations qui contribuèrent à l'étude de l'habitation de Shkodra.

Une habitation à un étage du type «à tchardak sur une seule aile», conservée encore à Shkodra, représente un exemple typique de l'habitation de cette ville. Il y eut une série de questions qui se posèrent au chercheur; – quelle est la juste définition des phases de construction? – à quelle variante appartient-elle l'habitation originale? – quel est le rapport de temps des phases de construction? Grâce aux interventions de restauration on corrigea de façon argumentée la première opinion sur l'initiale phase de la construction de cette habitation qui en avait subi trois. Il s'agissait d'une habitation de la plus simple variante, celle à tchardak dans toute la partie frontale précédant deux pièces.

Un autre exemple se rapporte à la variante évoluée «à tchardak au centre». La restauration de ce monument mit à jour d'importantes valeurs historiques, précisa les quatre phases de construction et sa phase initiale de la plus simple variante «à tchardak dans toute la partie frontale» précédant trois pièces.

Ce qui est important dans cette communication, c'est que les exemples analysés, bien que peu nombreux vu le nombre des restaurations effectuées dans l'habitation de Shkodra, précisent bien qu'en général, que la variante initiale de l'habitation de Shkodra est celle «à tchardak dans toute la partie frontale» précédant deux ou trois pièces en face. Les passages aux autres variantes plus évoluées représentent les échelles de son évolution en contribuant à l'évolution typologique, architectonique et décorative de l'habitation.

Donc, on peut conclure que l'étude sur l'habitation de Shkodra et les travaux de restauration y effectués sont en relations de contributions réciproques l'un envers l'autre pendant les différentes phases de cette large activité théorique et pratique qu'on nomme «restauration des monuments». Beaucoup de données, mises à jour par la restauration, constituent entre temps des faits importants pour la typologie de l'habitation de Shkodra et l'histoire de l'architecture populaire en général.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Nr. 2 1988

monumente

DO NOT COPY

Leonard SULI

BANESA POPULLORE E RRETHIT TË SARANDËS (SHEK. XV – XX)

Nga studimet e deritanishme del në pah se trashëgimia ndërtimore në rrethin e Sarandës është e shumtë dhe e larmishme. Në këtë veprimtari, të përfaqësuar nga gjini të ndryshme ndërtimesh, pa dyshim banesa popullore zë një vend të rëndësishëm. Duke përjashtuar zonën e Konispolit, që përfaqëson pjesën veriore të krahinës së Çamërisë, zonat e tjera përfshihen në njësinë e madhe etnografike të Labërisë (fig. 1). Nga burimet historike dhe gjurmimet në vend, rezulton se në zonat në studim ruhen vendbanime të lashta, që vazhdojnë nga mesjeta deri më sot. Vendbanimi në vendin e quajtur



Fig. 1

DO NOT COPY

Qafa e Ktismave ose dhe Bregu i Stresës është i përbërë nga 23 banesa dhe një sterë. (fig. 1). Banesat kryesisht, janë një dhe dykthinëshe, përdhese dhe me gjysmë kat (Tab. I). Ndër të tjera, në këto rrënoja, me interes është dhe ndërtimi i murit perimetral të mjedisit ballor, që ka formë harku, teknika e ndërtimit dhe shfrytëzimi racional i terrenit. Halil Shabani i quan banesa të periudhës antike (shek. IV-III p.e.re), ndërsa Neritan Ceka, i cili ka asistuar dhe gjatë gërmimeve të vitit 1983, ka mendimin se ky vendbanim i përket fillimit të mesjetës së mesme, mendim të cilin e kemi dhe ne, duke u nisur gjithnjë nga materiali i grumbulluar deri tani. Ndërtimet që i përkasin shek. XV – XVII, kryesisht, i takojnë Kamenicës, e cila, sipas regjistrit të vitit 1431 – 32, kishte 267 banesa dhe ishte qendra më e madhe e banuar e këtyre anëve. Sipas regjistrit të vitit 1583, Kamenica kishte vetëm 163 banesa. Shalësi 171 banesa, kurse Konispoli 230 banesa. Banorët e këtyre anëve janë marrë me blegtori dhe bujqësi. Klima ka qenë e përshtatshme për zhvillimin e olivikulturës. Vetëm bujqit e zonës së Vurgut ishin çifçinj, Shkëmbimi i produkteve të ekonomisë fshatare bëhej kryesisht në Delvinë, e cila ka qenë qendra më e rëndësishme zejtaro-tregtare e sanxhakut të saj. Veprimtaria ndërtimore e trashëguar në këtë zonë mund të ndiqet mirë gjatë shek. XV – XX

Konispoli, i ngritur kryesisht mbi terren malor, përbëhet nga 5 lagje që mbajnë emra fisesh. Qendrën e Konispolit e përbën pazari. Lagjet e shpërndara lidhen me qendrën me rrugë të shtruara me kalldrëm. Banesat që formojnë lagjet janë relativisht afër njëra-tjetrës dhe përgjithësisht qarkohen me mure rrethuese. Në rastin kur terreni është i rrafshët, siç është ai ku ngrihet lagjja «Shehat», ka kushtëzuar ndërtimin e banesave në mënyrë të atillë, që pamja kryesore të jetë paralel me rrugën (fig. 2). Në disa fshatra, si p.sh., në Selicë, vendin kryesor të qendrës së fshatit e zinte mexhlisi (sheshi i kuvendeve) me rrapin e vjetër (fig 5). Terreni i pjerrët, përgjithësisht, kushtëzonte vendosjen e pamjes kryesore normal me rrugën. Në zonën e Vurgut banesat kanë qenë vendosur në këmbët e kodrave, deri në dy të tretat e lartësisë. Në pjesën mbizotëruese ngrihej kulla e beut, ajo e qehallarëve dhe ndërtimet e kultit. Në këtë rreth takohen banesa që nga variantet më të thjeshta, siç është kasollja për banim dhe radhazi banesa përdhese me gjysmëkat dhe me kat.

Kasollja për banim ka qenë ndërtuar kryesisht nga bujqit çifçinj të zonës së Vurgut. Mbas Çlirimit ato nuk u përdorën më për banim, por vetëm për strehimin e bagëtive. Kasollja për banim shfaqet në tri variante. Varianti njëkthinësh, ai dykthinësh dhe ai dykthinësh me korridor në mes. Lënda që përdorej



Fig. 2

për ndërtimin e kasolleve ishte druri, balta dhe ka shta. Kasollet rrezistonin 15-20 vjet dhe pastaj rindë toheshin përsëri.

Banesa përdhese, megjithëse e ndërtuar kry sisht nga shtresat e varfëra dhe rrallë nga shtresat mesme të popullsisë, nuk ka pasur përhapje të gjer sidomos në shek. XVII-XX. Varianti më i thjeshtë ësh njëkthinësh, një shembull të të cilit e gjejmë në R hullë më 1910 (fig. 7). Një prej shembujve të b nesës përdhese dykthinëshe gjendet në Senicë (Ta II). Kthina e parë është oda e miqve, ndërsa e dy magjeria (mjedis gatimi). Gjithashtu varianti i b nesës përdhese dykthinëshe me korridor në mes, t kohet jo rrallë në fshatrat e rrethit në studim. Ban sën përdhese dykthinëshe, njëra prej të cilave përd rej për depozitë bari, ku kamarja e zjarrit ruan fo mën primitive, gjendet në fshatin – rrënojë të F shë-Bardhës.

Banesën me gjysmëkat e gjejmë të ndërtuar n të gjitha fshatrat e rrethit. Kompozimi i saj karakt rizohet nga një thyerje karakteristike në volum. N kompozimin e saj ka ndikuar kryesisht terreni i pj rrët. Ndikim në kompozimin e saj ka pasur kërkes për të siguruar truall të padjegshëm për magjerin Lloji më i thjeshtë i kësaj banese është ai me k tuan njëkthinësh në katin përdhes, odën e miqve katin e parë, në vazhdim të së cilës ngrihej magjer e mbështetur mbi truallin natyror. Një shembull thjeshtë i kësaj banese gjendet në Konispol (Tab. II Shembullin më të zhvilluar të banesës me gjysmë kat e gjejmë të ndërtuar në Sirakat, në vitin 1864. N kompozim, ky shembull ka karakteristikat e banesë qytetare (fig. 3).

Banesa me kat ka përhapje mjaft të gjerë. A

e gjejmë të ndërtuar në kompozim të thjeshtë, i cili përmban një kthinë për secilin kat, deri te varianti më i zhvilluar, që është banesa me zhvillim në dy krahë. Një prej shembujve të thjeshtë e gjejmë në Vagalat (fig. 4). Në kompozimin e kësaj banese spikat ndjeshëm karakteri i fortifikuar. Me interes për sa i përket anës funksionale është shembulli në Fushë-Bardhë, i ndërtuar në fund të shek. XVIII. Ky ndërtim është ngritur vetëm për mbrojtje. Variantin e dytë me kat e gjejmë të ndërtuar në Mursi, në fund të shek. XIX (Tab. IV).

Banesën me zhvillim në një krah e gjejmë të ndërtuar shpesh, sidomos në zonën e Konispolit. Ky variant përbën banesën tipike të kësaj zone. Një prej këtyre shembujve e gjejmë të ndërtuar në fshatin Vërvë, në fund të shek. XIX (Tab. V). Me interes është kompozimi i banesës në Shalës, ndërtuar në vitin 1911. Në planimetri ajo ka formën e kryqit me krahë të barabartë. Banesa me zhvillim në dy krahë është e ndërtuar në Rrëzomë dhe veçanërisht në zonën e Konispolit. Një shembull të arritur, përsa i përket kompozimit, paraqet banesa e ndërtuar në Rusanj, në vitin 1858. Ky shembull ka tiparet e banesës qytetare dhe ngjason me variantin respektiv të banesës gjirokastrite. Me mjaft interes për sa i përket kompozimit, është banesa me zhvillim në dy krahë, me kullë, e ndërtuar në Konispol në vitin 1858 (Tab. VI). Në brendësi të oborrit është ndërtuar dhe odajashta, në kompozimin e katit të parë të saj bën pjesë çardaku, i cili ka interes për lidhjet në mes të banesës fshatare dhe asaj qytetare. Mjeshtërit pobullorë kanë qenë kryesisht nga Opari i Korçës dhe Përmeti, në disa raste vinin ustallarë dhe nga Konica. Opariotët merreshin me ndërtimin e muraturës e të çatisë, kurse përmetarët kryenin punimet e drurit dhe suvatimet. Vendbanimi i shek. XII, në Qafën e Stismave, Kamenica e ndërtuar që në shek. XIV, si dhe një pjesë e banesave të Fushë-Bardhës, të ndërtuara në fund të shek. XVIII, përbëjnë dëshmitë relativisht të hershme të fondit të përgjithshëm të banesave të trashëguara. Duke pasur parasysh banesën më të thjeshtë, që është kasollja për banim dhe atë të varianteve të zhvilluara, del qartë në pah diferencimi klasor. Kryesisht kasollet kanë qenë ndërtuar në Vurg. Përjashtuar zonën e Konispolit, banesa më e përhapur në rreth ka qenë banesa me kat dhe pikërisht ajo me dy kthina në katin e banuar. Banesa me zhvillim në një krah shfaqet më tepër në zonën e Konispolit dhe është banesa më tipike e zonës. Banesën me zhvillim në dy krahë e gjejmë në Rrëzomë dhe veçanërisht në zonën e Konispolit. Duke krahasuar banesën e rrethit në studim, me atë të zonës në kufi, vërejmë se në banesën e rrethit të Vlorës, në kompozimin e banesës përdhese bën pjesë portiku, kurse



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

në banesat e rrethit në studim, portiku takohet shumë rrallë. Në zonat në kufi nuk shfaqet banesa me zhvillim në dy krahë. Me gjithë ndryshimet e mësipërme, banesat e zonave në studim qëndrojnë në unitet me banesat e zonave në kufi që përfshihen në të njëjtën njësi etnografike. Në dallim me zonat e tjera të rrethit, pjesa veriore e Çamërisë, për vetë karakterin e trajtimit tipologjik të banesës, të trajtimit të elementeve konstruktive e dekorative, si dhe rrugës së zhvillimit të banesës, zë një vend të veçantë. Rruga e zhvillimit të banesës së Çamërisë, për të arritur në skemën tipike paraqitet e tillë. Fillimisht banesës me kat, me dy kthina banimi në katin e parë, i është bashkëngjitur nga ana e magjerisë, normal me aksin gjatësor, një bllok dykatësh. Blloku përbëhej nga një mjedis për secilin kat. Por, gradualisht, skema e re, që ka formën e shkronjës L, bëhet më organike dhe skema më tipike e Çamërisë. Nën magjerinë është ndërtuar «kubeja» e mbuluar me qemer cilindrik me hark gjysmërrethor. Kubeja shërbente si vend për mbajtjen e freskët të zahireve dhe futjen e plaçkave me vlerë, kur familja shp ngulej. Në këtë rast hyrja e kubesë murosej. trajtimin e jashtëm karakteristike janë kornizat p shtë dritareve, të cilat formohen prej pllakash guri mbajtura në konsola guri. Kornizat e çative, puni i pastër i muraturës, dritaret e shumta dhe mbules në formë harku, karakterizojnë këto ndërtime. Traj mi i njëjtë i njësive kompozicionale të brendësisë, dhe përpunimi arkitektonik dekorativ i pamjeve jashtme, krahas rrugës së zhvillimit të banesës, shf qin unitetin e theksuar të banesës në këtë zonë. N trajtimin e banesave të varianteve të thjeshta, ajo k lidhje me variantet respektive të ndërtuara në zon e tjera të rrethit dhe në disa zona në veri të tij. N variantet e zhvilluara shihen paralele sidomos m banesën gjirokastrite. Karakteristikat e mësipërm bëjnë që banesa e Çamërisë Veriore, pa mohua lidhjet e saj me banesat e krahinave të tjera, të zër një vend të veçantë, jo vetëm në banesën popullor të zonave të tjera të rrethit, por në mbarë arkitek turën tonë popullore.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

TAB. I

BANESA 5

BANESA 4

BANESA 2

BANESA RRENOJE NE QAFEN E KTISMAVE · KONISPOL

PRERJE 1:1

PRERJA 1:1

0 1 2 3 4 M.

PRERJE 1:1

TAB. II



PAMJE JUGORE



KATI PERDHE

0 2 4 6

TAB. III



PAMJE VERIPERENDIMORE (perspektive)

TAB. IV



PAMJE JUGORE

0 1 2 3 4 M.





KATI PERDHE

0 2 4 6M

KATI I PARE



KATI PERDHE



KATI I PARE

0 1 2 3 4 M

DO NOT COPY

. TAB. V

BANESE NE VERVE



PAMJE LINDORE *(perspektivë)*



PRERJA 1 : 1

0 1 2 3 4 M.



PLANIMETRI E KATIT PERDHE



PLANIMETRI E MANXATOS



PLANIMETRI E KATIT PARE

0 2 4 6 M.

DO NOT COPY

TAB. VI

BANESE NE KONISPOL



PAMIE JUGORE (perspektivë)



GEN - PLAN



PAMIE VERIPERENDIMORE (Perspektivë)



ODA JASHTA PAMIE VERIORE

0 1 2 M

KATI PERDHE



KATI I PARE





ODA JASHTA

0 2 4 6 8 10 M

Leonard SULI

DO NOT COPY

L'HABITATION POPULAIRE DE LA REGION DE SARANDA AUX XV-XXe SIECLES

RESUME

L'habitation populaire occupe une place importante dans le patrimoine des constructions de la région de Saranda. Mise à part la zone de Konispol, qui représente la partie septentrionale de la province de Çamëria, les autres zones font part de la grande unité ethnographique de Labëri. Par les sources historiques et les recherches effectuées sur place il résulte que dans cette région on conserve d'anciens habitats. Non loin de Konispol se trouve un habitat moyenâgeux. Il est composé de 28 habitations et il est surnomé par les indigènes «Qafa e Stismave». Une partie des habitations sont d'une composition à demi-étage alors que celles de l'autre partie sont à simple rez-de-chaussée à une pièce. A part la technique de la construction et l'adaptation au terrain en pente ces habitations se distinguent par la présence du mur périmétral de l'ambiance faciale en forme d'arc. A Kamenicë, qui, selon le registre des années 1431-1432 comptait 267 habitations on rencontre des habitations du XV-XVIIe sc. D'après le registre de l'an 1583 Kamenicë comptait 163 habitations, et Shalë en comptait 171 et Konispol 230. Les habitants de ces zones s'occupaient d'agriculture, d'élevage et d'oliviculture. Seulement les agriculteurs de Vurg étaient des métayers. L'échange des produits paysans se faisait à Delvinë. A part la zone de Vurg, habitée par des métayers où la plupart des habitations n'étaient que des chaumières, les autres villages groupaient des habitations en pierres avec des murs d'enceinte. Les quartiers étaient reliés au centre du village par des ruelles pavées. Dans cette région on rencontre des habitations à simple rez-de-chaussée de diverses variantes comme p. ex. celle à une pièce, à deux pièces, l'habitation à demi étage, celle à un étage. La variante la plus développée est celle de l'habitation composée de deux ailes pourvu d'une «Kulla». L'habitation à simple rez-de-chaussée construite par les pauvres couches de la population n'a pas été très répandue surtout pendant le XVII-XXe siècles. Dans cette habitation une des pièces servait de lieu où l'on cuisinait alors que l'autre était utilisée comme chambre d'amis. L'habitation à demi-étage, dans sa si variante, était composée par l'étable au rez-de-chaussée chambre d'amis au-dessus de l'étable et à la suite de ce la pièce qui servait de cuisine construite à même le sol. L bitation à étages était très répandue. La plus simple vari est celle du type «Kulla» à un étage, où le rez-de-chau et le premier étage étaient composés d'une seule pièce rez-de-chaussée sérvait d'étable, au premier se déroulait la familliale. L'habitation développée sur une aile est l'ha tion la plus typique surtout pour la zone de Konispol. L cette variante l'étage habité contient trois pièces vides chambre (la chambre des amis), la pièce servant à fair cuisine et une autre pièce d'habitation. Dans ces habita se trouve aussi la «manxete» (où l'on dépose les produits mentaires) qui se trouve entre l'étable et la meilleure chan

L'habitation développée sur les deux ailes se renc plus souvent dans la zone de Konispol. Cette variante, à l' rieur de la cour, comprend la «zepana» (la chambre à térieur) à un étage, où séjournaient les servants et les du second ordre.

Ces deux variantes ont dans leur composition les trait l'habitation citadine et ressemblent surtout aux variantes pectives de l'habitation de Gjirokastra. En général les hab ons sont datées, surtout celles qui appartiennent à la pé XVIII-XXe siècles.

Les maîtres constructeurs qui construisirent les habita de cette période venaient d'Opar de Korça, de Përme de Konicë. L'habitation de la région en question, bien qu soit en unité avec les habitations des zones aux alent se distingue de celles-ci dans quelques directions. Su l'habitation du Konispol se distingue en particulier pa même traitement des unités compositionnelles ainsi que p traitement architectonique et décoratif des vues extérieures qui fait qu'elle occupe une place importante dans architecture populaire.

Nr. 2 1988

monumentet

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

NDËRTUESIT SHQIPTARË TË RRUGËVE DHE URAVE GJATË SHEKUJVE XV-XIX

Në këtë kumtesë do të trajtojmë organizimin e veprimtarisë së ndërtimit të rrugëve dhe urave në trevat e banuara nga shqiptarët, financuesit dhe sipërmarësit e këtyre lloj ndërtimeve, si dhe mjeshtrit e zbatimit të punimeve të tyre gjatë shekujve XV-XIX, kohë kur trojet tona ndodheshin nën sundimin e Perandorisë Osmane. Nga ana e Institutit të Monumenteve të Kulturës është kryer gjurmimi dhe dokumentimi i këtyre ndërtimeve duke vënë në mbrojtje rrugët dhe urat, si ndërtime më të prekura nga faktorët natyrorë. Trevat iliro-shqiptare, duke pasur një pozitë kyçe gjeografike në Evropën Juglindore e në Ballkan, që nga antikiteti kanë qenë taban i një rrjeti të dendur rrugor që lidhte Evropën Perëndimore e Qendrore me Ballkanin e Azinë. Po kështu rrugë të shumta të brendshme ndërkrahinore i binin kryq e tërthor territorit tonë. Në përgjithësi në sistemin rrugor, në trevat tona, pushtuesit osmanë shfrytëzuan trasetë paraardhëse. Këto rrugë, veçanërisht pas shekullit XVI, fituan një rëndësi të dorës së parë si pasojë e lidhjes së krahinave të ndryshme, e rimëkëmbjes së qyteteve të rrënuara, si dhe krijimit të tregjeve të mëdha ndërkrahinore. Më tej, gjatë fundit të shek. XVIII e fillimit të shek. XIX me poshallëqet e mëdha shqiptare dhe gjatë fundit XIX me shfaqjen e borgjezisë tregtare, bazuar gjithnjë në traditën e tij të hershme, mjeshtrit shqiptarë e zhvilluan më tej traditën e ndërtimit të urave dhe rrugëve.

Gjatë shekujve XV-XIX ekzistonte sistemi i fshatrave dervenë, banorët e të cilëve duhej të ruanin shtigjet rrugore malore, të siguronin qarkullimin e lirë të karvaneve duke vënë rojë në çdo fshat, të hapnin grykat në kohën e dimrit dhe të ndërtonin e të mirëmbanin rrugët dhe urat në zonat e tyre. Në këtë mënyrë nga ana strategjike pushtuesi mendonte të siguronte kalimin pa shqetësim të trupave të tij nëpër pikat rrugore kyçe. Por nga ana tjetër ndërtimi i tyre tregon aftësitë teknike të mjeshtërve vendas për ndërtimin e rrugëve e të urave. Në Shqipërinë e Veriut gjatë shekujve XV – XVI dervenxhinj ishin malësorët e krahinave të Hotit, të Pultit të sotëm, të Shalës, Shoshit, të Nikaj-Mërturit dhe të Kelmendit. Këto krahina dervenxhinjsh duhej të kontrollonin rrugët malore që lidhnin krahinat bregdetare me krahinat lindore të Sanxhakut të Shkodrës. Fshatra të tjera dervenë gjatë shekullit XV në Shqipërinë e Veriut ishin dhe Dragobia në Tropojë, Rrijolli në Shkodër dhe Bukmira në Mirditë. Po në këtë kohë banorët e fshatrave Guri i Bardhë, Klos e Bulqizë ishin caktuar për mirëmbajtjen e rrugës së rëndësishme të karvaneve Durrës-fushë e Tiranës-Dibër, që kalonte nëpër tokat e tyre. Në Shqipërinë e Mesme, gjatë shek. XVI, banorët e fshatit Bilaj të krahinës së Misjes u caktuan dervenë në rrugën që çon në Kalanë e Ishmit, ndërsa fshati Milot iu ngarkua mirëmbajtja e rrugës së karvaneve Durrës-Lezhë-Shkodër, si dhe fshati Gjorm. Me vendosjen e sistemit të fshatrave dervenë tregtarët dhe udhëtarët gjatë kalimit nëpër qafat e ndryshme të njohura me emrin «dervende», ku zakonisht ndodheshin dhe karakollet, postblloqet (qafa e Çajupit, Qafëmurriza, qafa e Sekcës, Rugova, etj) ishin të detyruar të paguanin taksën e kalimit, që në veri quhej «baxhi dervend» dhe në jug «dervenatiko».

Në mes të shek. XVIII arkitekt Kasemi me origjinë nga Grëmshi i Skraparit, më tej kryearkitekt i Perandorisë osmane, mirëmbante rrugët Berat – Korçë dhe Berat – Elbasan – Ohër. Ai ndoshta ndërtoi dhe urën e Kasabashit mbi lumin e Çorovodës pranë qytetit të Çorovodës. Një veprimtari e gjerë për ndërtimin e rrugëve dhe urave është kryer gjatë kohës së poshallëqeve të mëdha shqiptare me Ahmet Kurt Pashën në Berat, Ali Pashë Tepelenën në Shqipërinë

DO NOT COPY



Fig. 1

e Jugut dhe me Bushatlinjtë në Veri. Në vitin 1777 Ahmet Kurd Pasha ndërtoi me qemere guri urën e Gorricës mbi Osum (fig. 1). në vendin e urës prej druri, që ekzistonte të paktën nga mesi i shek. XVII, në kohën e Çelebiut. Ura e Kurt Pashës pësoi dëmtime gjatë vitit 1888 dhe Luftës së Parë Botërore. Ali Pashë Tepelena gjatë fundit të shek. XVIII dhe fillimit të shek. XIX në Shqipërinë e Jugut mirëmbajti mjaft rrugë dhe ndërtoi ura, hane, karakolle. Kështu ai mirëmbajti rrugën Gjirokastër – Pogon – Greqi, Gjirokastër – Çajup – Zagori – Përmet, atë Muzinë – Delvinë – Rrëzomë – Kalasë – Bregu i Detit etj. Ai ndërtoi dhe një sërë urash që ruhen ende sot, si ura e Limarit në luginën e Zagorisë (fig. 2),



Fig. 2

ura e Hoshtevës dhe e Nivanit në Zagori, ura e minxhit dhe Kaçarellos në Pogon, urat e Rrëzo (tre në Kalasë, dy në Tatzat), riparoi urën e Vjo në Tepelenë, ndërtoi urën e madhe të ujësjellësit kalasë së Gjirokastrës dhe atë të ujësjellësit të B çës në Tepelenë. Gjithashtu ai ngriti karakollin e fës së Çajupit në rrugën Gjirokastër – Çajup – P met (fig. 3), si dhe ato të grykës së Selcës në rru e Pogonit. Gjurmë të rëndësishme në ndërtimin mirëmbajtjen e rrugëve dhe urave në Shqipëri Veriut kanë lënë Bushatllinjtë e Shkodrës gj gjysmës së dytë të shek. XVIII dhe fillimit të sh XIX. Mehmet Pashë Bushati (1757-1775) mirëmba rrugën më të rëndësishme të veriut, Shkodër – P zren – Danub, rrugën Lezhë – Shkodër, rrugët e peve që lidhen me Kosovën, rrugët që çonin në M të Zi, Dalmaci etj. Ai ndërtoi dy urat e mëdha Vezirit mbi Drinin e Bardhë në Kukës në rrugën Sh dër-Prizren. Prej tyre ura e qafës së Morinës ës urë e fortifikuar. Në njërin breg ndodhet hani i f tifikuar dhe në tjetrin kulla me frëngji. Mehmet Pas ndërtoi dhe Urën e Mesit, mbi lumin Kir, gjatë r gës Shkodër – Malësi e Pultit (fig. 4). Në vitin 17 Mehmet Pasha ndërtoi dhe urën e gurit mbi Kir, p mbi urën e sotme të Bahçallëkut gjatë rrugës zhë – Shkodër, e cila u shkatërrua në mesin e sh XIX. Vepër e Mehmet Pashës ishte dhe Ura e Ve rit mbi lumin e Moraçës në Podgoricë, e shkatërru gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pasuesi i Mehm Pashës, Kurt Mahmud Pasha (1776-1796), ndër urën e Tamarës mbi lumin e Cemit gjatë rrug Shkodër – Kelmend – Gucijë – Pejë.

Veç këtyre feudalëve të njohur, edhe feudalë tjerë shqiptarë të krahinave të ndryshme kanë mi



Fig. 3

mbajtur dhe ndërtuar rrugë dhe ura. Ismail Pashë Velabishti, sundimtar i sanxhaqeve të Vlorës dhe Delvinës, në mesin e shek. XVIII ndërtoi urën e Velabishtit afër Beratit gjatë rrugës Vlorë – qafë e Sinjës – Berat. Mbi Osum, në vendin e quajtur sot Ura Vajgurore, ka qenë një urë guri me qemere deri në vitin 1918 kur u dëmtua, të cilën e filloi Ahmed Kurt Pasha dhe e përfundoi Ibrahim Pashë Vlora, më 1800. Në vitin 1860 kjo urë u riparua nga Hasan beu duke marrë dhe emrin e tij. Rruga mesjetare Berat – Elbasan, gjatë Devollit, e cila e kalonte lumin e Devollit në Gostinë me një urë guri me disa qemerë, u ndërtua nga sundimtari i Sulovës, Haxhi Sali bej Përrenjasi, rreth vitit 1785. Në fillim të shek. XVIII, Muço Hysoja, udhëheqës i kryengritjes antiosmane në kazatë e Tepelenës, Kurveleshit, gjatë viteve 1701--1704, ndërtoi mbi Vjosë një urë të madhe gjatë rrugës Këlcyrë – Limar – Zagori (sot e shkatërruar).

Kontribut të veçantë për ndërtimin e urave dhe rrugëve kanë dhënë dhe shoqëritë esnafore, sidomos gjatë shekujve XVIII-XIX. Esnafi i tabakëve në Gjakovë gjatë shek. XVIII, ndërtoi në qytet, mbi lumin Jerenik Urën e Tabakëve (fig. 5), kurse esnafi i terzive ndërtoi ndërmjet Gjakovës dhe Prizrenit Urën e Terzive. Po nga esnafi i tabakëve (lëkurëregjësve) u ndërtua në Tiranë mbi lumin e Lanës, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, Ura e Tabakut. Realizimi i këtyre ndërtimeve kryhej nga vetë mjeshtrit shqiptarë. Të njohur kanë qenë edhe kolonjarët, që ndërtuan në gjithë Shqipërinë e Jugut dhe në Greqi. Kështu, Dhimitër Bezhani, mbi lumin Osum në Orgockë ndërtoi një urë guri e më pas (fig. 6), rreth vitit 1830, mje-



Fig. 5

shtri Sotir Ura nga Luarasi po këtu ndërtoi urën e Orgockës. Mjeshtër urash kanë qenë dhe Hari Stefa nga Lëngëzi, Thoma Joxe nga Rehova etj. Gjatë shekullit të kaluar mjeshtër kolonjarë nga familja Mihali e Borovës kanë punuar në ndërtimin e urave në krahinën e Theollogos – Sarandë. Prej tyre ruhet ura e Cerkovicës mbi lumin Theollogos e vitit 1888. Mjeshtër të njohur kanë qenë dhe oparakët nga fshatrat Lekas, Tudas, Gjonbabas, Gjergjavicë, Marjan e Xerje, të cilët të organizuar në grupe me një drejtues, që quhej «bashostan», shkonin për të punuar në vende të ndryshme, me veglat, plaçkat dhe kafshët e punës me vete. Kështu usta Tolja me një grup



Fig. 4



Fig. 6

PO KOPJE

10 – 15 vetash me vete më 1889 ndërtoi urën e Drashovicës në Vlorë. Grupi angazhoi 100 forca pune vendase dhe ndërtimi mbaroi brenda vitit. Mjaft të njohur kanë qenë në ndërtimin e urave dhe mjeshtrit dribranë dhe ata nga Reka. Ata duhet të kenë punuar në ndërtimin e urave gjatë periudhës së Bushatllinjve në Shqipërinë e Veriut. Mjeshtrit shqiptarë të ndërtimit të rrugëve dhe urave kanë ushtruar aktivitetin e tyre dhe në vende të tjera. Kështu arkitekt Kasemi ka ndërtuar një urë mbi lumin Egrixhan në Greqi. Mjeshtrit lunxhjotë të njohur sidomos p realizimin e ujësjellësve, kanë ndërtuar mjaft ura në zonën e Gjirokastrës, ashtu dhe në Greqi. Re lizime të tyre në Greqi janë ura e Konicës mbi lun e Voidhomadhit dhe Ura me katër Harqe pranë tetit të Artës. Kalldrëmxhinjtë shqiptarë nga Opo Çermenika, Elbasani, etj., preferoheshin kurdohe për ndërtimin e rrugëve në kryeqendrën e Perand risë Osmane.

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA

DO NOT COPY

LA CONSTRUCTION DES ROUTES ET DES PONTS ALBANAIS AU COURS DES XV-XIXe SIECLES

RESUME

Dans cette communication nous allons traiter l'aspect de la construction des routes et des ponts, l'organisation de cette activité dans les contrées habitées par les albanais, leurs financiers ou entrepreneurs et les maîtres qui les réalisèrent au cours des XV-XIXe siècles, pendant l'occupation ottomane. Les routes et les ponts mieux conservés sont ceux des derniers siècles. Les contrées illyriennes-albanaises, occupant une position clée au sud-est de l'Europe et dans les Balkans, depuis l'Antiquité ont constitué le fond d'un dense reseau routier qui reliait l'Europe Occidentale et Centrale aux Balkans et à l'Asie.

En général, dans nos contrées, les occupants ottomans utilisaient les précédents tracés des routes antiques et médiévales. Au cours des XV-XIXe siècles existait le système des villages «Dervene», dont les habitants devaient guetter les sentiers montagneux et construire et entretenir les routes et les ponts de ces zones. C'étaient les habitants des villages Kelmend de Shkodra, Dragobi, Bukmire (Mirditë), Bilaj (Krujë), Xhyra (Librazhd), etc. Les féodaux et les dominateurs du pays donnèrent la plus grande contribution à la construction et l'entretien des routes.

Au milieu du XVIIe sc., Kasem, originaire de Skrapar, le chef des architectes de l'Empire Ottoman, entretenait les routes Berat-Korçë et Berat-Ohër et construisit le pont de Kasabash. Au cours de la deuxième moitié du XVIIIe sc. Ahmed Kurd Pasha à Berat fit construire quelques ponts dont le principal fut celui de Gorica sur Osum. Au cours de la fin du XVIIIe sc. et du début du XIXe sc., Ali Pasha de Tepelena fit construire et entretenir plusieurs routes et ponts dans l'Albanie méridionale comme à Gjirokastra, à Zagori-Pogon, Lunxheri, Rrëzomë de Delvine. Dans l'Albanie du Nord, au cours de la deuxième moitié du XVIIIe sc. les «Bushatlinj» de Shkodra construisirent plusieurs routes et pont telles les routes Shkodër-Prizren, celles des «Alpes», Mahmut Pasha Bushati fit construire le pont de Mes, de Vezir à Kukës, de Vezir à Pogradec, de Bahçallëk etc. tandis que son successeur Kara Mahmud Pasha fit construire le pont de Tamara à Vermosh. De pair à ces féodaux connus, d'autres féodaux, moins connus, firent construire des ponts au cours des XVIII-XIXe sc. tels Ismail Pasha Velabishti: le pont de Velabisht à Berat, Ibrahim Pasha Vlora à Berat, Haxhi Sali Bej Prenjasi à Gramsh etc. A cette époque-là, les corporations d'artisans contribuèrent assez à la construction des ponts. Ainsi là corporation des «tabak» construisit le pont de Gjakova et de Tirana, celle des «terzinj» construisit un grand pont entre Gjakove et Prizren. Des maîtres de Kolonja construisirent des ponts à Kolonja et ailleurs. Sotir Ura, originaire de Luaras construisit le pont d'Orgocka, tandis que quelques maîtres constructeurs de la famille Mihali à Borove, construisirent des ponts dans la région Theollogos à Saranda. Les maîtres constructeurs albanais des routes et des ponts exercèrent leur activité même en d'autres pays. L'architecte Kasem a construit un pont sur le fleuve Egrixhan en Grèce. Les maîtres de Lunxheri construisirent en Grèce le pont de Konica et le pont à quatre arcs près de la ville d'Arte. Les maîtres albanais d'Opar, de Çermenikë, d'Elbasan, sont préférés pour la construction des routes pavées de la capitale de l'Empire Ottoman.

Les nombreux ponts et routes construits chez nous au cours de cette période, témoignent d'une puissante tradition nationale dans ce domaine de construction.

DO NOT COPY

Ali MUKA

MBI OBORRIN E BANESËS FSHATARE NË DISA ZONA MALORE TË SHQIPËRISË SË MESME (SHEK. XIX-XX)

Banesa tradicionale fshatare, së bashku me mjedisin e afërt ku realizohej, formonin hapësirën e banimit të familjes. Aty organizohej jetesa, gjenin zgjidhje nevoja të ndryshme si për nga natyra, ashtu edhe për nga vendi, roli dhe rëndësia. Në këtë kumtesë do të japim një ekspoze të shkurtër për karakterin dhe tiparet e oborrit të banesës në zonat malore të Shqipërisë së Mesme. Vëmendja do të përqendrohet në shek. XIX dhe në dekadat e para të shek. XX, pasi materiali ekzistues jep mundësi për një trajtim të sigurt të fenomenit.

Materiali bazë u përket zonave të tilla si: Çermenika, Malësia e Tiranës, Martaneshi, Shmili dhe Shpati i Sipërm. Katër të parat shtrihen në krahun e



Fig. 1 – Kompleks banimi për një familje të madhe në fshatin Rinas – Çermenikë (Librazhd).

DO NOT COPY

djathtë të rrjedhës së lumit Shkumbin dhe bëjnë pjesë në Gegëri, Shpati i Sipërm shtrihet në të majtë të lumit dhe u përket atyre zonave që njihen si ndërmjetëse, në të cilat gjen dukuri të Jugut dhe të Veriut, me prirje më shumë nga i pari. Shumica e vendbanimeve të këtyre zonave përmenden që në shek. IV. Përmes numrit të banesave të fiksuara në atë kohë dhe natyrës së taksave që paguanin banorët, zbulohet pa mëdyshje karakteri i ngulitur i vendbanimeve me natyrë ekonomike të përzier, bujqësore e blegtorale. Realiteti i dy shekujve të fundit tregon se bërthama e parë e shumicës së fshatrave ka qenë e vendosur gjeografikisht në një zonë të mesme, rreth 700 – 800 m mbi nivelin e detit, duke pasur «Vërrinë» (ose «Zallin») dhe «malin» e vet. Brenda këtyre caqeve ka ndodhur rritja e fshatit herë drejt vërrisë herë drejt malit, pa pasur braktisje të bërthamës fillestare, të njohur në traditën popullore me emrin «katund» (krahu i djathtë i Shkumbinit) ose «Katund Plak» (krahu i majtë i këtij lumi). Në fizionominë urbanistike të dy shekujve të fundit, në këto zona vërehet një fshat me mëhalla të vogla me bazë vëllazërie, të vendosura relativisht larg njëra-tjetrës, pa munguar edhe banesa të veçuara. Gjurmimet dhe materiali i mbledhur konfirmojnë se përmbajtja dhe karakteri i oborrit të banesës kanë qenë të kushtëzuara nga një varg faktorësh të natyrave të ndryshme. Aty janë pasqyruar e kanë lënë vulën e vet terreni (trualli) dhe faktorë të tjerë gjeografikë e natyrorë. Aty ka gjetur pasqyrim natyra e ekonomisë dhe shkalla e zhvillimit të saj. Për një ekonomi të përzier bujqësore e blegtorale flasin të gjitha ndërtimet ndihmëse. Në oborr ka lënë vulën e vet familja dhe struktura e saj (përbërja numerike) etj. Fjala vjen, kërkesat e familjes së madhe ishin më të ndërlikuara nga ato të një familjeje të zakonshme. Në të parën, veç të tjerash, merrte përparësi zgjidhja e nevojave për fjetjen e kurorëve. Në rast se familja ndahej, kur mungonin mundësitë e krijimit të një oborri të ri, në një truall të ri, problemet e riorganizimit të oborrit ekzistues, për t'u shërbyer tanimë dy familjeve, thoshin fjalën e tyre.

Oborri, përmes kompleksit të ndërtimeve që përfshihen në të, ka kryer funksione banimi dhe njëherazi dhe funksione ndihmëse e ekonomike. Të dy këto grupe funksionesh të marra së bashku janë pasqyrë e programit të kërkesave që ka shtruar e zgjidhur vetë familja, në përputhje me mundësitë reale që ka pasur. Trojet për oborrin zgjidheshin në përputhje me mundësitë reale. Ato zgjidheshin të tilla, që të lidheshin sa të ishte e mundur më mirë me pronën, me aktivitetin e familjes në tokat e punës dhe kullotat. Prirja kryesore ka qenë kursimi i tokës së bukës dhe



Fig. 2 – Kompleks banimi në fshatin Pashtresh – Shpati i S përm (Elbasan).



Fig. 3 – Oborr banese në fshatin Pashtresh – Shpati i Sipër (Elbasan).

shfrytëzimi racional i kushteve gjeografike e natyror ekzistuese.

Oborri paraqitet me rrethim të pjesshëm ose t plotë, qoftë me gardh purtekash, ashtu edhe m mure guri. Në ato raste kur rrethimi është bërë m mure guri, ky nuk është konceptuar si qëllim në vet vete. Aty janë mbështetur ndërtime ose janë sajuc

DOMI COPY



Fig. 4 – Skema funksionale e një banese me tri kate në Çermenikë (Librazhd).



Fig. 5 – Kompleks banimi në fshatin Brar – Malësia e Tiranës (Tiranë).

hajatllëqe duke e bërë më organike pjesëmarrjen e murit rrethues në shfrytëzimin sa më ekonomik të hapësirës së oborrit. Oborri ka qenë njëfamiljar. Ndërtimet më të zakonshme brenda tij janë: banesa, koshari i misrit, kasollja, pusi me ujin e pijshëm dhe kënde e strehë për nevoja të ndryshme. Aty gjen edhe furën e pjekjes, këndin e bletëve, hajatllëqe për veglat bujqësore etj. Po ashtu në oborr nuk kanë munguar pemët frutore e deri pjergullat, të cilat, përveç rolit ekonomik, në periudhën e ngrohtë të vitit e bënin mjaft komod qëndrimin nën hijen e tyre. Në oborrin e familjeve me gjendje të mirë ekonomike shtroheshin me kalldrëm guri edhe rruginat kryesore të lëvizjes së njerëzve, duke realizuar edhe kunetat për kullimin e ujërave. Karakteri ekstensiv i ekonomisë diktonte që disa aktivitete të kryheshin edhe jashtë hapësirës së oborrit. Këtu është fjala për stanet e bagëtive (që realizoheshin në mal ose në vërri), lëmenjtë e shirjes (që më shumë bëheshin me karakter stinor pranë arës së mbjellë) dhe kopshtin e perimeve (që, gjithsesi, preferohej pranë një burimi uji për vaditje). Shpesh edhe uji i pijshëm sigurohej jashtë oborrit dhe transportohej me krahë ose me kafshë. Karakteri utilitar ka qenë kryesori në fizionominë e oborrit e përmbajtjen e tij. Vërehet prirja për shfrytëzimin maksimal të çdo ndërtimi. Vendin kryesor në kompozimin e oborrit e zë banesa. Ajo paraqitet në shumicën e rasteve një ndërtim me dy kate, pa munguar as shembuj të banesës përdhese, por as edhe trikatëshe. Në banesë mbetet si një konstante e përhershme ndarja funksionale e kateve. Kati përdhes ishte caktuar për mbajtjen e bagëtisë (sidomos qetë e punës dhe kafshët e transportit), ndërsa katet e sipërme për jetesën e familjes. Në banesë nuk mungojnë edhe anekse, kënde ose pajisje për ruajtjen e përpunimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të nevojshme për ushqim, veshje e fjetje. Ideja e përdorimit për më shumë se një funksion, që shihet e materializuar në banesë, nuk mungon as në ndërtimet ndihmëse. Fjala vjen, gazhdari (ose koshari), si element i përhershëm i oborrit ka pasur funksionin kryesor mbajtjen e misrit në formë kallinjsh të pashkoqur. Realizimi i tij, në mjaft raste, ka bërë që krahas funksionit kryesor të kryejë edhe funksione të tjera ndihmëse. Edhe me kasollen ka ndodhur e njëjta gjë. Krahas funksionit kryesor për mbajtjen e bagëtisë së imët, ajo është shfrytëzuar edhe për qëllime të tjera.

Dy janë problemet më me peshë që kanë preokupuar familjen në realizimin e oborrit. Së pari, jetesa e familjes dhe së dyti, strehimi i sigurt i kafshëve dhe i bagëtisë, sidomos i asaj pjese që mbahej pranë familjes, duke mos lënë pas dore sigurimin e ushqimit dimëror të tyre. Peshë me rëndësi për të dy grupet ka bartur banesa. Mjaft kërkesa e nevoja

DOKTORATURA



DO NOT COPY

Fig. 6 – Kompleks banimi për një familje të madhe në fshatin Shëngjin i Vogël – Malësia e Tiranës (Tiranë).

të familjes janë zgjidhur brenda volumit të saj. Edhe kur është ndjerë nevoja për kthina të reja, në përgjithësi, është synuar që ato të sajohen brenda volumit ekzistues, ose me shtesa përngjitur këtij volumi. Vetëm në raste të kufizuara nga familjet e mëdha, e sidomos nga familjet me gjendje të mirë ekonomike, është kaluar në ndërtime banimi të shkëputura nga volumi fillestar i banesës.

Ndërtimet brenda oborrit vihen në raport të tillë me njëri-tjetrin, që të mos pengojnë rrjedhshmërinë e lëvizjeve e të mos spostojnë rolin e elementit kryesor në oborr. Këtij qëllimi i nënshtrohen edhe hyrjet e daljet, prandaj në çdo rast lexohet një trajtim i diferencuar arkitektonik i elementeve formuese, lidhur gjithnjë me funksionet që kryejnë. Në varë me këtë trajtim të diferencuar, vërehen zakonisht edh dy duar ndërtuese. Banesën e ka realizuar mjeshtr kurse ndërtimet e tjera vetë fshatari. Duke u ndalu te ndërtimet në oborr, qëllimet funksionale e rapo tet ndërmjet tyre, për vetë mënyrën e jetesës në fsha edhe hapësira e oborrit luante rolin e saj. Ajo përshtatej jo vetëm nevojave të përditshme, por sido mos nevojave sipas stinëve, në përputhje me piku e punëve të shumta e të njohura për kompleksin tyre brenda një ekonomie thuajse të mbyllur. Duk vënë theksin në disa aspekte të karakterit e të arritjev

të oborrit të banesës, nuk mund të pohojmë se ato kanë qenë të pranishme në të gjitha shtresat e fshatarësisë. Madje, vetë bashkëjetesa e zgjidhjeve të shkallëzuara shpreh pa mëdyshje praninë e këtij shtresëzimi edhe në këto zona të thella malore. Prandaj, me gjithë arritjet, karakteri ekstensiv i ekonomisë, që kishte si pasojë rendimentet e dobëta, i pleksur me një varg faktorësh të tjerë, kanë bërë që oborri i banesës në këto zona të jetë i kursyer në sipërfaqe, në repertorin e elementeve që e formojnë dhe në arritjet në përgjithësi.

Këto dukuri nuk përbëjnë një fenomen të izoluar, që takohet edhe në zona të tjera malore të vendit tonë, me natyrë ekonomike e mënyrë jetese të njëjtë me atë të zonave që shqyrtuam. Nëse për banesën fshatare është bërë e po bëhet një punë me të vërtetë e lavdërueshme edhe në mbrojtjen dhe restaurimin e saj, ky pohim jo gjithnjë ka vend për mjedisin ku ajo është ndërtuar. Pa mohuar edhe vështirësitë e karakterit objektiv, mendojmë se rritja e kujdesit edhe në këtë drejtim do të sillte veç të mira në ruajtjen sa më të plotë të thesarit të arkitekturës sonë popullore.

DO NOT COPY

Ali MUKA

DO NOT COPY

LA COUR DE L'HABITATION RURALE DANS QUELQUES REGIONS MONTAGNEUSES DE L'ALBANIE CENTRALE (XIX-XX sc.)

RESUME

Cette communication fait un bref exposé sur le caractère et les traits de la cour de l'habitation dans les régions montagneuses de l'Albanie Centrale, écrit sur la base du matériel étudié sur place au cours des expéditions de recherche d'étude effectuées par l'auteur lui même. L'auteur concentre l'attention au XIXe sc. et aux premières décennies du XXe sc. parce que le matériel qui se rapporte à cette époque permet un traitement sûr du phénomène. Voilà quelques aspects du caractère de la cour de l'habitation traités par cette communication.

1. La cour et le complexe de constructions qui s'y trouve, ont joué des fonctions d'habitation et en même temps des fonctions auxiliaires et économiques. Le programme des exigences envers la cour est réalisé conforme aux moyens réels de la famille. Cela met en relief aussi l'existence des couches sociales, la nature de l'économie et le degré de son évolution.

1. La cour appartient à une seule famille. D'habitude on y trouve: l'habitation la cabane, le puit à eau potable, et les coins en forme de tente servant à de différents besoins.

2. L'habitation, qui occupe la place principale dans la composition de la cour, par les fonctions qu'elle accomplit, constitue en même temps son noyau principal. C'est une construction à caractère solide, qui représente la meilleure réalisation architectonique de la composition de la cour. Toutes les autres constructions qui s'y rattachent se mettent à son service. Toutes ces constructions, de n'importe quel caractère ou fonction, se mettent à un certain rapport l'un à l'autre, afin de ne pas empêcher les mouvements et de ne déplacer le rôle de l'élément principal. Dans la cour on marque un traitement différencié architectonique des éléme constituants qui est toujours lié à leur destination. On ren que aussi que ces éléments ne sont pas réalisés par mêmes constructeurs. En général l'habitation est constr par le maçon tandis que les autres éléments auxiliaires par paysan lui-même.

3) Le caractère utilitaire prédomine dans la phisionor et la composition de la cour. On tient toujours à l'idée que c que construction doit accomplir plus qu'une fonction, pern nente ou de caractère saisonnier. Le meilleur exemple en l'habitation construite en étages qui est aménagée selon fonctions. Le mode de vie et le caractère extensif de l'économ dictait un espace de cour convenable non seulement c besoins quotidiens mais aussi à ceux saisonniers. Mais, cause de ce caractère extensif, quelques activités se réalisaie à l'extérieur de la cour (les parcs à moutons d'été ou d'hiv les aires, le potager etc.).

4) Dans ces régions montagneuses, sans un remarquab évolution économique, le matériel apporté témoigne d'une c versité de solutions. Elles ne constituent pas un phénomè isolé par rapport à tout le pays. La présence des mêm conceptions dans l'organisation de l'espace de l'habitation, est temoin.

Cette réalité exige une meilleure attitude envers la cou quant à son étude à sa conservation et à sa restauration.

Izmini HAXHIU

DO NOT COPY

BANESAT HISTORIKE VATRA TË RËNDËSISHME GJATË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE DHE VEPRIMTARISË REVOLUCIONARE TË SH. ENVER HOXHA

Në kompleks të monumenteve të kulturës shqiptare, si një kategori e veçantë, bëjnë pjesë banesat që përjetësojnë luftën shekullore të popullit tonë për liri e pavarësi, figurat e shquara që ai ka nxjerrë gjatë historisë së tij të lavdishme. Këtu grupohen edhe bazat e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në të cilat jetoi e punoi udhëheqësi i madh i popullit e i Partisë shoku Enver Hoxha.

Këto dëshmi të prekshme të historisë sonë, marrin një vlerë të veçantë, në kuadrin e krejt trashëgimisë sonë të kulturës materiale, jo vetëm sepse janë të lidhura me ngjarje e figura të shquara, por edhe sepse një pjesë e këtyre monumenteve ruajnë vlera arkitektonike duke pasur kështu vlera të dyfishta. Në tërësinë e kësaj trashëgimie, për të cilën tek ne tregohet një përkujdesje e veçantë, shquajnë monumentet (fig. 1) që lidhen me figurën e udhëheqësit të paharruar të Partisë e të popullit tonë shokut Enver Hoxha. Ato i gjejmë kudo në vendin tonë: në malësi, fshatra (fig. 2) dhe qytete, (fig. 3, 4) në të katër skajet e atdheut, sepse udhëheqësi ynë i shtrenjtë gjendej gjithmonë pranë popullit, në ato vite të stuhishme të Luftës heroike.

Shoku Enver i ka vlerësuar gjithmonë këto shtëpi të thjeshta të popullit. Ai është ndalur e i ka përshkruar ato me dashuri në kujtimet e veta. Në ditët e vështira po heroike të Luftës sonë Antifashiste, – thotë shoku Enver në librin «Mes njerëzve të thjeshtë», – shtëpitë e thjeshta të popullit ishin bazat tona, ishin vendet tona të punës, të strehimit, të shtypit ilegal, ishin spitale për shokët e plagosur. Njerëzit e thjeshtë të këtyre shtëpive të varfëra u bënë një me ne, djemtë komunistë, që i kishin vënë qëllim vetes çështjen e madhe të Çlirimit të atdheut. Bazat e Luftës ku punoi shoku Enver janë evidentuar dhe njihen plotësisht. Shumë prej këtyre banesave ruhen mjaft mirë, ndërsa



Fig. 1



Fig. 2



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

disa vetëm pjesërisht, sepse janë rrënuar gjatë Luftës ose janë transformuar gjatë kohës. Këto transformime kanë të bëjnë me ndryshime kompozicionale ose me humbjen e elementeve të ndryshme arkitekturore. Kjo pasuri kulturore, për vlerat dhe gjendjen në të cilën ndodhej monumenti në kohën e vënies në mbrojtje, kërkonte një përkujdesje të veçantë, e cila përfshihej brenda kritereve të njohura të restaurimit të monumenteve.

Për restaurimin e banesave ku ka zhvilluar veprimtarinë shoku Enver Hoxha gjatë Luftës Antifashiste nacionalçlirimtare jemi udhëhequr nga këto kritere kryesore metodike:

– Secila bazë e shokut Enver lidhet me ngjarje të shënuar për jetën e Partisë, për zhvillimin e Luftës Antifashiste nacionalçlirimtare dhe të ardhmen e vendit tonë. Për këtë arsye ato mbeten sot e përgjithmonë dokumente autentike për këtë periudhë të shquar të historisë sonë. Duke mbajtur parasysh këto vlera, ndërhyrja restauruese në këto monumente shpie deri në kufij të skajmë të kërkesës për ruajtjen e mjedisit dhe elementeve origjinale të monumentit, pra të autentitetit të veprës.

– Si vatra të edukimit komunist të masave, bazat e shokut Enver janë kthyer në muze.

– Edhe bazat e Luftës ku punoi shoku Enver i nënshtrohen kritereve të përgjithshme të restaurimit të monumenteve të arkitekturës. Veçoria e tyre, ashtu si e mbarë monumenteve historike qëndron në respektimin e fazës, apo gjendjes që lidhet me momentin historik, pra në rastin e dhënë me periudhën kur në të ka punuar dhe jetuar shoku Enver.

– Bazat e shokut Enver nuk qëndrojnë jashtë kontekstit urban, por shihen në lidhje të ndërsjel me ndërtesat e tjera që përbëjnë mjedisin histo të tyre, nga mungesa e të cilave do të humbiste ku timi i një baze ilegale. Kjo ka kërkuar që shpe bazat e shokut Enver të shihen si pjesë e zonc ose ansambleve qytetare dhe t'u nënshtrohen kri reve të restaurimit të tyre.

– Vlerat e veçanta edukuese të këtyre mor menteve bëjnë të pranueshme rindërtimin e tyre n bazën e dokumentacionit. Në këto raste, në cilësi e të dhënave të vlefshme për rindërtimin, një rënd të dorës së parë marrin kujtimet e bashkëkohësve, cilat për largësinë e vogël kohore kanë vërtetësinë dokumentit.

Gjurmimi dhe dokumentimi i bazave të shol Enver Hoxha, në të katër anët e vendit, u shoqër me një veprimtari të gjerë studimore, për të arri në fazën në të cilën gjendej monumenti në kohën k zhvilloi veprimtari shoku Enver. Gjurmët materia fotografitë, kujtimet e vetë shokut Enver, ato të nj rëzve të thjeshtë, që jetonin në këto banesa, si d ato të bashkëluftëtarëve, dhanë shpejt atë që kërk hej, të dhëna të plota për restaurimin e këtyre m numenteve mbi bazën e kritereve të parashtruara.

Mbi bazën e këtyre të dhënave dhe projekte përkatëse janë bërë punime sistematike për restau min dhe kthimin në muze të tyre. Sot numërohen monumente që lidhen me veprën e shokut Env gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të cilat kthyera në muze janë shndërruar në qendra të vërt ta të edukimit patriotik revolucionar të masave to punonjëse sidomos të brezit të ri të cilët jetoj aty çaste të paharruara emocionante që lidhen r jetën dhe veprën e pavdekshme të shokut Enver.

Izmini HAXHIU

FOYERS IMPORTANTS PENDANT LA LUTTE DE LIBERATION NATIONALE ET L'ACTIVITE REVOLUTIONNAIRE DU CAMARADE ENVER HOXHA

RESUME

Dans l'ensemble des monuments culturels albanais fait partie une catégorie particulière de constructions qui commémorent la lutte séculaire de notre peuple pour la liberté et l'indépendance, des constructions qui se rattachent à la fondation du Parti ou aux hommes renommés qui émanèrent du sein du peuple au cours de l'histoire. Dans ce groupe font partie aussi les bases où vit et déploya son activité révolutionnaire pendant la lutte de Libération Nationale le grand dirigeant du Parti et du peuple, le camarade Enver Hoxha. Ces bases se trouvent partout dans le territoire de notre pays dans les pays montagneux, dans les villages et dans les villes partout où la guerre et le travail exigeaient notre guide pour diriger notre Parti à la lutte partisane de libération.

La restauration de ces monuments tient à quelques importantes exigences.

1) Chacune des bases où le camarade Enver Hoxha déploya son activité, matérialise un événement marqué de la vie du Parti, de la lutte de Libération Nationale et de l'avenir communiste de notre pays. Telles quelles, elles demeurent à l'heure actuelle des documents authentiques de l'histoire de l'Albanie. Donc, l'intervention de restauration s'effectue rigoureusement toujours en conservant le matériel original.

2) En tant que centres d'éducation communiste des travailleurs, ces constructions devenues musées ont besoin de quelques petites transformations fonctionnelles et représentatives. Ces interventions n'altèrent pas la valeur ethnographique des monuments, elles s'adaptent aux intérieures desquels elles se distinguent nettement.

3) Chacune de ces bases représente un modèle architectonique compris dans la typologie de l'habitation urbaine ou rurale, donc elle se soumet à une étude de restauration selon les critères définis pour le genre des habitations populaires. La différenciation des phases de construction s'arrête au moment historique puisque les adjonctions et les modifications ultérieures sont réalisés au cours de la Lutte de Libération Nationale afin de servir au travail illégal.

4) Ces constructions ne demeurent pas en dehors du contexte urbain, elles se voient en corrélation avec les autres constructions sans lesquelles elles auraient perdues le sens d'une base clandestine. Cela exige que ces bases clandestines se considèrent en tant que partie des zones ou des ensembles urbains et qu'elles se soumettent aux critères de restauration de l'urbanisme.

5) Quant aux bases historiques endommagées ou ruinées par la guerre, on permet leur reconstruction architectonique basée sur une documentation complète. Dans ce cas, l'intérieur du musée peut être plus complet et plus motivé par les exigences contemporaines.

Sur ces principes et critères, on a pu restaurer et convertir en musée 30 bases où le camarade Enver Hoxha déploya son activité révolutionnaire au cours de la Lutte de Libération Nationale.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Kliti KALLAMATA

MBI RESTAURIMIN E PAZARIT TË KORÇËS

Ndonëse pazari i Korçës ka filluar të ekzistojë qysh në fund të shek. XV, apo në fillim të shek. XVI, pamjen e tij, siç e shohim sot, nisi ta marrë mbas gjysmës së parë të shek. XIX. Futja e koncepteve të reja në urbanistikën dhe arkitekturën e pazarit u krye në kuadrin e përgjithshëm të zhvillimit të qytetit të Korçës, të ndihmuar dhe nga pozicioni i ndërtimit të tij jashtë lagjeve të banuara të qytetit. Ky pazar dallohet për një përputhje të zonimit funksional me një strukturë të përparuar urbanistike për kohën. Njësitë prodhuese e tregtare që janë kompozuar sipas skemës së rrjetit drejtkëndor, qarkohen nga një gjysmunazë e formuar nga ndërtimet për pushim e çlodhje. Këto arritje në urbanistikë janë shoqëruar me trajtime të pasura në arkitekturë e dekoracion, që e bëjnë pazarin e Korçës të dallohet në mënyrë të ndjeshme nga pazaret e Krujës, Gjakovës, Shkodrës, Kavajës, Gjirokastrës etj. Për këto veçori historike urbanistike e arkitektonike, në vitin 1971, ky ansambël u vu në mbrojtje shtetërore. Që nga kjo kohë janë ndërmarrë studime të shumta, të cilat ndihmuan në orientimin, përcaktimin e vlerave dhe ndërhyrjeve restauruese për çdo njësi. Këto çuan në ndarjen e kësaj qendre në dy zona. (Fig. 1). Ajo që ruante ndërtimet më me vlerë u cilësuan «zonë – muze», ndërsa rreth saj u konturua një «zonë e mbrojtur». Zona – muze e pazarit formohet nga 19 blloqe dyqanesh në pjesën qendrore të tij, të cilat rrethohen nga 30 dyqane dhe 8 hane të vendosura në formë gjysmërrethi. Blloqet e dyqaneve përgjithësisht janë të plota, me përjashtim të disave prej tyre ku mungon ndonjë njësi që prish formën e rregullt të planimetrisë. Gjendja konstruktive paraqitet e mirë, por keqpërdorimi për një kohë të gjatë ka dëmtuar elemente të ndryshme, si në pamjet e jashtme, ashtu dhe në ato të brendshme.

Ndryshe ishte gjendja e haneve, 4 prej të cilave paraqisnin rrezikshmëri për shkak të degradimit të tepërt të konstruksioneve prej druri. Me sa duket me konstruksion druri duhet të kenë qenë ndërtuar edhe disa njësi në këtë varg gjysmërrethor, të cilat janë shkatërruar krejtësisht duke lënë vende bosh midis 30 dyqaneve, të cilët paraqiten mjaft mirë nga ana konstruktive.

Zona e mbrojtur ka ndërtime të ndryshme, shumë prej të cilave janë përdhese, të rëndomta dhe pa vlera të rëndësishme. Megjithatë nga pikëpamja historike ato dokumentojnë lidhjen që ka pasur pazari me qytetin, duke mos qenë këto njësi krejtësisht të shkëputura nga njëra-tjetra. Këtu ngrihen edhe disa banesa të tipit të njohur korçar, të ndërtuara në fillim të shekullit tonë. Kjo zonë nuk është e lidhur mirë me arteriet kryesore të qytetit dhe lejon kalim të automjeteve nëpër pazar, gjë që shkakton disa herë dridhje të konsiderueshme në ndërtesat me ndotje të mjedisit. Gjithashtu, instalimet elektrike e telefonike janë ajrore duke dëmtuar pamjen e ndërtimeve të pazarit dhe krijimin e vështirësive gjatë restaurimit të tyre (Fig. 2). Duke e konsideruar zonën e pazarit si pjesë përbërëse të qytetit të Korçës dhe duke marrë parasysh vlerat historike – arkitektonike të tij, u synua që ky ansambël të rigjallërohej dhe të mos mbetej një relikt pasiv. Kjo kërkonte integrimin e tij në jetën e sotme ekonomike, shoqërore e shpirtërore, dhe natyrisht, integrimin në planin e përgjithshëm urbanistik të qytetit. Në zonën e mbrojtur shumë ndërtime ishin dëmtuar, madje rëndë, në vlerat e tyre. Kjo krijonte mundësinë për sistemimin e sipërfaqes përreth «zonës – muze», duke lënë ato banesa dhe ndërtime që mund të rifitonin vlerat e tyre të dikurshme dhe duke krijuar sipërfaqe të gjelbëra. Kështu lidhja e zonës – muze me qytetin e sotëm arrihej mirë. Ndalimi i trafikut të rëndë brenda zonës – muze lindi nevojën e zgjerimit të rrugëve përreth zonës së mbrojtur dhe lidhjen e tyre me arteriet kryesore të qytetit. Në këtë mënyrë i gjithë ansambli do të qar-



Fig. 1



Fig. 2

kohet nga rrugë, të cilat do të krijojnë lehtësi qarkullimi për kalimin e automjeteve, pa qenë e nevojshme të futen në zonën – muze. Gjithashtu, për një integrim më të kujdesshëm nga ana urbanistike, është e nevojshme që ndërtimet, të cilat do të bëhen rreth tij, të harmonizohen me të, për të ruajtur atmosferën dhe për të krijuar një mjedis unik. Duke u bazuar në motivet e këtij veprimi planizues, qëllimi i të cilit është jo vetëm zbukurimi i këtij rajoni të qytetit, por edhe krijimi i një ansambli që të jetë i qëndrueshëm, me perspektivë, u hartua një plan i shfrytëzimit të ardhshëm të pazarit, për ta rigjallëruar atë, duke i dhënë një bazë të re jetësore. Rigjallërimi i pazarit duhej bërë duke ruajtur karakterin e ansamblit dhe funksionet e vjetra, por duke shtuar edhe funksione të reja, të cilat nuk ia tjetërsojnë këtë karakter. Gjatë hartimit të këtij plani duhej përcaktuar se si dhe në çfarë mase këto dyqane janë të përshtatshme për këtë apo atë nevojë të jetës së përditshme, duke



Fig. 3

DO NOT COPY

pasur parasysh edhe kërkesat e ardhshme praktike e estetike. U mendua që pjesa qëndrore e pazarit të shërbejë për tregtinë dhe shërbimet në popull, duke futur mjeshtëritë tradicionale që vazhdojnë të ruhen ende, si p.sh.: këpucar, rrobaqepës, teneqexhinj, argjendarë, araçë etj. Edhe njësitë për tregtinë do të jenë të llojeve të ndryshme, si ato për stofra, veshje, prodhime artistike, orendi shtëpiake, kinkaleri etj. Nuk do të mungojnë edhe lokalet e ushqimit sociol si restorante, rostiçeri, mëngjesore, pastiçeri etj. Njësitë në pjesën veriore të kësaj zone shërbimi u caktuan të përdoren për kompleksin e kulturës popullore të rrethit, ku do të prezantohen edhe vlerat e veprimtarive prodhuese të këtij ansambli. Këtu bëjnë pjesë: Hani i Elbasanit, si Hotel-restorant karakteristik, Hani i Manastirit si Ekspozitë e kulturës popullore (fig. 3) dhe vargu i dyqaneve në shërbim të këtij kompleksi.

Ndër funksionet e reja që mendohen të futen në pazar, janë dhe adaptimet për studio artistësh (piktorë, skulptorë, arkitektë, muzikantë, etj) të disa blloqeve në krahun jugor të ansamblit. Në këtë mënyrë do të krijohet një «mikrolagje» krijuesisht, në qendër të së cilës do të jetë një sallë për ekspozita të ndryshme sezonale, apo për koncerte dhome. Pjesa tjetër e dyqaneve, për njëfarë kohe, u la të përdoren si zyra të ndërmarrjeve e institucioneve të ndryshme. Të gjitha këto studime u kryen me qëllim që ndërhyrjet restauruese të ishin të orientuara dhe të gjykuara mirë. Ishte e natyrshme që në një ansambël të tillë kërkesat për restaurim të ishin shumë të ndryshme. Ato renditen nga qëndrimi shumë rigoroz për të ruajtur tiparet dhe elementet e ndryshme të arkitekturës e deri te çlirimi nga ndërtimet e vona, që nuk kanë respektuar vlerat e ansamblit. Për sa u përket punimeve restauruese, dallohen dy lloje apo grupe ndërhyrjesh:

I pari ka të bëjë me ripërtëritjen e godinave duke zbatuar kriteret rigoroze të restaurimit për çdo njësi. Punimet kanë kryesisht karakterin e ripërtëritjes së pamjeve të jashtme e të brendshme, duke ruajtur dhe restauruar çdo element arkitektonik. Për të realizuar kërkesat funksionale, në ndonjë rast, janë bërë ndryshime të brendshme për bashkimin e disa njësive në katet e poshtme, apo të sipërme. Kështu p.sh. dyqanet 1, 2, 3 janë të veçanta, por në kuadrin e kompleksit të kulturës popullore këto lidhen me njëra-tjetrën për të lehtësuar lëvizjen e vizitorëve. Ose, në njësitë e tjera, ku nuk ka podrume, mund të ndërtohen shtresa të forta betoni për makineritë e ndryshme, apo të bëhen punime të tjera, por gjithnjë duke mos cënuar vlerat e strukturave të brendshme dhe duke paracaktuar dyqanet e përshtatshme për funksionet që nevojiten. Vështirësitë në këtë drejtim nuk janë të mëdha dhe problemet që dalin janë më tepër çështje kompetence, kujdesi dhe cilësie teknike në punë. Në restaurimin e zonës – muze, një vëmendje të veçantë kërkon zgjidhja e problemeve teknike, siç janë ato të kanalizimeve, linjave elektrike e telefonike, ngrohja etj, të cilat detyrimisht duhet të jenë të gjitha nëntokësore. Kjo do të kërkojë një punë të kujdesshme për zbatimin e tyre dhe për riparimin e rrugëve me kalldrëm dhe trotuare karakteristike.

Në ndërhyrjet e llojit të dytë, problemet që shtrohen për t'u zgjidhur kanë të bëjnë me punime çliruese, për të vlerësuar të gjithë ansamblin. Këto veprime do të kryhen kryesisht në «zonën e mbrojtur» dhe rrallë në «zonën – muze», siç qe prishja e ndërtesës së vonë në mes të sheshit «Liria». Kjo u bë me qëllim që të rikrijohet përsëri tregu i hapur i dikurshëm dhe të dalin në pah vlerat e dyqaneve përreth tij.

Së fundi, një çështje me rëndësi është mënyra se si do të trajtohen njësitë që mungojnë. Disa mënyra janë në diskutim e sipër. Ekziston mendimi për të mos kryer asnjë ndërtim në këto vende bosh, veç sistemimit të tyre ashtu siç janë. Kjo mund të gjejë zbatimin në disa blloqe, por mund të dëmtojë disa të tjera. Prandaj ekziston edhe mendimi tjetër, i cili është për plotësimin e vendeve bosh me njësi të tjera të reja, që të harmonizohen me arkitekturën e bllokut dhe të ansamblit. Çështja e ndërtimeve të reja brenda zonës – muze është një problem delikat që qëndron ende i hapur dhe kërkon vlerësime kolektive të peshuara.

Studimet e përgjithshme për restaurimin e pazarit të Korçës janë hartuar dhe miratuar në instancat përkatëse prej disa vjetësh. Ky ansambël i restauruar do të përbëjë një dëshmi me vlera të rëndësishme në trashëgiminë tonë urbanistike – arkitektonike.

DOKTORATURA

Kliti KALLAMATA

DO NOT COPY

SUR LA RESTAURATION DU BAZAR DE KORÇA

RESUME

Mis sous protection de l'Etat pour ses valeurs, le bazar de Korça, se distingue par la structure urbaine avancée par rapport à l'époque et la valeur particulière de son organisation fonctionnelle. Les unités de production et commerciales qui ont été composées suivant le schéma du réseau quadrangulaire, sont entourés d'un demi-anneau formé par les constructions conçues pour repos. Le traitement architectonique de l'ensemble se distingue par la solution fonctionnelle et par la riche décoration, en lui réservant une place particulière dans l'héritage de ce genre.

Selon les valeurs que représente, le bazar de Korça se divise en «zone musée» et «zone protégée». Prenant en considération les valeurs historiques et architectoniques de cet ensemble on a visé à ce qu'il se réanime. Ceci impose son intégration dans la vie quotidienne économique et sociale, naturellement dans le plan urbain. Dans la zone protégée, vu sa valeur double en tant que partie de l'ensemble et point de liaison avec la nouvelle ville, dans un grand nombre d'unités endommagées on a pensé effectuer des travaux de restauration aux constructions de valeurs, et créer des surfaces vertes. Le réseau routier tout autour de cette zone sera élargi parce que dans la zone musée il sera interdit la circulation des poids lourds. Les nouvelles constructions tout autour de l'ense au point de vue de dimensions et traitement doivent s'harmo avec les anciennes.

La perspective des interventions a été rendu plus f par un plan détaillé concernant les futures fonctions de ensemble après la restauration. On a jugé convenables de les fonctions comme artisanat traditionnel, locaux de ser musée de la culture populaire, adaptations pour studios créateurs etc.

De pair aux interventions originales, on a prévu égalen quelques interventions de débarrassement de construct sans valeur et plus tardives qui lui nuisent. Quant à l'attit envers les constructions ruinées, dans de différentes parties l'ensemble, il a été préconsenti la protection de la situa existante sans exclure quelques interventions complémentai toujours après de motivations convaincantes.

Les études générales pour la restauration du bazar Korça, ont été rédigées et approuvées par les instances pectives et depuis des années, sur une base d'études partiel continue le travail pour la restauration et la réanimation cet ensemble de valeurs importantes.

monumentet

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

TIPARET E ZBUKURIMORES NGA SHEK. XVII DERI NË FILLIM TË SHEK. XX NË SHQIPËRI

Zbukurimet që i përkasin shek. XVII janë të pakëta. Ato i hasim në disa ndërtesa kulti e hamame të realizuara me teknikën e stuk reliefit dhe gdhendjes.

Përkundrazi, dëshmitë e zbukurimores gjatë shek. XVIII vijnë duke u shtuar dhe na paraqiten madje me tipare lokale në qytete të ndryshme të vendit tonë. Gjatë shek. XVIII në Shkodër tavanet u pikturuan me motive yllore ose diellore, të pasuruara me pano të blerta, të mbuluara prej trëndafilash të kuq e zambakësh të bardhë, rozetat u punuan në trajtë ylli me vijëza dyfish të ndërprera, raftet e murit u pajisën me flegra që paraqisnin vazo me lule në trajtë kryedemi dhe kamare me lajle zambakësh (fig. 1).

Tymtarët u plazmuan me daulle gjysmëcilindrike e shatore gjysmëkonike me kufiza të luhatura, mbi të cilat u modeluan hëna, dielli, ditët e javës e të 12 muajt. Në qytetin e Beratit tavanet u veshën me lajle gjethesh të gjera të okërta mbi fusha të blerta, të mbuluara me lulëkuqe e zambakë dhe muret u pikturuan me pano vezake të stolisura prej drethkash që rrethojnë peizazhe, ose kompozime katrore me tufëza lulesh e spiralesh. Raftet u punuan me flegra të thonjëzuara dhe kamare të gardhuara në trajtë rombi. Ndërsa tymtarët nga fundi i shek. XVIII e fillimi i shek. XIX u modeluan me ballorë prizmatikë e shatore gjysmëkonike. Gjirokastra u zbukurua me brendi të spikatura, ku u kryen tavane të pikturuara dhe pano murore të ngjashme me ato të Beratit (fig. 2). Raftet e thjeshta u pajisën me gardhime të rombuara. Tymtarët me ballorë prizmatikë dhe shatore gjysmëkonike u kompozuan në mënyrë të veçantë me pemë e perime si natyra të gjalla në krye të shatores.

Në qytetin e Tiranës nga zbukurimorja vlejnë të përmenden panotë e pikturuara me drethka të shkathëta të xhamive të Sulejman Pashës, të Haxhi Ethem Beut, të afërta me xhamitë e Kavajës e Peqinit, të punuara nga mjeshtri Zaim Kurti prej Ostrenit të Madh, në fillim të shek. XIX, si dhe shtyllat me krejsa të skalitura të Xhamisë së Ethem Beut dhe Tyrbes së Kapllan Pashës, që janë punuar prej Hasan Burgut të Vjetër (fig. 3), një mjeshtër nga Ternova e Zerqanit, me origjinë matjane.



Fig. 1

Në Krujë u pikturuan disa brendi dhe teqe prej mjeshtërve të familjeve Muça dhe Kurti, nga Ostreni i Madh, ndërsa në Elbasan, zbukurimet në stuk të mureve në dy hamame që paraqesin simbole diellore



Fig. 2

i përkasin shek. XVII. Nga fillimi i shek. XIX pas reformave që vuri në zbatim Perandoria Osmane, me anë të të cilave kufizonte sipërmarrjet private, duke shtetëzuar shumë prej tyre, mjeshtrit shqiptarë vendosën të ktheheshin në atdhe, ku gjetën kushte të favorshme për ndërtime banesash me brendi të zbu-



Fig. 3

kuruara në shumë qytete të Shqipërisë. Midis ishte dhe mjeshtri i shquar Jashar Xhafa prej S shti, i cili kreu disa brendi me vlerë në qytetin e Sh drës, si dhe tavanin yllor me rozetë prej rrathësh shkëqendrorë të një banese në rrugën «Musa L Në këndet dhe trekëndëshat e fushës ai zbatoi k pozime drethkash helike. Këtë tavan më vonë e turoi Gaspër Piktori. Raftet, trapazanët e musan e Shkodrës, gjatë shek. XIX, u pajisën me harqe luhatura dhe drethka të shkathëta, ndër të cilat het trapazani i muzeut, i gdhendur nga mjeshtri Haxhiu prej Sebishti. Dyert u mbërthyen me cop në trajtë svastike. Tymtarët u kompozuan me l qerthuj, helika shtjellëse në të dy anët e shat tri – deri pesëllampëshe, të rrethuara prej kurorës luhatur barroke. Ballori prizmatik u modelua bisqe të drejta prej Zef Arsenit. Në të dy anët u v dosën shtyllëza me kandilore e dy kamare, ndërsa pjesën e poshtme të ballorit u sajua flaka e pash Tymtarë të tillë punuan Mehmet Metani e Rama Dibra, Hasë Burgu, Ramë Selimi e Mahmut Metan

Në qytetin e Krujës disa mjeshtër të talent okshtunas si Osman e Sali Sallaku gdhendën br dinë e banesës së Topçinjve. Banesa e Belegëve pikturuar me pano që në fillim të shek. XIX, u p tësua me zbukurimet e gdhendura të musandrës tavanit. Tymtari i saj i pikturuar si panotë u mode me ballë të valëzuar e kurorë barroke tipike (fig.

Tirana e shek. XIX u stolis me brendi të shqu në stuk reliev e gdhendje prej mjeshtërve Osm Sallaku e Myftar Burgu. Tavanet e dy banesave Rrugën e Barrikadave dhe kalanë e qytetit, ve të mjeshtër Osmanit, paraqesin kompozim vezak lesh me gjethe lisi (fig. 5). Ndërsa në një banesë tër të kalasë, usta Myftar Burgu ka gdhendur bre të shkëlqyera. Tavani i njërës nga dhomat përshko prej trëndafilash. Tymtarët në Tiranë paraqiten ballorë prizmatikë e shatore të mbështetura mbi kuf rrethore në mënyrën e mjeshtërve që ndërtuan E ratin, ose plazmohen me ballorë gjysmëcilindrikë, kufizë barroke të luhatur e shatore të zbukuruara në një banesë të rrugës «Tefta Tashko»

Mjeshtri i përmendur, Hasan Teta nga Zabzu gdhendi disa tavane në Elbasan gjatë shek. XIX, cilat i sajoi në trajtë ylli me drethka të imëta si pa të qëndisura, ku përjetohen motivet popullore të h likës e svastikës. Tymtarët e këtij qyteti, me ballo gjysmëcilindrikë dhe lule që dridhen mbi tel të luh tur, janë tipike të mjeshtrit Sulë Boriçi. Gjatë she XIX zbukurimorja e Beratit u krye prej mjeshtër ardhur nga Dibra, Kolonja, Opari dhe Tomorri. Du u bindur për karakterin vendas të Shqipërisë Jugo të banesës së Berdunit në lagjen «13 Shtatori» (Ma

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

galem), po vemë në dukje brendinë e saj, ku shihet tavani i pajisur me rozetë tetëkëndore të thelluar me faqe të zbukuruara, raftet e daltuara me kamare barroke dhe tymtarin prizmatik të derdhur në mënyrë të përkryer, në spreth të luhatur rrethor e të përshkuar prej bisqesh mbi shatoren gjysmëkonike (fig. 6), vepër e Leonidha Pulliqit, nga Karbanjozi i Oparit. Një familje ndërtuesish hormovitë, të udhëhequr nga Niko Bashari, u vendos në Gjirokastër nga fillimi i shek. XIX, ku kreu shumicën e daltimeve në brendinë e qytetit. Njera nga më të shquarat ndodhet në banesën e Çabejve në Hasmurat. Tavani, me fushë të ndarë së gjati, mban trekëndësha të daltuar me zogj e tufa gjethesh, ndërsa rozeta yllore me tetë cepa paraqet drethka të ngathëta si shqiponja ndër anët, ndërsa musandra e ndërtuar ndën harkun në trajtë zemre, si në qytetin e Beratit e në krahinën e Kolonjës, është vepër e mjeshtrit Gjikë Bashari, i cili ka punuar dhe disa tavane.

Tymtarët në këtë kohë plazmohen me ballorë gjysmëcilindrikë, harkluhatur dhe shatore gjysmëkonike të qarkuara prej drethkash. Trapazanët ngrihen më lart se në qytetet e tjera të Shqipërisë, porse lozha teatri me harqe të zbukuruara si në banesën e Skëndulajve. Në ndërtesat e kultit zbukurimorja, nga karakteri i saj i thjeshtë me gjarpërime të thonjëzuara, si në kishën e Shën Mëhillit të Shalësit e shek. XVII, kaloi në trajtën e hardhisë, petashuqe dhe kurorave me zambakë të kishës së Shën Kollit, po aty dhe të kishave të Shën Mërisë e Shën Thanasit në Voskopojë të shek. XVIII. Në këto kisha u gjetën motive pavodash eukaristike, zogj fazanë, krerë demi (bukranione) me kryq mes brirësh, si në kohët homerike, kur demave u vendosnin sëpata dyprerëse ose he-

shta të kryqëzuara midis brirësh. Sipas mbishkrimit, këto vepra u takojnë disa mjeshtërve kosturiotë. Gjatë shek. XIX ikonobartësit u pasuruan me kompozime madhështore drethkash, në mes të cilave u ripërtërinë motive skenash mitologjike. Mjeshtri i madh, Dhimitri nga Konica, daltoi disa korabartës në Vithkuq, Korçë, Përmet, Labovë të Kryqit, Shën Mitër të Peshkopisë dhe në Shqipërinë e Mesme, sipas një teknike të kryer, me dritë – hije të theksuara, si në Manastirin e Ardenicës ku punoi grupi i tij. Trigjethëshi i mjeshtrit, i ushtruar në triplane sajon kompozime të shkëlqyera rreth skenave biblike. Në gjurmët e tij u zhvilluan artistë të shquar, Nikolla nga Magarova e Manastirit, i cili daltoi në mënyrë të përkryer ikonobartësit e Lashovës, të Sopikut dhe Kondasit me gjethe të strëholluara së gjati të lisit cerr, Pjetër Filipi ng Reka, që gdhendi ikonobartësit e Shkupit, Bigor Lesnovës, Tetarpazarit dhe Elbasanit me gjethe d shku (fig. 7) dhe mjeshtër Thanasi nga Vakëfet e Ko çës autori i ikonombartësit të manastirit të Rilës. N kompozimet e tyre shihen lejlekë, kaproj, shqiponj që shqyejnë gjarpërinj si dhe vazo adonide me trë ndafila të egër dhe shqiponja dykrenare.

Në fillim të shek. XX zbukurimorja u zbatua m plotime të çimentuara mbi ballorët e ndërtesave q tetare, ku shihen trajta të reja kurriz gjarpëri dhe d fish spira të gjetëzuara, sidomos në qytetin e Tiranë si dhe gardhime të hekurta ballkonesh me disqe sp rale e dragonj në qytetin e Shkodrës, të Korçës e Durrësit.



Fig. 6



Fig. 7

DO NOT COPY

Fatbardha SHKUPI

DO NOT COPY

LES TRAITS DE LA DECORATION DU XVIIe SC. JUSQU'AU DEBUT DU XXe SC. EN ALBANIE

RESUME

Nos monuments sont riches en motifs décoratifs.

Du XVIIe sc. on ne conserve que quelques décors d'hammams tandis que les éléments décoratifs conservés du XVIIIe sc. sont plus nombreux et revêtent des traits locaux. A Shkodra on applique des plafonds décorés de motifs d'étoiles, les placards sont ornés de motifs symboliques tandis que les cheminées à tambour cylindriques sont décorées de lunes et d'étoiles.

A Berat, les plafonds et les panneaux des murs sont peints, les placards sont ornés et les cheminées en tambour prismatique.

Les habitations de Gjirokastra sont garnies de plafonds et de murs peints comme ceux de Berat. Les tambours prismatiques des cheminées sont modélés de fleurs et d'arbres sculptés.

A Tirana sont construites les mosqués d'Ethem Bey et de Sulejman Pacha, peintes par Zaim Kulti. Les chapiteaux des «hayats» et le turbé de Kapllan Pacha sont sculptés par Hasan Burgu.

Les peintures de la ville de Kruja se réalisèrent par les Trenovas.

La ville d'Elbasan conserve les plastiques des hammams avec des symboles solaires.

Au début du XIXe sc. après les réformes de Tanzimat, les maîtres albanais rentrèrent à leur patrie pour réaliser de belles oeuvres. A Shkodra, Jashar Xhafa originaire de Sebisht, construisit des plafonds en forme d'étoile, des rosaces rondes et des motifs d'hélice, qui sont peints par Gaspër le peintre.

Isuf Haxhi cisela le «trapazan» du musée, des plafonds et des portes. Les frontons sont travaillés par Zef Arsen, les foyers par Mehmet Metani, Ramadan Dibra, Hasë Burgu, Rame Selimi et Mehmet Metani.

Dans la ville de Kruja Osman et Sali Sallaku ciselèrent l'habitation des Topçij.

Les intérieurs des habitations de Tirana sont enrichis en bois et en stuc par les maîtres Sallaku et Myftar Burgu. Les foyers se présentent prismatiques et semi-cylindriques.

Les habitations de la ville d'Elbasan sont ornées de plafonds décorés d'étoiles et de foyers en couronnes.

A Gjirokastra, les maîtres Harmovit ciselèrent des rosaces à huit saillies, de hauts «trapazans» et des foyers circulaires.

Parmi les constructions de culte, la décoration en lignes tortueuses de l'église de Saint Michel de Shalës passa à la décoration en feuilles de vigne plates, à l'église de Saint Nicolas qui se trouve tout près, à celle de Notre Dame et de Saint Thanas à Voskopojë.

Au cours du XIXe sc. les iconostases furent enrichis de compositions mythologiques et de techniques particulières de rinceaux.

Les décorations sculptées des églises de Vithkuq, Korçe, Përmet, Labovë, Peshkopi e Poshtme sont réalisées par le maître Dhimitri, originaire de Konica.

Le maître Nikolla, originaire de Magarova, réalisa les décorations sculptées des églises de Lashovë, Sopik, Kondas.

Les décorations sculptées des églises de Shkupi, Biqari, Leshova, Tatarpazar, Elbasan, se réalisèrent par Pjetër Filipi, originaire de Reka.

Le maître Thanas, originaire du Vakëf de Korça sculpta les décorations de la principale église du Monastère de Rilë.

Cette riche tradition de la décoration albanaise se poursuit même à nos jours.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Servet DANI – Marita BECI

METODA E ANALIZËS SË VEPRAVE TË ARTIT NËPËRMJET RREZATIMIT X TË FLUORESHENCËS

Vlerësimi dhe ruajtja e veprave të artit, si detyrë sa e rëndësishme, aq dhe e ndërlikuar, kërkon për zgjidhjen e saj edhe ndihmën e teknikave dhe metodave të shkencave të tjera. Metodat fizike dhe kimike të analizës si: kolorimetria, kromatografia, spektrometria e absordimit atomik, difraksioni i rrezeve X etj, kanë gjetur përdorim të gjerë si për studimin, ashtu dhe për restaurimin e veprave të artit.

Ndër këto metoda, një vend të veçantë, zë analiza nëpërmjet rrezatimit X të fluoreshencës dhe sidomos varianti i saj me dispresion energjitik. Kjo metodë mbështet në ngacmimin e atomeve të elementeve përbërëse të materialit në studim, nëpërmjet rrezatimit X gama, me energji të ulët elektronike. Gjatë këtij procesi ngacmohen shtresat më të thella elektronike të atomeve, çka pasohet me lëshimin e rrezatimit X, karakteristik për çdo element. Rrezatimi X i sapolëshuar bie mbi një dedektor, ku kthehet në impulse elektrike. Këto impulse regjistrohen në sisteme elektronike të quajtura **analizatorë shumëkanalësh** dhe më tej ky informacion përpunohet në sisteme të ndryshme llogaritëse. Sipas llojit të rrezatimit të dedektuar, mund të thuhet menjëherë cilat janë elementet përbërëse të materialit, kurse intensitetet e këtyre rrezatimeve janë në drejtëpjestim me përmbajtjen e elementeve në material. Ndër epërsitë e kësaj metode përmendim:

– Mund të analizohen praktikisht të gjitha elementet (me përjashtim të atyre më të lehtave).

– Si rregull, analiza është shumë e shpejtë, pasi bëhet për disa dhjetëra sekonda.

– Kostoja e analizës është e ulët.

– Ekziston mundësia për të përdorur edhe sisteme të thjeshta e të lëvizshme analize, të cilat mund të çohen pranë objekteve që nuk mund të zëvendësohen (si p.sh. piktura murore).

Epërsia kryesore e metodës së analizës, nëpërmjet rrezatimit X të fluoreshencës, është ruajtja tërësore dhe paprekshmëria e plotë e objekteve që analizohet. Kjo merr rëndësi të veçantë kur është fjala për monumentet e artit.

Sistemi ynë i analizës nëpërmjet dispersionit energjitik të rrezatimit X të fluoreshencës është i përbërë nga burimi i rrezatimit ngacmues (si të tillë mund të përmendim: Fe^{55}, Pu^{238}, Am^{241}), dedektori Si (Li) i rrezatimit X, analizatori shumëkanalësh elektronik, shoqërues, si dhe sistemi i përpunimit të të dhënave (fig. 1a, b). Objekti që do të analizohet vendoset mbi mbajtësen e mostrave (fig. 2). Nëpërmjet kalimtarëve të përshtatur për punime në fushë të studimit të veprave të artit, rrezatimi ngacmues përqendrohet në njollën që do të analizohet. Informacioni i marrë nga kjo metodë shfaqet në ekranin e analizatorit shumëkanalësh ose mund të regjistrohet në letër në formën e një spektri karakteristik të rrezatimit X, të lëshuara nga njolla në shqyrtim (fig. 3). Duke u nisur nga epërsitë e sipërpërmendura të metodës së analizës nëpërmjet rrezatimit X të fluoreshencës, sektori i artit, në Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe grupi i spektrometrisë së rrezatimit X në Institutin e Fizikës Bërthamore, gjatë këtij pesëvjeçari të fundit, nëpërmjet një bashkëpunimi të gjerë e të pritshëm, kanë kryer studimin e një sërë veprash arti, me qëllim njohjeje dhe restaurimi. Me ndihmën e kësaj metode kemi studiuar dhe kemi marrë të dhëna të pazëvëndësueshme për përbërjen elementare të pigmenteve të ikonave, të afreskeve, suporteve mbajtëse të tyre, grunteve, intonakos dhe arriçios. Me këtë metodë është studiuar përbërja elementare e pigmenteve në shumë pika të «Portretit të plakut», që mendohet të jetë i Rembrandit.

Qëllimi i këtyre ekzaminimeve ka qenë i shumëfishtë. Së pari, është synuar të merren të dhëna



Fig. 1 a



Fig. 1 b

që mbështetin rrugën e restaurimit të veprave në shqyrtim. Së dyti, janë mbledhur të dhëna për të vënë në dukje masën e zbatimit të teknikës bizantine në vendin tonë. Së treti, në ndonjë rast, me të dhënat e marra në këtë rrugë, është ndihmuar në shtimin e njohurive të përgjithshme për identifikimin e ndonjë vepre arti. Më poshtë, për ilustrim, të punës së kryer, po japim rezultatet e ekzaminimeve të bëra mbi disa objekte me problematikë tipike.

1. Ikona «Ungjillëzimi» është pikturë e shek. XIV, anonime (fig. 4). Ajo ndodhet e ekspozuar në muzeun «Onufri», në kalanë e Beratit. Për t'u bërë e ekspozueshme, ikona, kishte nevojë për një pastrim të lehtë. Paraprakisht u bë analiza elementare e disa pigmenteve, me qëllim që zgjidhja e kimikateve, të cilat do të përdoreshin për pastrimin, të ishte sa më efikase. Nga përbërja e spektrave doli se e kuqja kishte përmbajtje të lartë hekuri dhe zhive, pra i ta-

kon një kompozimi inorganik. Analiza e sfondit verdhë tregoi për përmbajtje shumë të lartë ari. bazë të këtyre të dhënave, u pa me vend përdorim një tretësi të lehtë organik dhe në rastin konkret zgjodh terpentina.

2. Ikonostasi i kishës së Vangjelizmosë në Ber (fig. 5), vepër e piktorit tonë të mirënjohur mesjet Onufri, ndodhet e ekspozuar, gjithashtu, në muze «Onufri», në kalanë e Beratit. Ky objekt iu nënshtr një procedure të plotë restaurimi, duke përfshirë p ceset e pastrimit, të konsolidimit të plotësimit dhe integrimit. E gjithë kjo punë u parapri nga një ek minim i plotë spektral i ngjyrave — bazë, nga i rezultuan të dhënat e mëposhtme:



Fig. 2



Fig. 3

DO NOT COPY



Fig. 4

– Spektri i ngjyrës së kuqe tregon për përmbajtje të konsiderueshme zhive.

– Spektri i sfondit të verdhë paraqet përmbajtje ari dhe hekuri, çka flet për një polikromi të nëntëshme.

– Spektri i ngjyrës së gjelbër rezulton në përmbajtje të lartë të bakrit.

– Këta spektra tregojnë se kemi të bëjmë me pigmente të natyrës inorganike. Në këto kushte, largimi i shtresave të mbivëna, kryesisht vernik i dekompozuar, mund të bëhej me anë të tretësve organikë, që janë inertë kundrejt pigmenteve, por tretin shtresën e vernikut. Në këtë rast u punua me përzierje në raporte të caktuara të dimitil formamidës me amil açetat e terpentinë



Fig. 5

3. Ekzaminimi i pigmenteve të afreskeve është bërë me marrje mostrash nga zona të përshtatshme. Analiza e këtyre mostrave është bërë duke i vendosur në sistem, në disa gota me fund të hollë plastik. Në përgjithësi, përbërja e pigmenteve ka rezultuar me bazë inorganike, çka lejon përdorimin e tretësve organikë dhe tretësirat ujore të kimikateve. Nga shqyrtimit i bërë mund të nxirret ky përfundim përgjithësues:

Të gjitha të kuqet e afreskeve të vrojtuara janë me përmbajtje hekuri dhe jo zhive, siç janë në rastin e ikonave. Kjo tregon se mjeshtrit e tyre e njihnin natyrën e lëndës që përdornin dhe kushtin kategorik të teknikës bizantine, që cinabri i kushtueshëm dhe i paqendrueshëm ndaj lagështisë të përdorej vetëm në ikonografi dhe jo në afresk.

Përfundimisht, themi se metoda e analizës nëpërmjet rrezatimit X të fluoreshencës jep një informacion të pasur orientues për natyrën e pigmentit. Kjo metodë, e kombinuar me metodën e difraksionit të rrezeve X, na jep përbërjen e saktë të pigmenteve inorganike të zbatuara në objekte të ndryshme të artit. Kjo njohje mund të arrihet vetëm nëpërmjet thellimit të një bashkëpunimi të organizuar ndërmjet institucioneve përkatëse, duke ndikuar ndjeshëm në të mirë të studimit dhe restaurimit të veprave të artit.

DO NOT COPY

Servet DANI – Marita BECI

QUELQUES APPLICATIONS DE L'ANALYSE AUX RAYONS X DANS LE DOMAINE DE LA CONSERVATION DES OEUVRES D'ART

RESUME

Les méthodes physiques et chimiques telles la colorimétrie, la chromatographie, la spectrométrie à absorption atomique, la diffraction aux rayons X etc. ont trouvé une application très large à l'étude ainsi qu'à la restauration des oeuvres d'art. Parmi ces analyses, celles effectuées aux rayons X occupent une place importante. Notre système aux rayons X est composé de la source (Fe^{55}, Pn^{238}, Am^{241}), du detecteur Si (Li), de l'analyseur à plusieurs canaux ainsi que l'électronique qui l'accompagne, du système de traitement des données.

En utilisant cette méthode nous avons étudié la composition élémentaire des pigments utilisés aux icônes et aux fresques, des enduits, de l'intonaco de l'arricio. Pour illustrer les travaux réalisés ci-dessous nous donnons les résultats obtenus par les examens effectués sur quelques objets.

L'icône «L'annonciation» est une peinture du XIVe sc. Elle n'avait besoin que d'un nettoyage léger. Au début on effectua l'analyse élémentaire de certains pigments. Vu la composition des spectres il s'est avéré que le rouge avait une hau teneur en fer et en mercure. L'analyse du fond en jaune révé de l'or en teneur importante. Sur la base de ces données no avons trouvé juste l'utilisation d'un solvent léger qui dans not cas était la terpentine.

Les examens des fresques ont été faits par prise d'échanti lons dans des zones appropriées qui furent introduits dans u système de verres à fond mince en matériau plastique. E général il résulta que les pigments avaient une base inorg nique ce qui permit l'utilisation de solvents organiques et a solutions acqueuses pour les pigments.

En conclusion nous pouvons dire que l'analyse par le rayons X donne une assez riche information orientatrice quan à la nature des pigments. Cette méthode combinée avec cell aux rayons X nous renseigne sur la composition des pigment inorganiques appliqués sur de divers objets d'art et nou rend plus facile la protection et la restauration de ceux-c

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Gjergj SARAÇI

Diskutim
MBI DISA TIPARE TË FORTIFIKIMEVE ILIRE TË SHEKUJVE IV – III P.E. SONË

Në këtë diskutim do të ndalemi në evidentimin e disa tipareve të rëndësishme të fortifikimeve të viseve jugore ilire, që filluan të shfaqen aty nga mesi i shek. të IV p.e.s, në përmirësimet që i sollën ato sistemit fortifikues ilir, si edhe në shkaqet historike që diktuan lindjen e tyre. Për ndonjë prej këtyre tipareve është shkruar në «Historinë e arkitekturës shqiptare» dhe në «5000 vjet fortifikime në Shqipëri», por jo të sistemuara sipas kritereve metodike të zbatuara prej nesh në këtë diskutim. Për më tepër ato janë vendosur në një kuadër tjetër historik, në krahasim me trajtimet e mëparshme. Edhe kufijtë kronologjikë gjatë të cilave formohen këto tipare ne i shohim tashmë shumë më ngushtë. Shtjellimin e problemit po e nisim me një vështrim të shpejtë të ndryshimeve që pësuan fortifikimet ilire të kësaj kohe, ndryshime të cilat vihen re në këto drejtime:

Së pari, rritet sipërfaqja e mbrojtur me mure e qyteteve, që siguronte edhe një hapësirë të domosdoshme jetike për të përballuar një rrethim të gjatë. Kjo dukuri vihet re në qytetet e trashëguara nga e kaluara, ku sipërfaqja rritet ndieshëm, p.sh. 10 herë në Zgërdhesh e Buthrot, ashtu edhe në qytetet e reja të ndërtuara në këtë kohë, që kanë tashmë një sipërfaqe të konsiderueshme, si Lisi, Bylisi, etj. **Së dyti,** rifutet në përdorim traseja me shkallëzime të shumëfishta. Kjo lidhet me kërkesat e kohës për të realizuar ritme të larta dhe ekonomike ndërtimi, pa e dëmtuar aftësinë mbrojtëse të fortifikimit, sepse, siç dihet, shkallëzimet e shumëfishta ndërtoheshin më shpejt dhe kushtonin më pak se kullat, duke siguruar në të njëjtën kohë edhe një mbrojtje të mirë anësore të trasesë. Ky element duke filluar nga fundi i shek. IV p.e.s, gjeti një përhapje të gjerë në qytetet ilire, si Lisi, Buthroti, Çuka e Ajtoit etj. Edhe në Greqi, ndryshe nga ç'është thënë, shkallëzimet e shumëfishta nuk janë shfaqur për herë të parë në shek. VIII-VII p.e. sonë, se ato janë përdorur në pjesën jugore të fortifikimit të Tirintit që në 1400 p.e. sonë dhe nuk janë ripërdorur gjerësisht në shek. V p.e.s. sepse sipas studimeve më të fundit, ky ripërdorim vihet re duke filluar nga gjysma e dytë e shek. IV p.e.sonë. **Së treti,** futet në përdorim kulla e rrumbullaktë, që i përgjigjet më mirë kërkesave të vëzhgimit dhe mbrojtjes, sepse krijon ndër të tjera edhe mundësinë e një mbrojtjeje «panoramike», në të cilën zhduken këndet e vdekura të rrezikshme dhe në sajë të rikoshetimit, u rreziston më mirë makinave gurëhedhëse. Por, duhet vënë në dukje se ky tip kulle në fortifikimet ilire, sikurse edhe në ato të disa vendeve të tjera, ku u përdor nga gjysma e dytë e shek. IV p.e.sonë, mbeti i kufizuar. Kështu, në fortifikimin e qytetit të Lisit është përdorur vetëm një kullë e tillë. **Së katërti,** shtohen portat e dorës së dytë, të cilat në kohë paqeje lehtësonin komunikimin me mjedisin e jashtëm, ndërsa në kohë lufte u lejonin të rrethuarve të bënin dalje të befasishme për të goditur kundërshtarin kur ai ndodhej në këndet e vdekura të sistemit fortifikues, për të kundërsulmuar atë, si edhe për të shkatërruar makinat e rrethimit. Kjo dukuri vihet re në një sërë qytetesh ilire, si në Çukën e Ajtoit, Buthrot etj. Në fortifikimet antike të mjaft vendeve të tjera shtimi i numrit të këtyre portave fillon me fushatat e Aleksandrit të Madh. **Së pesti,** vendosen në sistemin fortifikues makina luftarake edhe nga të rrethuarit. Nga shembujt më të mirë në këtë drejtim është bastioni i Persqopit, në të cilin mund të vendoseshin bateri të tëra armësh të tilla. Në disa nga vendet antike vendosja e makinave luftarake në fortifikime, për një mbrojtje më të efektshme, fillon nga viti 336 p.e.sonë. **Së gjashti,** hapen frëngji edhe në katet përdhese të kullave, për të shmangur këndin e vdekur të krijuar

në rrëzën e muraturës vertikale. Frëngji të tilla kanë fortifikimet e Matohasanajt, Buthrotit e Vagalatit. Përgjithësisht kjo dukuri vihet re duke filluar nga fundi i shek. IV p.e.sonë. **Së shtati,** për ndërtimin e mureve është përdorur vetëm teknika e ëmplektonit. Përdorimi i saj lidhet me efektshmërinë dhe ekonominë që ajo siguronte në ndërtimet fortifikuese të kësaj kohe. Ëmplektoni, duke filluar nga mesi i shek. IV p.e.s, është e vetmja teknikë ndërtimi edhe për fortifikimet bashkëkohore të mjaft vendeve të tjera. **Së fundi,** në faqen e jashtme të blloqeve lihen sistematikisht fryrje, jo aq për ekonomizim në gdhendjen e gurit, sesa për shtimin e inercisë së muraturës. Këto fryrje i shtonin asaj një masë jo të papërfillshme, sipërfaqja e parregullt e së cilës zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme goditjet dhe mbronte bashkimet e blloqeve. Edhe kur thithte ndonjë goditje, fryrja thyhej pa prekur masën e gurit. Shembujt më të bukur në këtë drejtim i ofrojnë blloqet e mureve të Lisit dhe të Beratit. Në fortifikimet greke fryerje të tilla shohim të lihen sistematikisht nga shek. IV p.e.sonë, e sidomos nga periudha e fushatave të Aleksandrit të Madh.

Periudha historike gjatë së cilës lindën në arkitekturën ushtarake ilire ndryshimet e mësipërme flet për lidhje të rëndësishme të ndërsjella iliro-maqedonase. Në qoftë se gjatë gjysmës së parë të shek. IV p.e.sonë ilirët ndërhynin deri edhe në problemet e fronit të Maqedonisë, nga viti 358 p.e.sonë raporti i forcave ndryshoi në dobi të palës maqedonase. Në këtë situatë historike, të ngopur me luftra të vazhdueshme, ku marrëdhëniet me Maqedoninë përbëjnë pa dyshim lidhjet e jashtme më të rëndësishme, shteti ilir na paraqitet si një pengesë serioze për shtrir maqedonase drejt perëndimit, pengesë kjo që nul kalua as në momentet e lulëzimit më të madh të hës së mbretërimit të Filipit II dhe të Aleksandrit Madh.

Të lidhura ngushtë me këto ngjarje histori ndryshimet në sistemin fortifikues dëshmojnë për ngritje cilësore të aftësisë mbrojtëse të arkitektu ushtarake të viseve jugore ilire dhe për përpjekje bëra për të ndërtuar fortifikime që përballonin rret me të gjata. Ato i përgjigjen ndryshimit të strategj së kohës, e cila, lidhur me ndërtimin e fortifikime kushtëzohej nga përdorimi masiv, prej maqedonas të makinave të fuqishme e të perfeksionuara të r thimit, gjë që vihet re dhe në qytetet helene të kë periudhe.

Si përfundim, mund të theksojmë se në sister fortifikues të viseve jugore ilire të shek. IV – III p sonë ndodhën ndryshime të rëndësishme që çuan lindjen e disa tipareve të reja të fortifikimeve të kë periudhe. Ato synonin të ngrinin më lart nivelin e l tyre fortifikimeve dhe ta unifikonin atë me më të p paruarin e kohës. Në lindjen e këtyre tipareve të r ka luajtur rol edhe fqinjësia me Maqedoninë, e c përbën, për mendimin tonë, faktorin e jashtëm nxi më të rëndësishëm. Megjithatë ai mbetet i dorës dytë, sepse diktoi kryesisht nëpërmjet faktorit të brer shëm, i cili krijoi mundësinë për t'u përgjigjur k kesave që shtronte koha për fortifikimet në sajë zhvillimit që kishte arritur shoqëria ilire e kësaj p riudhe.

DOKICOPY

Gjergj SARAÇI

DO NOT COPY

SUR QUELQUES TRAITS DES FORTIFICATIONS ILLYRIENNES DES IV-IIIe SC. AV.N.E.

RESUME

Par cette discussion nous visons mettre en évidence quelques traits principaux des fortifications méridionales illyriennes qui virent le jour vers le milieu du IVe sc. av.n.è.; les améliorations qu'on apporta au système fortifié illyrien ainsi que les causes qui dictèrent leur apparition, puisque, comme on le sait déjà, les décrochements multiples étaient plus faciles et moins coûteux à bâtir que les tours, assurant en même temps une meilleure défense latérale de la tranchée. Même en Grèce, différemment à ce que l'on prétend, les décrochements multiples n'apparurent pas pour la première fois aux VIIIe-VIIe sc. av.n.è., ils furent utilisés dans la partie méridionale de la fortification de Tirynthe, depuis 1400 av.n.è., et ne furent pas largement utilisés au Ve sc. av.n.è. D'après les plus récentes recherches, cette réutilisation apparaît depuis la deuxième moitié du IVe sc. av.n.è., parce que, entre autres, il assure une défense «panoramique», en éliminant les angles morts dangereux et par ricochet résiste mieux aux machines de guerre, à l'attaque de l'ennemi quand il se trouve aux angles morts du système fortifié, au contre-attaque et à la destruction des machines de siège. Ce phénomène apparait dans beaucoup de villes illyriennes auxquelles on pouvait disposer des batteries d'armes pareilles. Dans quelques pays antiques, l'aménagement des machines de guerre aux fortifications, pour assurer une défense plus efficace, commence depuis l'année 336 av.n.è. C'est un procédé efficace et économique pour les constructions des fortifications de cette époque. L'emplecton depuis le milieu du IVe sc. av.n.è. demeure l'unique appareil, même pour les fortifications de cette époque.

Comme conclusion, nous pouvons souligner que le système de fortification des contrées méridionales illyriennes des IVe-IIIe sc. av.n.è., subit d'importantes transformations qui amenèrent à la naissance de quelques nouveaux types de fortification de cette époque. Elles visaient à élever le niveau de ces fortifications et à les unifier avec celle qui était la plus avancée à l'époque.

Dans la création de ces traits, le voisinage avec la Macédoine a joué un rôle, qui, à notre avis, constitue le plus important facteur stimulant extérieur. De toute façon, il est de seconde importance parce qu'il influença essentiellement par l'intermédiaire du facteur intérieur qui créa la possibilité de l'adapter aux exigences de l'époque pour les fortifications grâce au développement acquis de la société illyrienne de l'époque.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Sokol AGOLLI

Diskutim

ROLI DHE INTERESIMI I SHTETIT NË MBROJTJE TË MONUMENTEVE TË KULTURËS NËPËRMJET NORMAVE LIGJORE

Si akti i parë juridik që i shërben problemit të mbrojtjes së monumenteve, ishte Dekret Ligja Nr. 586 Dt. 17.3.1948 «Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve natyrore të rralla». Mbi bazën e këtij akti çështja e parë që sanksionohej ishte se «të gjitha pasuritë të luejtshme dhe të paluejtshme kulturore dhe historike, artistike dhe etnografike, si dhe sendet natyrore të rralla me karakter botanik, gjeologjik, paleontologjik, petrografik ose me bukuri të veçantë vihen në mbrojtje të shtetit, pa marrë parasysh se kush i ka në pronësi ose në posedim. Me këtë rregullim juridik shteti ynë i kthente monumentet e kulturës nga pasuri në duart e personave të veçantë fizikë e juridikë në pronësi të përbashkët të popullit, aspekt ky vendimtar, thelbësor dhe i një rëndësie të posaçme, që i hapi rrugën çështjes për zgjidhjen e problemit të madh, të mbrojtjes së monumenteve të kulturës, administrimit të drejtë dhe me kritere shkencore të tyre, si dhe punës së gjerë, komplekse e të shumanëshme të mirëmbajtjes dhe restaurimit.

Pa u futur në procesin e zhvillimit që ka patur ky legjislacion, të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në periudha të ndryshme, akti i fundit normativ që paraqet rregullimin më të plotë të kësaj fushe është Dekreti Nr. 4874 Dt. 23.9.1971 «Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe historike».

Në hartimin e këtij akti legjislativ dhe ndryshimeve të mëvonshme, kanë shërbyer orientimet dhe direktivat e Partisë dhe mësimet e shokut Enver dhe posaçërisht, vendimi i Komitetit Qendror të Partisë të dt. 7 Korrik 1959 «Mbi traditat patriotike revolucionare të popullit tonë dhe masat për mbrojtjen e zhvillimin e mëtejshëm të tyre». Në këtë vendim theksohet se: «Në veprat monumentale të arkitekturës, të arteve dhe të kulturës të shumë brezave duket gjenia krijuese e masave punonjëse të vendit tonë, forca shpirtërore dhe gjallëria e tyre e pamposhtur, mishërohen tiparet e veçanta kombëtare të popullit tonë, rruga e tij drejt zhvillimit dhe përparimit, kontributi i popullit tonë për pasurimin e thesarit të kulturës botërore». Si në çdo fushë tjetër, ashtu dhe për zbatimin e këtyre orientimeve, si nga organet e pushtetit shtetëror, ashtu dhe nga institucionet e ngarkuara posaçërisht me ruajtjen e monumenteve dhe shtetasit ka një kuptim dhe vlerësim të drejtë të rolit që luan dhe vendit që zë legjislacioni në mbrojtjen e vlerave kulturore e historike. Puna e madhe edukative që është bërë në këtë drejtim ka lejuar që sot të tregohet një kujdes dhe interesim më i mirë ndaj krijimtarisë shekullore kulturore e historike të popullit. Megjithëkëtë i shikuar problemi në dinamikë, në kërkesat që shtrohen për zgjidhje, duhet theksuar se është e nevojshme të gjallërojmë më shumë punën me njerëzit, rritjen e interesit të tyre për njohjen e historisë sonë dhe të monumenteve të saj.

Praktika tregon se edhe pse të shkëputura, ka raste që monumentet, si pasojë e mospërcaktimit të saktë të tyre, të mos studimit kompleks ose të kujdesit të pamjaftueshëm dhe nënvleftësues, si dhe të mungesës së mirëmbajtjes dhe të ndryshimeve për interesa vetiake që bëhen, të pësojnë dëmtime. Ky është një problem serioz që duhet të na prekupojë seriozisht. në mënyrë që t'u dalin gjërave përpara, të

parandalojmë ardhjen e pasojave të mundëshme negative e shpesh të pakorrigjueshme. Mbrojtja e monumenteve është mbi të gjitha një problem që i takon ngritjes së vazhdueshme të kulturës së njerëzve dhe të zbatimit me korrektësi nga organet dhe institucionet të pengesave që vë ligja për mbrojtjen e monumenteve. Rrugët, mjetet dhe metodat e punës që duhet ndjekur dhe që janë në funksion të këtij qëllimi janë të ndryshme. Një prej tyre është dhe puna për njohjen e popullarizimin e masave punonjëse me legjislacionin, e edukimit të njerëzve me normat p katëse të së drejtës për problemet që rregullo sanksionon, që lejon e ndalon, si dhe për masat duhen marrë e zbatuar ndaj veprimeve të paligjsh Puna e gjerë komplekse dhe sistematike nga të gji institucionet e organet e pushtetit në qendër në bazë e realizuar në këtë drejtim do ti shërbe pa dyshim mbrojtjes së vlerave e administrimit të mirë të monumenteve të kulturës, kësaj pasurie madhe e të pazëvendësueshme të kombit tonë.

DO NOT COPY

Sokol AGOLLI

DO NOT COPY

LE ROLE ET L'INTERET QUE L'ETAT PORTE A LA PROTECTION DES MONUMENTS CULTURELS PAR DES NORMES LOYALES

RESUME

Les problèmes traités au cours de ce symposium furent mutiples, appartenant à de différentes branches des sciences sociales. En totalité, chacun d'eux concerne de différents aspects de caractère général et particulier, des problèmes complexes quant à l'étude, à la protection et à la restauration des monuments culturels. Sans m'imposer le devoir de m'arrêter aux questions déjà traitées, je pense que dans ce domaine, une contribution particulière revient au rôle de la législation, des normes respectives du droit, comme régulateur des critères établis par notre Etat socialiste quant à la juste compréhension scientifique de l'importance, de la protection, de la restauration et de l'administration des monuments culturels.

Sous l'aspect historique, il faut souligner que dès l'instauration du pouvoir populaire, le Parti et l'Etat, ayant en vue l'importance historique, politique, culturelle et scientifique des monuments culturels ainsi que leur grand rôle à l'éducation esthétique des gens, sanctionna en voie législative nombre de différents actes juridiques, lesquels répondent aux nouvelles exigences de l'époque et au stade de l'évolution de la société. Ils vînrent toujours en s'améliorant et se complétant par de nouvelles normes afin d'affronter des problèmes plus complexes et plus profonds.

Notamment par une telle mise en valeur du problème, la législation sur la protection des monuments fut soumise à une élaboration et une amélioration continuelle, définissant des critères de plus en plus justes quant à la compréhension des monuments et de leurs valeurs culturelles et historiques, des critères à suivre à l'étude, la restauration et la protection. On attacha de l'importance au travail des organes d'état respectifs chargés à leur protection ainsi qu'aux termes juridiques qu'il faut appliquer en cas d'altération des valeurs scientifiques des monuments culturels.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Diskutim

Vera BUSHATI

DISA TENDENCA TË ARKITEKTURËS SHQIPTARE GJATË PERIUDHËS 1912-1944

Duke i hedhur një vështrim objekteve arkitektonike të periudhës 1912-1944 vërejmë se ato janë komplekse e me prirje të ndryshme. Krahas arkitekturës popullore që vazhdonte sipas një tradite tashmë të kultivuar u zhvillua një arkitekturë e përpunuar nga mjeshtër, arkitektë e inxhinierë të shkolluar.

Me gjithë se kjo periudhë karakterizohet nga një zhvillim historiko-shoqëror i paqëndrueshëm në etapa të caktuara sidomos në atë midis 2 Luftrave të Mëdha Botërore vërehet se ndërtimet arkitektonike marrin një zhvillim të ngadalshëm.

Duke qenë se borgjezia e re, që sapo mëkëmbej, ishte akoma një klasë e pafuqishme si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë politik, ndërtimet e kryera gjatë kësaj periudhe ishin të pakta e një pjesë e mirë e tyre me tendenca eklektike.

Tradita ndërtimore e arkitektonike e borgjezisë shqiptare mungonte, prandaj si modele filluan të kopjohen format e ndërtuara jashtë vendit. Këto kthime të vështrimit nga e huaja bëhen me qëllim që të shënohen shfaqje të sigurisë, të pasurisë, të pushtetit dhe të ngritjes shoqërore e kulturore të borgjezisë kohës. Elita e borgjezisë shqiptare kishte mendim se ishte më mirë të kopjojë të tjerët se të krijojë vet nga e para.

Përshtatja e eklektizmit, si më e përshtatshmja rrymë, që kënaqte të gjitha ekzigjencat e borgjezisë së kohës, në fakt, ishte një tendencë jo progresive në raport me zhvillimin e arkitekturës bashkëkohore.

Korenti eklektik gjeti shprehjen e vet si në arkitekturën private, ashtu dhe në atë zyrtare të Shqipërisë në vitet 1912-1944.

Për të analizuar veprat e projektuara e të ndërtuara me këtë frymë në arkitekturën e viteve 1912-1944 është vështirë të gruposh sepse ato paraqiten si bashkime mekanike të përmbajtjes e të formës arkitektonike dhe madje nuk ka një platformë teorike ideore për t'i vlerësuar. Karakteristikë e përgjithshme është repertori i gjerë i mjeteve shprehës konservatore, tashmë të ezauruara në arkitekturën bashkëkohore. Objekte si: Komiteti Ekzekutiv Shkodër, Komiteti Ekzekutiv Vlorë (fig. 1), Banka e Durrësit (fig. 2), etj., të konceptuara me një frymë të theksuar eklektike tregojnë dëshirën për t'iu imponuar masave me anën e këtyre ndërtimeve administrative. Të gjitha elementet e përdorura në plan vëllim detaje nuk kanë gjë të përbashkët me traditën. Synimi është që të bukurën ato ta gjejnë tek monumentalja, tek format, detajet eklektike. Këto trajta vinë e mblidhen pa princip si një amalgam, duke mos krijuar dot një fizionomi tonën. Po kështu dhe në objektet me karakter shoqëror si: Kinema Mazhestik (Korçë), Kafja e Madhe



Fig. 1



Fig. 2

(Shkodër), Teatri i Kukllave (Tiranë), Lidhja e Shkrimtarëve (Tiranë). Gjuha shprehëse e tyre përmblidhet brenda kufijve të eklektizmit.

Këto karakteristika përmblidhen dhe në banesat individuale të borgjezisë së re. Vëllimet, zgjidh planimetrike, përmasat simetrike, akset e hyrjeve, k pjo ndaj rrugës janë ato karakteristika që tregojnë tendencat e porositësve për luks, ashtu dhe hyj zimin e artit eklektik (fig. 3).

Të gjitha ndërtimet janë të pasura me dekor. këtë dekor borgjezia e kohës gjente vlerat e orig nalitetin e saj. Me pasurinë e ornamentikës që gje det në të gjithë tipologjinë e ndërtimeve, borgjezia re tenton t'i paraqesi spektatorit hapet, në ekster dhe çka synon të arrijë.

Le të shohim si shembull bibliotekën e Korç Me gjithë ndikimin e banesës korçare në koncep min e bibliotekës si p.sh. në zgjidhjen e qartë pl nimetrike dhe vëllimin e saj kompakt, vëmendja kry sore i kushtohet hyrjes që zgjidhet me një por prej 2 kolonash të orderit jonik të cilat të krijoj përshtypjen sikur mbajnë strukturën e sipërme me in time të antablementit frizës dhe kornizës, zgjidhja fasadës së saj duket sikur kërkon të evokojë ter pujt e antikitetit.

Por krahas përkrahjes së eklektizmit, si një ri më zyrtare akademike, nuk mund të lihen mënja një sërë shfaqjesh të tendencave të ndryshme si ne goticizëm, neoklasiçizëm etj. Ndërtesat e Bankës Shkodër e projektuar nga Kolë Idromeno, ish Kom teti i Partisë në Vlorë, Turizmi i vjetër Vlorë, e janë objekte me karakteristika rudimentale të neog tikut. Zgjedhja e këtij stili i përshtatet shijes e kë kesës së borgjezisë për të gjetur mbështetjen t historikja duke rënë në intime e forma të kopjuar

Ndërtimet neoklasike patën një shtrije të gje në qytetet Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë. Duke qen



Fig. 3



Fig. 4

DO NOT COPY

se kjo rrymë është zotëruese në metropole e veçanërisht në Italinë Fashiste, mjaft shfaqje të saj u dukën dhe në arkitekturën e Shqipërisë, sidomos pas pushtimit italian. Neoklasicizmi që shfaqet në objektet si: Universiteti, Instituti i Lartë i Arteve, Bashkia në Durrës, (fig. 4). etj. është si reminishencë e artit të vjetër klasik përsa i përket vëllimeve e formave, por këto ishin të zhveshura nga dekori barok, përdorur në ndërtimet e mëparshme dhe paraqiteshin me thjeshtësi skajore. Karakteristike e këtij stili është se gjeti zbatim vetëm në ndërtimet zyrtare, të cilat u projektuan dhe u ndërtuan prej arkitektëve e inxhinjerëve të huaj.

Nga ethja funksionaliste e kohës nuk shpëtoi dhe arkitektura e vendit tonë. Aspekte të ndryshme të objekteve na lejojnë të provojmë se rryma funksionaliste u zhvillua si një rrymë divergjente e arkitekturës shqiptare të viteve 1912-1944. Kjo rrymë kaq e përhapur me moton e saj «forma ndjek funksionin» gjen materializim në objektet si: Ambasada franceze, ndërtesa pranë merkatos së Tiranës së Re, Spitali i Korçës, Shkodër etj. Gjuha e re shprehëse e funksionalizmit gjeti terren të gjerë aplikimi veçanërisht nga futja në përdorim e betonit dhe hekurit. Konceptime arkitekturale të kohës janë realizuar të diktuara prej materialeve të ndërtimit. Ndërtimet me beton krahas përparësive me soliditet e shpejtim afatesh sollën dhe një farë brutalizmi e skematizmi. Por lodhja e shkaktuar tashmë nga eklektizmi e neoklasicizmi çoi në parapëlqimin e formave funksionaliste.

Ndonëse gjatë rrugës e përpjekjeve, arkitektura shqiptare nga viti 1912-1944 pati luhatje e kthime ndaj metodave e mënyrave arkitektonike të huaja, tashmë mjaft të kultivuara, në tërësinë e saj ajo ruajti lidhjen me ndërtimet e mëparshme. Tradita ndërtimore e së kaluarës e sidomos në drejtim të banesës qytetare luajti një rol të dorës së parë në përcaktimin e fizionomisë arkitektonike të kësaj kohe.

Kjo arkitekturë u bë një pasqyrim i ndërgjegjshëm i ndryshimeve ekonomiko shoqërore. Ndonëse në mënyrë krejt sporadike mund të themi se u ruajt një raport i drejtë midis traditës dhe të resë që po hynte. E reja në arkitekturë u bë më e dallueshme në rritjen e kërkesave për teknikat e reja ndërtimore, përdorimi i gërshetuar midis materialit rrethanor tradicional e atij modern. Një tendencë që gjithashtu dhe përputhja e zgjidhjeve planimetrike funksionale me një konstruksion sa më racional. Gjatë kësaj periudhe u formuan një sërë elementesh të reja arkitektonike në interier e në eksterier të objektit, gjithashtu, shtimi i gamës tipologjike të ndërtimeve që një ndër sukseset e arkitekturës së kohës.

DO NOT COPY

Vera BUSHATI

DO NOT COPY

QUELQUES TENDENCES DE L'ARCHITECTURE ALBANAISE AU COURS DES ANNEES 1912-1944

RESUME

Si l'on jette un coup d'oeil aux objets architectoniques de la période 1912-1944, on remarque qu'ils sont assez complexes.

Cette période se caractérise d'un développement historique social instable, par conséquent, les constructions architectoniques connaissent une lente évolution. L'élite de la bourgeoisie pensait qu'il valait mieux copier que créer.

L'apparition de l'éclectisme fut une tendence régressive par rapport au développement de l'architecture contemporaine. L'analyse et le groupement des oeuvres est difficile, elles se présentent comme des unions mécaniques du contenu et de la forme architectonique. Parmi de nombreux exemples on peut citer le Comité exécutif de Shkodra, le café Parku à Shkodra, le Comité exécutif de Vlora, la bibliothèque de Korça etc.

De pair à l'éclectisme, on ne peut pas laisser à l'écart la tendence négative qui répond au goût de la bourgeoisie et trouve appui aux faits historiques en imitant et en copia comme c'est le cas de la Banque de Shkodra, l'ex-comité c Parti de Vlora.

Les constructions néo-classiques apparurent en architectu pendant l'occupation fasciste italienne. Ce style qui fut a pliqué à l'architecture officielle et élaboré essentielleme par des architectes étrangers se repandit dans beaucoup c villes albanaises telles Tirana, Durrës, Vlora, Korça etc.

Même chez nous, le courant fonctionnaliste de l'époqu se matérialise en nombreux objets tels: l'hôpital de Korç l'ambasade française, etc. Il s'appliqua largement surtout apr l'introduction du béton et du fer.

Malgré les variations et les retours vers les modes arch tectoniques bien cultivées, l'architecture albanaise des anné 1912-1944, en sa totalité garda une liaison avec les constructio précédentes.

DO NOT COPY

Çmimi 10 lekë